



## **RAPORT AUDITIMI TEMATIK**

# **“MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E EVADUAR NGA DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS NË GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2024”,**

**për auditimet si më poshtë:**

1. Auditim performance me temë: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”.
2. Auditim performance me temë: “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore” (Fondi i Ekselencës) nga Ministria e Arsimit dhe Sportit”.
3. Auditim performance me temë: “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”.
4. “Auditim përputhshmërie dhe rregullshmërie” në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë.

# PËRMBAJTJA

<b>1.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>3</b>
<b>2.1</b>	<b>AUDITIMI PERFORMANCE ME TEMË, “BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE, PËRMES PËRFSHIRJES NË TREGUN E PUNËS” .....</b>	<b>7</b>
<b>2.2</b>	<b>AUDITIMI PERFORMANCE ME TEMË, “MBËSHTETJA FINANCIARE E STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE (FONDI I EKSELENCËS) NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT” .....</b>	<b>45</b>
<b>2.3</b>	<b>AUDITIMI PERFORMANCE ME TEMË, “RESPEKTIMI I STANDARDEVE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE, SFIDË E QËNDRUESHME, NË ZVOGËLIMIN E NDOTJES SË MJEDISIT DHE MBROJTJEN E SHËNDETIT TË POPULLSISË” .....</b>	<b>80</b>
<b>2.4</b>	<b>AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE DHE RREGULLSHMËRIE NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT, FIER, VLORË DHE GJIROKASTËR .....</b>	<b>100</b>
<b>3.</b>	<b>ANEKSE .....</b>	<b>161</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 684 prot, datë 17.06.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) zhvilloi auditimin tematik, “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar nga Departamenti i Auditimit të Performancës në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024”. Auditimi është kryer mbështetur në Manualin “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe regjistrin institucional”, miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së, Auditimi u zhvillua në 19 subjektet si më poshtë vijon:

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit;
2. Agjencia Kombëtare e Punësimit;
3. Bashkia Shkodër;
4. Bashkia Kukës;
5. Bashkia Lezhë;
6. Bashkia Dibër;
7. Bashkia Krujë;
8. Bashkia Elbasan;
9. Bashkia Kavajë;
10. Bashkia Divjakë;
11. Bashkia Lushnjë;
12. Bashkia Berat;
13. Bashkia Pogradec;
14. Bashkia Vlorë;
15. Bashkia Gjirokastrë;
16. Bashkia Durrës;
17. Bashkia Korçë;
18. Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë;
19. Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

### **Auditimi u krye nga:**

***Për Raportin përmbledhës*** mbi zbatimin e rekomandimeve u angazhuan:  
K.Xh. dhe M.M.

***Për Raportet e veçanta*** mbi zbatimin e rekomandimeve u angazhuan audituesit si më poshtë:

- 1- Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin e performancës me temë, “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”;
  - E. K, përgjegjëse grupi;
  - A.Ç, anëtare;
  
- 2- Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin e performancës me temë, “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës) nga Ministria e Arsimit dhe Sportit”;
  - A.S, përgjegjës grupi;
  - M.L, anëtare;

**3-** Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin e performancës me temë, “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme, në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”;

- A.G, përgjegjës grupi;
- A.H, anëtare;
- R.L, anëtar;

**4-** Për zbatimin e rekomandimeve në auditimin, “Mbi përputhshmërisë dhe rregullshmërinë në Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë” dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;

- Q.C, përgjegjës grupi;
- Sh.H, anëtare.

**Auditimi ka filluar më,** datë 20.06.2025.

**Auditimi ka përfunduar më,** datë 18.07.2025.

**Periudha e auditimit:** për auditimet e Departamentit të Auditimit të Performancës të evaduara në periudhën **01.01.2024-30.06.2024.**

Subjektet e audituara sipas temave përkatëse paraqiten si më poshtë:

<b>Auditimet:</b>	<b>Subjektet e audituara:</b>
1. Për auditimin e performancës me temë, “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”;	-Bashkia Shkodër; -Bashkia Kukës; -Bashkia Lezhë; -Bashkia Dibër; -Bashkia Krujë; -Bashkia Elbasan; -Bashkia Kavajë; -Bashkia Divjakë; -Bashkia Lushnjë; -Bashkia Berat; -Bashkia Pogradec; -Bashkia Vlorë; -Bashkia Gjirokastrë; -Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
2. Për auditimin e performancës me temë, Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës) nga Ministria e Arsimit dhe Sportit”;	-Ministria e Arsimit dhe Sportit;
3. Për auditimin e performancës me temë, “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme, në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”;	-Bashkia Durrës; -Bashkia Shkodër ; -Bashkia Vlorë; -Bashkia Korçë;
4. Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë.	-Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë; -Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Nga auditimi rezultoi se, nga ana e këtyre institucioneve janë marrë masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupet e auditimit të KLSH efektet e të cilave trajtohen më poshtë.

Nga auditimi tematik “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, standardet e INTOSAI-t, Manualët e Auditimit të KLSH, për periudhën 01.01.2024 deri më 30.06.2024, rezultoi se **niveli i pranimit të rekomandimeve** nga auditimi i ushtruar për zbatimin e rekomandimeve, paraqitet sipas tabelës vijon:

***Tabela mbi nivelin e pranimit të rekomandimeve sipas llojit:***

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar Në numër
1	Organizative	60	60	-
2	Shpërblim dëmi	2	2	-
3	Masa disiplinore	53	53	-
	<b>Total</b>	<b>115</b>	<b>115</b>	-

Në **19** subjekte të audituara, nga KLSH, janë rekomanduar gjithsej **115** masa të cilat janë pranuar në masën 100%.

Sipas llojit ato paraqiten:

- Masa organizative, janë rekomanduar **60** masa të cilat janë pranuar në masën **100%**.
- Masa Shpërblim dëmi, janë rekomanduar **2** masa të cilat janë pranuar në masën **100%**.
- Masa disiplinore janë rekomanduar **53** masa të cilat janë pranuar në masën **100%**.

Në numër dhe në % statusi i zbatimit të masave “Organizative”, “Shpërblim dëmi”, dhe “Disiplinore”, paraqitet sipas tabelës vijon:

***Tabelat mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve në total:***

Nr.	Statusi i masave “Organizative”	Në numër	Në %
1	Totali	115	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	115	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	36	31.3%
2	Zbatuar pjesërisht	21	18.3%
3	Në proces	35	30.4%
4	Pa zbatuar	23	20%

Nga **115** masa të pranuar gjithsej, janë zbatuar **36** masa ose **31.3%**, zbatuar pjesërisht **21** masa ose **18.3%**, në proces zbatimi **35** masa ose **30.4%** dhe pazbatuar **23** masa ose **20%** e tyre.

*Tabelat mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve sipas llojit:*

Nr.	Statusi i masave “Organizative”	Në numër	Në %
1	Totali	60	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	60	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	14	23.3%
2	Zbatuar pjesërisht	21	35%
3	Në proces	15	25%
4	Pa zbatuar	10	16.7%

Nr.	Statusi i masave “Shpërblim dëmi”	Në numër	Në %
1	Totali	2	100%
2	Pa pranuar	0	0
3	Pranuar	2	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar		
2	Zbatuar pjesërisht		
3	Në proces	2	100%
4	Pa zbatuar		

Nr.	Statusi i masave “Disiplinore”	Në numër	Në %
1	Totali	53	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	53	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar	22	41.5%
2	Zbatuar pjesërisht		
3	Në proces	18	34%
4	Pa zbatuar	13	24.5%

Analizuar sipas llojit të masave të rekomanduara rezulton se:

- Janë rekomanduar gjithsej **60 masa organizative**, të pranuar nga subjektet e audituara. Nga këto, janë zbatuar plotësisht **14 masa ose 23.3%**, janë zbatuar pjesërisht **21 masa ose 35%**, janë në proces zbatimi **15 masa ose 25%**, dhe janë të pazbatuara **10 masa ose 16.7%** e tyre.
- Janë rekomanduar gjithsej **2 masa për shpërblim dëmi**, të pranuar nga subjektet e audituara. Nga këto, janë në proces zbatimi **2 masa ose 100%** e tyre.
- Janë rekomanduar gjithsej **53 masa disiplinore** të pranuar nga subjektet e audituara. Nga këto, janë zbatuar plotësisht **22 masa ose 41.5%**, janë në proces zbatimi **18 masa ose 34%**, dhe janë të pazbatuara **13 masa ose 24.5%** e tyre.

***Në përfundim, grupi i auditimit konkludoi se veprimtaria e 19 subjekteve të audituara, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve, nuk ka qenë plotësisht efektive.***

## **2.1 PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE, PËRMES PËRFSHIRJES NË TREGUN E PUNËS”**

### **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

#### **1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, në zbatim të Programit të Auditimit me Nr. 684 prot., datë 17.06.2025 me objekt “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e performances me temë: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024”, ushtroi auditim tematik në 14 (katërmëdhjetë) subjektet pjesë e Auditimit të Përformancës me temë: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, përkatësisht në: në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Bashkitë Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnje, Berat, Pogradec, Vlorë dhe Gjirokastër. Auditimi i kryer në vitin 2023, kishte si periudhë auditimi nga data 01.01.2019 deri më datën 30.09.2023 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me **Vendimin nr. 27 datë 08.02.2024 të Kryetarit të KLSH-së** si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 262/34/35/36/37/38/39/40/41/42/43/44/45/46/47 prot., datë 12.02.2024. Auditimi u krye nga data 20.06.2025 deri më datë 18.07.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet e audituara u mbajtën Akt-Verifikimet përkatëse të cilat janë regjistruar përkatësisht:

- Në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Akt-Verifikimi nr. 14, datë 18.07.2025;
- Në Bashkinë Lezhë, Akt-Verifikimi nr. 7, datë 15.07.2025;
- Në Bashkinë Shkodër, Akt-Verifikimi nr. 6, datë 15.07.2025;
- Në Bashkinë Pogradec Akt-Verifikimi nr. 9, datë 17.07.2025;
- Në Bashkinë Vlorë, Akt-Verifikimi nr. 12, datë 17.07.2025;
- Në Bashkinë Divjakë, Akt-Verifikimi nr. 3, datë 03.07.2025;
- Në Bashkinë Elbasan, Akt-Verifikimi nr. 8, datë 16.07.2025;
- Në Bashkinë Lushnje, Akt-Verifikimi nr. 10, datë 17.07.2025;
- Në Bashkinë Berat, Akt-Verifikimi nr. 2, datë 03.07.2025;
- Në Bashkinë Kavajë , Akt-Verifikimi nr. 11, datë 18.07.2025;
- Në Bashkinë Kukës Akt-Verifikimi nr. 5, datë 14.07.2025;
- Në Bashkinë Dibër Akt-Verifikimi nr. 4, datë 14.07.2025;
- Në Bashkinë Krujë Akt-Verifikimi nr. 13, datë 17.07.2025;
- Në Bashkinë Gjirokastër Akt-Verifikimi nr. 1, datë 02.07.2025.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja “j” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Nga auditimi u konstatua se:

*Kanë miratuar nga titullari Programin e Punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kjo në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja “j”, subjektet si më poshtë:*

- Bashkia Berat, nëpërmjet shkresës nr. 3/2, datë 04.03.2024;
- Bashkia Lushnje, nëpërmjet shkresës nr. 1445/2, datë 04.03.2024;
- Bashkia Elbasan, nëpërmjet shkresës nr. 54/6, datë 04.03.2024;
- Bashkia Lezhë, nëpërmjet shkresës nr. 15898/4, datë 08.03.2024.

*Nuk kanë miratuar nga titullari Programin e Punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kjo në mos përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenit 15, shkronja “j”, subjektet si më poshtë:*

- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- Bashkia Shkodër;
- Bashkia Kukës;
- Bashkia Dibër;
- Bashkia Krujë;
- Bashkia Kavajë;
- Bashkia Divjakë;
- Bashkia Pogradec;
- Bashkia Vlorë;
- Bashkia Gjirokastrë.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

*Nuk kanë dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve subjektet si më poshtë:*

- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- Bashkia Shkodër;
- Bashkia Kukës;
- Bashkia Dibër;
- Bashkia Krujë;
- Bashkia Kavajë;
- Bashkia Divjakë;
- Bashkia Pogradec;
- Bashkia Vlorë;
- Bashkia Gjirokastrë;
- Bashkia Berat;
- Bashkia Lushnje;
- Bashkia Elbasan;
- Bashkia Lezhë.

#### 4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 262/34/35/36/37/38/39/40/41/42/43/44/45/46/47, prot., datë 12.02.2024, janë rekomanduar gjithsej 11 masa:

Masa organizative, 11 rekomandime.

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella në KLSH mbi planin e masave si dhe shpjegimet e paraqitura për secilin rekomandim në fazën e verifikimit të tyre, rezultojnë se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore	-	-	-
2	Organizative	11	11	0

## II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të evaduara në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2024, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 23.06.2020.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 262/14 Prot., datë 16.10.2023. Rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm me temë “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës” me konkluzionet përkatëse janë miratuar me **Vendimin nr. 27 datë 08.02.2024 të Kryetarit të KLSH-së** dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresat nr. 262/34/35/36/37/38/39/40/41/42/43/44/45/46/47, prot., datë 12.02.2024.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së, me përbërje:

1. E.Ka, përgjegjëse grupi;
2. A.H, anëtare.

Auditimi ka filluar më, 20.06.2025

Auditimi ka përfunduar më, 18.07.2025

### II.1. Objekti i auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Bashkitë Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnje, Berat, Pogradec, Vlorë dhe Gjirokastrë, me shkresat nr. 262/34/35/36/37/38/39/40/41/42/43/44/45/46/47, prot., datë 12.02.2024.

### II.2. Qëllimi i auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të

vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

### II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Bashkitë Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnje, Berat, Pogradec, Vlorë dhe Gjirokastrë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat e sipërcituara, rezulton se nga 11 (njëmbëdhjetë) masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar 11 masat nga subjektet e audituara.

Nga masa e pranuar:

është zbatuar 1 rekomandim ose 9% e tyre,  
janë zbatuar pjesërisht 6 rekomandime ose 55% e tyre,  
gjenden pa zbatuar 4 rekomandime ose 36% e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Ndryshime apo përmirësime ligjore	-	-		-	
2	Masa organizative	11	1	6		4
	<b>Gjithsej</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>6</b>		<b>4</b>

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave Organizative	Në numër	Në %
1	Totali	11	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	11	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar Plotësisht	1	9%
2	Zbatuar pjesërisht	6	55%
3	Në proces zbatimi		
4	Pa zbatuar	4	36%

### II.5. Opinioni i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Pavarësisht nga puna e bërë dhe masat e marra, niveli i zbatimit të plotë të rekomandimeve është i ulët rreth 9%. Për disa nga masat organizative të lëna (institucionet) nuk kanë mundur realizimin e tyre. Rëndësia dhe ndjeshmëria e lartë e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna për garantimin e një trajtimi dinjitoz të fuqizimit të grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës.

### **III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:**

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit prej subjekteve të audituara, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacionit të tyre, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**Pyetja Kryesore: A përfshijnë politikat kombëtare punësimin e grave në zonat rurale?**

**Pyetja 1 A mundësojnë programet kombëtare punësimin aktiv të grave në zonat rurale?**

**Nënpyetja 1.1** A janë programet e nxitjes së punësimit të diversifikuara, të zbatuara në të gjithë vendin, për punësimin e grave në zonat rurale?

**1. Gjetje nga auditimi:** Programet e nxitjes së punësimit të zbatuara nga AKPA për vitet 2020-2023 janë të përgjithshme, nuk kanë në fokus gratë dhe në veçanti gratë në zonat rurale.

Këto programe parashikohet të zbatohen në të gjithë vendin dhe fokusohen te grupet vulnerabil, por nuk evidentohet se sa janë të zbatueshme në zonat rurale.

- Indikatorët e përdorur, nuk ndahen në gra në fshat apo gra në qytet, por të dhënat e referuara dhe analizimi i tyre është për gratë në përgjithësi. Po ashtu edhe të dhënat e tjera (si p.sh për nivelin e arsimimit, grupmosha), të cilat administrohen nga AKPA kufizohen vetëm në nivel kombëtar dhe nuk ka klasifikime në rang urban dhe rural.

**1.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim të përqendrohet edhe te nevojat reale të grave në zonat rurale në lidhje me shërbimet e programeve të nxitjes së punësimit, shërbimet e trajnimit dhe sistemet e informacionit mbi tregun.

**Në vijimësi**

**Përgjigje e subjektit të audituar:**

**Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim**

Është miratuar dhe po zbatohet VKM Nr. 401, datë 19.06.2024, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet ri integritit social”, ku një nga grupet përfitues janë edhe gratë që banojnë në njësitë administrative/vendore ku nuk ka struktura vendore punësimi. Grupi i synuar përfiton shërbime të këshillimit të specializuar, nisur nga kompleksiteti i vulnerabilitetit që paraqet, si dhe mbështetje me programe punësimi në zonat e pambuluara nga shërbimet e punësimit. Pika III.1 e kësaj VKM-je përcakton “Përfituesit e këtij programi janë punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrën e punës, të cilët evidentohen nga ndërveprimi me sistemin tatimor se kanë më shumë se 6 (gjashtë) muaj të papunë (në vijim “përfituesit”). Prioritet kanë përfituesit e skemës së ndihmës ekonomike, anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, gratë që banojnë në njësitë administrative vendore, ku nuk ka struktura vendore punësimi, si dhe punëkërkues të tjerë nga grupet e veçanta.”

Programi i ri integritit social ofron përfituesve, përveç shërbimeve mbështetëse, edhe mbështetje financiare për pjesëmarrjen në program, përfshirë pagesë për pjesëmarrje, bonuse për shpenzime transporti dhe mbështetje për kujdesin ndaj fëmijëve, të moshuarve apo personave të sëmurë në ngarkim. Efektet e pritshme të programit përfshijnë ofrimin e këshillimit të specializuar dhe të dedikuar për punësim, vetëpunësim ose formim profesional, në bazë të Planit Individual të Ri integritit dhe Punësimit. Gjithashtu, programi synon integrimin e qëndrueshëm në tregun e punës përmes bonuseve për punësim deri në 6 muaj pa ndërprerje pas përfundimit të programit.

Organizatave Joqeveritare (OJF) janë aktorë të rëndësishëm në këtë proces, duke ofruar trajtim të specializuar për grupet vulnerabël dhe ndihmuar në reduktimin e fluksit të punëkërkuësve në zyrat e punës. Synohet gjithashtu që OJF-të të zgjerojnë veprimtarinë në zona të pambuluara, duke ofruar këshillim për individët që jetojnë në zona rurale ose me akses të kufizuar në shërbime.

Gjatë viteve të fundit është vërejtur një rritje e bashkëpunimit me pothuajse të gjitha Bashkitë, në kuadër të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, të mbështetura nga VKM nr. 535, datë 08.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet”. Një pjesë e madhe e institucioneve zbatuese janë Bashkitë. Ky bashkëpunim është forcuar edhe në zbatim të Urdhrit të Përbashkët të MFE dhe MSHMS për mekanizmin e referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune.

Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve për grupet vulnerabël, veçanërisht gratë në zonat rurale dhe individët me barriera të shumëfishta në punësim, AKPA është partnere në projektin “BE për Përfshirjen në Tregun e Punës (EU4LMI)”, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP Shqipëri, në partneritet me P.. Suedez dhe FSHDPAK. Ky projekt ka në fokus Menaxhimin e Integruar të Rastit (MIR), një qasje strategjike për koordinimin e shërbimeve të punësimit me ato sociale. Në bashkëpunim me P.. Suedez janë trajtuar mekanizmat e bashkërendimit ndërinstitucional në nivel vendor, për të rritur efikasitetin e shërbimeve për grupet më të margjinalizuara.

Projekti “Fuqizimi dhe Mbrojtja gjatë gjithë jetës në Shqipëri” (LEAP) është një tjetër program dyvjeçar i përbashkët i OKB-së, i financuar nga Fondi i Përbashkët për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), i cili synon përmirësimin e sistemeve të mbrojtjes sociale dhe mundësive të punësimit për grupet e margjinalizuara në Shqipëri. Programi adreson papunësinë e të rinjve, varfërinë dhe aksesin e pamjaftueshëm në shërbimet sociale. Me fokus te fëmijët, gratë, të moshuarit dhe familjet në nevojë, LEAP synon zbatimin e përfitimit universal për fëmijët, shërbimeve të kujdesit afatgjatë dhe strategjive për menaxhimin e kujdesit të integruar dhe fuqizimit ekonomik.

Një tjetër iniciativë ku AKPA është e përfshirë është projekti “Forcimi i kapaciteteve institucionale vendore për migracionin”, i mbështetur nga G.. dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. I.. ka organizuar një seri eventesh konsultative me pjesëmarrjen e Strukturave të Migracionit dhe Diasporës të 61 bashkive, përfaqësues të AKPA dhe institucione të tjera përkatëse. Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe integrimi i migracionit si faktor zhvillimi lokal. AKPA kontribuon në këtë proces përmes diskutimeve për ri integrimin e migrantëve të rikthyer dhe nxitjes së punësimit për këtë kategori.

Për më tepër, AKPA është në proces të forcimit të bashkëpunimit me organizatat vendore dhe aktorët lokalë për identifikimin e nevojave reale të grave në zonat rurale në fushën e punësimit dhe aftësimin. Parashikohet zhvillimi i analizave më të thelluara dhe përcaktimi i indikatorëve matës për monitorimin e aksesit dhe përfitimit nga programet, me qëllim orientimin e ndërhyrjeve drejt zonave dhe kategorive me nevojë më të madhe.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i zbatuar**.

**2. Gjetje nga auditimi:** AKPA, për të gjykuar efektivitetin e programeve aktuale të miratuara, nuk ka matur dhe analizuar nivelin e rezultateve të punësimit nga këto programe për gratë në zonat rurale. Aktualisht AKPA, nëpërmjet strukturave të saj, ka kryer gjurmim të rezultateve për programet e përfituara nga punëkërkuësit e papunë vetëm për vitin 2020. Sipas përcaktimeve të rregulloreve të zbatimit të programeve, ky proces duhej të realizohej 6 muaj mbas përfundimit të tyre.

**2.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, të grumbullojë dhe të analizojë të dhënat mbi realizimin e programeve të nxitjes së punësimit duke i ndarë në bazë të zonave administrative urbane - rurale si dhe duke shtuar e përfshirë në analizimin e të dhënave edhe kategorinë “gra në zonat rurale”.

Në vijimësi

**Përgjigje e subjektit të audituar:**

**Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim**

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e gjurmimit të rezultateve të programeve. Në këtë kuadër, është realizuar për të dytin vit radhazi gjurmimi për ndjekjen e statusit në punësim të pjesëmarrësve në programet e nxitjes së punësimit për vitin 2021–2022, gjashtë muaj pas përfundimit të programeve. Faza e anketimit/gjurmimit filloi në muajin mars 2023 dhe u finalizua me Raportin e Gjurmimit të Pjesëmarrësve në fund të vitit 2023. Referuar pjesëmarrësve të vitit 2022-2023, aktualisht, pas mbledhjes së të dhënave është në proces përpunimi dhe analizimi i tyre.

Sqarojmë se programet e nxitjes së punësimit, pas fazave të planifikimit, miratimit, alokimit dhe shpalljes në Buletinin Zyrtar, nisin zbatimin kryesisht në muajt shkurt-mars, dhe zgjasin deri në muajin nëntor të vitit kalendarik. Përfituesit më të fundit të një programi në një vit kalendarik janë zakonisht të muajit nëntor, dhe duke marrë parasysh që shumë nga programet kanë afat zbatimi 12-mujor, vlerësimi i rezultateve të tyre duhet të bëhet 18 muaj më pas.

Për shembull, përfituesit e fundit të vitit 2021 duhet të gjurmohen në periudhën maj–qershor 2023. Për shkak të organizimit të proceseve të punës, gjurmimi nuk zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, por planifikohet të realizohet çdo vit në periudhën maj–qershor, me qëllim që të përfshihen në analizë edhe përfituesit më të vonshëm të programeve.

Gjithashtu, përpunimi dhe analizimi i të dhënave përbën një proces të ndërlikuar dhe që kërkon kohë të konsiderueshme. Duke marrë parasysh këto specifika teknike dhe organizative, gjurmimi është realizuar brenda afateve të parashikuara në rregulloret përkatëse.

Ndërkohë, është parashikuar që në raportin e ardhshëm të gjurmimit, që do të përgatitet për përfituesit e viteve të ardhshme, të përfshihet edhe ndarja dhe analiza e të dhënave sipas vendbanimit urban/rural dhe gjinisë, për të adresuar konkretisht rekomandimin e dhënë nga auditimi. Në këtë mënyrë, do të mundësohet një analizë më gjithëpërfshirëse e impaktit të programeve, duke evidentuar nëse dhe sa efektive janë ndërhyrjet për kategorinë "gra në zonat rurale", dhe duke informuar përmirësimet e nevojshme për politikën në vijim.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i zbatuar pjesërisht.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Vlerësimi i nevojave të grupeve të veçanta për mbështetje nëpërmjet PATP nuk është bërë gjithmonë në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Konkretisht, AKPA ka bërë hartimin dhe diversifikimin e PATP-ve duke u bazuar vetëm në data bazën e të dhënave që ka në dispozicion, por studimi i data bazës nuk jep panoramën e gjithë rajoneve. Po kështu edhe NJVQV – të që kanë bërë një analizë më të gjerë të nevojave faktike të grave me qëllim fuqizimin e tyre, si në rastin e Dibrës, nuk i kanë adresuar këto nevoja në AKPA. Për rrjedhojë të kësaj shtate, nuk ka patur, raporte të vlerësimit të nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zona të pambuluara.

**3.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, t'i propozojë Ministrisë së Financave për pjesën e mbetur të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, prioritetet sipas zonave gjeografike, sektorëve ekonomikë dhe nevojave të punëkërkueseve gra në zonat rurale, si dhe të hartojë programe konkrete punësimi për përfshirjen e tyre në tregun e punës.

**Në vijimësi**

**Përgjigje e subjektit të audituar:**

**Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim**

Në përgjigje të rekomandimit për të propozuar prioritetet e reja në zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, sipas zonave gjeografike, sektorëve ekonomikë dhe nevojave të grave në zonat rurale, sqarojmë se Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim ka ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete për orientimin më të mirë të politikave të punësimit në funksion të grupeve vulnerabël dhe për forcimin e qasjes së barabartë në tregun e punës.

Në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, janë zhvilluar instrumente dhe modele të reja për identifikimin e nevojave në nivel lokal, për pilotimin e shërbimeve të personalizuar për gratë në zonat rurale, si dhe për integrimin e qasjeve të kombinuara sociale dhe të punësimit në ofrimin e shërbimeve publike.

Duhet theksuar se, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive mbështet integrimin në tregun e punës të individëve që janë të angazhuar aktivisht në kërkimin e një pune, përmes regjistrimit të tyre pranë Zyrave Vendore të Punësimit. Fokus i veçantë i ndërhyrjeve mbetet përmirësimi i qasjes në shërbime për gratë që banojnë në zonat rurale dhe për grupet me më shumë vështirësi në aksesimin e punësimit.

Në këtë kuadër, është miratuar dhe po zbatohet VKM nr. 401, datë 19.06.2024, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet riintegrit social”, ku ndër grupet përfitues janë gratë që banojnë në njësitë administrative pa struktura vendore punësimi. Programi synon të ofrojë këshillim të specializuar dhe shërbime të dedikuara në zonat e pambuluara, bazuar në shkallën e vulnerabilitetit të individëve përfitues.

Me mbështetjen e E... France, AKPA ka hartuar dhe validuar një paketë të zgjeruar e gjithëpërfshirëse shërbimesh punësimi, të përshtatura posaçërisht për gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të pambuluara. Pilotimi i kësaj pakete po zhvillohet në bashkitë Elbasan, Lushnjë dhe Kamëz. Dokumenti përfundimtar është rezultat i një procesi të gjerë konsultimi me Ministrinë përgjegjëse për punësimin, strukturat vendore të AKPA, shërbimet sociale në nivel vendor, OJF-të dhe partnerët ndërkombëtarë, duke garantuar një kuptim të përbashkët të objektivave dhe përfituesve të synuar.

Metodologjia e hartimit të kësaj pakete është bazuar në një model praktik operacional, që shfrytëzon kapacitetet ekzistuese të AKPA, integron tregues performance dhe përfshin për herë të parë profilizimin ekonometrik në sistemin e menaxhimit të rasteve. Grupi i synuar përkufizohet si gra që jetojnë në njësi administrative pa akses fizik ose gjeografik në strukturat ekzistuese të punësimit.

Në funksion të rritjes së personalizimit të shërbimeve për grupet në nevojë, veçanërisht gratë në zonat rurale dhe individët me barriera të shumëfishta në punësim, AKPA është përfshirë si partner në projektin “BE për Përfshirjen e Tregut të Punës (EU4LMI)”, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP Shqipëri, në bashkëpunim me P.. Suedez dhe FSHDPAK. Në kuadër të këtij projekti, AKPA ka kontribuar në diskutime dhe shkëmbime përvoja për Menaxhimin e Integruar të Rastit (MIR), një model që synon bashkërendimin e shërbimeve të punësimit me ato sociale, për t'u ardhur në ndihmë individëve me pengesa të shumëfishta në tregun e punës.

Një tjetër projekt me ndikim është “Fuqizimi dhe Mbrojtja gjatë gjithë jetës në Shqipëri” (LEAP), një program dyvjeçar i përbashkët i OKB-së, i financuar nga Fondi i Përbashkët për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), i cili synon përmirësimin e sistemeve të mbrojtjes sociale dhe

mundësive të punësimit për popullatën e marginalizuar, përfshirë gratë, të rinjtë, të moshuarit dhe familjet në nevojë. Përmes këtij programi, synohet zbatimi i masave si Përfitimi Universal për Fëmijët (UCB), Shërbimet e Kujdesit Afatgjatë dhe modelet e integruara të kujdesit dhe punësimit. Gjithashtu, AKPA ka qenë pjesë e iniciativës për Forcimin e kapaciteteve institucionale vendore për migracionin, në kuadër të një projekti të mbështetur nga G. dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe të zbatuar nga I., ku janë zhvilluar një seri eventesh konsultative me përfaqësues të bashkive, strukturave të diasporës, institucioneve qendrore dhe AKPA. Qëllimi i kësaj nisme është të integrojë migracionin si faktor zhvillimi lokal, përmes shkëmbimit të praktikave dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e punësimit dhe ri-integrimit të migrantëve të rikthyer. Sqarojmë gjithashtu se Politikat Aktive të Tregut të Punës hartohen nga ministria përgjegjëse në nivel kombëtar, bazuar në analizat dhe prioritetet strategjike të qeverisë. Programet janë gjithëpërfshirëse dhe nuk kanë karakter lokal, por synojnë të adresojnë nevojat e tregut të punës në shkallë vendi, me qasje të diferencuar për grupet në nevojë dhe për rajonet më pak të zhvilluara.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i pa zbatuar**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi nuk rezultoi të jenë zhvilluar kurse të trajnimit profesional në zonat rurale e për rrjedhojë nuk u evidentuan gra nga këto zona, të cilat të kenë ndjekur kurse të trajnimit profesional. Vetë AKPA disponon të dhëna për kursantët që kanë ndjekur kurset e formimit profesional sipas njësive bashkiake ku ata banojnë, kjo pasi Qendrat e Formimit Profesional janë të lokalizuara në qytetet kryesore, por këto të dhëna nuk janë të dizagreguara sipas prejardhjes urbane - rurale.

**4.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, të mundësojnë hapjen e kurseve profesionale për gratë e vajzat në zonat rurale, të përcaktuara në bazë të prioriteteve dhe zhvillimit të secilës zonës rurale.

**Brenda vitit 2024**

#### **Përgjigje e subjektit të audituar:**

##### **Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim**

AKPA disponon të dhëna për kursantët, të cilët kanë ndjekur kurset e formimit profesional sipas njësive bashkiake ku ata banojnë duke përfshirë edhe njësitë bashkiake të zonave rurale. Duke filluar nga 1 korrik 2024 tashme këto të dhëna menaxhohen nëpërmjet sistemit informatik të qendrave të formimit profesional.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) ka ndërmarrë një sërë hapash konkrete, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim rritjen e aksesit të grave dhe vajzave në formim profesional duke mundësuar organizimin e kurseve të formimit profesional sa me afër vendbanimeve të tyre me aq sa është e menaxhueshme në bashkëpunim me Shkollat e Mesme Profesionale apo bizneset:

1. Ofrimi i kurseve jashtë qendrave të formimit profesional: Aktualisht, nëpërmjet qendrave të formimit profesional publike të shpërndara në 10 qarqe, organizohen kurse profesionale edhe jashtë ambienteve të qendrave të formimit profesional, si në bashkitë: Pogradec, Devoll, Gramsh, Peqin, Berat, Përmet, Tepelenë, Sarandë, Malësi e Madhe, Lezhë, etj. Këto kurse zhvillohen në ambiente të shkollave profesionale publike, në ambiente e Zyrave të Punësimit

ose në ambiente të siguruara nga organizata jofitimprurëse, në bashkëpunim me institucionet vendore.

2. Qendra e Formimit Profesional Lëvizëse: Për rajonin verilindor, AKPA ka vënë në funksion Qendrën e Formimit Profesional Lëvizëse, e cila organizon kurse në njësi vendore të ndryshme të këtij rajoni në varësi të kërkesave dhe nevojave të identifikuar në komunitet si bashkitë: Dibër, Mat, Has, Tropojë, Puke, Kukës. Këto kurse zhvillohen në ambiente të shkollave profesionale publike, në ambiente e Zyrrave të Punësimit ose në ambiente të siguruara nga institucionet vendore.
3. Zbatimi i Programit të nxënimit në vendin e punës: Miratuar dhe po zbatohet Vendimi Nr. 264, datë 27.4.2023 “Për miratimin e procedurave, kriterëve dhe rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, sipas skemës së Garancisë Rinore nëpërmjet të nxënimit në vendin e punës” i cili synon përfshirjen në tregun e punës të rinjve të moshës 15–29 vjeç, që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional, nëpërmjet trajnimit profesional të kombinuar me praktikë në subjekte punëdhënëse. Qëllimi është përgatitja e tyre për tregun e punës dhe punësimi i mëvonshëm për një periudhë jo më pak se 6 muaj. Programi parashikon mbështetje financiare për kursantët gjatë periudhës së trajnimit, duke përfshirë edhe pagesën e shpenzimeve të transportit në rast se banojnë më shumë se 2 (dy) km larg vendit të punës. Ky program po zbatohet aktualisht në rajonet Vlorë, Tiranë dhe Shkodër.
4. Zbatimi i programit të kodimit: Miratuar dhe po zbatohet VKM-së Nr. 646, datë 5.10.2022, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private.” Ky vendim synon kualifikimin dhe rikualifikimin e punëkërkuarve të papunë për integrim më të shpejtë në tregun e punës, në fushën e programimit me kurse që zgjasin nga 3 deri në 12 muaj. Për punëkërkuarët e papunë të regjistruar, mbështetja financiare është deri në 100% të kostos së kursit, për kategoritë e tjera të punëkërkuarve, financimi është deri në 50% të kostos së kursit. Personat me aftësi të kufizuara përfitojnë edhe mbështetje për elementët e përshtatjes së trajnimit. Ky program është shtrirë edhe në qytete të tjera si Durrës, Korçë, Fier, Durrës etj.
5. Hartimi i kuadrit ligjor për mbështetje financiare të pjesëmarrësve në formim profesional: Për të nxitur më tej pjesëmarrjen në formim profesional të punëkërkuarve në zonat rurale, AKPA ka hartuar një draft të projekt-Vendim të ri, i cili synon të përcaktojë procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të mbështetjes financiare në kurse të formimit profesional për një kategori të veçantë punëkërkuarish të papunë. Ky draft pas validimit me grupet e interesit parashikohet t’i dërgohet për miratim Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2025.

AKPA mbetet e angazhuar të vazhdojë bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe partnerët e tjerë, me synimin për të ofruar programe formimi profesional të përshtatura për nevojat specifike të grave dhe vajzave në zonat rurale, si një mundësi reale për rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të tyre.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i zbatuar pjesërisht.**

### **Pyetja 2 A janë marrë masa konkrete që nxisin përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës?**

**Nënpyetja 1.2** A është investuar nga qeveria qendrore dhe vendore në përmirësimin e infrastrukturës në kuadër të nxitjes së punësimit?

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të grumbulluara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore objekt auditimi, u konstatua se pothuajse në 80 % të tyre, raporti i çerdheve dhe kopshteve nuk është në proporcion të drejtë me njësitë administrative rurale dhe ato urbane, që i përkasin një Bashkie. Referuar të dhënave zyrtare nga Bashkitë objekt auditimi, konstatohet se çerdhet mungojnë në njësitë administrative rurale dhe në disa raste edhe në njësitë administrative urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohet një mbulim i plotë dhe ndarje e drejtë sipas zonave urbane dhe rurale, me kopshte dhe çerdhe.

**1.1 Rekomandimi:** Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në përputhje me strategjitë rajonale për zhvillimin e zonave rurale, të marrin masa për të vlerësuar situatën në këto zona, për mbulimin e tyre me çerdhe dhe kopshte si dhe hartojnë plane investimesh në varësi të nevojave proporcionale me numrin e banorëve.

**Brenda vitit 2024**

**Përgjigje e subjektit të audituar:**

**Bashkia Berat**

Bashkia Berat pasi u njoh me rekomandimet e lëna nga ju gjatë procesit të auditimit “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës” shpreh gadishmërim maksimale për të nisur procesin e zbatimit të këtyre rekomandimeve si dhe për të përmirësuar situatën aktuale. Në vazhdim do t’ju informojmë rreth masave të marra.

**Bashkia Dibër**

Në përgjigje të rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit të KLSH, lidhur me disproporcionin në mbulimin me çerdhe dhe kopshte në njësitë administrative rurale, ju informojmë se Bashkia Dibër përmes strukturave të saj, Njësi Administrative dhe Drejtorisë së Arsimit Parashkollor, vit pas viti vlerëson gjendjen infrastrukurore të kopshteve dhe çerdheve në njësitë administrative rurale, por edhe nevojën për shtim kapacitetesh të reja (procesverbale nga takimet dhe mbledhjet e Drejtorisë së Arsimit Parashkollor me edukatorët).

Aktualisht, në Bashkinë Dibër, funksionojnë 88 kopshte vetëm në njësitë administrative rurale, pa përfshirë, qytetin, pra Peshkopinë. 60 prej tyre janë në brendësi të shkollave.

Ndërsa sa i përket çerdheve, janë tri të tilla në qytet, çerdhja pranë Muzeut (110 fëmijë), në lagjen Dobrovë(20 fëmijë) dhe në lagjen Kamen(18 fëmijë).

Vetëm në njësinë administrative Maqëllarë, njësia administrative rurale më e madhe, është vlerësuar nevoja për shtim kapacitetesh për kopshtin, por që do të ketë edhe një ambient për çerdhe, nevojë të cilën kemi planifikuar ta adresojmë përmes buxhetit 2025 të bashkisë.(Programi buxhetor 2025).

Ndërsa në 13 njësitë e tjera administrative rurale, nuk ka patur kërkesa nga edukatorët, banorët apo komunitetet respektive për të hapur çerdhe dhe kopshte të reja, sepse numri i fëmijëve që po frekuentojnë kopshtet në fshatra është në rënie për shkak të migrimit dhe emigrimit të banorëve, kryesisht në njësitë e largëta,, fenomen që ka prekur edhe Bashkinë Dibër.

Në kopshtet ekzistuese në njësitë administrative rurale, sipas vlerësimit të nevojave dhe mundësi financiare, nga Bashkia Dibër kryhen rikonstruksione të plota e të pjesshme në këto institucione me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukurore.

Institucioni i Bashkisë Dibër shpeshherë bashkëpunon edhe me organizata joqeveritare për përmirësimin e kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla, ndër prioritet kryesorë të bashkisë. Ndërsa mirëmbajtja e këtyre institucioneve është periodike dhe realizohet përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Për vitin 2024, Bashkia Dibër ka rikonstruktuar me fondet e veta, çerdhen në Peshkopi, 3 shkolla 9-vjeçare (Mustafe, Dohoshisht, Zall Dardhë), në brendësi të të cilave funksionojnë edhe kopshtet.(Programi buxhetor 2024)

Po kështu, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Bashkisë është rikonstruktuar kopshti i fshatit Begjunec, njësia administrative Melan.

Siç e cituam edhe më sipër, në buxhetin e vitit aktual 2025 janë parashikuar investime për zgjerimin e kopshtit Maqellarë, shkolla 9-vjeçare Sllovë( ku është edhe kopshti) dhe riparime të ndryshme në objektet arsimore sipas kërkesave.

Në Projektbuxhetin Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Dibër janë parashikuar edhe ndërhyrje në institucionet arsimore sipas nevojave.

## **Bashkia Divjakë**

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës sociale për nxitjen e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës, Bashkia Divjakë ka ndërmarrë këto masa konkrete:

Në njësinë administrative Cermë Sektor është hapur një çerdhe publike në muajin janar 2024, e cila fillimisht nisi funksionimin me 9 fëmijë të regjistruar dhe aktualisht ka të regjistruar 15 fëmijë. Ky shërbim ka krijuar mundësi më të mira për gratë e zonës që të angazhohen në tregun e punës dhe të marrin pjesë në aktivitetet ekonomike dhe sociale.

Në territorin e bashkisë aktualisht funksionojnë dy kopshte me shërbim dreke:

- Kopshti në Divjakë frekuentohet nga 160 fëmijë, prej të cilëve 70 ndjekin shërbimin e drekës.
- Kopshti në Cermë Sektor frekuentohet nga 109 fëmijë, prej të cilëve 20 ndjekin shërbimin e drekës.

Ky shërbim i plotë gjatë ditës u vjen në ndihmë familjeve dhe lehtëson mundësitë që nënat të angazhohen në tregun e punës apo në aktivitete të tjera ekonomike dhe sociale, duke pasur një ndikim të ndjeshëm pozitiv në komunitet. Është hartuar një plan paraprak për zgjerimin e shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve të moshës 0-6 vjeç edhe në njësitë e tjera rurale të bashkisë, në varësi të kërkesave dhe numrit të banorëve. Po vijon puna për identifikimin e mundësive për hapjen e një çerdheje tjetër në një njësi administrative gjatë vitit 2025.

Dokumentacioni përkatës mbi hapjen e çerdhes në Cermë Sektor, funksionimin e kopshteve me shërbim dreke, si dhe planet e investimeve do t'i vihen në dispozicion grupit të auditimit të KLSH-së gjatë verifikimit fizik.

Në kuadër të fuqizimit të grave në tregun e punës, i kemi përfshirë në Projektin e Punësimit, në bashkëpunim me zyrën e punës, mundësi punësimi për gratë që janë të divorcuara, të veja, me vështirësi ekonomike dhe të papuna. Në këtë projekt kanë qenë të përfshira edhe gratë që i përkasin etnitetit rom/egjiptian. Kemi asistuar gra duke i ndihmuar me punësimin e tyre të përhershëm ose sezonal. Gjithashtu kemi ndihmuar gra që të punojnë me siguracione për të dalë nga sistemi i ndihmës ekonomike.

Ne kemi orientuar gra të komunitetit shumicë, por edhe të komunitetit rom/egjiptian, që kanë pasur probleme shëndetësore, për të marrë shërbime si Ndhimja Ekonomike (NE) dhe Pagesa e Aftësisë së Kufizuar (PAK). Gjithashtu ka pasur edhe raste emergjente ku jemi drejtuar për ndihmë me pako ushqimore dhe veshmbathje, në bashkëpunim me OJF, Kishën, Xhaminë dhe biznese të ndryshme. Ndhimë të veçantë kanë marrë edhe gra nga komuniteti rom/egjiptian, të cilave, përveç punësimit, u kemi ofruar mbështetje në bashkëpunim me UNDP, ku janë ndihmuar të ndërmarrin nisma, sado të vogla, për të ardhur në ndihmë familjarëve të tyre, si p.sh. hapja e lavazheve, byrektoreve, pajisja me mjete pune etj.

Kemi ndërmarrë nisma sensibilizuese në shkolla, në njësitë administrative dhe në komunitetet e margjinalizuara e me më shumë nevoja të shoqërisë sonë, në kuadër të ndërgjegjësimit kundër dhunës në familje, veçanërisht ndaj grave, që është një fenomen i trashëguar në shoqërinë tonë.

### **Bashkia Gjirokastrë**

Për çerdhet dhe kopshtet në zonat rurale; Njësitë administrative të Bashkisë Gjirokastrë disponojnë godina ekzistuese që plotësojnë parametrat dhe kapacitetet për t'u përshtatur si çerdhe apo kopshte. Aktualisht, nuk jemi në fazë planifikimi për ndërtim apo rikonstruksion të këtyre strukturave, pasi infrastruktura ekzistuese e lejon funksionimin e tyre. Megjithatë, sfida kryesore mbetet lëvizja e popullsisë dhe tendenca e banorëve për t'u shpërngulur drejt qytetit, çfarë ndikon në uljen e numrit të fëmijëve dhe në vështirësinë për t'i mbajtur këto shërbime të hapura.

### **Bashkia Kukës**

Në të gjithë Njësitë Administrative dhe çdo fshat është i mbuluar me kopshte duke përjashtuar fshatrat që nuk kanë numrin e përcaktuar të fëmijëve si kushte për hapjen e një kopsht. Ndërsa me çerdhe mbulojmë vetëm qytetin.

### **Bashkia Lezhë**

Nga gjetjet e lëna nga KLSH, Bashkia Lezhë ka marrë një plan masash për të vlerësuar situatën në zonat rurale për mundësinë e hapjes së çerdheve dhe kopshteve. Aktualisht është kryer një studim për hapjen e një çerdheje në njësinë më të madhe, atë të Shënkollit. Gjithashtu po kryhet një studim tjetër, bazuar mbi nevojën e dalë, për hapjen e një çerdheje të dytë në qytet, në bazë të kërkesave të larta për dërgimin e fëmijëve në çerdhe.

Për sa i përket kopshteve, Bashkia Lezhë gjatë vitit 2024, në qytetin e Lezhës ka hapur kopshtin “Hirushja”, në sajë të kërkesave të larta për regjistrimin e fëmijëve në kopshtet e qytetit.

1- Gjithashtu, pranë kopshtit “Besëlidhja” është hapur një grup i ri gjatë vitit 2024, për të bërë të mundur uljen e shumë kërkesave për regjistrimin e fëmijëve gjatë vitit.

2- Gjatë vitit 2024, u bënë disa tentativa për të hapur dy kopshte në zonat rurale: një kopsht në Njësinë Administrative Shënkoll, për të cilin u miratua në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Lezhë. U zhvilluan dëgjesa publike dhe banorët e zonës ishin mjaft të kënaqur, por procedura ka ngelur në gjysmë, për shkak se në godinën ku mendohej të hapej kopshti ndodhi një problem me pronarin, i cili nuk ra dakord që kjo godinë të kthehet në kopsht. Theksojmë se në Njësinë Administrative Shënkoll funksionojnë dy kopshte private me ushqim; një kopsht është hapur nga kisha në fshatin Shënkoll, ndërsa kopshti tjetër është hapur privat dhe jep shërbimin e tij deri në orën 17:00. Gjithashtu, edhe në Njësinë Administrative Ungrej u miratua në Këshillin Bashkiak të Lezhës hapja e një kopshti të ri në fshatin Kalivaç. Pas disa kërkesave të dërguara në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, jemi ende në pritje të përmbushjes së disa pikave të kërkuara nga Ministria.

3- Jemi në proces për hapjen e një grupi të ri pranë kopshtit “Hirushja”, pasi këtë vit kërkesa është ende shumë e lartë për regjistrim.

4- Gjatë vitit 2024, u miratua në buxhetin e Bashkisë Lezhë rikonstruksioni i të gjitha kopshteve në Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Lezhë, e cila do të përmirësojë shërbimin në arsimin parashkollor dhe do të sigurojë që të gjitha kopshtet të kenë kushte bashkëkohore.

## **Bashkia Shkodër**

Bashkia Shkodër nisur nga rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit konsideron të rëndësishëm avancimin e përpjekjeve drejt një zhvillimi të barabartë mes zonave urbane dhe rurale, si dhe për rritjen e përfshirjes së grave në tregun e punës.

Nisur nga kjo ju informojmë se:

Vlerësimi i situatës aktuale: Bashkia ka nisur një proces të brendshëm vlerësimi të shpërndarjes së institucioneve parashkollore (çerdhe dhe kopshte) në të gjitha njësitë administrative, me fokus të veçantë në zonat rurale, për të identifikuar boshllëqet ekzistuese dhe nevojat specifike të komuniteteve.

Në përputhje me nevojat e konstatuara dhe në vijim të procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm, Bashkia do të integrojë objektiva konkrete për zgjerimin e rrjetit të çerdheve dhe kopshteve.

Në këtë drejtim, Bashkia Shkodër është në proces të hartimit të “Planin e Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor 2025–2029”, një dokument strategjik që:

- Përmban një analizë të detajuar të situatës ekzistuese, duke identifikuar shpërndarjen jo të barabartë të çerdheve dhe kopshteve në territorin e Bashkisë, me theks të veçantë tek mungesat në njësitë administrative rurale.
- Parashikon masa konkrete për përmirësimin e infrastrukturës edukative, duke përfshirë vlerësimin teknik të godinave, ndërtimin dhe rikonstruksionin e kopshteve, veçanërisht në zonat me mungesë të theksuar të shërbimeve.

Lidhur me rajonalizimin e shkollave e kopshteve, kemi marrëveshje me MAS, konkretisht protokolluar në MAS me nr. 6667 prot., dt. 22.10.2024 si dhe protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. 247/8 prot, dt. 22.10.2024.

Projekt pilot 1 vjeçar të përfshirjes së Bashkisë në ushtrimin e përgjegjësi në fushën e arsimit para universitar për institucionet arsimore para universitare që janë në territorin e saj.

Bashkia Shkodër mbetet e angazhuar për zbatimin e këtij plani në bashkëpunim me institucionet publike dhe partnerët zhvillimorë, duke garantuar që çdo fëmijë të ketë akses në edukimin e hershëm dhe çdo prind, veçanërisht nënat, të kenë mundësi reale për përfshirje ekonomike.

## **Bashkia Elbasan**

Bashkia Elbasan ka gjithmonë në fokus dhe prioritet të saj, krijimin e rrethanave dhe mundësive që fëmijët e familjeve që i përkasin shtresave vulnerabël, që frekuentojnë rregullisht arsimin parashkollor, me qëllim integrimin e tyre në jetën sociale dhe edukative të kopshtit si një e drejtë e barabartë e tyre për arsimim gjithëpërfshirës.

Aktualisht, Bashkia Elbasan ka në juridiksionin e saj:

- 3 Çerdhe publike;
- 17 Kopshte publike me drejtori më vete, prej të cilave :
- 8 kopshte me ushqim
- 9 kopshte pa ushqim
- 72 kopshte të shpërndara në njësitë administrative në mjediset e shkollave ose jo;

Regjistrimi i të gjithë fëmijëve 0-6 vjeç në çerdhet dhe kopshtet publike të bashkisë Elbasan, është pa pagesë.

Prindërit/kujdestarët ligjorë që kanë regjistruar fëmijët në çerdhet dhe kopshte me ushqim, në mbështetje të VKB-së nr.44 datë 24.10.2011 ”Mbi Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore” i ndryshuar ose VKB-së nr.119, datë 14.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në bashkinë Elbasan për vitin 2022”, neni 53 “Tarifa për Qendrën Ekonomike të Arsimit”, shkronjat (a) dhe shkronja (b), paguajnë vetëm tarifën e ushqimit të

fëmijëve në vlerën minimale 160 lekë/ditë. Këtë kuotë prindërit/kujdestarët ligjorë e paguajnë në bazë të ditëve të frekuencimit të fëmijëve të tyre në kopshte dhe çerdhe.

Në mbështetje të shtresave në nevojë dhe kategorive vulnerabël, Bashkia Elbasan ka vendosur lehtësime për përballimin e tarifës ushqimore në kopshte me ushqim, nëpërmjet mbulimit të pjesshëm ose të plotë të saj, falë financimit të drejtpërdrejtë nga vetë bashkia dhe bashkëpunimit me organizata joqeveritare partnere. Këto masa synojnë të garantojnë përfshirjen dhe mirëqenien e fëmijëve, pavarësisht kushteve socio-ekonomike të familjes.

Për sa më sipër:

Me Vendim nr. 126 datë 30.09.2019 “Për gratë e dhunuara” Bashkia mbulon tarifën e ushqimit për fëmijët 0–6 vjeç, nënat e të cilëve kanë një Urdhër Mbrojtjeje aktiv të lëshuar nga Gjykata. Kjo mbështetje është në fuqi për gjithë kohëzgjatjen e urdhrin të mbrojtjes. Gjatë viteve 2021 -2024 numri i fëmijëve përfitues nga kjo VKB është rreth 10 fëmijë 0-6 vjeç.

Në lagjen Rrapishtë, pranë Qendrës Komunitare Rome (në varësi të Kopshtit Publik nr.11), rreth 60 fëmijë romë të moshës 3–6 vjeç përfitojnë ushqim pa pagesë, si pjesë e bashkëpunimit të Bashkisë Elbasan me organizatat S.. the C... dhe R.. S., në kuadër të projektit “Kujdes dhe zhvillim në fëmijërinë e hershme për fëmijët rom/egjiptianë në Shqipëri”.

Ky projekt ka funksionuar në dy faza:

- Faza I: Tetor 2016 – Shtator 2019, me financim 100% nga S.. the C...;
- Faza II: Tetor 2019 – Shtator 2021, me bashkëfinancim 70% Save dhe 30% Bashkia;
- Pas përfundimit të projektit, nga shtatori 2021 e në vijim, Bashkia Elbasan ka marrë përsipër mbulimin e plotë (100%) të kostos ushqimore për këta fëmijë, bazuar në pikën 7.4 të nenit V të Marrëveshjes dypalëshe nr.317 prot, datë 07.10.2020.

Gjithashtu, bashkia ka siguruar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për këtë shërbim, përfshirë stafin edukativ dhe ndihmës (kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, sanitare, shërbimin e gazit), materialet industriale dhe mirëmbajtjen e godinës.

- Në mbështetje të projektit “Drejt një edukimi gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët në Shqipëri” me donator S... the C... dhe organizatë implementuese MEDPAK, bashkia ka disa vite që mbështet shtresat vulnerabel përfshirë këtu fëmijë rom, egjiptianë dhe me Nevoja të Veçanta, duke ofruar ushqim pa pagesë për rreth 121 fëmijë në 6 kopshte me dite ngrënie dhe 2 çerdhen.

Edhe ky projekt ka funksionuar në dy faza :

- Faza I: Prill 2018 – Mars 2019 me financim 100% nga S.. the C...;
- Faza II: Maj 2019 – Maj 2020 me bashkëfinancim 75% S... dhe 25% Bashkia;
- Faza II: Prill 2020 – Korrik 2020 me bashkëfinancim 50% Save dhe 50%

Bashkia;

- Pas përfundimit të projektit, nga shtatori 2020 e në vijim, Bashkia Elbasan ka marrë përsipër mbulimin e plotë (100%) të kostos ushqimore për këta fëmijë, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan dhe S... the C... me 23.12.20219 Bashkia Elbasan është duke hartuar PVVBGJ 2025-2030 dhe në masën 5.5të Draft Matricës së aktiviteteve të propozuara parashikohet. Shtimi i shërbimeve të përkujdesit (çerdhe, kopshte) sidomos në zonat rurale, për fëmijët vajza dhe djem, si një mundësi për t’u krijuar nënave më shumë hapësirë për t’u integruar në tregun e punës<sup>1</sup>Në këtë kontekst janë parashikuar ngritja e 4 çerdheve respektivisht:

1 çerdhe në Njësinë administrative Shushicë(e planifikuar)

1 çerdhe në Rajonin nr. 4 (e planifikuar)

1 çerdhe në Rajonin nr. 6 (e planifikuar)

<sup>1</sup> Në përputhje me rekomandimet e KLSH 2024

1 çerdhe në Rajonin nr. 1 (në përfundim të ndërtimit)

Bazuar në raportin e monitorimit të PVVBGJ 2022-2024 ku është synuar Lehtësimin e punësimit të grave përmes mbështetjes për kujdesin ndaj fëmijëve; është realizuar ndër të tjera Shërbimi “Shtëpia e Gjyshes” është një ndër nismat më të rëndësishme, i cili ofron kujdes pasdite për fëmijët e nënave të vetme që punojnë, por edhe për familje në vështirësi ekonomike. Ky shërbim funksionon deri në orën 18:00 dhe realizohet në bashkëpunim me fondacionin "M... e N.. T..." në qytetin e Elbasanit. Kjo ndërhyrje ka lehtësuar ndjeshëm barrën e kujdesit ndaj fëmijëve për gratë që janë të vetme dhe punojnë.

Po në PVVBGJ 2025-2030 janë parashikuar këto masa:

Masa 1.28 Bashkëpunimi me AKPA për angazhimin e grave me AK në programet e punëve publike në komunitet (në zbatim të VKM përkatëse).

Masa 3.30 Angazhimi i fëmijëve të familjeve ku ushtrohet dhunë, në aktivitete sportive, artistike e kulturore, si mundësi për të trajtuar stresin dhe traumën e shkaktuar nga dhuna

Masa 1.27 Ofrimi i shërbimeve të përkujdesit me orar të përkohshëm (p.sh. 4 orë në ditë) në qendrat ekzistuese apo përmes programeve/qendrave të reja, të shtrira edhe në zonat rurale, për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, për t’u krijuar mundësi për punësim kujdestar/eve të tyre.

Dokumenti në dispozicion.

## **Bashkia Lushnjë**

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH Bashkia Lushnjë në të gjitha planet e veta strategjike, si PBA, apo planet e tjera më afatgjata të cilat prekin ndjeshëm zhvillimin ekonomik, por dhe social e kulturor të bashkisë 2024, 2025 është munduar që të trajtojë me veçanti këtë temë. Si zbatim i rekomandimit dhe në vlerësim të nevojave të marra, në PBA tashëm është një kapitull i veçantë kushtuar barazisë gjinore.

Në vlerësim të situatës dhe në zbatim të rekomandimeve të lëna, po hapet kopshti i ri sipas nevojave dhe kërkesave të shumta të banorëve, kopshti nr. 7 i qytetit, është në fazë përfundimi (Godina pas kopshtit ¼ lagjja “Xh. Nepravishta”).

Nga vlerësimi i situatës në kopshte, shkolla etj. është realizuar instalimi i rreth 150 paneleve fotovoltaike në 6 kopshte dhe 2 shkolla në qytetin e Lushnjës, e cila krijon kushte më të mira për rreth 1500 fëmijë dhe nxënës. Një nga rekomandimet e lëna nga KLSH dhe e zbatuar nga ne dhe do të vijojë dhe në kopshte të tjera.

- Si vlerësim i nevojave dhe kërkesave të vazhdueshme nga nënat janë realizuar krijimi i këndeve të lojërave në bllokbanimet mes lagjeve.
- Si rekomandim i lënë nga KLSH për të marrë masa dhe vlerësuar nga afër zhvillimin e zonave rurale është hartuar Projekti i Kryetares së Bashkisë “Një kafe me gratë”, në çdo rajon dhe njësi administrative (dhe fshatra). Për të qenë më afër grave për problemet e tyre të përditshme.
- Si rekomandim i lënë nga KLSH për të marrë masa dhe vlerësuar nga afër zhvillimin e zonave rurale kemi krijuar bashkëpunim me Myftininë e Qytetit për kurse profesionale rrobaqepësie për gratë, veçanërisht në zhvillimin e grave rurale.

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH, në zbatim të vlerësimit të nevojave që gratë dhe vajzat në zonat në periferi apo në zona rurale kanë nevojë është hapur Qendër Multifunksionale në lagjen Saver (lagje në periferi të qytetit, Rajoni nr. 5) për nevojat e grave dhe vajzave Rome, Egjiptiane dhe jo vetëm për trajnime me kurse profesionale dhe mundësi për rritje të ekonomisë familjare.

Bashkia Lushnje vlerësoi situatën në Lagjja “Saver”, ku në të cilën janë të regjistruar rreth 994 gra. Qëllimi i këtij rekomandimi është të kontribuojë në integrimin social dhe mirëqenien e familjeve veçanërisht të grave, fëmijëve dhe të moshuarve duke përfshirë banorët në nevojë ekonomike dhe minoritetet e marginalizuara dhe të pafavorizuara si komuniteti rome, egjiptian dhe personat të tjerë me banim në lagjen “Savër” të Bashkisë Lushnje, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse dhe ngritjes së kapaciteteve në Qendrën Komunitare Savër.

Objektivat Kryesore të zbatimit të këtij rekomandimi janë:

1: Të asistojë rreth 120 gra në Savër, me këshillim shëndetësor, psikologjik, ligjor e social në Qendrën Komunitare Savër.

2: Të mbështesë dhe të ofrojë shërbime për 80-100 fëmijë nga familjet në nevojë, të cilët nuk janë të regjistruar në sistemin arsimor, me regjistrimin në shkollë, transport dhe support pas-shkollë në Qendrën Komunitare Savër.

Objektivi 3: Të fuqizojë 50-80 vajza dhe gra nga grupet vulnerabël me trajnim profesional dhe t’i mbështesë për t’u punësuar pas trajnimit.

Objektivi 4: Të ofrojë suport për 100 të moshuar dhe aktivitete gjithëpërfshirëse për mirëqenien e tyre në Qendrën Komunitare Savër.

Përfitues të drejtpërdrejtë: do të jenë 350 banorë në nevojë në lagjen Saver, 120 vajza/gra nga grupet e ndryshme sociale, 80 fëmijë jashtë sistemit arsimor, 50 vajza/gra në nevojë, 100 persona të moshës së tretë që frekuentojnë aktivitetet e Qendrës Komunitare Saver.

Përfitues të tërthortë: do të jenë 350 familje të zonës, që përfitojnë nga shërbimet e ofruara dhe rreth 1,400 individë ndikohen nga impakti i këtij projekti.

Puna kryhet nga Bashkia e Lushnjes ku përfitojnë:

- kontrole bazë shëndetësore për vajzat/gratë;
- seanca individuale këshillimi me psikologun/punonjës social;
- terapi në grup për fuqizimin e grave;
- konsulta individuale ligjore për të drejtat e grave;
- takime advokuese në bashki për përfshirjen e grave në vendimmarrje.

Bashkia Lushnjë do të kryejë studim në terren për evidentimin e fëmijëve 6-15 vjeç jashtë sistemit arsimor;

- Do të ndihmojë për pajisjen e dokumentacionit të 80 fëmijëve dhe regjistrimin në shkolla fillore;
- Do të organizojë takime me Drejtoritë Arsimore për ndjekjen e frekuentimit të fëmijëve në shkolla;
- Transport të përditshëm në shkolla për 80 fëmijë, për vitin shkollor;
- Suport për mësimin pas-shkollor me 1 mësues për 30 fëmijë, 2 herë në javë për 2 muaj;
- Aktivite tematike jashtëshkollore, sportive e kulturore me fëmijët, 1 herë në muaj;
- Do të ofrojë kurse mbështetëse plotësuese falas si kurset e pikturës, muzikës, aktrimit, etj., 1 herë në javë për 6 muaj;
- Aftësimin e grave dhe vajzave në parukeri dhe bujqësi;
- Trajnime aftësuese 2-javore për 50 gra dhe vajza;
- Asistencë individuale me 15 gra dhe vajza për përgatitjen e CV, aplikime pune, intervista 1 herë në javë pranë qendrës për 3 muaj;
- Asistencë 3-mujore për 15 të punësuar për orientim në vendin e punës;
- Krijohet klubi i Grave dhe Vajzave "Saver", që do të organizohet me aktivitete rekreative me tematike ekonomike dhe sociale për forcimin e gruas, 1 herë në 2 javë për 3 muaj, pranë qendrës komunitare;

- Do të kryejë një fushatë promovimi të gruas në punë.

### **Bashkia Pogradec**

Në lidhje me numrin e kopshteve ju bëjmë me dije se, pavarësisht ndryshimit të numrit të popullsisë numri i fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor në zonat rurale, por edhe ato urbane, është ulur ndjeshëm duke mos plotësuar kriteret e përcaktuara në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Paragrafi I, Pika A/1 “Grupet e veçanta të nxënësve në kopësht me ushqim në zonat urbane të formohen me jo më pak se 25 nxënës që frekuentojnë”, si dhe pika A/2 “Grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet e zonave rurale të formohen me jo më pak se 15 nxënës që frekuentojnë”, si dhe më pas prej vitit 2023 në bazë të Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në Institucionet e Arsimit Parauniversitar”, Paragrafi I, Pika 1/a dhe 1/b ku përcaktohet numri i nxënësve për klasë në arsimin parashkollor “Grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet me ushqim në zonat urbane të formohen me jo më pak se 25 nxënës që frekuentojnë”, si dhe “Grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet e zonave rurale të formohen me jo më pak se 15 nxënës që frekuentojnë”.

Hapja e një institucioni të arsimit parashkollor bazohet në nenin 41 "Hapja dhe mbyllja e institucioneve arsimore publike" të Ligjit Nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut I të Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në Institucionet e Arsimit Parauniversitar”, dhe pika 4 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 662, datë 08.10.2014, "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për hapjen dhe për mbylljen e institucioneve arsimore parauniversitare publike". Të zgjerojmë aksesin në arsim parashkollor, duke ndërtuar një çerdhe që plotëson standardet bashkëkohore për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0–3 vjeç.

Në vitin 2020, Bashkia Pogradec pas konsultimeve me përfaqësues të komunitetit të zonës dhe me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore paruniversitare publike ka ndërmarrë një inisiativë për:

1. Hapjen dhe funksionimin e Institucionit Arsimor Publik Parashkollor "Kopsht", në fshatin Homçan, Njësia Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec.
2. Hapjen dhe funksionimin e Institucionit Arsimor Publik Parashkollor "Kopsht", në fshatin Losnik, Njësia Administrative Velçan, Bashkia Pogradec.

Nga këto dy propozime të dërguara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, u arrit në vitin 2020 hapja e një grupi të përzier në fshatin Homçan.

Në planin e Arsimit parauniversitar që është aktualisht në fazën e konsultimit publik (<https://bashkiapogradec.gov.al/publikime/njoftime-te-keshillit-bashkiak-12/konsultim-publik---plani-i-arsimit-parauniversitar-per-bashkine-pogradec---706/>)

dhe pritet të miratohet së shpejti është planifikuar ndërtimi i një godine të re për çerdhe për vitin 2025-2026 me qëllim që të zgjerojmë aksesin në arsim parashkollor, duke ndërtuar një çerdhe që plotëson standardet bashkëkohore për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0–3 vjeç. Gjithashtu edhe rikonstruksioni i 1 një kopshti dhe një shkolle në Gështenjas.

### **Bashkia Vlorë**

Në zbatim të programit të auditimit tematik me Nr. 684 prot. datë 17.06.2025 me objekt « Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës me temë: « Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës », bashkia Vlorë,

Drejtoria e Përgjithshme Juridike do të përgatis planin për zbatimin e masave sipas të gjitha rekomandimeve të lëna nga KLSH, të cilat nuk janë realizuar për periudhën e kërkuar.

Tabela nr.1 Përmbledhje e statusit të rekomandimit 1.1 në bashkitë subjekt auditimi.

Rek. 1.1 pyetja 2	Statusi i rekomandimit	Bashkia												
		Lushnje	Lezhe	Shkoder	Diber	Kukes	Vlore	Elbasan	Kruje	Berat	Divjake	Gjirokastrer	Kavaje	Pogradec
Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, në përputhje me strategjitë rajonale për zhvillimin e zonave rurale, të marrin masa për të vlerësuar situatën në këto zona, për mbulimin e tyre me çerdhe dhe kopshte si dhe hartojnë plane investimesh në varësi të nevojave proporcional e me numrin e banorëve.	Zbatuar Plotësisht	x												
	Zbatuar pjesërisht		x											
	Në proces zbatimi													
	Pa zbatuar			x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x

### Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Një numër i lartë i bashkive (11) subjekt auditimi, nuk kanë marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit. Bashkia Lushnje e ka zbatuar plotësisht ndërsa Bashkia Lezhë pjesërisht rekomandimin.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **pjesërisht i zbatuar**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të grumbulluara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore objekt auditimi, u konstatua se në disa njësi të qeverisjes vendore nuk sigurohet transport publik përveçse në njësitë administrative urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohen kushte lehtësimi, për të afruar gratë dhe vajzat sa më afër tregut të punës.

**2.1 Rekomandimi:** Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të marrin masa për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat që ka për mbulimin me transport publik në çdo njësi administrative për ta ofruar atë nga zonat rurale drejt zonave urbane.

**Brenda vitit 2024**

### Përgjigje e subjektit të audituar:

#### Bashkia Dibër

Në Bashkinë Dibër transport publik ofrohet në qytetin e Peshkopisë dhe rreth qytetëse në njësitë administrative Maqellarë dhe Kastriot. Ndërsa për njësitë e tjera administrative nuk ka patur kërkesa

nga operatorë të caktuar për të ofruar shërbimin e transportit publik. Në këta njësi administrative ofrohet transport privat, pra mundësitë e lëvizjes së banorëve, përfshirë gratë dhe vajzat, nga zonat rurale drejt qendrës urbane të Bashkisë Dibër, ekzistojnë.

### **Bashkia Divjakë**

Duke ju referuar transportit publik, në qytetin Divjakë, e cila ka miratuar në Këshillin Bashkiak mbulimin e transportit publik për dy linja për qytetarët: linja Divjakë - Rrethrotullimi i Cermës, dhe anasjelltas, me stacione ndërmjetësuese të saj, si dhe linja Divjakë - Pushimi i Shoferit dhe anasjelltas, me stacione ndërmjetësuese të saj, me VKB nr. 59, datë 25.11.2024.

Ofrimi i shërbimit të transportit publik në Bashkinë Divjakë është bërë për 3 Njësi Administrative, ky shërbim është i rregullt për këto njësi.

Transporti publik ka ndikuar pozitivisht në jetën e familjeve në këto zona, pasi u ka dhënë mundësi vajzave dhe grave në zonën rurale të Bashkisë Divjakë për të aksesuar qytetin e Divjakës, në të cilin mundësitë për punësim janë më të larta.

### **Bashkia Gjirokastrë**

Për transportin publik drejt tregut të punës; Në bashkinë Gjirokastrë funksionon rrjeti i shërbimit të transportit në zonat rurale, si më poshtë: Njësia Administrative Antigone, ku punojnë 2 operatorë: Njësia Administrative Lunxhëri, ku punojnë 4 operatorë: Njësia Administrative Cepo, ku punojnë 2 operatorë: Njësia Administrative Picar, ku punojnë 1 operatorë: Njësia Administrative Lazarat, ku punojnë 8 operatorë:

Bashkia Gjirokastrë ndodhet në fazën e shqyrtimit të alternativave për bashkëpunim me operatorët e transportit publik, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm e aksesit nga zonat rurale drejt qendrave urbane dhe tregut të punës në përputhje me nevojat e identifikuar.

### **Bashkia Kukës**

Në Njësitë e Vetëqeverisjes vendore në Bashkinë Kukës ofrojmë transporte publike nëpërmjet dhënies së licencave për transport rreth Qytetës- ( Njësi Qytet)

### **Bashkia Lezhë**

Bashkia Lezhë nuk ka transport publik por në territorin tonë veprojnë subjekte private të cilat janë të pajisura me licence të vlefshme për një periudhë 10 vjeçare dhe mbulojnë të gjithë territorin e bashkisë duke siguruar akses dhe rritje ekonomike pasi ato garantojnë lidhje midis zonave të ndryshme duke u lejuar njerëzve të arrijnë në vendin e tyre të punës dhe gjithashtu për një kohezion më të mirë social.

Aktualisht bashkia Lezhë ka një vendim këshilli bashkiak i cili bën të mundur rregullimin e linjave rrethqytetase, oraret dhe stacionet e tyre, stacionet e linjave ndërqytetase, terminalin e transportit të udhëtarëve si dhe vend-ndodhjet e agjencive të transportit të udhëtarëve brenda vendit.

Bashkia Lezhë ka të mbuluar me transport ditor dhe me orare të përcaktuara Linjat rrethqytetëse ekzistuese për të gjitha njësitë administrative me transport.

Gjithashtu ka të vendosura dhe linja shtesë vetëm për sezonin turistik nga 15 Maji deri me 30 Shtator për linjën :

- 1.Gjadër –Shengjin ;
- 2.Dajç-Shengjin;
- 3.Blinisht-Shengjin;
- 4.Kallmet-Shengjin;

- 5.Zejmen-Shengjin;
- 6.Balldren –Shengjin;
- 7.Ungrej-Shengjin;
- 8.Manati-Shengjin; gjithashtu dhe një linjë tjetër për gjithë vitin dhe pa kufizime mjetesht.

### **Bashkia Shkodër**

Në Bashkinë Shkodër, transporti publik i udhëtarëve mbulon linjat qytetëse (urbane) dhe rrethqytetëse. Linjat rrethqytetëse, mbulojnë transportin publik të udhëtarëve, ndërmjet qytetit Shkodër si qendër bashkie me njësitë administrative. Bashkangjitur, do të keni VKB nr.5, datë 5.1.2022 “Për miratimin e rjetit të linjave dhe tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve, për periudhën afatmesme 2022-2024 në Bashkinë Shkodër” dhe VKB nr.68, datë 06.11.2026 “Për një ndryshim në VKB nr.5, datë 5.1.2022 “Për miratimin e rjetit të linjave dhe tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve, për periudhën afatmesme 2022-2024 në Bashkinë Shkodër”. Sqarojmë se, jemi në pritje të shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefekturës Shkodër të VKB nr.44, datë 25.06.2025 “Për miratimin e rjetit të linjave, stacioneve të qëndrimit dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë Shkodër”.

Në përfundim ju informojmë se Bashkia Shkodër ofron shërbimin e transportit të udhëtarëve të të gjitha moshave, kategorive dhe gjinive, me drejtim nga qendra administrative e qytetit Shkodër drejt të gjitha njësiteve Administrative të Bashkisë Shkodër dhe anasjelltas.

### **Bashkia Elbasan**

Gjatë procesit të konsultimit me grupet e interesit për hartimin e PVVBGJ doli si nevojë mbulimi i territorit me linja të transportit në aspektin gjeografik por edhe në orare për tu krijuar mundësi komunitetit veçanërisht grave/vajzave nga zonat rurale të punësohen, të ndjekin kurse të formimit profesional apo të aksesojnë në shërbime të tjera sipas nevojave. Për këtë arsye në Matricën e PVVBGJ 2025-2030 për fushën e ndërhyrjes Fuqizimi ekonomik i grave është parashikuar në masën 1.29 Përmirësimi i shërbimit të transportit publik në shtrirje gjeografike (veçanërisht për mbulimin e NJA të zonave rurale)<sup>2</sup> dhe afate kohore, si mundësi për lehtësimin e aksesit në tregun e punës për gratë në zonat rurale

Dokumenti në dispozicion

Draft Matrica e aktiviteteve të PVVBGJ 2025-2030

Informacion për zbatimin e PVVBGJ 2022-2024

### **Bashkia Krujë**

Bashkia Krujë, e ka të organizuar transportin publik në linjat deri në Njësitë Administrative si: Fushë Krujë – Bubq; Fushë Krujë – Thumanë; Fushë Krujë –Nikël deri në fshat Kurcaj; Krujë-Fushë Krujë. Ky shërbim ofrohet nga subjekte private të licencuara.

### **Bashkia Lushnjë**

Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH Bashkia Lushnjë ka tashmë linjë transporti urban, ku këtë vit, në 2025, ka shtuar linjën e lagjes “Saver”, e cila është si rrjedhojë e vlerësimit të nevojave për banoret e veçanërisht për gratë e kësaj zone. U vlerësua se mospasja e kësaj linje urbane pengonte gratë për të lëvizur më shpesh e për tu punësuar në qytet.

---

<sup>2</sup> Në përputhje me rekomandimin e KLSH 2024

Në zbatim të rekomandimeve dhe vlerësimit të nevojave në dy lagjet e rajonit 5 është bërë urbanizim i gjithë zonës së lagjeve “Saver” dhe “Karbonare” dhe pasja e transportit publik urban u ka ardhur në ndihmë grave dhe vajzave (por jo vetëm) të cilat sot janë punësuar në qytet dhe në zonat përreth. Transport publik urban, në vlerësim të situatës për tu ardhur në ndihmë grave dhe vajzave të asaj zone ka dhe fshatin Pluk, të Njësisë Administrative Golem, kjo gjë bën që këto gra të punësohen apo arsimohen në qytet.

Si vlerësim i situatës në njësitë e tjera administrative, dhe në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH problematike mbetet zgjidhja e transportit publik urban, sepse fshatrat e tjera preken nga autostrada dhe është e ndaluar të vendosesh urban. Ky problem është zgjidhur duke shtuar linja dhe orare të mjeteve të tjera private, si furgon, taxi etj.

### Bashkia Pogradec

Në lidhje me transportin publik në Njësitë administrative rurale/urbane të bashkisë Pogradec, ju informojmë se për 7 Njësitë Administrative rurale transporti sigurohet nga Shoqëritë e transportit rrethqytetas, të cilët funksionojnë sipas orareve dhe stacioneve të përcaktuara. Janë rreth 14 shoqëri transporti që ofrojnë rregullisht shërbimin e transportit në Njësitë Administrative rurale, duke mbuluar me shërbim pothuajse 90% të fshatrave të të gjitha Njësiave Administrative.

Tabela nr. 2 Përmbledhje e statusit të rekomandimit 2.1 në bashkitë subjekt auditimi.

Rek. 2.1 pyetja 2	Statusi i rekomandimit	Bashkia												
		Lushnje	Lezhe	Shkoder	Diber	Kukes	Vlore	Elbasan	Kruje	Berat	Divjake	Gjirokastrë	Kavaje	Pogradec
Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të marrin masa për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat që ka për mbulimin me transport publik në çdo njësi administrative për ta ofruar atë nga zonat rurale drejt zonave urbane.	Zbatuar Plotësisht		x											x
	Zbatuar pjesërisht	x												
	Në proces zbatimi													
	<b>Pa zbatuar</b>			x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	

### Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Një numër i lartë i bashkive (10) subjekt auditimi, nuk kanë marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit. Bashkia Lezhë dhe Pogradec e ka zbatuar plotësisht ndërsa Bashkia Lushnje pjesërisht rekomandimin.

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **pjesërisht i zbatuar**.

**2.2 Rekomandimi:** Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të vlerësojnë gjendjen e infrastrukturës në zonat rurale dhe të hartojnë një plan investimesh në varësi të situatës, të numrit të banorëve dhe nevojave të konstatuara.

**Brenda vitit 2024**

### **Përgjigje e subjektit të audituar:**

#### **Bashkia Dibër**

Pas zbatimit të reformës territoriale në 2015-ën, Bashkia Dibër trashëgoi nga ish komunat një infrastrukturë të amortizuar, veçanërisht në zonat rurale, ku mungesa e investimeve ndër vite kishte krijuar problematika të theksuara në të gjithë sektorët, sidomos në infrastrukturën rrugore.

Gjatë periudhës 10 vjeçare (2015-2025), falë financimeve nga qeveria qendrore dhe nga vetë buxheti i bashkisë, janë realizuar ndërhyrje të konsiderueshme si në infrastrukturën rrugore urbane, ashtu edhe në atë rurale, duke përmirësuar ndjeshëm vit pas viti gjendjen ekzistuese të rrugëve.

Vetëm gjatë vitit 2024 janë asfaltuar 13.9 km rrugë rurale me financim të vetë bashkisë. (Buxheti 2024).

Ndërsa janë parashikuar për asfaltim për vitin 2025 me financim të bashkisë 20.4 km rrugë rurale. (Buxheti 2025).

Po kështu, në planin buxhetor afatmesëm 2026-2028 janë planifikuar ndërhyrjet për asfaltim të rrugëve të tjera rurale. (PBA 2026-2028).

Krahas ndërhyrjeve për asfaltim, Bashkia Dibër, përmes Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, ka vijuar në mënyrë të vazhdueshme ndërhyrjet për mirëmbajtjen dhe për rehabilitimin e rrugëve rurale.

#### **Bashkia Divjakë**

Bashkia Divjake është në procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit është duke punuar me planin e detajuar të investimeve për periudhën Afatmesme 2026-2028, duke marr parasysh nevojat më emergjente të Banorëve të Bashkisë Divjakë duke përfshirë këtu edhe Buxhetimin mbi bazë gjinore.

#### **Bashkia Kukës**

Nga ana e Bashkisë është vlerësuar gjendja e infrastrukturës në zonat rurale dhe janë hartuar dhe po zbatohen një sërë projektesh, si nga financimet e Qeverisë Shqiptare, nga fondet e Bashkimit Evropian në kuadrin e bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe nga financimet e Bashkisë Kukës. Janë një sërë projektesh si:

- Rehabilitim i rrugës në Njësinë Administrative Topojan.
- Rehabilitim i rrugëve të zonave ndërkufitare.
- Ndërtim i rrugës Kolesian – Bjeshkë, e cila ndikon në zhvillimin e agroturizmit.
- Riparime të rrugëve rurale si rruga e Orgjostit, rrugët në Njësinë Administrative Malzi.
- Është dorëzuar projekti i rrugës që lidh fshatrat Mamëz – Myç – Mamëz, Surrojë, Arrën etj.

#### **Bashkia Lezhë**

Bashkia Lezhë gjatë vitit 2024 ka realizuar sistemimin dhe asfaltimin e 21 rrugëve rurale. Ky plan investimesh është realizuar në :

1. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Tanush Topia 2 (Sheher)
2. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Kolepepje (Kallmet i Vogel)
3. Sistemimi dhe asfaltimi i rruga e Xhoceve (Kallmet i Vogel)

4. Sistemimi dhe asfaltimi i rruga e Markapalëve (Kallmet i Vogel)
5. Sistemimi dhe asfaltimi i rruga e Habereve (Kallmet i Vogel)
6. Sistemimi dhe asfaltimi i rruga e Kryezezeve (Kallmet i Vogel)
7. Sistemimi dhe asfaltimi i rruga e Lekjeve (Kallmet Madh)
8. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Bajraktari (Manati)
9. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës 54 (Manati)
10. Sistemimi dhe asfaltimi rruga Nikolli Stomthane (Barbullojë e Re)
11. Sistemimi dhe asfaltimi rruga e Lekajve (Rrile)
12. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës së ambulances (Tresh)
13. Sistemimi dhe asfaltimi i rruga e Kovaceve (Tresh)
14. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës së Varrezave (Spiten)
15. Sistemimi dhe asfaltimi i rruga 7 Bajraket (Gryke Lumi Shenkoll)
16. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës se Kishes (Shenkoll)
17. Sistemimi dhe asfaltimi i rruga Viktoria (Shenkoll)
18. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës së Zejmenit të Vjetër (Zejmen)
19. Sistemimi dhe asfaltimi rruga e Gjokajve (Gajush)
20. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës në lagjen Margegaj (Pllane)
21. Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës në Varrezat e Berzanes (Zejmen).

### **Bashkia Elbasan**

Sa i përket investimeve në infrastrukturë bazuar dhe ne raportin e monitorimit të PVVBGJ bashkia ka investuar në:

- rikonstrucionin e 18 objekteve shkolla, kopshte, çerdhe nga të cilat 10 në zonat urbane dhe 8 në zonat rurale, për vitin 2024. Rikonstruksionin e pjesëshëm të 51 objekteve arsimore, nga të cilat 29 në zonat urbane dhe 22 në zonat rurale, për vitin 2024.
- Pajisjen e shkollave, kopshteve, çerdheve me kamera për të rritur nivelin e sigurisë së fëmijëve vajza e djem. Gjithashtu, bashkia financon çdo vit pagesën e kopshteve/çerdheve për 35 raste të fëmijëve të familjeve në nevojë, kryesisht Rom/Egjiptjan, si dhe të rasteve të fëmijëve të përfshirë në UM/UMM. Kanë përfituar gjithsej 105 fëmijë në nevojë për periudhën 2022-2024.
- Në mbështetje të grave sipërmarrëse është ngritur një treg i vogël zejesh në rrugën Egnatia, ku gra dhe vajza ekspozojnë dhe shesin produkte artizanale tradicionale. Bashkia ka ndihmuar në lehtësimin e barrës fiskale dhe ofrimin e hapësirës publike. Megjithatë Hartëzimi i iniciativave ekonomike të iniciuara, zhvilluara apo trashëguara nga gratë në Bashkinë Elbasan dhe mbështetja për brandimin e produkteve dhe përgatitjen e historikut të trashëgimisë janë aktivitete në proces, duke mbetur një fushë për ndërhyrje të mëtejshme

Në vijimësi të përmirësimit të infrastrukturës në zonat rurale si dhe të mbështetjes të grave për tu punësuar apo vetëpunësuar duke ngritur në PVVBGJ 2025-2030 janë parashikuar masat:

1.1 Përcaktimi nga bashkia i fushave prioritare të zhvillimit ekonomik, ku do fokusohet vëmendja për periudhën 2025 – 2030, përmes hartimit të Planit Vendor të Zhvillimit Ekonomik, me ndjeshmëri gjinore

1.3 Krijimi i lehtësirave infrastrukturore për zhvillimin e bizneseve të vogla/sipërmarrjeve të reja nga gratë dhe të rejtat/rinjtë nga grupet e cënueshme me fokus të veçantë gratë dhe të rejtat në zonat rurale.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> Në përputhje dhe zbatim të rekomandimeve të KLSH 2024

1.22 Informimi i grave, të rejave e të rinjve që jetojnë në zonën nga kalon rruga Egnatia, mbi mundësitë e zhvillimit ekonomik përmes ngritjes së agrobizneseve, zhvillimit të turizmit familjar, etj.

1.14 Takime informuese me nxënës dhe nxënës të shkollave nëntë vjeçare dhe të mesme, sidomos në zonat rurale, mbi thyerjen e stereotipave gjinore në punësim, si dhe shërbimet e punësimit dhe formimit profesional që ofrohen nga AKPA (përfshirë dhe programet e vetëpunësimit, mbulimin e shpenzimeve të transportit, bursa, programi i garancisë rinore, etj).

Dokumenti në dispozicion

Draft Matrica e aktiviteteve të PVVBGJ 2025-2030

Informacion për zbatimin e PVVBGJ 2022-2024

### **Bashkia Krujë**

Bashkia Krujë, për çdo vit miraton buxhetin e saj, në të cilën janë parashikuar kryerja e investimeve në infrastrukturën rrugore. Kjo bëhet gjithnjë në konsultim me publikun. Për vitin 2024, janë miratuar investime në infrastrukturën rrugore, shtrim rruge me asfalt për 24 segmente rrugore.

### **Bashkia Lushnje**

Në zbatim të rekomandimeve të lëna dhe vlerësimit të situatës, Bashkia Lushnje vendosi të hartojë plane investimi në zonat rurale, sidomos në funksion të rikonstruksioneve të rrugëve, të cilat po zbatohen nga Ndërmarrja e Pasurisë Publike e Bashkisë Lushnje.

Si nevojë dhe vlerësim i situatës në fshatra, rekomandim i lënë nga KLSH, gjithashtu janë realizuar shtrim dhe riparime të shumë rrugëve të shtruara tashmë, të cilat kanë qenë tepër të amortizuara dhe sot mbulohen nga lëvizja e mjeteve. Kjo u ka ardhur në ndihmë grave dhe vajzave (por jo vetëm) të cilat sot janë punësuar në qytet, por edhe në zonat përreth vendbanimit të tyre.

Sipas vlerësimit dhe nevojave, janë realizuar dëgjesa publike me banorë, në zbatim të rekomandimit të lënë, ku bashkia, në zbatim të rekomandimeve, ka miratuar plane investimi në zonat rurale. Po përmendim disa prej tyre:

- Sistemi dhe urbanizimi i bllokut të banimit, lagjja Savër dhe lagjja Karbunarë;
- Rikonstruksion i rrugës së “Kishës Shën Koli”, Krutje e Sipërme;
- Rruga e fshatit Hajdaraj, NjA Golem;
- Rruga e Bregut, Zhyme, Krutje;
- Rruga Zham Sektor, Dushk;
- Rruga Çanakaj, Hysgjokaj;
- Rruga Taq Loshe, Rajoni 1;
- Rruga në lagjen e Haskallarëve, Rajoni 5;
- Rruga e fshatit Ballagat.

(Në buxhetin e vitit 2025 reflektohet kjo gjë, sidomos në funksion të rrugëve në Ndërmarrjen e Pasurisë Publike).

Referuar kësaj, në vitin 2024 pati një numër të madh investimesh në rrugë (përcaktuar si prioritet), sidomos ato me rëndësi për gratë dhe vajzat, në zbatim të rekomandimeve të lëna.

- Në zbatim të rekomandimeve të lëna, bashkia ka hartuar plane investimi në kopshte, çerdhe, në shkolla etj.;
- Ndërtimi i shkollave të reja në lagjen “Karbunare”, rikonstruksioni i Gjinnazit “Jani Nushi” Lushnje, shkollës së Mesme Mekanike “Hasan Gina”;
- Fillimi së shpejti i rikonstruksionit të shkollës Hysgjokaj;

## Bashkia Pogradec

Bashkia Pogradec në buxhetin e vitit 2024 dhe 2025 ka planifikuar ndërhyrje të ndryshme rehabilituese për rrugë dhe objekte shkollore në Njësitë Administrative, sipas nevojave të konstatuara. Gjithashtu, nga muaji shtator pritet të hapet për transportin publik aksi i plotë Qukës - Qafë Ploçë. Ky aks i rëndësishëm do të shkurtojë distancën dhe kohën e udhëtimit nga zonat rurale drejt atyre urbane dhe stimulojë në perspektivë impulse të reja të zhvillimit ekonomik dhe punësimit edhe për zonat rurale të bashkisë Pogradec.

Tabela nr. 3 Përmbledhje e statusit të rekomandimit 2.2 në bashkitë subjekt auditimi.

Rek. 2.2 pyetja 2	Statusi i rekomandimit	Bashkia												
		Lushnje	Lezhe	Shkoder	Diber	Kukes	Vlore	Elbasan	Kruje	Berat	Divjake	Gjirokastrer	Kavaje	Pogradec
Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të vlerësojnë gjendjen e infrastrukturës në zonat rurale dhe të hartojnë një plan investimesh në varësi të situatës, të numrit të banorëve dhe nevojave të konstatuara.	Zbatuar Plotësisht	x	x					x						
	Zbatuar pjesërisht													
	Në proces zbatimi													
	<b>Pa zbatuar</b>			x	x	x	x		x	x	x	x	x	x

### Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Një numër i lartë i bashkive (10) subjekt auditimi, nuk kanë marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit. Bashkitë Lezhë, Lushnje dhe Elbasan e kanë zbatuar plotësisht rekomandimin. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **pjesërisht i zbatuar**.

### Pyetja 3 A ka ndërveprim të institucioneve qendrore me strukturat vendore për nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale?

**Nënpyetja 1.3** A është monitoruar nga AKPA zbatimi i politikave të punësimit të grave në zonat rurale?

**1. Gjetje nga auditimi:** Detyrimet e përcaktuara në akt marrëveshjet e nënshkruara nga Bashkitë Lushnje, Lezhë dhe Elbasan nuk janë zbatuar. Nuk dokumentohen aktivitetet e zhvilluara në kuadër të nxitjes së punësimit. Njësitë Administrative që janë në distancë të largëta nga Zyrat Vendore të Punës, nuk regjistrojnë punëkërkesit në një regjistër i cili më pas të dërgohet periodikisht pranë Zyrës Vendore të Punës.

Gjithashtu, në Njësitë Administrative nuk është caktuar një person me përgjegjësi për të koordinuar punën dhe të mbajë kontakte të vazhdueshme me Zyrën Vendore të Punës për të adresuar çështjet e punësimit.

AKPA nga ana e saj nuk ka dokumentuar ecurinë e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkuara me Bashkitë Elbasan, Lushnje dhe Lezhë. Gjithashtu, nuk është kryer një vlerësim mbi efektivitetin e tyre në përmirësimin e situatës së punësimit.

**1.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të monitorojë zbatimin e kushteve të marrëveshjeve aktive që ka me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Në vijim të synohet mbledhja e informacionit sipas njësive administrative me qëllim identifikimin e grave rurale që duan të punësohen. Gjithashtu, në akt marrëveshjet që do të lidhë në vijim me bashkitë të përfshijë edhe aktivitete me fokus në grupin e grave rurale.

**Brenda shtator 2024 dhe në vijimësi**

**Përgjigje e subjektit të audituar:**

Në përgjigje të rekomandimit të dhënë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka ndërmarrë hapa konkretë për forcimin e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit. Në këto marrëveshje, konkretisht në seksionin “Qëllimi”, pika 4, është përfshirë angazhimi për ofrimin e përbashkët të shërbimeve në njësi administrative ku mungojnë strukturat vendore të punësimit, ose ku distanca fizike krijon pengesa për akses të rregullt në shërbime.

Për të rritur mundësitë për bashkëpunim në nivel vendor dhe për të avancuar qasjen gjithëpërfshirëse ndaj punësimit, AKPA është e angazhuar në disa projekte me mbështetje ndërkombëtare që veprojnë pikërisht në këtë drejtim:

- Projekti “Forcimi i kapaciteteve institucionale vendore për migracionin”, i zbatuar nga I. me mbështetjen e G.. dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, ku janë zhvilluar konsultime me strukturat e 61 bashkive dhe institucione të tjera për të integruar migracionin si një faktor zhvillimi lokal.
- Projekti “BE për Përfshirjen e Tregut të Punës (EU4LMI)”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP, ku AKPA është partnere për zbatimin e Menaxhimit të Integruar të Rastit (MIR) në nivel vendor, në bashkëpunim me P... Suedez dhe FSHDPAK.
- Paketa e zgjeruar e shërbimeve për gratë në zonat rurale, e zhvilluar nga AKPA me mbështetjen e E... France, dhe që u pilotua në tre bashki: Elbasan, Lushnjë dhe Kamëz, përmes një modeli operacional të shërbimeve të personalizuar dhe bazuara në të dhëna konkrete.

Këto projekte, së bashku me marrëveshjet e bashkëpunimit që po thellohen me njësitë vendore, përfaqësojnë një qasje të re dhe të qëndrueshme për të fuqizuar punësimin në nivel lokal, me fokus të posaçëm në përfshirjen e grave dhe të grupeve më të margjinalizuara.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i pa zbatuar**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk ka ngritur pika shërbimi në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të cilat nuk kanë zyra vendore punësimi, me qëllim trajtimin e çështjeve të punësimit, sikundër është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

**2.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të bashkëpunojë me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të ngritur pika shërbimi për trajtimin e çështjeve të punësimit në ato bashki ku nuk ka zyra vendore punësimi.

**Brenda shtator 2024**

## **Përgjigje e subjektit të audituar:**

### **Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive**

Në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi dhe për të siguruar kohezion territorial dhe qasje të barabartë në shërbimet e punësimit në të gjithë territorin, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka ndërmarrë një sërë masash konkrete:

Është rishikuar dhe miratuar struktura organizative e Drejtorive Rajonale të Punësimit, ku për herë të parë janë ngritur dy zyra vendore punësimi lëvizëse (mobile) në Tiranë dhe Durrës. Këto njësi do të angazhojnë specialistë që ofrojnë shërbime në njësi administrative të pa mbuluara nga struktura të përhershme.

Në disa bashki ku nuk ekzistojnë zyra të dedikuara, janë caktuar specialistë të punësimit që ofrojnë shërbime të rregullta, si në: Rrogozhinë, Shijak, Poliçan, Vau i Dejës, Patos, Roskovec, Divjakë etj. Këto praktika janë mbështetur përmes bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe janë të dokumentuara në strukturat zyrtare të miratuara të AKPA.

Një nga risitë më domethënëse është digjitalizimi i shërbimeve të punësimit, i cili ka rritur ndjeshëm mundësinë e aksesit në shërbime për individët që jetojnë në zona të largëta. Të gjitha shërbimet kryesore të punësimit ofrohen tashmë online përmes portalit e-Albania, si dhe në faqen zyrtare të AKPA dhe portalin e punësimit [www.puna.gov.al](http://www.puna.gov.al). Ky zhvillim ka lehtësuar aksesin, ka shmangur nevojën për paraqitje fizike në sportel dhe ka përmirësuar transparencën dhe efikasitetin në ofrimin e shërbimeve.

Gjithashtu, në kuadër të projekteve ndërkombëtare me fokus në qasjen vendore dhe gjithëpërfshirëse, AKPA ka qenë partnere në nisma të rëndësishme që e mbështesin këtë rekomandim:

- Projekti EU4LMI – BE për Përfshirjen e Tregut të Punës, që promovon Menaxhimin e Integruar të Rastit (MIR) në nivel vendor, në bashkëpunim me UNDP, P.. Suedez dhe FSHDPAK.
- Paketa e zgjeruar e shërbimeve për gratë në zonat rurale, e mbështetur nga E.. France, e cila pilotohet në Elbasan, Lushnjë dhe Kamëz dhe përfshin ofrimin e shërbimeve punësimi aty ku nuk ka zyra ekzistuese.
- Projekti me I. për Forcimin e kapaciteteve institucionale vendore për migracionin, që ka përfshirë 61 bashki në konsultime për qasjen ndaj punësimit dhe riintegrimin në nivel lokal.

Përmes kombinimit të formave të decentralizuara të ofrimit të shërbimeve, të përhershme, të lëvizshme apo digjitale, dhe nëpërmjet bashkëpunimit të strukturuar me bashkitë, AKPA po zbaton një model të ri për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive në shërbimet e punësimit për të gjithë qytetarët, pavarësisht vendbanimit.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **pjesërisht i zbatuar**.

### **3. Gjetje nga auditimi:**

Shërbimet e punësimit të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk janë plotësisht të bashkërenduara me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komunikimi midis strukturave qendrore dhe vendore nuk identifikon nevojat e grave në përgjithësi dhe grave rurale në veçanti.

**3.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të identifikojnë nevojat e grave rurale për pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës si dhe të planifikojnë fonde për financimin e programeve të nxitjes së punësimit të tyre.

**Brenda shtator 2024 dhe në vijimësi**

**Përgjigje e subjektit të audituar:**

**Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive**

Në funksion të rekomandimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka ndërmarrë një qasje të strukturuar dhe të shumanshme për të identifikuar dhe mbështetur gratë në zonat rurale në drejtim të përfshirjes së tyre në tregun e punës. Kjo qasje është realizuar përmes kombinimit të instrumenteve ligjorë, mekanizmave institucionalë dhe ndërhyrjeve të drejtpërdrejta në nivel vendor, me fokus të posaçëm te target-grupet vulnerabël, përfshirë gratë që jetojnë në njësi administrative të pambuluara nga shërbimet publike të punësimit.

Në këtë drejtim, është në zbatim VKM nr. 401, datë 19.06.2024, e cila përmes programit të riintegritimit social synon mbështetjen me shërbime të specializuara të këshillimit dhe punësimit për gratë që jetojnë në zona pa struktura vendore punësimi. Ky program, përveç shërbimeve bazë, ofron mbështetje financiare dhe stimuj për pjesëmarrjen në tregun e punës, përfshirë subvencione për kujdesin ndaj fëmijëve apo të moshuarve, si dhe bonuse në rast punësimi deri në 6 muaj pas përfundimit të programit.

Përtej aspekteve programatike, AKPA ka mbështetur qasjen proaktive nëpërmjet mekanizmave ndërinstitutionalë të referimit për punësim, të vendosur me VKM nr. 822/2019 dhe Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë përgjegjëse për punësimin dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në të gjitha qarqet e vendit, janë ngritur dhe funksionojnë 12 komisione rajonale që vlerësojnë dhe referojnë për punësim anëtarët në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, duke përfshirë edhe gratë në zonat rurale. Këto komisione operojnë në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e pushtetit vendor dhe përfaqësuesit lokalë të AKPA, duke rritur ndërveprimin dhe mbulimin territorial.

Bëjmë me dije gjithashtu se AKPA referuar planit të saj vjetor, detyrimeve që burojnë nga strategjitë e ndryshme por dhe më specifikisht planit vjetor të rakorduar e dakordësuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi trajtimin e kategorisë NE vendos objektiva/indikatore konkret për trajtimin e punëkërkuesve të papunë të skemës së Ndihmës Ekonomike. Indikatorët specifik janë të përfshirë në Kartën e Performancës, e cila miratohet në fillim të vitit nga ministri dhe më pas shpërndahet në nivel rajoni dhe zyre vendore. Treguesit e përcaktuar ndiqen dhe monitorohen në nivel mujor për të siguruar përmbushjen e tyre dhe efikasitetin e zbatimit të programeve. Treguesit në të njëjtën kohë ndiqen e raportohen dhe në nivel gjinor.

Theksojmë gjithashtu se në kuadër të vlerësimit të efikasitetit të programeve gjatë procesit të gjurmimit të përfituesve të programeve të nxitjes së punësimit, një vëmendje e veçantë i kushtohet dhe grupeve vulnerabël ku nxirren dhe analizohen të dhëna specifike për këto grupe, përfshirë dhe NE.

Së fundi, në kuadër të zgjerimit të ndërhyrjeve për gratë në zonat rurale, AKPA po bashkëpunon me partnerë ndërkombëtarë si E... France, UNDP, P.. Suedez, si dhe me I., për të pilotuar paketa gjithëpërfshirëse të shërbimeve të punësimit të përshtatura për këtë target-grup, si dhe për të forcuar bashkëpunimin institucional me bashkitë. Këto ndërhyrje janë pjesë e një strategjie afatmesme që synon jo vetëm përfshirjen e grave në tregun e punës, por dhe fuqizimin e tyre social dhe ekonomik në një mënyrë të qëndrueshme dhe të matshme.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i pa zbatuar**.

**4. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive edhe pse e ka monitoruar periodikisht zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara për t'u realizuar me qëllim arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019-2022, nuk konstatohet se si janë përdorur konkretisht rezultatet e monitorimit për të përmirësuar politikën e punësimit, apo cilat janë përmirësimet specifike që janë bërë përkatësisht në referencë të rezultateve të monitorimit.

**4.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të analizojë rezultatet e monitorimit të aktiviteteve të zhvilluara në përmbushje të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe të ndër marrë aktivitete specifike që sjellin adresimin e problematikave të konstatuara nga rezultatet e monitorimit.

**Në vijimësi**

#### **Përgjigje e subjektit të audituar:**

##### **Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive**

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive monitoron në mënyrë të vazhdueshme aktivitetet e strategjisë lidhur me çështjet ku është përcaktuar si institucion përgjegjës apo bashkëpërgjegjës, dhe përcjellë rezultatet e monitorimit në ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe aftësive. Gjithashtu në rastet e evidentimit të problematikave apo identifikimit të elementëve që sjellin përmirësim të politikave aktive të tregut të punës, AKPA është angazhuar në formë proaktive për iniciimin e ndryshimeve të programeve. Gjithsesi, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është institucion zbatues dhe jo hartues i politikave aktive dhe pasive të tregut të punës. Në të njëjtën kohë bëjmë me dije se vlerësimi i efektivitetit të programeve aktive të tregut të punës, referuar përcaktimeve të VKM-ve të këtyre programeve nuk është tagër i AKPA-s.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe **i pa zbatuar**.

#### **IV. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE**

Në vijim të Projekt raportit të dërguar, nga ana e subjekteve të audituara janë paraqitur observacione lidhur me Akt-Verifikimet nr. 2, datë 02.07.2025 dhe Akt-Verifikimi nr. 14, datë 18.07.2025, mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna, përkatësisht subjektet Bashkia Berat dhe Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim.

**Nëpërmjet shkresës “Observacion i Akt Verifikimit nr. 2 në Bashkinë Berat”, nr. 3601/1 datë 11.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 684/3 datë 14.07.2025, Bashkia Berat ka paraqitur observacione si më poshtë vijon:**

Në lidhje me gjetjen nr. 2 të zbatimit të rekomandimeve ku thuhet:

Gjetja nr. 2: “U konstatua se në disa njësi të Q. Vendore nuk sigurohet transporti publik përveçse në njësitë administrative urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohen kushte lehtësimi, për të afuar gratë e vajzat sa më afër tregut të punës”:

Sqarojmë se :

Bazuar në ligjin nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit,

Është miratuar në Këshillin Bashkiak me vendim nr. 116, datë 22.12.2016 miratimi i linjave rreth qytetëse, (Zonat Rurale) stacionet e qëndrimit, numri i orareve dhe tarifa e biletave

1. Roshnik-Berat-Roshnik
2. Karkanjoz- Berat- Karkanjoz
3. Bogdani 1- Berat -Bogdani 1.
4. Duhanas - Nj. Administrative Velabisht – Duhanas
5. Berat -Sinjë- Berat
6. Veterrik–Starovë – Velabisht-Berat-Velabisht -Starovë- Veterrik
7. Molisht-Veleshnje-Gjeroven-Berat - Gjeroven – Veleshnje – Molisht
8. Malinat – Berat – Malinat
9. Bilçë – Nj.Administrative Velabisht – Bilçë
10. Drobonik -Nj.Administrative Velabisht – Drobonik
11. Lapardha 2 – Otlak – Berat - Otlak – Lapardha 2.
12. Qereshnik – Ullinjas – Berat - Ullinjas - Qereshnik
13. Berat – Lumas – Berat
14. Berat – Terpan – Berat

Vendimi Nr. 30, datë 30.03.2017, (4 orare shtesë në linjat 1,2,3,4 të VKB 116 + 2 linja të reja 1 dhe 2)

1. Veleshnje–nj. Administrative Velabisht (Starovë)-Veleshnje.
2. Gjeroven–Nj. Administrative Velabisht (Starovë)-Gjeroven.  
Nr. i linjave rreth qytetëse 16  
Nr. i operatoreve juridik 3  
Nr. i operatorëve fizik 6

Këto subjekte janë licencuar në vitin 2017 dhe licenca e tyre është e vlefshme deri në vitin 2027, ndërsa certifikatat janë rinovuar në vitin 2022, sipas kriterëve të udhëzimit 5627, datë 18.11.2016.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Observacioni i paraqitur nga Bashkia Berat dhe argumentimi i tij, i referohet periudhës e cila është audituar dhe rekomandimit të lenë nga grupi i mëparshëm i auditimit. Auditimi i kryer në vitin 2023, me temë: “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”, kishte si periudhë auditimi nga data 01.01.2019 deri më datën 30.09.2023 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me Vendimin nr. 27 datë 08.02.2024 të Kryetarit të KLSH-së si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 262/34/35/36/37/38/39/40/41/42/43/44/45/46/47 prot., datë 12.02.2024.

Observacioni i paraqitur është jashtë periudhës së auditimit të zbatimit të rekomandimeve dhe si i tillë nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

### ***Observim i pikës 2.2***

Në lidhje me Rekomandimin nr. 2.2 ku thuhet:

“Njësitë e qeverisjes vendore të vlerësojnë gjendjen e infrastrukturës në zonat rurale dhe të hartojnë një plan investimesh në varësi të situatës, të numrit të banorëve dhe nevojave të konstatuara,”

Sqarojmë se : Nga Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë të Bashkisë Berat janë aplikuar projekte për fuqizimin e grave në zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës., konkretisht :

Nga Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve janë aplikuar dy projekte:

#### 1. Green Market (Shtëpizë) - 2021

Qëllimi: Themelimi i një Green Market (shtëpizë) për shitjen dhe promovimin e produkteve të grave fermerë dhe artizane.

Fuqizimi ekonomik i grave përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe futjes në skemat e biznesit. Mbështetje për hyrje në tregje të reja dhe përmirësim të kushteve të punësimit për gratë.

Nxitja e produkteve të reja dhe përdorimi i teknologjive të qëndrueshme.

Pikat Kryesore të Marrëveshjes:

Shtëpiza (Green Market) do të përdoret vetëm për shitje të produkteve të grave fermerë dhe do të mbetet pronë e Bashkisë Berat. Shoqata “N.. dhe I..” do ta administrojë për 5 vjet. Mbështetje për gratë në zhvillimin e aftësive dhe akses në tregje më të gjera. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm pune dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Objektivat dhe Aktivitetet:

Bashkëpunim për projekte të përbashkëta dhe modele të qëndrueshme të biznesit. Hartim dhe zbatim të programeve të grandeve dhe produkteve inovative. Promovim, pjesëmarrje në konferenca dhe punëtori. Partneritete me organizata shkencore dhe aktorë të tjerë në nivel rajonal e kombëtar. Aplikime të përbashkëta për fonde nga programet e BE-së. Në përfundim, kjo marrëveshje synon të krijojë një model funksional për fuqizimin ekonomik të grave përmes sipërmarrjes dhe inovacionit në zonën e Beratit.

#### 2. Fuqizimi i grave në zonat rurale për vlerësimin e nevojave për investime kapitale publike në bashkinë Berat.

Ky projekt synoi të fuqizonte pjesëmarrjen aktive të grave nga zonat rurale të Bashkisë Berat në proceset e vendimmarrjes vendore, veçanërisht në identifikimin, prioritizimin dhe propozimin e investimeve kapitale publike që përmbushin nevojat reale të komunitetit.

Projekti u financua nga UN W.A., me mbështetjen e Qeverisë Suedeze, dhe u zbatua nga Qendra A. për B. G.– G., në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Berat.

Në qendër të projektit ishin gratë nga katër zona rurale të bashkisë, të cilat u angazhuan në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes aktiviteteve ndërjegjësuëse, trajnimeve dhe sesioneve praktike. Metodave pjesëmarrëse që u përdorën mundësuan që gratë të shprehnin lirshëm mendimet, përvojat dhe prioritetet e tyre, duke i konsideruar ato jo vetëm si përfituese të shërbimeve publike, por si kontribuuese aktive në hartimin e politikave dhe buxhetimit lokal.

Një nga aktivitetet kyçe të projektit ishte organizimi i Forumit Vendor “Gratë dhe Investimet kapitale vendore”, i cili u zhvillua më 9 nëntor 2024, në ambientet e Hotel C. në Berat (ish-Universiteti i Beratit). Ky forum shërbeu si një hap konkret drejt përfshirjes më të madhe të grave në proceset vendimmarrëse.

Në forum morën pjesë:

- Gratë përfaqësuese nga zonat rurale, që paraqitën prioritetet e tyre në lidhje me investimet publike;
- Organizata lokale të shoqërisë civile (OSHC), që mbështesin përfshirjen gjinore dhe zhvillimin komunitar;
- Përfaqësues të Bashkisë Berat, që dëgjuan propozimet e komunitetit dhe u angazhuan për t'i reflektuar në planet zhvillimore.

Forumi përfshiu prezantimin e qëllimit të nismës, ndarjen e konkluzioneve të dala nga workshop-et paraprake me gratë (“Ide dhe mendime të grave mbi zgjidhjet e mundshme”), diskutime në grupe të vogla dhe shkëmbim mendimesh ndërmjet grave dhe përfaqësuesve institucionalë. Aktiviteti u mbyll me paraqitjen e konkluzioneve dhe një drekë bashkëbisedimi.

Ky projekt kontribuoi në ndërgjegjësimin gjinor, rritjen e kapaciteteve të grave rurale dhe vendosjen e një praktike të mirë për buxhetimin e ndjeshëm ndaj gjinisë në nivel vendor, duke krijuar një model që mund të shërbejë edhe për bashki të tjera në Shqipëri.

Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë e Bashkisë Berat, në hartimin e politikave dhe zbatimin e programeve për të rinjtë e Zonave Administrative janë pjesë integrale dhe në fokus të disa iniciativave që zbatohen aktualisht e kanë

Në evidentimin e nevojës për një Shkollë Verore të zbatuar pranë zonave të banimit dhe Shkollave Qendër Komunitare, (e zbatuar për tre edicione; që prej vitit 2023) të rinjtë nga zonat administrative, pjesë e KVR kanë dhënë një kontribut të vlefshëm dhe me peshë në propozime mbi programe dhe aktivitete të zbatuara me fëmijët përfitues.

Si pjesë e KVR, të rinj/të reja nga zona administrative të Bashkisë Berat, jo vetëm kanë qenë pjesë e të rinjve të miratuar formalisht si anëtarë me vendim të Këshillit Bashkiak, por kanë shfaqur vazhdimisht angazhim dhe pjesëmarrje serioze në takime dhe aktivitete e programe për shërbime të propozuara.

Të rinj e të reja të cilët studiojnë e jetojnë në zona administrative kanë dhënë kontribut në komunitet nëpërmjet angazhimit në disa programe vullnetarizmi: Shkolla Verore në Shkollat Qendër Komunitare, “Half Green Marathon”, Rrjeti Urat”.

Vajza nga zonat administrative të Bashkisë Berat kanë qenë pjesë e projektit në bashkëpunim me Y... A...; ku janë trajnuar dhe fuqizuar 25 vajza të grup moshës 15-18 vje? në hartim dhe shkrim të mini-projekteve në mbrojtje të mjedisit. Në përfundim të projektit; njëra prej ideve u vlerësua fituese dhe e përshtatshme për financim dhe zbatim.

Fokusi ndaj të rinjve të zonave administrative reflektohet po ashtu në projektin për një Qendër Rinore Multifunktionale në Lapardha; si pjesë e përmirësimit të infrastrukturës rinore dhe ofrimit të kushteve optimale për zhvillim e të rinjve.

Vëmendja për ndërhyrje dhe mbështetje të vazhdueshme për të rinjtë e zonave administrative, reflektohet po ashtu në disa seksione të Planit Lokal të Veprimit 2025-2027:

Zgjerimi i shërbimeve në qendrat apo hapësirat publike të projektuara për të rinjtë; me fokus zonat administrative. Fokus i vazhdueshëm ndaj hapësirave rekreative dhe përmirësimi i qendrave sportive.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Observacioni i subjektit nuk lidhet me rekomandimin e lenë për vlerësimin e gjendjes së infrastrukturës në zonat rurale dhe të hartimin e një plani investimesh në varësi të situatës, të numrit të banorëve dhe nevojave të konstatuara.

Subjekti nuk ka paraqitur evidencë për zbatimin e rekomandimit, për këtë arsye nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit dhe statusi mbetet i pa zbatuar.

**Nëpërmjet shkresës “Observacion mbi Akt Konstatimin nr. 14”, me nr. prot. 1387/2, datë 24.07.2025, protokolluar në KLSH me nr. 684/4 datë 25.07.2025, Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim”, ka paraqitur observacione si më poshtë vijon:**

**Në lidhje me qëndrimet tuaja, konsiderojmë si më poshtë:**

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, si institucion në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ka një mandat të qartë si zbatues i politikave të punësimit, të hartuara dhe miratuara nga ministria përkatëse. Më konkretisht përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të punësimit përcaktohen në Ligjin nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit” dhe VKM-në nr.554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, ku më specifikuat:

- Germat b dhe c të Nenit 5 të Kreut II të ligjit të sipërcituar përcaktojnë:

Kompetencat e ministrisë në lidhje me politikën e punësimit

b) harton politika të reja për rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë;

c) harton programe dhe merr masa për nxitjen e punësimit e të vetëpunësimit;

- Germa b e Pikës 2 të Nenit 14 të Kreut V të ligjit të sipërcituar përcakton:

Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ushtron kompetencat e mëposhtme:

b) në bashkëpunim me punëdhënësit, administron dhe zbaton programet e nxitjes së punësimit;

- Germa b e Pikës 1 të Kreut II të VKM-së së sipërcituar përcakton:

AKPA-ja ka përgjegjësi që: b) të organizojë punën për administrimin dhe zbatimin e programeve aktive e pasive të tregut të punës;

Për sa më sipër **AKPA nuk është hartues i politikave, por zbatues e tyre**. Ajo ka vetëm rolin e propozuesit për sa i përket akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me nxitjen e punësimit.

Në këtë kuptim, një shembull konkret është VKM Nr. 401, datë 19.06.2024, e cila u propozua nga AKPA dhe u hartua nga MEKI, duke u fokusuar në mbështetjen e grave që jetojnë në zona të pambuluara nga shërbimet e punësimit, me një qasje gjithëpërfshirëse për ri integrimin e tyre në tregun e punës.

Gjithashtu, Zyrat e Punësimit, sipas legjislacionit në fuqi, regjistrojnë persona të aftë dhe të gatshëm për punë që paraqiten rregullisht pranë zyrave, **por nuk kanë kompetenca për të regjistruar persona që nuk paraqiten apo kanë problematika të tjera sociale ose ekonomike** që ndikojnë në punësueshmëri, përveç referimit të tyre në institucionet përkatëse.

Në këtë kontekst, në kuadër të zgjerimit të mundësive për punëkërkuesit që shprehin vullnetin për të përfutur shërbime punësimi, AKPA po krijon një mekanizëm të ri referimi përmes portalit [www.puna.gov.al](http://www.puna.gov.al), me funksionin 'Refero Punëkërkues', me synim formalizimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndër-institucional në identifikimin dhe mbështetjen e individëve që kërkojnë përfshirje në tregun e punës (Bashkëlidhur formati).

Ndërkohë, zbatimi i programit të ri integritit social, apo punëve publike në komunitet të cilët zbatohen në bashkëpunim me OJF-të, si dhe projektet e mbështetura nga donatorët ndërkombëtarë si EU, L. dhe G., dëshmojnë për një qasje të integruar që AKPA ka ndërtuar për fuqizimin e grupeve vulnerabël dhe grave në zonat rurale, përmes shërbimeve të personalizuara dhe bashkëpunimit të ngushtë me pushtetin vendor.

Gjithsesi, AKPA ka ndërmarrë veprime konkrete për gjurmimin dhe analizimin e rezultateve të programeve të nxitjes së punësimit, duke përfshirë nga viti 2024 ndarjen e të dhënave sipas gjinisë dhe vendbanimit urban/rural. Gjithashtu, janë krijuar forma të reja të ofrimit të kurseve të formimit profesional për gratë dhe vajzat si:

- ✓ Përfshirja e Qendrës Lëvizëse të Formimit Profesional për zonën verilindore (qarqet Kukës dhe Dibër),

- ✓ Përdorimi, në zonat e pambuluara, i ambienteve të sistemit publik të arsimit profesional (shkollat profesionale) për kurse profesionale,
- ✓ Zbatimi i programit të të nxënit në vendin e punës në kuadër të Garancisë Rinore,
- ✓ Zbatimi i Programit të Kodimit për të lehtësuar aksesin në trajnime profesionale.

Theksojmë se, AKPA operon në bazë të një strukture dhe buxheti që kanë burime të limituara dhe funksionon mbi atë çka programon dhe financon buxheti i shtetit.

AKPA ka forcuar marrëveshjet e bashkëpunimit me bashkitë duke përfshirë mekanizma të strukturuar bashkërendimi dhe duke përcaktuar rolet e çdo institucioni. Gjithashtu, përmes përdorimit të treguesve të performancës, profilizimit ekonomik dhe sistemit SSHP, po synon të sigurojë një ndërveprim më të efektshëm dhe të matshëm për vlerësimin e nevojave dhe ndikimin e politikave të ndërmarra për fuqizimin e grave në zonat rurale. Për të gjitha sa më sipër, vlerësojmë se një pjesë e konkluzioneve të auditimit nuk reflektojnë plotësisht zhvillimet e kryera nga AKPA, veçanërisht në aspektin e digjitalizimit, bashkëpunimit ndër-institucional dhe krijimit të instrumenteve të reja të targetimit të grave në zonat rurale. AKPA mbetet e angazhuar të thellojë këto ndërhyrje dhe të përmirësojë më tej adresimin gjinor dhe territorial në tregun e punës.

Në përmbyllje, theksojmë se për konstatimet e parashtruara në Aktin e Konstatimit Nr. 14, AKPA do të marrë masat përkatëse për adresimin e tyre në mënyrë të strukturuar dhe afatshkurtër. Këto çështje do të evidentohen dhe trajtohen në mënyrë të qartë në paketat rregullatore që kemi aktualisht në proces rishikimi dhe zbatim, me qëllim forcimin e mekanizmave të kontrollit, transparencës dhe rritjes së efektivitetit në administrimin e shërbimeve apo programeve të tregut të punës.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Observacioni i subjektit nuk paraqet argumente lidhur me masën e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Subjekti nuk ka paraqitur evidencë për ndryshimin e vlerësimit të masës së zbatimit të rekomandimeve, për këtë arsye nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit dhe statusi i rekomandimeve mbetet i pa ndryshuar.

### **V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresat nr. 262/34/35/36/37/38/39/40/41/42/43/44/45/46/47, prot., datë 12.02.2024, konstatohet se një pjesë e madhe e tyre është e zbatuar pjesërisht ose e pazbatuar. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

##### **Për pyetjen e auditimit: A mundësojnë programet kombëtare punësimin aktiv të grave në zonat rurale?**

Nënpyetja 1.1 A janë programet e nxitjes së punësimin të diversifikuara, të zbatuara në të gjithë vendin, për punësimin e grave në zonat rurale?

**1. Gjetje nga auditimi:** AKPA, për të gjykuar efektivitetin e programeve aktuale të miratuara, nuk ka matur dhe analizuar nivelin e rezultateve të punësimin nga këto programe për gratë në zonat rurale. Aktualisht AKPA, nëpërmjet strukturave të saj, ka kryer gjurmim të rezultateve për

programet e përfituara nga punëkërkuesit e papunë vetëm për vitin 2020. Sipas përcaktimeve të rregulloreve të zbatimit të programeve, ky proces duhej të realizohej 6 muaj mbas përfundimit të tyre.

**1.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, të grumbullojë dhe të analizojë të dhënat mbi realizimin e programeve të nxitjes së punësimit duke i ndarë në bazë të zonave administrative urbane - rurale si dhe duke shtuar e përfshirë në analizimin e të dhënave edhe kategorinë “gra në zonat rurale”.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Vlerësimi i nevojave të grupeve të veçanta për mbështetje nëpërmjet PATP nuk është bërë gjithmonë në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Konkretisht, AKPA ka bërë hartimin dhe diversifikimin e PATP-ve duke u bazuar vetëm në databazën e të dhënave që ka në dispozicion, por studimi i databazës nuk jep panoramën e gjithë rajoneve. Po kështu edhe NJVQV – të që kanë bërë një analizë më të gjerë të nevojave faktike të grave me qëllim fuqizimin e tyre, si në rastin e Dibrës, nuk i kanë adresuar këto nevoja në AKPA. Për rrjedhojë të kësaj situatë, nuk ka patur, raporte të vlerësimit të nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zona të pambuluara.

**2.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, t’i propozojë Ministrisë së Financave për pjesën e mbetur të zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit, prioritetet sipas zonave gjeografike, sektorëve ekonomikë dhe nevojave të punëkërkueseve gra në zonat rurale, si dhe të hartojë programe konkrete punësimi për përfshirjen e tyre në tregun e punës.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi nuk rezultoi të jenë zhvilluar kurse të trajnimit profesional në zonat rurale e për rrjedhojë nuk u evidentuan gra nga këto zona, të cilat të kenë ndjekur kurse të trajnimit profesional. Vetë AKPA disponon të dhëna për kursantët që kanë ndjekur kurset e formimit profesional sipas njësisive bashkiake ku ata banojnë, kjo pasi Qendrat e Formimit Profesional janë të lokalizuara në qytetet kryesore, por këto të dhëna nuk janë të dizagreguara sipas prejardhjes urbane - rurale.

**3.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësim, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, të mundësojnë hapjen e kurseve profesionale për gratë e vajzat në zonat rurale, të përcaktuara në bazë të prioritetëve dhe zhvillimit të secilës zonës rurale.

**Brenda muajit mars 2026**

**Pyetja 2 A janë marrë masa konkrete që nxisin përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës?**

Nënpyetja 1.2 A është investuar nga qeveria qendrore dhe vendore në përmirësimin e infrastrukturës në kuadër të nxitjes së punësimit?

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të grumbulluara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore objekt auditimi, u konstatua se pothuajse në 80 % të tyre, raporti i çerdheve dhe kopshteve

nuk është në proporcion të drejtë me njësitë administrative rurale dhe ato urbane, që i përkasin një Bashkie. Referuar të dhënave zyrtare nga Bashkitë objekt auditimi, konstatohet se çerdhet mungojnë në njësitë administrative rurale dhe në disa raste edhe në njësitë administrative urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohet një mbulim i plotë dhe ndarje e drejtë sipas zonave urbane dhe rurale, me kopshte dhe çerdhe.

**4.1 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Berat, Pogradec, Vlorë dhe Gjirokastrë, në përputhje me strategjitë rajonale për zhvillimin e zonave rurale, të marrin masa për të vlerësuar situatën në këto zona, për mbulimin e tyre me çerdhe dhe kopshte si dhe hartojnë plane investimesh në varësi të nevojave proporcionale me numrin e banorëve.

**Brenda muajit mars 2026**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave të grumbulluara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore objekt auditimi, u konstatua se në disa njësi të qeverisjes vendore nuk sigurohet transport publik përveçse në njësitë administrative urbane. Për rrjedhojë, nuk sigurohen kushte lehtësimi, për të afruar gratë dhe vajzat sa më afër tregut të punës.

**5.1 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Kukës, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnje, Berat, Vlorë dhe Gjirokastrë, të marrin masa për të identifikuar dhe vlerësuar nevojat që ka për mbulimin me transport publik në çdo njësi administrative për ta ofruar atë nga zonat rurale drejt zonave urbane.

**Brenda muajit mars 2026**

**5.2 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Kukës, Dibër, Krujë, Kavajë, Divjakë, Berat, Vlorë, Pogradec dhe Gjirokastrë të vlerësojnë gjendjen e infrastrukturës në zonat rurale dhe të hartojnë një plan investimesh në varësi të situatës, të numrit të banorëve dhe nevojave të konstatuara.

**Brenda muajit mars 2026**

**Pyetja 3 A ka ndërveprim të institucioneve qendrore me strukturat vendore për nxitjen e punësimit të grave në zonat rurale?**

Nënpyetja 1.3 A është monitoruar nga AKPA zbatimi i politikave të punësimit të grave në zonat rurale?

**6. Gjetje nga auditimi:** Detyrimet e përcaktuara në akt marrëveshjet e nënshkruara nga Bashkitë Lushnje, Lezhë dhe Elbasan nuk janë zbatuar. Nuk dokumentohen aktivitetet e zhvilluara në kuadër të nxitjes së punësimit. Njësitë Administrative që janë në distancë të largëta nga Zyrat Vendore të Punës, nuk regjistrojnë punëkërkuarit në një regjistër i cili më pas të dërgohet periodikisht pranë Zyrës Vendore të Punës.

Gjithashtu, në Njësitë Administrative nuk është caktuar një person me përgjegjësi për të koordinuar punën dhe të mbajë kontakte të vazhdueshme me Zyrën Vendore të Punës për të adresuar çështjet e punësimit.

AKPA nga ana e saj nuk ka dokumentuar ecurinë e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkuara me Bashkitë Elbasan, Lushnje dhe Lezhë. Gjithashtu, nuk është kryer një vlerësim mbi efektivitetin e tyre në përmirësimin e situatës së punësimit.

**6.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të monitorojë zbatimin e kushteve të marrëveshjeve aktive që ka me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Në vijim të synohet mbledhja e informacionit sipas njësive administrative me qëllim identifikimin e grave rurale që duan të punësohen. Gjithashtu, në akt marrëveshjet që do të lidhë në vijim me bashkitë të përfshijë edhe aktivitete me fokus në grupin e grave rurale.

**Brenda vitit 2025 dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk ka ngritur pika shërbimi në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të cilat nuk kanë zyra vendore punësimi, me qëllim trajtimin e çështjeve të punësimit, sikundër është përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

**7.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të bashkëpunojë me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të ngritur pika shërbimi për trajtimin e çështjeve të punësimit në ato bashki ku nuk ka zyra vendore punësimi.

**Brenda vitit 2025**

## **8. Gjetje nga auditimi:**

Shërbimet e punësimit të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk janë plotësisht të bashkërenduara me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komunikimi midis strukturave qendrore dhe vendore nuk identifikon nevojat e grave në përgjithësi dhe grave rurale në veçanti.

**8.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të identifikojnë nevojat e grave rurale për pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës si dhe të planifikojnë fonde për financimin e programeve të nxitjes së punësimit të tyre.

**Brenda muajit mars 2026 dhe në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive edhe pse e ka monitoruar periodikisht zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara për t'u realizuar me qëllim arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019-2022, nuk konstatohet se si janë përdorur konkretisht rezultatet e monitorimit për të përmirësuar politikat e punësimit, apo cilat janë përmirësimet specifike që janë bërë përkatësisht në referencë të rezultateve të monitorimit.

**9.1 Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të analizojë rezultatet e monitorimit të aktiviteteve të zhvilluara në përmbushje të objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe të ndërmarrë aktivitete specifike që sjellin adresimin e problematikave të konstatuara nga rezultatet e monitorimit.

**Në vijimësi**

## **2.2 PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “MBËSHTETJA FINANCIARE E STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE” (FONDI I EKSELENCËS) NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT.**

### **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

#### **1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 684 prot., datë 17.06.2025 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitin 2024”, ushtroi auditim tematik në subjektin Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), pjesë e Auditimit të Përformancës me temë: “*Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore*” (Fondi i ekselencës).

Auditimi i kryer në vitin 2024, kishte në fokus periudhën e auditimit 01.01.2014-31.12.2023 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me **Vendimin nr. 98, datë 31.05.2024 të Kryetarit të KLSH-së** dhe Raporti Përfundimtar i shoqëruar me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse i është dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024.

Auditimi u krye nga data 20.06.2025, deri më datë 18.07.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektin e audituar MAS u mbajt Akt-Verifikimi nr. 1, i cili është regjistruar me nr. 4585 prot., më datë 18.07.2025.

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga auditimi u konstatua se,

- Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka dërguar në KLSH planin e masave 20 ditore, meqë GANDRYSHE nga sa pretenduar nga MAS, vëren se, në shkresën nr. 2707/22 prot., datë 20.06.2024 “Kthim përgjigje” (me tonën nr. 583/11 prot., datë 21.06.2024), Ministria e Arsimit dhe e Sportit referon se: “...konsideron se nuk mund të marrë parasysh rekomandimet e dhëna në raport për dhënie masash disiplinor për nëpunësit ...”. Në përfundim të trajtimit të kësaj çështjeje, në po të njëjtën shkresë, MAS i referon KLSH – së, se: “Në lidhje me pjesën tjetër të rekomandimeve, MAS do të hartojë planin e zbatimit të tyre dhe do t’ju informojë në vijim...”.

*Për sa më lart, nga vetë përmbajtja e shkresës nr. 2707/22 prot., datë 20.06.2024 “Kthim përgjigje”, konstatohet se kjo shkresë nuk referon asnjë plan masash, ndaj si i tillë, detyrimi i respektimit të afatit ligjor prej 20 ditësh për informimin dhe raportimin në KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nuk është përmbushur.*

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh,** për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

-Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve, meqë GA konstaton se, në shkresën nr. 2707/25 prot., datë 31.07.2024 "Kthim përgjigje" (me tonën nr. 583/15 prot., datë 02.08.2024), MAS referon se: "Me Urdhrin nr. 370, datë 23.07.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të masave dhe monitorim e zbatimit të tyre, në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përcjellë në raportin përfundimtar nr. 583/10 prot., datë 03.06.2024....., është ngritur grupi i punës i cili do të hartojë planin e masave në zbatim të rekomandimeve që KLSH ka lënë".

Shkresa nr.2707/25 prot., datë 31.07.2024 "Kthim përgjigje", e cila në fund ka një plan masash, nuk përfaqëson në përmbajtjen e saj raportimin e MAS në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky detyrim ligjor përcakton dhënien e një informacioni përmbajtësor mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe jo referimin e faktit se MAS tetë ditë më herët, nga shkesa nr. 2707/25 prot., datë 31.07.2024, ka miratuar Urdhrin nr. 370, datë 23.07.2024, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të masave dhe monitorim e zbatimit të tyre, në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit..", apo që Grupi i punës do të marrë masa...", ndaj për sa më lart, detyrimi ligjor konsiderohet i papërmbushur.

#### **4. Statusi i pranimit të rekomandimeve:**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 583/10, datë 3.06.2024, janë rekomanduar gjithsej 35 masa:

Masa organizative: 7 rekomandime;

Masa disiplinore: 28 masa, nga të cilat, 13 masa disiplinore ndaj punonjësve të MAS dhe 15 masa disiplinore të ezauruara, meqë punonjësit ishin larguar nga institucioni.

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella në KLSH mbi planin e masave si dhe shpjegimet e paraqitura për secilin rekomandim në fazën e verifikimit të tyre, rezulton se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Organizative	7	7	0
2	Disiplinore	28	28	0
<b>Gjithsej</b>		<b>35</b>	<b>35</b>	<b>0</b>

## **II. HYRJA**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të evaduar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve" miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 23.06.2020.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 684 prot., datë 17.06.2025. mbi Rekomandimet e lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm me temë “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore ” me konkluzionet përkatëse, të cilat janë miratuar me **Vendimin nr. 98, datë 31.05.2024 të Kryetarit të KLSH-së** dhe janë përcjellë në subjektin e audituar me shkresën me nr. 583/10 prot., datë 3.06.2024.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së, me përbërje:

1. A.S., përgjegjës grupi;
2. M.L, anëtare.

Auditimi ka filluar më, 20.06.2025

Auditimi ka përfunduar më, 18.07.2025

## II.1. Objekti i auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10 prot., datë 3.06.2024.

## II.2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

## II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

## II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Ministria e Arsimit dhe Sportit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën e sipërcituar, rezulton se nga 35 (tridhjetë e pesë) masa të rekomanduara gjithsej, 35 (tridhjetë e pesë) janë pranuar nga subjekti i audituar.

Nga këto masa rezultojnë:

të zbatuara 16, ose 45,7 % e të tyre;

të zbatuara pjesërisht 2, ose 5,7 % e të tyre;

në proces zbatimi 4, ose 11,4 % e masave të lëna.

Nërkohë që 13 masa rezultojnë të pazbatuara, ose 37,2 % të tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Pa pranuar	Statusi i zbatimit për të pranuarat			
				Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	7	0	1	2	4	0
2	Disiplinore	28	0	15	0	0	13
<b>Gjithsej</b>		<b>35</b>		<b>16</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>13</b>

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave Organizative	Në numër	Në %
1	Totali	7	100%
2	Pa pranuar	0	0%
3	Pranuar	7	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar Plotësisht	1	14,28%
2	Zbatuar pjesërisht	2	28,57%
3	Në proces zbatimi	4	57,14%
4	Pa zbatuar	0	0%

Nr.	Statusi i masave Disiplinore	Në numër	Në %
1	Totali	28	100%
2	Pa pranuar	0	0%
3	Pranuar	28	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar Plotësisht	15	53,57%
2	Zbatuar pjesërisht	0	0%
3	Në proces zbatimi	0	0%
4	Pa zbatuar	13	46,4%

## II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Sikurse u konstatua gjatë auditimit, rezultoi se angazhimi i subjektit kishte siguruar një nivel të ulët zbatimi të plotë të rekomandimeve me rreth 45.7% të tyre. Për sa u përket masave organizative, vetëm **1** rekomandim është **zbatuar plotësisht** ose 14,28 % e tyre, **2** rekomandime ose 28,57 % janë **të zbatuara pjesërisht** dhe **4** rekomandime ose 57,14% gjenden **në proces zbatimi**. Për këtë kategori masash, zgjatja e procesit të zbatimit të rekomandimeve është shkaktuar nga mbartja e problematikave nga periudha të largëta në kohë, numri i lartë i personave përfitues nga fondi i ekselencës, si dhe hapat e shumta të nevojshme procedurale, përfshirë dhe proceset gjyqësore, për zbatimin e plotë të rekomandimeve.

Sa i përket masave disiplinore, nga 28 prej tyre, **15** masa konsiderohen **të zbatuara**, ose 53,57%, nisur nga fakti se, punonjësit ndaj të cilëve do ndërmerreshin, nuk ishin në marrëdhënie pune me MAS në kohën e miratimit të Vendimit Vendimin nr. 98, datë 31.05.2024 të Kryetarit të KLSH-së dhe përcjelljes së Raporti Përfundimtar i shoqëruar me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024. Ndërsa **13** masat e tjera disiplinore të rekomanduara janë **të pazbatuara**.

Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi, kërkon më tepër impenjim nga subjekti i audituar për përmbushjen e rekomandimeve të lëna, për monitorimin dhe kthimin e parave nga personat përfitues, të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet, sipas marrëveshjeve të lidhura me MAS.

## III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit prej subjektit të audituar, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

## A. MASA ORGANIZATIVE

### 1. A është hartuar kuadri rregullator i nevojshëm me qëllim mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil?

**1. Gjetje nga auditimi:** Me gjithë punën e bërë konstatohen disa mangësi në dokumentet e strategjisë e konkretisht:

- Është hartuar Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2014-2020, por nuk ka pasur një strategji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me objektiva e për pasojë edhe për Fondin e Ekselencës deri në fund të vitit 2020.

- Në objektivat strategjike të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020 nuk është arritur plotësisht zbatimi i indikatorëve të rritjes me 10% të fondit të ekselencës nga viti në vit bazuar në buxhetin e vitit 2015 për ekselencën si dhe financimi i 50 studentë në vit nga fondin e ekselencës,

- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 nuk ka parashikuar fonde për studentët e ekselencës që studiojnë jashtë vendit,

- Nuk ka të dhëna për monitorimin sipas objektivave të strategjisë.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit dhe Sportit të hartojë plan pune për monitorimin e performancës dhe ecurisë së Fondit të Ekselencës për periudhën 2014-2023 si dhe të analizojë mangësitë dhe shkaqet e mos realizimit të objektivave e nxjerrë përgjegjësitë.

**Brenda vitit 2024**

#### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

“Fondi i Ekselencës është ndërprerë për studentët e rinj që në vitin 2022, me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 458, datë 29.6.2022 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, të ndryshuar”.

Në vijim të punës së kryer nga strukturat përkatëse në MAS është analizuar disa herë ndër vite ecuria e FE së bashku me problematikat e ndeshura, në aspektin e nevojshmërisë për ndryshimin e akteve rregullatore siç reflektohet edhe në memon e datës 17.09.2019 “Lidhur me ndryshimet në VKM-në e Fondit të Ekselencës”, bashkëlidhur. Në këtë memo është kryer analiza për periudhën e zbatimit të VKM 483 (2014-2019). Gjithashtu, siç është shpjeguar në Memon e datës 07.10.2021 me lëndë “Mbi fondin e ekselencës 2019-2022”, është analizuar performanca e Fondit të Ekselencës, duke marrë për bazë periudhën 2019-2022, si dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse në lidhje me eficientë dhe performancën e këtij fondi. Në vijim të kësaj analize, MAS ka propozuar në Këshillin e Ministrave ndryshimin e akteve nënligjore në fuqi të cilat rregullonin Fondin e Ekselencës, përkatësisht të Vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, të ndryshuar, me të cilin rregullohej Fondi i Ekselencës në kohën që u krye vlerësimi i performancës dhe eficientë së tij.

Nga viti 2022 e në vijim, nëpërmjet ndryshimit të akteve rregullatore në fuqi të FE, nuk është pranuar asnjë aplikim i studentëve të rinj që kërkonin mbështetje nga ky fond, pra asnjë student i ri nuk ka përfitur bursë financiare nga fondi i ekselencës.

Për periudhën 2019-2021, për të cilën është kryer edhe analizë e detajuar sipas memos së sipërcituar, rezulton se janë shpallur fitues dhe kanë përfitur gjithsej 40 studentë të rinj dhe kanë vijuar të financohen studentët e ndërmjetëm, të cilët kanë filluar studimet para vitit 2019. Evidentohet, se për

një periudhë 3-vjecare, numri i përfituesve që ndjekin studimet e doktoratës dhe kategoria e nëpunësve civile është shumë i ulët (vetëm një nëpunës civil dhe tre doktorantë);

Shumica e përfituesve ka ndjekur studimet e ciklit të dytë/master (kjo për shkak edhe të ndryshimit të VKM në vitin 2020 ku u përjashtuan studimet bachelor). Evidentohet se shumë pak studentë kanë aplikuar për bursë pranë universiteteve ku janë pranuar. Nga studentët të cilët kanë përfitur nga FE, vetëm 3 (tre) prej tyre kanë përfitur bursë nga universiteti pritës dhe nga FE u është kompensuar diferenca e tarifës së shkollimit ose shpenzimeve të jetesës.

Sa i përket ndjekjes së studentëve të cilët kanë përfunduar studimet e financuara nga fondi i ekselencës dhe kanë detyrimin të kthehen e të punojnë në Shqipëri, në analizë evidentohet se ata ose nuk kthehen ose pjesa dërrmuese e tyre punësohen kryesisht në sektorin privat ose deklarojnë se janë të regjistruar pranë zyrës së punësimit si të papunë.

Përfituesit e punësuar pranë sektorit privat, rezultojnë të deklaruar me pagë minimale pranë organeve tatimore, çka na bën të kemi dyshime të arsyeshme se këto studentë nuk kthehen fare në Shqipëri, por për të shmangur moskthimin e shumës së përfitur nga FE, detyrohen të bëjnë deklarime punësimi pranë subjekteve private me pagë minimale.

Për periudhën 2019-2021, janë evidentuar 18 raste të studentëve përfitues të fondit të ekselencës, të cilët nuk kanë përmbushur fare detyrimin për tu kthyer e për të punuar në Shqipëri. Këto raste janë deklaruar në sektorin e përfaqësimit gjyqësor në MAS, të cilët janë duke ndjekur çështjet e tyre në rrugë gjyqësore. Sa më sipër, vetëm me të dhënat për një periudhë 3-vjeçare, vlerësohet se efektiviteti i fondit të ekselencës është shumë i ulët ose i pa konsiderueshëm, në raport me qëllimin dhe objektivat për të cilët ky fond është dizajnuar dhe miratuar. Taksapaguesve shqiptarë u kushton çdo student i fondit të ekselencës mesatarisht 55 mijë USD/vit për të përballuar shpenzimet e studimeve dhe të jetesës në një nga 15 universitetet e renditur të parët sipas Times Higher Education (THE). Gjithashtu evidentohet se studentët të cilët ndjekin studimet në Amerikë kanë kosto më të lartë se ato që ndjekin studimet në universitet evropiane (Përjashtuar Mbretërinë e Bashkuar ku kosto e studimeve është e lartë, por pak më e ulët se në Amerikë).

Në vijim të këtyre gjetjeve dhe rekomandimeve pas kryerjes së analizës së efikasitetit të programit të FE, si rezultat i ndjekjes me përgjegjësi të problematikave të shfaqura me FE, në vitin 2022 MAS ka ndërmarrë nisma për ndryshimin e akteve rregullatore në fuqi për FE, nismë e cila u finalizua me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 458, datë 29.6.2022 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, të ndryshuar”, i cili mbylli funksionimin e Fondit të Ekselencës për aplikantët e rinj.

Në vijim të rekomandimit të KLSH-së, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka hartuar planin e punës, bazuar në:

- 1) Urdhri nr. 370, datë 23.07.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të masave dhe monitorimin e zbatimit të tyre, në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, përcjelle mbi raportin përfundimtar nr. 53/3 prot., datë 03.06.2024 (mbi auditimin e performancës me temë “Mbështetja financiare e studenteve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore” (Fondi i Ekselencës) si dhe bashkëlidhur matrica shoqëruese e planit të masave;
2. Urdhri nr. 151/1, datë 02.09.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin dhe digjitalizimin e dokumentacionit të FE për periudhën 2014-2024”.  
(Bashkëlidhur kopje).

Ne vijim është hartuar raporti i përfituesve të fondit të ekselencës, në Janar 2025, i cili përfshin informacion për studentët përfitues për herë të parë, në periudhën 2014-2022.

Një kopje të raportit e gjeni bashkëlidhur. (Raporti Janar 2025).

Në vijim, ST ka vijuar punën dhe është hartuar një raport i dytë, në Qershor 2025, ku janë evidentuar të gjithë gjetjet dhe statusi i rishikuar i përfituesve.

Bashkëlidhur Raporti nr. 2 Qershor 2025.

Raportet janë hartuar duke kryer verifikimet në dokumentacionin sa më poshtë:

- a) Të dhënat për përfituesit janë verifikuar duke përdorur informacionin që ata vetë kanë dërguar në MAS përmes komunikimit elektronik nga adresa zyrtare e Fondit të Ekselencës [www.fondi.ekselenca.gov.al](http://www.fondi.ekselenca.gov.al);
- b) Shkresë nr. 555 prot., datë 19.01.2024, të MAS “Kërkesë për informacion”, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë;
- c) Shkresë nr.10124/3 datë 5.02.2024, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë “Kthim përgjigje” (Informacion zyrtar përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë në përgjigje të shkresës së MAS nr. 555 prot. datë 19.01.2024)
- d) Shkresë nr. 556 prot., datë 19.01.2024, të MAS “Kërkesë për informacion”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë;
- e) Shkresë nr. 13169/1, datë 02.08.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë “Kthim përgjigje” (Informacion zyrtar përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë, në përgjigje të shkresës së MAS nr.556 prot., datë 19.01.2024);
- f) Shkresë nr. 556/2 prot., datë 18.07.2024, të MAS “Kërkesë për informacion në vijim të shkresës suaj nr.13169/1, datë 02.08.2024”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë;
- g) Shkresë nr. 554 prot datë 19.01.2024, të MAS “Kërkesë për informacion”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike Tiranë;
- h) Shkresë nr. 505/1, datë 07.02.2024, të Departamentit të Administratës Publike Tiranë “Mbi kërkesën për informacion lidhur me studentët e ekselencës” (Informacion zyrtar përcjellë nga Departamenti i Administratës Publike Tiranë, në përgjigje të shkresës së MAS nr. 554 prot., datë 19.01.2024)
- i) Shkresë nr. 7635 prot., datë 11.12.2024 “Kërkesë për informacion”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike Tiranë;
- j) Shkresë nr. 6736/1, datë 20.12.2024, të Departamentit të Administratës Publike Tiranë “Mbi kërkesën për informacion lidhur me studentët e ekselencës” (Informacion zyrtar përcjellë nga Departamenti i Administratës Publike Tiranë, në përgjigje të shkresës së MAS 6736/1, datë 11.12.2024)
- k) Shkresës nr. 244, datë 14.01.2025 , të MAS “Kërkesë për informacion”, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë.
- l) Shkresë nr. 108/1, datë 27.1.2025, të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Tiranë “Kthim përgjigje” (Informacion zyrtar përcjellë nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në përgjigje të shkresës së MAS nr. 244, date 14.01.2025)
- m) Shkresë nr. 4455 prot, datë 27.08.2020, të MAS “Kërkesë për informacion”, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë;
- n) Shkresë nr. 6308/1 date 03.09.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë “Kthim përgjigje” (Informacion zyrtar përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Tiranë, në përgjigje të shkresës së MAS nr. 4455 prot. date 27.08.2020); ku citohet se: “...informacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion. Të drejtën ligjore për të marrë informacion e kane vetë personat, duke paraqitur një kërkesë me shkrim,

*bashkëlidhur dokumentin e identifikimit”). Bashkëlidhur kopje të shkresave. Rekomandimi i përmbushur”.*

### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Sekretariati Teknik i Fondit të Ekselencës nëpërmjet dy memove (pa datë) u ka përcjellë Zv. Ministres së Arsimit dhe Sportit dhe Sekretarit të Përgjithshëm dy raporte.

Në janar – shkurt 2025, është përgatitur “Raporti mbi përfituesit e mbështetjes financiare (Fondi i Ekselencës) për periudhën 2014-2024”.

Në qershor 2025, është përgatitur “Raporti mbi përmbushjen e detyrimeve të përfituesve të mbështetjes financiare (Fondi i Ekselencës) për periudhën 2014-2024”.

Referuar matricës në shkresën nr. 2707/25 prot., datë 31.07.2024, për zbatimin e këtij rekomandimi ngarkoheshin Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe Drejtoria Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar.

Dy raportet sjellin informacion mbi ecurinë e Fondit të Ekselencës, por nuk analizohen mangësitë dhe shkaqet e mos realizimit të objektivave, sikurse dhe nuk nxirren përgjegjësitë, në përputhje me rekomandimin e KLSH.

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton, **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.**

**Statusi i rekomandimit: pjesërisht i zbatuar.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në kuadrin ligjor të Fondit të Ekselencës konstatohen disa mangësi si:

- nuk ka asnjë të dhënë mbi ecurinë e VKM nr. 875, datë 19.12.2012 “Për fondin e ekselencës për mbështetje financiare të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj të shkëlqyer”,
- nuk është shfuqizuar pjesërisht dhe të rishikuar Udhëzimi nr. 6, datë 04.03.2020 për studentët e ndërmjetëm që janë në proces të financimit të Fondit të Ekselencës,
- janë nxjerrë rreth 4 vjet më vonesë nga hyrja në fuqi e Ligjit të ri nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM dhe Udhëzimeve nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Sportit.

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë masa për përditësimin dhe harmonizimin në kohë të kuadrit ligjor e rregullator të Fondit të Ekselencës dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij dhe publikimin e tyre në WEB.

**Brenda vitit 2024**

### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

“Në lidhje me rekomandimin e grupit të auditimit ku citohet se “MAS të marrë masa për përditësimin dhe harmonizimin në kohë të kuadrit ligjor e rregullator të Fondit të Ekselencës dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij dhe publikimin e tyre në web”, sqarohet se edhe ky rekomandim është i ezauruar dhe të gjitha aktet që kanë rregulluar Fondin e Ekselencës kanë qenë të publikuara në Fletoren Zyrtare dhe faqen WEB të MAS.

Kështu për shembull, në rastin e Vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, të ndryshuar, ndryshimet e vitit 2022, kanë bërë të pamundur financimin e aplikimeve të reja në kuadër të FE. Në lidhje me harmonizimin e akteve nënligjore, konkretisht të vendimit 160, datë 19.02.2020 të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar dhe udhëzimit të ministrit nr. 6, datë 4.3.2020 “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kritereve dhe procedurave, për

përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”, duke qenë se formulimi dhe veprimi i këtij të fundit e gjen referencën në pikën 5 të Vendimit nr. 160/2020 të Këshillit të Ministrave, e cila rezulton e shfuqizuar nga VKM nr. 458/2022, cituar më lart, për pasojë edhe udhëzimi nr. 6 do të ndjekë të njëjtin fat juridik me dispozitën nga e cila i burojnë kompetencat për atë pjesë specifike të përcaktimeve që burojnë nga këto dispozita.

Në kushtet kur politika e mbështetjes financiare me anë të FE ka ndryshuar si pasojë e mos realizimit të qëllimit të programit të Fondit të Ekselencës duke ndryshuar vendimin nr. 160, datë 19.2.2020 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, MAS ka vijuar të zbatojë përcaktimet e parashikuara në aktet nënligjore duke trajtuar vetëm kërkesat e studentëve të ndërmjetëm të FE.

Për këtë arsye, në kuadër të ndryshimit të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, i ndryshuar”, me vendimin nr. 458, datë 29.6.2022 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, të ndryshuar ku u shfuqizuan pikat 5 dhe 6 të vendimit në fuqi, përkatësisht si më poshtë:

*“5. Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve e procedurave, për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit si dhe për numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni, për secilën nga bursat e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili miratohet brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.*

*6. Përzgjedhja e kandidateve kryhet para fillimit të vitit akademik, nga komisione përzgjedhëse të ngritura me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Komisioni përzgjedhës kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij, në nivel zëvendësministri ose nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues. Kur Fondi i Ekselencës plotësohet edhe nga donacione, në komision ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve”, theksohet se nga MAS nuk është konsideruar e nevojshme ndryshimi i udhëzimit nr. 6, datë 4.3.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”, pasi vlerësohet e qartë, referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 6, datë 4.3.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë se dispozitat e udhëzimit, të cilat detajojnë përmbajtjen e vendimit nr. 160, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të zbatueshme vetëm për studentët vijues që kanë përfituar mbështetje financiare përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 458, datë 29.6.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, i ndryshuar”.*

Me shfuqimin e pikave 5 dhe 6 të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar bien automatikisht detyrimet e përcaktuar në udhëzimin e sipërcituar, i cili del në bazë dhe për zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe në këtë aspekt juridik, nuk konsiderohet e nevojshme ndryshimi i udhëzimit nr. 6, datë 4.3.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pasi pikat e tij që lidhen me shfuqizimin përkatësisht të pikave të VKM-së, janë *de jure* automatikisht të shfuqizuar.

Pavarësisht sa më sipër, në vijim do të kryhen ndryshimet e nevojshme të aktit rregullator në fuqi, nëse vlerësohet, përtej arsytimit sa më lart, që udhëzimi duhet të ndryshohet detyrimisht. Rekomandimi përmbushur pjesërisht”.

### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton **i pranuar dhe pjesërisht i zbatuar.**

**Statusi i rekomandimit: pjesërisht i zbatuar.**

## **2. A ka ndarje të qarta të roleve dhe përgjegjëse të institucioneve përgjegjëse në mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil?**

**3.1 Gjetje nga auditimi:** Me gjithë punën e bërë konstatohen disa mangësi e konkretisht:

- Ristrukturimi i shpeshtë i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit 2014-2023, ka sjellë ndryshime të pozicioneve dhe funksioneve të drejtuesve dhe specialistëve përkatës duke mos u shoqëruar në kohë me rregulloret e brendshme të MAS, çka ka sjell, ndarje të pa qarta të roleve dhe mos kryerje të detyrave sipas funksionit përkatës;
- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet drejtorive përkatëse (Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator) ka sjellë mos evidentim në kohë reale të zbatimit të detyrimeve kontraktuale dhe marrjes së masave ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në lidhje me procesin e mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë.

**3.2 Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë megjithëse është krijuar në vitin 2017, sipas VKM-së nr. 397 datë 03.07.2017 nuk ka ushtruar kompetencat e saj ligjore si institucion në lidhje me financimin e studentëve të shkëlqyer.

**3.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë masa të ndajë rolet e detyrat ndërmjet Sekretariatit Teknik Përzgjedhës, Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në lidhje me ecurinë e Fondit të Ekselencës në ndjekjen e proceseve gjyqësore për të gjithë rastet e mos zbatimit të detyrimeve kontraktuale të studentëve përfitues.

**Brenda vitit 2024**

### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

“Në lidhje me rekomandimin 1.1 të grupit të Auditimit (faqe 33) ku citohet se “*MAS të marrë masa të ndajë rolet e detyrat ndërmjet sekretariatit teknik përzgjedhës, drejtorisë së politikave të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, drejtorisë së programimit standardizimit dhe harmonizimit në lidhje me ecurinë e fondit të ekselencës në ndjekjen e proceseve gjyqësore për të gjitha rastet e moszbatimit të detyrimeve kontraktuale të studentëve përfitues*”, sqarojmë se ky rekomandim u mor në konsideratë brenda vitit 2024.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka marrë masa të ndajë rolet e detyrat, duke hartuar matricën përkatëse të ndarjes së detyrave, ndërmjet Sekretariatit Teknik Përzgjedhës, Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në lidhje me ecurinë e Fondit të Ekselencës në ndjekjen e proceseve gjyqësore për të gjithë rastet e mos zbatimit të detyrimeve kontraktuale të studentëve përfitues.

Aktualisht janë 33 procese gjyqësore që po zhvillohen në sistemin gjyqësor me palë ndërgjyqëse MAS kundër ish-përfituesve të Fondit të Ekselencës, ndërsa 2 procese të tjera gjyqësore janë pushuar nga MAS, pasi të paditurit (R. R.i dhe E. T.) kanë kthyer shumën detyrimit në llogari të MAS.

MAS po përgatit procese të tjera gjyqësore të vlerësuar nga Sekretariatit Teknik Përzgjedhës për mosplotësim të detyrimeve kontraktuale dhe inicim të procedurave të mëtejshme.

Bashkëlidhur Urdhër nr. 370, datë 23.07.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të masave dhe monitorimin e zbatimit të tyre, në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, përcjellë mbi raportin përfundimtar nr. 53/3 prot., datë 03.06.2024 (mbi auditimin e performancës me temë “Mbështetja financiare e studenteve të shkëlqyer dhe nëpunësve civile të administratës shtetërore” (Fondi i Ekselencës) dhe matrica shoqëruese. Rekomandimi është përmbushur”.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Referuar faktit që MAS pasi ka iniciuar 33 procese gjyqësore kundër ish-përfituesve të Fondit të Ekselencës, ndërsa 2 procese të tjera gjyqësore janë pushuar nga MAS, pasi të paditurit, kanë kthyer detyrimet në llogari të MAS, ndërkohë MAS paralelisht po përgatit procese të tjera gjyqësore të vlerësuar nga Sekretariatit Teknik Përzgjedhës, për mosplotësim të detyrimeve kontraktuale dhe inicim të procedurave të mëtejshme, vlerësohet se rekomandimi rezulton **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

**Statusi i rekomandimit: në proces zbatimi.**

**3. A kanë monitoruar MAS dhe strukturat e saj procesin e përfituesve të mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil (Fondin e Ekselencës) nga fillimi deri në përfundimin e tij?**

**4. Gjetje nga auditimi:** Me gjithë punën e bërë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në lidhje me procesin e mbështetjes financiare të studentëve ekselentë, u konstatua:

- Një monitorim i pjesshëm i ecurisë së tij që konsiston në mos kryerjen e detyrave funksionale të Drejtorive Përgjegjëse për këtë proces. (Komisionit Përzgjedhës, Sekretariatit Teknik Përzgjedhës, Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmozimit të kuadrit rregullator);

-Mungon një data base në MAS i përfituesve të FE me të gjithë elementët e nevojshëm të ecurisë së çdo individi: Periudha kohore studimeve, viti i mbarimit, respektimi i afatit 30 ditor nga studentët në sjelljen e dokumentacionit (diplomë + listë notash) në përfundim të ciklit të studimeve, respektimi i afatit 6 mujor nga MAS në nisjen e procedurave ligjore në rastet e mos kthimit të studentëve dhe punësimit në RSH etj. ;

-Nuk është realizuar monitorimi, koordinimi dhe raportimi efikas i ecurisë pas shkollorë për secilin individ nga drejtoritë dhe STP;

-Mungon inventarizimi i dosjeve të aplikantëve dhe përfituesve të Fondit të Ekselencës me gjithë dokumentacionin përkatës, duke sjellë mangësi në monitorimin e rrjedhshmërisë së veprimeve dhe dokumenteve të dorëzuara në vite si dhe mos përmbushje të detyrimeve kontraktuale nga të dy palët Student-MAS.

**4.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë masa të ngrejë një grup pune me anëtarë nga secila drejtori përgjegjëse dhe në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik Përzgjedhës të

plotësojnë dosjet me dokumentet periodikë për çdo përfitues të Fondit të Ekselencës deri në përfundimin e ciklit studimor si dhe kryejë inventarizimin e tyre.

## Menjëherë dhe vijimësi

### Komentet e Subjektit të auditimit:

“Në lidhje me rekomandimin 1.1 të grupit të auditimit (faqe 38) ku citohet se “MAS të marrë masa të ngrejë një grup pune me anëtarë nga secila drejtori përgjegjëse dhe në bashkëpunim me ST përzgjedhës të plotësojë dosjet me dokumentet periodike për çdo përfitues të fondit të ekselencës deri në përfundimin e ciklit studimor si dhe të kryejë inventarizimin e tyre”, sqarojmë se për çdo aplikant ekziston një dosje me dokumentacionin përkatës, mbi bazën e të cilit aplikanti është shpallur përfitues. Në vijim, për plotësimin e dosjeve me dokumentet përkatës pas përfundimit të studimeve,

MAS mori masat përkatëse duke ngritur një grup të posaçëm pune me Urdhrin nr. 151/1, datë 02.09.2024, për plotësimin periodik të dokumenteve dhe inventarizimin e tyre, brenda vitit 2024 i cili e realizoi plotësisht këtë detyrë mbi inventarizimin dhe digjitalizimin e dosjeve të aplikuesve.

Bashkëlidhur e-maili i datës 08.10.2024 nga z. I. S., i cili konfirmon se ka përfunduar me sukses procesin e skanimeve (digjitalizimit) të dokumentacionit të Fondit të Ekselencës, të vendosur në dispozicion nga Sektori i Arkiv/Protokollit (36 kuti në total).

Kopje në CD me inventarizimin e dokumentacionit për të gjithë përfituesit.

Rekomandimi është përmbushur”.

### Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezultoi **i pranuar dhe i zbatuar.**

### Statusi i rekomandimit: i zbatuar.

**4. A është matur impakti i financimit të mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil për kontributin e tyre në forcimin e kapaciteteve të institucioneve në vend, në hulumtim, inovacion përmirësimin e cilësisë së arsimit, shkencës, teknologjisë, apo sektorë të tjerë, sipas fushave ku ata kanë studiuar?**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga fondi total i ekselencës për një periudhë 10 vjeçare (2014-2023) në vlerën **1,292,755,018 lekë ose thënë ndryshe rreth 11,752,318 euro**, janë përdorur me eficiencë dhe efektivitet rreth 114,023 mln lekë<sup>4</sup> ose vetëm **8,82 % e fondit total** ndërsa pjesa tjetër e vlerës prej **1,178,731,778 lekë** është përdorur pa eficiencë dhe efektivitet ku vlera prej **623,439,870 lekë ose 48 % e totalit**, duhet të ishte kthyer tashmë në buxhetin e shtetit nëse proceset gjyqësore dhe detyrat funksionale do të ishin kryer në kohë nga MAS.

Grupi i auditimit i klasifikoi në 5 kategori 137 përfituesit e FE, ku rezultoi se:

-Janë iniciuar në tejkalim të afateve të përcaktuara me VKM nr.483 datë 16.07.2014 ‘‘Për mbështetjen financiare të studenteve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës), Kreu III, pika 3, proceset gjyqësore nga MAS/ Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmozimit të kuadrit rregullator, për 10 përfitues të FE (në intervalin kohor 23.11.2022-04.01.2023), për kthimin e lekeve të përfituar nga MAS dhe shkelje të detyrimeve

<sup>4</sup> Shuma është mbledhje e vlerave të Kategorisë IV dhe V.

kontraktale, ku shuma që duhet të kthehet në buxhetin e shtetit është **91.439 mln lekë ose 831, 267 euro**.

- Mos përmbushja e detyrimeve Kontraktuale të akt marrëveshjeve nga të dy palët: Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe ish studentët përfitues të Fondit të Ekselencës ka sjellë përdorimin pa eficiencë dhe efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën **532,000,468 lekë ose rreth 4,836,368 euro për** 60 ish-studentë (trajtuar në tabelën 2 të aneksit 5 bashkëlidhur këtij RA). Nga MAS nuk janë kryer veprimet përkatëse për kërkimin dhe kthimin e shumës së përfituar nga FE në kundërshtim me kuadrin ligjor si dhe akt-marrëveshjet e nënshkruara nga të dy palët për, për të cilët duhet të ishin iniciuar proceset gjyqësore në kthimin e lekëve, duke vepruar me dy standarde në vlerësimin e situatave edhe pse këta individë janë në të njëjtat kushte shkelje detyrimesh kontraktuale sikurse 12 personat për të cilët është iniciuar procesi gjyqësor.

-Ka munguar monitorimi i vazhdueshëm nga Sekretariati teknik Përzgjedhës për periudhën 2014-2023, për 50 studentë me vlerë të përfituar nga Fondi i Ekselencës në shumën **590,514,735 lekë ose e thënë ndryshe 5,368,316 euro**, (paraqitur hollësisht në tabelën 3, të aneksit 5, të këtij RA), të cilët përbëjnë risk të shtuar në mosrespektimin e detyrimeve kontraktuale që konsistojnë:

a. Në mosrespektimin e dorëzimit të dokumentacionit të detyrueshëm pas përfundimit të ciklit të studimeve brenda 30 ditëve nga mbarimi i shkollës. (diplomë + listë notash të Universitetit ku ka ndjekur studimet)

b. Në dorëzimin e kontratave të punës më tepër në subjekte privatë të siguruar me pagë minimale dhe këto jo në afatin 6 muajor të përcaktuar në ligj.

c. Në Mungesën e ndjekjes së vazhdimësisë të punësimit për 3 vite në Shqipëri të këtyre individëve nga Sekretariati teknik Përzgjedhës dhe drejtoritë përgjegjëse në MAS.

**5.1 Rekomandim:** Ministria e Arsimit dhe Sportit të marrë masa në monitorimin e akt marrëveshjeve të lidhura për fondin e ekselencës dhe respektimin e detyrimeve kontraktuale.

**Menjëherë e në vijimësi**

### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

“Janë hartuar dy raporte të ecurisë së përfituesve të FE për periudhën 2014-2022, në Janar 2025 dhe Qershor 2025. Bashkëlidhur gjeni kopje të raporteve.

Mbi bazën e tyre, ne vijim, aktualisht janë 33 përfitues duke u ndjekur në rrugë gjyqësore dhe procesi është në vijim.

Nga analiza e kryer statusi i ish-përfituesve është si më poshtë:

Raporti i përgatitur në muajin Qershor 2025, reflekton rishikimin edhe një herë të statusit të të gjithë përfituesve për periudhën 2014-2022. Sikurse evidentohet edhe me poshtë, në raportimin e muajit Qershor 2025, nga riveifikimi i të dhënave të përfituesve, rezultojnë ndryshime në statusin e tyre në të gjithë kategoritë si më poshtë:

- **28 Përfitues** (21% e përfituesve) kanë përmbushur detyrimet
- **33 përfitues** (25% e përfituesve) janë aktualisht duke u ndjekur në procese gjyqësore
- **25 përfitues** (19% e përfituesve) nuk kanë plotësuar detyrimet duhet të vijojë të ndiqen nga strukturat përkatëse të MAS në rrugë gjyqësore.
- **49 përfitues** 37% e përfituesve) duhet të vijojë të monitorohen në vijimësi, për të garantuar plotësimin e detyrimeve të punësimit/kthimit të shumave të përfituara, sipas kontratave të nënshkruara me MAS. Rekomandimi është zbatuar”.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe faktit se 37% e përfituesve duhet të vijojnë të monitorohen në vijimësi, për të garantuar plotësimin e detyrimeve të punësimit/kthimit të shumave të përfituara, sipas kontratave të nënshkruara me MAS rekomandimi rezulton **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

### **Statusi i rekomandimit: në proces zbatimi.**

**5.2 Rekomandimi:** Ministri i Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të kuadrit rregullator të marrë masa në ndjekjen dhe finalizimin e proceseve gjyqësore e konkretisht:

- për 10 përfitues të Fondit të ekselencës në vlerën **91,439 mln lekë dhe kthimin e tyre në buxhetin e shtetit sipas tabelës 1** në aneksin 5 (ndr.<sup>5</sup>);
- të nisi menjëherë proceset gjyqësore për kthimin e shumave të marra nga 60 ish përfitues të Fondit të Ekselencës me një vlerë **532,000,468 lekë, në shkelje të detyrimeve kontraktuale** sipas tabelës 2 në aneksin 5 (ndr.<sup>6</sup>).

### **Menjëherë e në vijimësi**

### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

“Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Sektori i Këshillimit të Çështjeve Ligjore, pas memos së dërguar nga Sekretariati Teknik i Fondit të Ekselencës me nr. 2707/18 prot., datë 22.05.2024, me lëndë “*Lidhur me përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të studentëve që kanë kryer studimet financiare nga Fondi i Ekselencës*”, ku referojnë për ndjekjen e procedurave përkatëse ligjore për kthimin e shumës nga 15 përfituesit e listuar, si më poshtë, ju informojmë se Sektori i Këshillimit të Çështjeve Ligjore është në proces gjyqësor për të gjithë përfituesit e listuar në memon e sipërcituar.

Më poshtë po ju japim informacionin përkatës për secilin prej tyre:

1. MAS- E. B. me objekt: “*Detyrimin e palës së paditur znj. E. B. të kthejë shumën në vlerën totale 60,356 (gjashtëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e gjashtë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 7311/2 prot., datë 16.10.2014.*

*Detyrimin e palës së paditur znj. E. Br. të kthejë shumën në vlerën totale 52,439 (pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 8624/5 prot., datë 27.10.2015.*

*Detyrimin e palës së paditur znj. E. B të kthejë shumën në vlerën totale 52,572 pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 11490 prot., datë 15.11.2016. Detyrimin e palës së paditur znj. E. Bi. të kthejë shumën në vlerën totale 56,456 (pesëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 8780/4 prot., datë 25.09.2017.”*

<sup>5</sup> Aneksi 5 i Raportit të Auditimit, përcjellë në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024.

<sup>6</sup> Aneksi 5 i Raportit të Auditimit, përcjellë në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024.

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

2. MAS- A. R me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. A. R. të kthejë shumën në vlerën totale 9,226 (njëzetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 7311/3 prot., datë 16.10.2014. Detyrimin e palës së paditur znj. A. R. të kthejë shumën në vlerën totale 8,972 (tetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 8624/6 prot., datë 27.10.2015. Detyrimin e palës së paditur znj. A. R. të kthejë shumën në vlerën totale 8,077 (tetë mijë e shtatëdhjetë e shtatë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9339/1 prot., datë 23.09.2016. Detyrimin e palës së paditur znj. A. R. të kthejë shumën në vlerën totale 10,586 (dhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 8780/3 prot., datë 25.09.2017.”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3. MAS- J. G. me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. J. Gj. të kthejë shumën në vlerën totale 9,000 (nëntë mijë) Euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Urdhrit nr. 419, datë 08.12.2009, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për pagesën e kandidatëve fitues që përfitojnë nga Fondi i Ekselencës për vitin 2010, për vitin e parë të studimeve”. Detyrimin e palës së paditur znj. J. Gj. të kthejë shumën në vlerën totale 5,150 (pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë) Euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 5460/16 prot., datë 28.09.2012. Detyrimin e palës së paditur znj. J. Gj. të kthejë shumën në vlerën totale 2,750 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 4463/14 prot., datë 10.09.2013. Detyrimin e palës së paditur znj. J. Gj. të kthejë shumën në vlerën totale 2,750 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 7311/5 prot., datë 16.10.2014.”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. MAS-D. M me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. D. M, të kthejë shumën në vlerën totale 36.795 USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 6182/3 prot., datë 25.08.2015.

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5. MAS- G. M me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. G. Mj të kthejë shumën në vlerën totale 87,979 (tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 10374 prot., datë 18.10.2016.”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. MAS –E. B me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. E. B të kthejë shumën në vlerën totale 22,376 (njëzetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) CHF të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9858/2 prot., datë 07.10.2016.”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7. MAS- I. M me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. I. M të kthejë shumën në vlerën totale 42.376 (dyzet e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) GBP të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 10374/2 prot., datë 18.10.2016”.

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8. MAS- M. Gj me objekt “ Detyrimin e palës së paditur znj. M. G.j, të kthejë shumën në vlerën totale 20, 911 (njëzetmijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë) CAD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9858/7 prot., datë 07.10.2016.

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

9. MAS- E. Ç me objekt “ Detyrimin e palës së paditur z. E. M. Ç. të kthejë shumën në vlerën totale 34.216 (tridhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) GBP të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 11214/5 prot., datë 07.12.2017”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

10. MAS- A. J me objekt “ Detyrimin e palës së paditur z. A. J. të kthejë shumën në vlerën totale 28,911 (njëzet e tetëmijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë) GBP ose 4,483,893 (katër milion e katërqind e tetëdhjetë e tremijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) Lekë, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 746 prot., datë 23.01.2018”.

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

11. MAS –R. L me objekt “Detyrimin e palës së paditur z. R. L. të kthejë shumën në vlerën totale 49,765 (dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) USD ose 6,287,623 (gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e shtatëmijë e gjashtëqind e njëzet e tre) Lekë, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9858/5 prot., datë 07.10.2016”.

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

12. MAS- R. A me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. R. A. të kthejë shumën në vlerën totale 25,869 (njëzet e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) Euro ose 3,347,448 (tre milion e treqind e dyzet e shtatëmijë e katërqind e dyzet e tetë) Lekë të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9650/7 prot., datë 19.09.2018.

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

13. MAS-U. K me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. U. K. të kthejë shumën në vlerën totale 38, 119.53 GBP ose 5,491,122.61 (pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e njëmijë e njëqind e njëzet e dy) Lekë të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9650/8 prot., datë 19.09.2018.”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

14. MAS-D. I me objekt “Detyrimin e palës së paditur znj. D. I. të kthejë shumën në vlerën totale 96,395.52 USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9650/10 prot., datë 19.09.2018.”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

15. MAS –I. M me objekt “*Detyrimin e palës së paditur znj. I. M. të kthejë shumën në vlerën totale 35,819 (tridhjetë e pesëmijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë) GBP ose 5,159,867 (pesë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë, të përfituar nga Fondi i Ekselencës*”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

16. MAS-J. Gj me objekt: “*Detyrimin e palës së paditur znj. J. G.j të kthejë shumën në vlerën totale 27,750 (njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) Euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 4364/24 prot., datë 05.07.2010, Akt-Marrëveshjes nr. 4230 prot. datë 03.08.2011, Akt-marrëveshjes nr. 6640/2 prot. datë 10.12.2012 si dhe Akt-marrëveshjes nr. 4463/22 prot. Datë 13.09.2013.*”

Statusi i gjyqit: Është në proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Për sa më sipër, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator ka hapur proceset gjyqësore për ish-përfituesit e FE, të sipërcituar, sipas memos me nr. 2707/18 prot., datë 22.05.2024, të Sekretariatit Teknik të FE.

Gjithashtu MAS është në proces gjyqësor për ish përfituesit, sipas memos me nr. 5792 prot., datë 4.11.2020, të Sekretariatit Teknik të FE, si më poshtë vijojnë:

17. MAS- A.I me objekt “*Detyrimin e palës së paditur znj. A. I. të kthejë shumën në vlerën totale 70,016 (shtatëdhjetë mijë e gjashtëmbëdhjetë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 8780/13 prot., datë 25.09.2017*”.

Statusi i gjyqit: Në lidhje me A. I, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka pranuar kërkesë padinë e MAS, me Vendimin nr. 4359 (80-2024-4540), datë 26.11.2024.

Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka sjellë njoftim me shkresën nr. 1760/1, datë 02.06.2025, për MAS me objekt “Rivendosje në afat të ankimit për me Vendimin nr. 4359 (80-2024-4540), datë 26.11.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, ku ka caktuar seancë përgatitore në prani të palë ndërgjyqëse me datë 17.09.2025, ora 09:30, pasi e paditura A. I ka depozituar një kërkesë për ‘Rivendosje në afat’ pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke pretenduar se “Nuk i është komunikuar në asnjë moment në formë të arsyetuar vendimi përfaqësuesve të saj në adresën e regjistruar të zyrës së avokatisë, pranë së cilës këta të fundit janë angazhuar si avokatë, duke i humbur kështu, e drejta e ankimit të vendimit.”

18. Paditës: Ministria e Arsimit dhe Sportit, i paditur E. D, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur z. E. D. të kthejë shumën në vlerën totale 41.061 (dyzet e një mijë e gjashtëdhjetë e një) GBP, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes nr. 8780/11 prot., datë 25.09.2017.*”

Statusi i gjyqit: Është në gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

19. Paditës: Ministria e Arsimit dhe Sportit, e paditur O. Sh, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur znj. O. Sh. të kthejë shumën në vlerën totale 34.725 (tridhjetë e katërmijë e shtatëqind e njëzet e pesë) GBP të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9958/3 prot., datë 10.10.2018.*”

Statusi i gjyqit: Në lidhje me O. Sh. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka pranuar kërkesë padinë e MAS. Nuk është njoftuar zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit vendimi i arsyetuar nga Gjykata, në këto kushte nuk ka asnjë veprim nga asnjëra palë.

20. Padiës: Ministria e Arsimit dhe Sportit, e paditur K. M, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur znj. K. M. të kthejë shumën në vlerën totale 60,933 (gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 11256/10 prot., datë 30.12.2015. Detyrimin e palës së paditur znj. K. M. të kthejë shumën në vlerën totale 71,890 (shtatëdhjetë e njëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9858/4 prot., datë 07.10.2016. Detyrimin e palës së paditur znj. K. M. të kthejë shumën në vlerën totale 69,126 (gjashtëdhjetë e nëntëmijë e njëqind e njëzet e gjashtë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 11214/2 prot., datë 07.12.2017. Detyrimin e palës së paditur znj. K.M. të kthejë shumën në vlerën totale 67,195+850 (gjashtëdhjetë e shtatëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) USD + 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 1126/10 prot., datë 30.12.2015.”*

Statusi i gjyqit: Në lidhje me K. M. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka pranuar kërkesë padinë e MAS. Nuk është njoftuar zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit vendimi i arsyetuar nga Gjykata, në këto kushte nuk ka asnjë veprim nga asnjëra palë.

21. Padiës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, i paditur K. T, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur z. K. T. të kthejë shumën në vlerën totale 60,931 (gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) USD, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes nr. 11256/8 prot., datë 30.12.2015”.*

Statusi i gjyqit: Në lidhje me K. T. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka rrëzuar kërkesë padinë e MAS, me vendimin nr. 3472 (80-2024-3553) datë 08.10.2024. MAS ka depozituar ankim me nr. 1461/1 prot., datë 11.03.2025. Cështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, ende nuk ka një datë për zhvillimin e seancës.

22. Padiës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, e paditur Iva Ballvora, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur znj. I. B. të kthejë shumën në vlerën totale 38,025 (tridhjetë e tetëmijë e njëzet e pesë) GBP +350 (treqind e pesëdhjetë) Euro, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me Nr. 6374/4 Prot., datë 22.06.2018.*

Statusi i gjyqit: Në lidhje me I. B Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka rrëzuar kërkesë padinë e MAS. Nuk është njoftuar zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit vendimi i arsyetuar nga Gjykata, së cilës po i dërgohet shkresë për vënie në dispozicion të vendimit për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

23. Padiës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, e paditur A. L, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur znj. A. L. të kthejë shumën në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) GBP, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes nr. 9671/3 prot., datë 26.12.2014. Detyrimin e palës së paditur znj. A. L. të kthejë shumën në vlerën 27,156 (njëzet e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) GBP, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas Akt-Marrëveshjes nr. 11256/9 prot., datë 30.12.2015.*

Statusi i gjyqit: Në lidhje me A. L. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka rrëzuar kërkesë padinë e MAS me vendimin nr. 3942 (80-2024-4004) datë 14.11.2024. MAS ka depozituar ankim me nr. 7326/1 prot., datë 05.12.2024. Cështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, ende nuk ka një datë për zhvillimin e seancës.

24. Padiës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, i paditur K. K, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur z. K. K. të kthejë shumën në vlerën totale 33,000 (tridhjetë e tre mijë) GBP të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 9671/6 prot., datë 26.12.2014.*”

Statusi i gjyqit: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, ka pranuar kërkesë padinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për K. K. me vendimin nr. 1051 (80-2024-1045), datë 08.04.2024, nuk ka veprim nga pala gjyqumbëse.

25. Padiës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, e paditur P. P, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur znj. P. P. të kthejë shumën në vlerën totale 10.158 (dhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes me nr. 7311/1 prot., datë 16.10.2014.*”

Statusi i gjyqit: Në lidhje me P. P Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka rrëzuar kërkesë padinë e MAS. Nuk është njoftuar zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit vendimi i arsyetuar nga Gjykata, së cilës po i dërgohet shkresë për vënie në dispozicion të vendimit për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

26. Në lidhje me përfituesin e H. K, rast individual, sipas memos, datë 27.08.2020, të Sekretariatit Teknik të FE. MAS ka depozituar kërkesë padinë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë me objekt “*Detyrimin e palës së paditur z. H. K. të kthejë shumën në vlerën totale 51.943 (pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e tre) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale*”.

Statusi i gjyqit: Ministria e Arsimit dhe Sportit në lidhje me këtë çështje ka hartuar kërkesë padinë protokolluar në MAS me nr. 2339 prot., datë 23.04.2021.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, në përfundim të gjykimit, me Vendimin nr. 2469, datë 14.09.2021, ka vendosur:

“1. Pranimin e kërkesëpadisë.

Detyrimin e palës së paditur z. H. K. të kthejë shumën në vlerën totale 51.943 (pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e dyzet e tre) USD të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale sipas aktmarrëveshjes me numër 6182 prot., datë 25.08.2015”.

Vendimi i sipërcituar është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, nga pala e paditur z. H. K, dhe çështja është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

**Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në vijim të memos së Sekretariatit teknik të FE, ka përfunduar hartimin e 7 kërkesë-padive për përfituesit sa më poshtë:**

1. MAS – J. K, me objekt : “Detyrimin e palës së paditur znj. J. K. të kthejë shumën në vlerën totale 36,500 (tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind ) GBP dhe 40, 000 (dyzet mijë) Lekë, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 4644/1 prot., datë 24.12.2021”.
2. MAS – I. C, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur znj. I. C. të kthejë shumën në vlerën totale 69, 840 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet) USD dhe 90,000 (nëntëdhjetë mijë) lekë të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 3476/3 prot., datë 24.12.2021”.
3. MAS – F. H, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur z. F. A. H të kthejë shumën në vlerën totale 74,627 (shtatëdhjetë e katërmijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) USD dhe 90,000

(nëntëdhjetë mijë) Lekë, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt - Marrëveshjes me nr. 4179/1 prot., datë 03.09.2020”.

4. MAS – O. H, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur z. O. A. H. të kthejë shumën në vlerën totale 53,586 (pesëdhjetë e tremijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë) USD dhe 90,000 (nëntëdhjetë mijë) Lekë, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 2242/1 prot., datë 29.07.2020”.
5. MAS – K. K, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur z. K. K. K. të kthejë shumën në vlerën totale 38,734 (tridhjetë e tetëmijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) GBP dhe 40, 000 (dyzet mijë) Lekë, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 4642/1 prot., datë 23.09.2021”.
6. MAS - Xh. P, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur znj. Xh. P. të kthejë shumën në vlerën totale 150,358 (njëqind e pesëdhjetëmijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) USD dhe 180,000 (njëqind e tetëdhjetëmijë) Lekë, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 2414/2 prot., datë 17.08.2021 dhe Akt-Marrëveshjes nr. 1004/2 prot., datë 03.08.2021”.
7. MAS – A. L, me objekt: “Detyrimin e palës së paditur z. A. L. të kthejë shumën në vlerën totale 67,772 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy) USD dhe 850 (tetëqind e pesëdhjetë) EUR, të përfituar nga Fondi i Ekselencës, për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas Akt-Marrëveshjes nr. 3253/1 prot., datë 29.07.2020”.

**Në total janë 33 kërkesë** padi drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, prej të cilave dy prej tyre është bërë pushim gjykimi (E. T dhe R. R), pasi palët e paditura kanë kthyer shumat e përfituara nga Fondi i Ekselencës.

Në vijim të raportit të Sekretariatit teknik të FE për muajin Qershor 2025, MAS do të vijojë menjëherë me proceset gjyqësore për ish përfituesit të cilët rezultojnë në shkelje të aktmarrëveshjes dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Procedurat për të gjithë ish-përfituesit do të vijojnë të ndiqen në vijimësi.

Aktualisht është në proces **përgatitja e njoftimeve për kthimin e shumës së përfituar** edhe për 21 (njëzetë e një) ish-përfitues të FE, sa më poshtë:

B.Xh, E.H, O.M, S.L, L.O, E.Gj, T.Q, A.S, J.N, R.M, H. S, B. M, E.Q, Gj.M, P.B, A.B, S.Sj, I.Xh, D.K, S.K, D.C.

Në rast te mos përmbushjes së detyrimit për kthim vullnetar të shumës së përfituar (brenda afatit 6 mujor), MAS do të vijojnë procedurat ligjore për zbatimin e akt marrëveshjeve. Rekomandimi është përmbushur”.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Lidhur me sa më sipër, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe faktit të pranuar nga vetë subjekti, se MAS do të vijojë menjëherë me proceset gjyqësore për ish përfituesit të cilët rezultojnë në shkelje të aktmarrëveshjes dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe se procedurat për të gjithë ish-përfituesit do të vijojnë të ndiqen në vijimësi, vlerësohet se rekomandimi rezulton **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

**Statusi i rekomandimit: në proces zbatimi.**

**5.3 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit dhe Sportit/ Drejtoria e Përgjithshme Rregullatorë për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin dhe Sekretariati Teknik Përzgjedhës të marrë masa të kontrollojë vërtetësinë e kontratave të punës për 50 ish studentë përfitues të Fondit të Ekselencës, në plotësimin e kriterit 3- vjeçar të punësimit në Republikën e Shqipërisë dhe të inicojë kërkesë paditë në shkelje të detyrimeve kontraktuale, sipas tabelës 3 në aneksin 5 (ndr.<sup>7</sup>).

**Menjëherë e në vijimësi**

**Komentet e Subjektit të auditimit:**

“Bashkëlidhur Raporti nr.2\_Qershor 2025, mbi bazën e të cilit do të vijohet me monitorimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore. Rekomandimi është përmbushur”.

Në informacionin shtesë ardhur me postë elektronike, më datë 9.07.2025 nga MAS sqarohet, se “Raporti i muajit Qershor 2025, është hartuar duke verifikuar dokumentacionin zyrtar, i cili është listuar në mënyrë analitike si dhe është vendosur në dispozicion në format hard-copy, në vijim të Rekomandimit nr. 1 (lutem referojuni listës së dokumenteve në rekomandimin nr. 1 të cilat i keni edhe në format hard-copy).

Mbështetur në këto informacione si dhe në komunikim zyrtar (me shkresa dhe komunikim elektronik) me përfituesit e ish-FE, është hartuar raporti i muajit Qershor 2025, i cili bazohet edhe në kontratat e punës së subjekteve. Sipas të dhënave të raportit të muajit Qershor 2025, statusi i ish përfituesve është si më poshtë:

28 përfitues kanë përmbushur detyrimet;

33 përfitues janë aktualisht në proces gjyqësor;

25 përfitues nuk kanë përmbushur detyrimet dhe do të vijohet me procedurat ligjore, pas përfundimit të afateve ligjore të njoftimit;

49 përfitues po monitorohen në vijim, për të garantuar plotësimin e detyrimeve të punësit/kthimit të shumave.

Në kategoritë e mësipërme, përfshihen edhe të gjithë ish-përfituesit e listuar në tabelën 3, Aneksi 5 të rekomandimit”.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Lidhur me sa më sipër, referuar dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rekomandimi rezulton **i pranuar dhe në proces zbatimi**

**Statusi i rekomandimit: në proces zbatimi**

**B. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”,

---

<sup>7</sup> Aneksi 5 i Raportit të Auditimit, përcjellë në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024.

I është rekomanduar **Ministrit të Arsimit dhe Sportit** në vlerësim të parregullive të konsideruara nga ana KLSH - së, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës në procesin e mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore dhe për mos kryerje të detyrave funksionale në kohë dhe inicimin me vonesë ose fare të proceseve gjyqësore për kthimin e lekëve të marra nga përfituesit e Fondit të Ekselencës në buxhetin e shtetit në shkelje të detyrimeve kontraktuale, të trajtuara në mënyrë të detajuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit. nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, e konkretisht:

### **B.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE**

1. Z. E. T., Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ish/drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullore për Arsimin dhe Sportin, dhe në rolin e Kryetarit të STP, sipas urdhrit të Ministrit të MAS, nr. 194, datë 19.05.2015, Largim nga shërbimi civil sipas nenit 58 pika ç;
2. Znj. V. K., Drejtori i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmozimit të Kuadrit Rregullator, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
3. Znj. Z. Gj, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
4. Znj. E. D., Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
5. Znj. M. B., Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar si dhe Kryetare e Komisionit/STP për periudhën 2020-2023, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
6. xhimit Financiar, në rolin e anëtarit të STP, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
7. Znj. A. D., në rolin e anëtarit të STP, me pozicion aktual specialiste e SPB, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
8. Znj. I. B., në rolin e anëtarit të STP me pozicion, Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
9. Z. I. S., në rolin e anëtarit të STP me pozicion, specialist i sektorit të administrimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
10. Z. N. G., në rolin e anëtarit të STP me pozicion, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
11. Znj. E. D., në rolin e anëtarit të STP, me pozicion, specialiste e Sektorit të Projekteve, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
12. Znj. I. J., në rolin e anëtarit të STP, me pozicion, Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit dhe Integritimit, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
13. Znj. E. C., në rolin e anëtarit të STP, specialiste në sektorin e koordinimit dhe integritimit, larguar në tetor 2022, Vërejtje sipas nenit 58 pika a.

#### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

Per 13 masat e dhëna sa më sipër MAS trajton: “Referojuni shkresës së MAS nr. 2707/22 datë 20.06.2024 “kthim përgjigje “ ku citohet: Ministria e Arsimit dhe Sportit konsideron se nuk mund të marrë parasysh rekomandimet e dhëna në raport për dhënie masash disiplinore për nëpunësit e propozuar nga ana juaj, sipas sqarimeve të dhëna në shkresën bashkëlidhur”.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Rekomandimi i mësipërm i KLSH-së, referuar 13 punonjësve të sipërpërmendur i adresohet “Ministrit të Arsimit dhe Sportit, i cili në vlerësim të parregullsive të konsideruara nga ana KLSH - së, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës.....”.

Pas një vlerësimi të thelluar, duke pasur parasysh, se shkresa e MAS nr. 2707/22 datë 20.06.2024, me lëndë “Kthim përgjigje” mban firmën e Zëvendësministres, znj. A.K e jo të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe përderisa nga kjo ministri nuk është vënë në dispozicion ndonjë dokument i cili provon se Ministri ia ka deleguar Zëvendësministres përgjegjësinë e dhënies së kësaj përgjigjeje, Grupi i Auditimit e konsideron rekomandimin, të pranuar dhe të pazbatuar.

### **Statusi i rekomandimit: i pazbatuar.**

## **B.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.**

Sa i takon seksionit “**B.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**”, vërehet se për 15 ish punonjës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, pavarësisht se u konstatuan me shkelje administrative, nuk u rekomanduan masa disiplinore, pasi këta persona nuk ishin në marrëdhënie pune me këtë institucion në momentin e miratimit të Vendimit nr. 98, datë 31.05.2024 të Kryetarit të KLSH-së dhe dërgimit të Raportit të Auditimit, përcjellë në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024.

Sikurse thuhet në Vendimin nr. 98, datë 31.05.2024 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, “Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të jepej në përputhje me ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, përkatësisht për punonjësit:

1. Z. O. Rr, Ish/zëvendës ministri përgjegjës për Arsimin e Lartë;
2. Znj. A. T, Ish/Zv. ministri përgjegjës për arsimin e lartë;
3. Z. O. M, Ish/Sekretari i Përgjithshëm;
4. Z. A. K, Ish/Sekretari i Përgjithshëm;
5. Znj.L. B, në rolin e anëtarit të STP, (larguar nga MAS në janar 2020);
6. Znj. O. I, në rolin e anëtarit të STP, (larguar nga MAS në tetor 2014);
7. Znj. L. P, në rolin e anëtarit të STP, (larguar nga MAS në maj 2020);
8. Znj. I. T, në rolin e anëtarit të STP, (larguar nga MAS në shkurt 2022);.
9. Znj. J. H, në rolin e Kryetarit të STP, sipas urdhrit të Ministrit të MAS, nr. 43, datë 03.02.2016, (larguar nga MAS në mars 2016);
10. Znj. Zh.Bj, në rolin e anëtarit të STP, (larguar nga MAS në gusht 2016);
11. Znj. M. Sh, në rolin e anëtarit të STP, (larguar nga MAS në dhjetor 2018);.
12. Z. E. A, në rolin e Kryetarit të STP, larguar nga MAS në shtator 2020.;
13. Z. A.Tj, në rolin e anëtarit të STP, larguar nga MAS në korrik 2021;
14. Z. A. H, në rolin e anëtarit të STP, larguar nga MAS në janar 2022;
15. Z. D. S, në rolin e anëtarit të STP, larguar nga MAS në korrik 2022.

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Rekomandimi për 15 ish punonjësit, i trajtuar në seksionin B.2. duke qenë se nuk ka fushë zbatimi, konsiderohet i zbatuar.

## Statuasi i rekomandimit: i zbatuar.

Në vijim të depozitimit të Akt Verifikimit nr. 1, datë 18.07.2025, protokolluar me nr. 4585 prot., datë 18.07.2025, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ky subjekt *me shkresën nr. 4585/I prot., datë ka përcjellë: “Kthim përgjigje Akt-Verifikimit nr. 1, datë 18.07.2025....”, protokolluar në KLSH me nr. 684/5, datë 28.07.2025*, duke bërë me dije sa më poshtë:

“Nga ana jonë janë vlerësuar me kujdes rekomandimet e lëna nga KLSH dhe janë ndërmarrë një sërë masash për zbatimin e tyre, duke respektuar në maksimum detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me dërgimin e planit të masave brenda afatit ligjor 20-ditor, sqarojmë se Ministria në përgjigje të shkresës nr.583/10, datë 03.06.2024, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të protokolluar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me nr. 2707/21 prot., datë 05.06.2025, me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar për auditimin e performancës me temë “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore” (Fondi i Ekselencës)”, MAS ka realizuar ndjekjen dhe zbatimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH.

Në mbështetje të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, brenda 20 (njëzetë) ditëve nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit, MAS ka përcjellë në KLSH shkresën nr.2707/22 prot., datë 20.06.2024 “Kthim përgjigje”.

MAS me shkresën nr.2707/22 prot., datë 20.06.2024 “Kthim përgjigje” ka përmbushur kushtin e parë të detyrimit ligjor me kthimin përgjigje brenda 20 ditëve (konkretisht 15 ditëve nga marrja dijëni) dhe së dyti ka bërë me dije, me anë të kësaj shkrese, mbi rekomandimet që pranon dhe ato që nuk pranon, ku për të parat ka shpjeguar që po punon për hartimin e planit të masave për zbatim dhe për të dytat MAS ka argumentuar se përse nuk e pranon rekomandimin.

Pra me anë të shkresës së sipërcituar MAS është shprehur mbi rekomandimet që pranon dhe që do të marrë masa për zbatimin e tyre, ashtu siç realisht ka vepruar në vijim dhe siç konstatohet edhe nga grupi i auditimit.

Megjithatë, ndonëse sa më lart, duke vlerësuar se ky aspekt procedural, i cili në thelb nuk cenon përmbajtjen esenciale të punës voluminoze që është bërë nga MAS, rekomandimi do të mbahet në konsideratë për dhënie informacioni më të detajuar në raste që KLSH të kërkojë brenda një afati kohor të caktuar edhe hartimin e një plani konkret masash për zbatimin e rekomandimeve.

Në lidhje me respektimin e afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, MAS ka vënë në dispozicion shkresën nr. 2707/25 prot., datë 31.07.2024 me lëndë “Kthim përgjigje” në të cilën sqarohen masat e marra nga MAS për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të pranuar, nëpërmjet së cilës ju është bërë me dije ngritja e grupit të punës me Urdhrin nr. 370, datë 23.07.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të masave dhe monitorimin e zbatimit të tyre, në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, përcjelle mbi raportin përfundimtar nr. 53/3 prot., datë 03.06.2024 (mbi auditimin e performancës me temë “Mbështetja financiare e studenteve të shkëlqyer dhe nëpunësve civile të administratës shtetërore”.

Detyrimi për raportim në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” është brenda 6 muajve dhe ky detyrim kohor nga MAS është plotësuar, ashtu si dhe me anë të kësaj shkrese është bërë me dije mbi zbatimin e rekomandimeve të pranuar nga MAS, duke i vënë në dispozicion krahas urdhrin nr.370/2024 edhe planin e veprimit (matricën) mbi detyrat e ndara.

Ecuria e zbatimit të rekomandimeve, ka qenë një proces verifikimi që kërkonte kohë dhe në kushtet kur nuk kishte diçka konkrete për të raportuar mbi masat e marra nuk mund të referohej e detajuar në atë shkresë ecuria e dërguar brenda 6 muajve, pasi procesi ka qenë në vijimësi.

Në lidhje me rekomandimin e grupit të auditimit ku citohet se “MAS të marrë masa për përditësimin dhe harmonizimin në kohë të kuadrit ligjor e rregullator të Fondit të Ekselencës dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij dhe publikimin e tyre ne web”, sqarojmë se edhe ky rekomandim është i ezauruar dhe të gjitha aktet që kanë rregulluar Fondin e Ekselencës janë të publikuara në Fletoren Zyrtare dhe faqen web të MAS.

Në lidhje me harmonizimin e akteve nënligjore, konkretisht të vendimit 160, datë 19.02.2020 të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar dhe udhëzimit të ministrit nr. 6, datë 4.3.2020 “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”, duke qenë se formulimi dhe veprimi i këtij të fundit e gjen referencën në pikën 5 të Vendimit nr. 160/2020 të Këshillit të Ministrave, e cila rezulton e shfuqizuar nga VKM nr. 458/2022, cituar më lart, për pasojë edhe udhëzimi nr. 6 do të ndjekë të njëjtin efekt juridik me dispozitën nga e cila i burojnë kompetencat për atë pjesë specifike të përcaktimeve që burojnë nga këto dispozita.

Në kushtet kur politika e mbështetjes financiare me anë të FE ka ndryshuar si pasojë e mos realizimit të qëllimit të programit të Fondit të Ekselencës duke ndryshuar vendimin nr. 160, datë 19.2.2020 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, MAS ka vijuar të zbatojë përcaktimet e parashikuara në aktet nënligjore duke trajtuar vetëm kërkesat e studentëve të ndërmjetëm të FE.

Për këtë arsye, në kuadër të ndryshimit të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, i ndryshuar”, me vendimin nr. 458, datë 29.6.2022 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (fondi i ekselencës)”, të ndryshuar ku u shfuqizuan pikat 5 dhe 6 të vendimit në fuqi, përkatësisht si më poshtë:

*“5. Rregullat e hollësishme për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve e procedurave, për përcaktimin e masës dhe të mënyrës së financimit si dhe për numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni, për secilën nga bursat e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, i cili miratohet brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.*

*6. Përzgjedhja e kandidateve kryhet para fillimit të vitit akademik, nga komisione përzgjedhëse të ngritura me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin. Komisioni përzgjedhës kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose nga personi i deleguar prej tij, në nivel zëvendësministri ose nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues. Kur Fondi i Ekselencës plotësohet edhe nga donacione, në komision ka të drejtë të marrë pjesë edhe një përfaqësues i donatorëve.”*

Për sa më lartë, theksohet se nga MAS nuk është konsideruar e nevojshme ndryshimi i udhëzimit nr. 6, datë 4.3.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”, pasi vlerësohet e qartë, referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 6, datë 4.3.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë se dispozitat e udhëzimit, të cilat detajojnë

përmbajtjen e vendimit nr. 160, datë 19.02.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të zbatueshme vetëm për studentët vijues që kanë përfituar mbështetje financiare përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 458, datë 29.6.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)”, i ndryshuar”.

Me shfuqizimin e pikave 5 dhe 6 të vendimit nr. 160, datë 19.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar bien automatikisht detyrimet e përcaktuar në udhëzimin e sipërcituar, i cili del në bazë dhe për zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe në këtë aspekt juridik, nuk konsiderohet e nevojshme ndryshimi i udhëzimit nr. 6, datë 4.3.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pasi pikat e tij që lidhen me shfuqizimin përkatësisht të pikave të VKM-së, janë de jure automatikisht të shfuqizuara.

Pavarësisht sa më sipër, MAS ka proceduar me hartimin e projekt-udhëzimit për ndryshimin e udhëzimit nr.6/2020 dhe do t'i riparaqitet titullarëve të institucionit për miratim, si ndryshim i aktit rregullator në fuqi, siç vlerësohet nga auditimi i KLSH që duhet ndryshuar detyrimisht, pavarësisht arsytimit sa më lart të dhënë nga MAS.

Në lidhje me monitorimin e SKA 2021-2026 sqarojmë se, MAS ndjek dhe monitoron zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit (SKA) 2021-2026, të miratuar me VKM-në nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj” me prioritet dhe në koordinim të plotë me të gjithë aktorët e përfshirë.

SKA pasqyron të gjitha sfidat në fushën e arsimit në përputhje me vizionin dhe tre objektivat e saj. Për secilin objektiv jepen masa dhe tregues si pjesë e kësaj strategjie. Monitorimi i strategjisë kombëtare të arsimit bëhet në periudha 6-mujore për të demonstruar realizueshmërinë e masave të planifikuara. Në zbatim të urdhrin nr. 337, datë 15.06.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e SKA 2021-2026 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj”, i ndryshuar, në periudhat 6 mujore, (janar-qershor 2022, korrik-dhjetor 2022, etj në vijim), është kryer monitorimi i SKA 2021-2026. Raportimet përmbledhëse i janë paraqitur grupeve koordinuese të monitorimit të ngritur me urdhrin nr. 368, datë 14.07.2023 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupeve koordinuese për zbatimin e SKA 2021-2026 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj”.

SKA nuk ka patur masa të dedikuara Fondit të Ekselencës. Po t'i referohemi raportimit të bërë nga grupet e punës në zbatim të urdhrin nr. 337, datë 15.06.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupeve të punës për monitorimin e SKA 2021-2026 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj”, i ndryshuar, referuar objektivit specifik C5, në raportin e monitorimit të strategjisë për vitin 2022 cilësohet:

*“IV.V. Objektivit specifik C5: Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare.”.*

Për sa më sipër, në kudër të këtij objektivit specifik janë trajtuar të gjitha ndihmat financiare për studentët përfshirë ato të Fondit të Ekselencës.

Në drejtim të rekomandimeve të tjera, Ministria ka realizuar:

-Hartimin e planit të veprimit me Urdhrin nr. 370, datë 23.07.2024;

-Ngritjen e grupit të punës për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve;

-Përcjelljen e gjetjeve dhe rekomandimeve përkatëse në nivel politikash.

-Rishikimin e procedurave për shpërndarjen e fondeve duke ndryshuar destinacionin e tyre nga financim i studenteve ekselente jashtë vendit në financim për studente ekselente brenda vendit apo në degë prioritare. Bashkëlidhur gjeni edhe VKM dhe praktikën e këtij vendimi, i cili provon njëkohësisht edhe analizën e performancës së FE nga strukturat përkatëse të MAS.

Në lidhje me rekomandimin për marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësve, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka shprehur qëndrimin dhe argumentimin e saj nëpërmjet shkresës nr.2707/22 prot., datë 20.06.2024 “Kthim përgjigje”.

Ministria mbetet e angazhuar për zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH dhe do të vijojë të ndjeke me përgjegjësi zbatimin e rekomandimeve si dhe të informojë mbi progresin e realizimit të tyre, në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014”.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Sa vënë dukje nga MAS në shkresën e sipërcituar, përbën një informacion të njohur dhe të vlerësuar që në fazë terreni, i cili nuk e ndryshon vlerësimin e Grupit të Auditimit, lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe statusin e tyre.

#### **IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit **ri-kërkojmë** nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, për masat e pazbatuara, pjesërisht të zbatuara dhe në proces zbatimi, dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 583/10, datë 3.06.2024, të Raportit Përfundimtar të Auditimit “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore” (Fondi i ekselencës), si më poshtë:

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

#### **1. A është hartuar kuadri rregullator i nevojshëm me qëllim mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë?**

**1. Gjetje nga auditimi:** Me gjithë punën e bërë konstatohen disa mangësi në dokumentet e strategjisë e konkretisht:

- Është hartuar Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2014-2020, por nuk ka pasur një strategji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor me objektiva e për pasojë edhe për Fondin e Ekselencës deri në fund të vitit 2020.

- Në objektivat strategjike të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020 nuk është arritur plotësisht zbatimi i indikatorëve të rritjes me 10% të fondit të ekselencës nga viti në vit bazuar në buxhetin e vitit 2015 për ekselencën si dhe financimi i 50 studentë në vit nga fondin e ekselencës,

- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 nuk ka parashikuar fonde për studentët e ekselencës që studiojnë jashtë vendit,

- Nuk ka të dhëna për monitorimin sipas objektivave të strategjisë.

**1.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit të hartojë plan pune për monitorimin e performancës dhe ecurisë së Fondit të Ekselencës për periudhën 2014-2023 si dhe të analizojë mangësitë dhe shkaqet e mos realizimit të objektivave e nxjerrë përgjegjësitë.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në kuadrin ligjor të Fondit të Ekselencës konstatohen disa mangësi si:

- nuk ka asnjë të dhënë mbi ecurinë e VKM nr. 875, datë 19.12.2012 “Për fondin e ekselencës për mbështetje financiare të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj të shkëlqyer”,

- nuk është shfuqizuar pjesërisht dhe të rishikuar Udhëzimi nr. 6, datë 04.03.2020 për studentët e

ndërmjetëm që janë në proces të financimit të Fondit të Ekselencës,  
- janë nxjerrë rreth 4 vjet më vonesë nga hyrja në fuqi e Ligjit të ri nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM dhe Udhëzimeve nga Këshilli i Ministrave dhe Ministri i Arsimit dhe Sportit.

**2.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit të marrë masa për përditësimin dhe harmonizimin në kohë të kuadrit ligjor e rregullator të Fondit të Ekselencës dhe udhëzimeve të dala në zbatim të tij dhe publikimin e tyre në WEB.

**Brenda datës 30.12.2025**

## **2. A ka ndarje të qarta të roleve dhe përgjegjësi të institucioneve përgjegjëse në mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil?**

**3.1 Gjetje nga auditimi:** Me gjithë punën e bërë konstatohen disa mangësi e konkretisht:

- Ristrukturimi i shpeshtë i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit 2014-2023, ka sjellë ndryshime të pozicioneve dhe funksioneve të drejtuesve dhe specialistëve përkatës duke mos u shoqëruar në kohë me rregulloret e brendshme të MAS, çka ka sjell, ndarje të pa qarta të roleve dhe mos kryerje të detyrave sipas funksionit përkatës;

- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet drejtorive përkatëse (Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator) ka sjellë mos evidentim në kohë reale të zbatimit të detyrimeve kontraktuale dhe marrjes së masave ligjore nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në lidhje me procesin e mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë.

**3.2 Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë megjithëse është krijuar në vitin 2017, sipas VKM-së nr. 397 datë 03.07.2017 nuk ka ushtruar kompetencat e saj ligjore si institucion në lidhje me financimin e studentëve të shkëlqyer.

**3.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit të marrë masa të ndajë rolet e detyrat ndërmjet Sekretariatit Teknik Përzgjedhës, Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në lidhje me ecurinë e Fondit të Ekselencës në ndjekjen e proceseve gjyqësore për të gjithë rastet e mos zbatimit të detyrimeve kontraktuale të studentëve përfitues.

**Brenda datës 30.12.2025**

## **3. A është matur impakti i financimit të mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civil për kontributin e tyre në forcimin e kapaciteteve të institucioneve në vend, në hulimtim, inovacion përmirësimin e cilësisë së arsimit, shkencës, teknologjisë, apo sektorë të tjerë, sipas fushave ku ata kanë studiuar?**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga fondi total i ekselencës për një periudhë 10 vjeçare (2014-2023) në vlerën **1,292,755,018 lekë ose thënë ndryshe rreth 11,752,318 euro**, janë përdorur me eficiencë dhe efektivitet rreth 114,023 mln lekë<sup>8</sup> ose vetëm **8,82 % e fondit total** ndërsa pjesa tjetër e vlerës prej **1,178,731,778 lekë** është përdorur pa eficiencë dhe efektivitet ku vlera prej **623,439,870 lekë ose 48 % e totalit**, duhet të ishte kthyer tashmë në buxhetin e shtetit nëse proceset gjyqësore dhe

---

<sup>8</sup> Shuma është mbledhje e vlerave të Kategorisë IV dhe V.

detyrat funksionale do të ishin kryer në kohë nga MAS.

Grupi i auditimit i klasifikoi në 5 kategori 137 përfituesit e FE, ku rezultoi se:

-Janë iniciuar në tejkalim të afateve të përcaktuara me VKM nr.483 datë 16.07.2014 ‘‘Për mbështetjen financiare të studenteve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore (Fondi i Ekselencës), Kreu III, pika 3, proceset gjyqësore nga MAS/ Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmozimit të kuadrit rregullator, për 10 përfitues të FE (në intervalin kohor 23.11.2022-04.01.2023), për kthimin e lekeve të përfituar nga MAS dhe shkelje të detyrimeve kontraktuale, ku shuma që duhet të kthehet në buxhetin e shtetit është **91,439 mln lekë ose 831, 267 euro**.

- Mos përmbushja e detyrimeve Kontraktuale të akt marrëveshjeve nga të dy palët: Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe ish studentët përfitues të Fondit të Ekselencës ka sjellë përdorimin pa eficiencë dhe efektivitet të fondeve të buxhetit të shtetit në vlerën **532,000,468 lekë ose rreth 4,836,368 euro për** 60 ish-studentë (trajtuar në tabelën 2 të aneksit 5 bashkëlidhur këtij RA). Nga MAS nuk janë kryer veprimet përkatëse për kërkimin dhe kthimin e shumës së përfituar nga FE në kundërshtim me kuadrin ligjor si dhe akt-marrëveshjet e nënshkruara nga të dy palët për, për të cilët duhet të ishin iniciuar proceset gjyqësore në kthimin e lekëve, duke vepruar me dy standarde në vlerësimin e situatave edhe pse këta individë janë në të njëjtat kushte shkelje detyrimesh kontraktuale sikurse 12 personat për të cilët është iniciuar procesi gjyqësor.

-Ka munguar monitorimi i vazhdueshëm nga Sekretariati teknik Përzgjedhës për periudhën 2014-2023, për 50 studentë me vlerë të përfituar nga Fondi i Ekselencës në shumën **590,514,735 lekë ose e thënë ndryshe 5,368,316 euro**, (paraqitur hollësisht në tabelën 3, të aneksit 5, të këtij RA), të cilët përbëjnë risk të shtuar në mosrespektimin e detyrimeve kontraktuale që konsistojnë:

a. Në mosrespektimin e dorëzimit të dokumentacionit të detyrueshëm pas përfundimit të ciklit të studimeve brenda 30 ditëve nga mbarimi i shkollës. (diplomë + listë notash të Universitetit ku ka ndjekur studimet)

b. Në dorëzimin e kontratave të punës më tepër në subjekte privatë të siguruar me pagë minimale dhe këto jo në afatin 6 muajor të përcaktuar në ligj.

c. Në Mungesën e ndjekjes së vazhdimësisë të punësimit për 3 vite në Shqipëri të këtyre individëve nga Sekretariati teknik Përzgjedhës dhe drejtoritë përgjegjëse në MAS.

**4.1 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit të marrë masa në monitorimin e akt marrëveshjeve të lidhura për fondin e ekselencës dhe respektimin e detyrimeve kontraktuale.

**Në vijimësi**

**4.2 Rekomandimi:** Ministri i Arsimit dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të kuadrit rregullator të marrë masa në ndjekjen dhe finalizimin e proceseve gjyqësore e konkretisht:

- për 10 përfitues të Fondit të ekselencës në vlerën **91,439 mln lekë dhe kthimin e tyre në buxhetin e shtetit sipas tabelës 1** në aneksin 5 (ndr.<sup>9</sup>);

- të nisi menjëherë proceset gjyqësore për kthimin e shumave të marra nga 60 ish përfitues të Fondit të Ekselencës me një vlerë **532,000,468 lekë, në shkelje të detyrimeve kontraktuale sipas tabelës 2** në aneksin 5 (ndr.<sup>10</sup>).

<sup>9</sup> Aneksi 5 i Raportit të Auditimit, përcjellë në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024.

<sup>10</sup> Aneksi 5 i Raportit të Auditimit, përcjellë në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024.

**4.3 Rekomandimi:** Ministria e Arsimit / Drejtoria e Përgjithshme Rregullatorë për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin dhe Sekretariati Teknik Përzgjedhës të marrë masa të kontrollojë vërtetësinë e kontratave të punës për 50 ish studentë përfitues të Fondit të Ekselencës, në plotësimin e kriterit 3- vjeçar të punësimit në Republikën e Shqipërisë dhe të inicojë kërkesë paditë në shkelje të detyrimeve kontraktuale, sipas tabelës 3 në aneksin 5 (ndr.<sup>11</sup>).

## B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*,

I rekomandojmë **Ministrin të Arsimit** në vlerësim të parregullsive të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës në procesin e mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore dhe për mos kryerje të detyrave funksionale në kohë dhe inicimin me vonesë ose fare të proceseve gjyqësore për kthimin e lekëve të marra nga përfituesit e Fondit të Ekselencës në buxhetin e shtetit në shkelje të detyrimeve kontraktuale, të trajtuara në mënyrë të detajuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, *“Për nëpunësin civil”*, e konkretisht:

### B.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE

1. Z. E.T, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ish/drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, dhe në rolin e Kryetarit të STP, sipas urdhrit të Ministrin të MAS, nr. 194, datë 19.05.2015, Largim nga shërbimi civil sipas nenit 58 pika ç;
2. Znj. V.K, Drejtori i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmozimit të Kuadrit Rregullator, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
3. Znj. Z.Gj, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
4. Znj. E.D, Drejtori i Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;

---

<sup>11</sup> Aneksi 5 i Raportit të Auditimit, përcjellë në Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me shkresën me nr. 583/10, datë 3.06.2024.

5. Znj. M.B, Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar si dhe Kryetare e Komisionit/STP për periudhën 2020-2023, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
6. Z. F.N, me pozicion, përgjegjës i sektorit të Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në rolin e anëtarit të STP, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
7. Znj. A.D, në rolin e anëtarit të STP, me pozicion aktual specialiste e SPB, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
8. Znj. I.B, në rolin e anëtarit të STP me pozicion, Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
9. Z. I.S, në rolin e anëtarit të STP me pozicion, specialist i sektorit të administrimit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
10. Z. N.G, në rolin e anëtarit të STP me pozicion, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
11. Znj. E.D, në rolin e anëtarit të STP, me pozicion, specialiste e Sektorit të Projekteve, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
12. Znj. I.J në rolin e anëtarit të STP, me pozicion, Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit dhe Integritimit, Vërejtje sipas nenit 58 pika a;
13. Znj. E.C., në rolin e anëtarit të STP, specialiste në sektorin e koordinimit dhe integritimit, larguar në tetor 2022, Vërejtje sipas nenit 58 pika a.

## V. OBSERVACIONE MBI PROJEKTRAPORTIN

Me shkresën nr. 4934/2 prot., datë 26.08. 2025 (shkresa nr. 684/33 prot., datë 27.08.2025, sipas protokollit të KLSH) Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka përcjellë këto observacione:

### ➤ Lidhur me Rekomandimin 1.1 të Projektraportit:

“...Në lidhje me rekomandimin që MAS të hartojë plan pune për monitorimin e performancës dhe ecurisë së Fondit të Ekselencës për periudhën 2014-2023 si dhe *të analizojë mangësitë dhe shkaqet e mos realizimit të objektivave e nxjerrë përgjegjësitë*, brenda datës 30.12.2025, sqarojmë se MAS në vijim të gjithë punës së kryer, të shpjeguar si më lart, do të vijoje monitorimin e performancës dhe ecurisë së Fondit të Ekselencës për periudhën 2014-2023, *duke u përpjekur që ky proces të mund të realizohet brenda datës 30.12.2025*, siç përcakton Grupi i Auditimit, në rast se nuk do të ekzistojë ndonjë shkak ligjor që do të pamundësojë objektivisht përmbushjen e këtij detyrimi brenda kësaj periudhe si psh. mospërfundimi i studimeve të mëtejshme ose vijimi i studimeve të cikleve më të larta nga ana e studentit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në bazë të të cilit është përfituar mbështetja financiare në kuadër të programit të Fondit të Ekselencës...”.

### Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Sikurse nga diskutimet dhe për sa dakordësuar midis përfaqësuesve të KLSH – së dhe të MAS, në takimin e mirëkuptimit të datës 4.09.2025, afati i zbatimit të rekomandimit do përcaktohet “**Në vijimësi**”.

Për sa më lart, **vetëm lidhur me afatin**, observacioni merret në konsideratë dhe ndryshimi i tij u reflektua në material.

### ➤ Lidhur me Rekomandimin 2.1 të Projektraportit:

“...Pavarësisht sa më sipër, në vijim, do të rivlerësojmë ndryshimet e nevojshme të aktit rregullator në fuqi dhe pas finalizimit, do të realizohet publikimi i tij në WEB, sikurse është rekomanduar nga Grupi i Auditimit të KLSH-së, për t’u përmbushur brenda datës 30.12.2025.”

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Grupi i Auditimit vëren, se përtej parashtrimit që i paraprin shprehjes të sa cituar më lart, edhe subjekti bie dakord me vlerësimin e grupit të auditimit.

Për sa më lart, *observacioni nuk merret në konsideratë.*

#### **➤ Lidhur me Rekomandimin 3.1 të Projektraportit:**

“Ministria e Arsimit dhe Sportit e ka zbatuar këtë rekomandim për ndarjen e roleve dhe detyrat, duke hartuar matricën përkatëse të ndarjes së detyrave, ndërmjet Sekretariatit Teknik Përzgjedhës, Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në lidhje me ecurinë e Fondit të Ekselencës në ndjekjen e proceseve gjyqësore për të gjithë rastet e mos zbatimit të detyrimeve kontraktuale të studentëve përfitues, e cila i është vënë në dispozicion grupit të auditimit.

Bashkëlidhur Urdhri nr. 370, datë 23.07.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të masave dhe monitorimin e zbatimit të tyre, në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, përcjellë mbi raportin përfundimtar nr. 53/3 prot., datë 03.06.2024 (mbi auditimin e performancës me temë “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore” (Fondi i Ekselencës) dhe matrica shoqëruese.”.

**Në takimin e mirëkuptimit të datës 4.09.2025**, zhvilluar me përfaqësuesit e MAS, grupi i auditimit i kërkoi subjektin, përcjelljen e matricës së ndarjes së detyrave, ndërmjet Sekretariatit Teknik Përzgjedhës, Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në lidhje me ecurinë e Fondit të Ekselencës, meqë nga sa u nënvizua, ky dokument as nuk ishte vënë në dispozicion më parë, sikurse dhe as nuk i ishte bashkëlidhur observacioneve të dërguara.

Në vijim të kërkesës së bërë nga grupi i auditimit, *me e-mailin e datës 9.09.2025*, MAS ka përcjellë në formatin Excel një file, atë që më lart e quan “matricë”.

#### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Grupi i Auditimit vëren se matrica e dërguar nga MAS, nuk është gjë tjetër veçse një plan masash, për zbatimin e rekomandimeve (lexo në faqen 4 të Raportit) dhe jo një matricë ndarje rolesh e detyrash, ndërmjet Sekretariatit Teknik Përzgjedhës, Drejtorisë së Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, si dhe Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit, sikurse kërkuar në rekomandim. Duke iu referuar konkretisht “produktit të pritshëm” citojmë sa referuar nga vetë MAS: “Me Urdhrin nr. 370, datë 23.07.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit të masave dhe monitorimin e zbatimit të tyre, në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit përcjellë me raportin përfundimtar nr. 583/10 Prot., datë 03.06.2024 “Mbi auditimin e performancës me temë “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore”, është ngritur grupi i punës i cili sipas urdhrin do të hartojë planin e masave në zbatim të rekomandimeve që KLSH ka lënë. *Grupi i punës do të marrë masa për të ndarë rolet e detyrat ndërmjet strukturave në MAS në lidhje me menaxhimin e FE.*”.

Pra vetë MAS e njeh mirë diferencën midis planit të masave për zbatimin e rekomandimeve dhe masat e nevojshme për ndarjen e roleve dhe detyrave ndërmjet strukturave në MAS në lidhje me menaxhimin e “Fondit të ekselencës”.

Për sa më lart, **observacioni nuk merret në konsideratë**.

➤ **Lidhur me Rekomandimin 4.1 të Projektraportit:**

“...Ndonëse nga MAS në hartimin e raporteve të cituar si më sipër është bërë një punë voluminoze në funksion të gjurmimit të shlyerjes së detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi dhe në akt-marrëveshjet e nënshkruara midis gjithë studentëve përfitues të FE dhe MAS, kjo e fundit do të vijojë me prioritet punën për gjurmimin mbi shlyerjen e detyrimeve të ish-përfituesve nga FE, por për arsye objektive konsiderohet e vështirë që ky rekomandim të përmbushet brenda datës 30.12.2025, pasi në procesin e gjurmimit duhet të kryhet jo vetëm verifikimi i të gjithë dokumentacionit shkresor të paraqitur nga përfituesi, i detyrimeve kontraktuale ndërmjet palëve, por duhet të bëhen edhe njoftime, komunikime shkresore me strukturat përgjegjëse të gjendjes civile, të tatimeve, të sigurimeve shoqërore, me vetë ish-përfituesit mbi nevojën për saktësime të ndryshme informacioni, sipas rastit apo për vënien në dijeni të tyre mbi ekzekutimin vullnetar të kthimit të shumës së përftuar mbi bazën e marrëveshjes së lidhur me MAS, fakte këto që krijojnë shumë vështirësi në aspektin kohor, **gjë që ndikojnë objektivisht në pamundësinë e përmbushjes së këtij rekomandimi brenda datës 30.12.2025**”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Sikurse dhe nga diskutimet dhe për sa dakordësuar midis përfaqësuesve të KLSH – së dhe të MAS, në takimin e mirëkuptimit të datës 4.09.2025, afati i zbatimit të rekomandimit do përcaktohet “**Në vijimësi**”.

Për sa më lart, **vetëm lidhur me afatin, observacioni merret në konsideratë** dhe ndryshimi i tij u reflektua në material.

➤ **Lidhur me Rekomandimin 4.2 të Projektraportit:**

“...Në vijim të raportit të Sekretariatit teknik të FE për muajin Qershor 2025, Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, do të vijojë menjëherë me proceset gjyqësore për ish-përfituesit të cilët kanë qenë në shkelje të aktmarrëveshjes dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, por në kushtet, siç u sqarua edhe më lart, që kërkohet një punë e gjerë hulumtuese dhe gjurmuese mbi rastet e çdo ish-përfituesi nga FE, si komunikime shkresore me strukturat përgjegjëse të gjendjes civile, të tatimeve, të sigurimeve shoqërore, si dhe me vetë ish-përfituesit mbi nevojën për saktësime të ndryshme informacioni, sipas rastit apo për vënien në dijeni të tyre mbi ekzekutimin vullnetar të kthimit të shumës së përftuar mbi bazën e marrëveshjes së lidhur me MAS, fakte këto që krijojnë shumë vështirësi në aspektin kohor, vlerësojmë se objektivisht do të jemi në pamundësi të përmbushjes së këtij rekomandimi brenda datës 30.12.2025”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Sikurse dhe nga diskutimet dhe për sa dakordësuar midis përfaqësuesve të KLSH – së dhe të MAS, në takimin e mirëkuptimit të datës 4.09.2025, afati i zbatimit të rekomandimit do përcaktohet “**Në vijimësi**”.

Për sa më lart, **vetëm lidhur me afatin, observacioni merret në konsideratë** dhe ndryshimi i tij u reflektua në material.

➤ **Lidhur me Rekomandimin 4.3 të Projektraportit:**

“...konsiderohet se *afati, brenda datës 30.12.2025, i rekomanduar nga Grupi i Auditimit, mund të jetë objektivisht i përealizueshëm*, por MAS zotohet se do të bëjë përpjekje maksimale që të përmbushë detyrimin brenda këtij afati ose do të argumentojë mbi bazë provash shkresore deri në cilën masë është përmbushur ky rekomandim dhe kohën shtesë që do të nevojitet për ta përmbushur plotësisht.”.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Sikurse dhe nga diskutimet dhe për sa dakordësuar midis përfaqësuesve të KLSH – së dhe të MAS, në takimin e mirëkuptimit të datës 4.09.2025, afati i zbatimit të rekomandimit do përcaktohet **“Në vijimësi”**.

Për sa më lart, **vetëm lidhur me afatin**, **observacioni merret në konsideratë** dhe ndryshimi i tij u reflektua në material.

**Lidhur me Rekomandimin nëpërmjet të cilit** “I rekomandohet Ministrit të Arsimit dhe Sportit në vlerësim të parregullsive të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës në procesin e mbështetjes financiare të studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore dhe për mos kryerje të detyrave funksionale në kohë dhe inicimin me vonesë ose fare të proceseve gjyqësore për kthimin e lekëve të marra nga përfituesit e Fondit të Ekselencës në buxhetin e shtetit në shkelje të detyrimeve kontraktuale, të trajtuara në mënyrë të detajuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit. nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, **subjekti shprehet se:** “Ministria e Arsimit dhe Sportit konsideron se nuk mund të marrë parasysh rekomandimet e dhëna për dhënie masash disiplinore për nëpunësit e propozuar nga ana e KLSH...”, duke listuar katër pretendime, që lidhen me përmbajtjen e Raportit dhe administrimin e procesit të auditimit nga grupi i auditimit, në vitin 2024.

Më tej, nga subjekti theksohet se: “... se lidhur me delegimin e kompetencave të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, zëvendësministrit të kësaj ministrie, znj. A. K, mbi dhënien e përgjigjeve për kontrollet dhe raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të auditit të brendshëm sipas fushës së përgjegjësisë për të ndjekur procedurën e nënshkrimit, në emër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit lidhur me procedurat shkresore me KLSH është i përcaktuar drejtpërdrejt në shkronjën “nj”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar...”. Po ashtu më lart subjekti citon urdhrin, i cili përcakton: ““2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

*nj) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet për kontrollet dhe raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të auditit të brendshëm sipas fushës së përgjegjësisë, të koordinuara nga Sekretari i Përgjithshëm.”*

**Në takimin e mirëkuptimit të datës 4.09.2025**, zhvilluar me përfaqësuesit e MAS, nga ana e përfaqësuesve të KLSH, u kërkua që të vihej në dispozicion dokumentacioni përkatës, për të gjithë procesin e vendimmarrjes që i ka paraprirë vendimit të mospranimit të zbatimit të rekomandimit, mbi bazën e të cilit do bëhej edhe vlerësimi, nëse ky mospranim është i argumentuar.

Në vijim të kërkesës së bërë nga përfaqësuesit e KLSH, **me e-mailin e datës 9.09.2025**, MAS ka përcjellë:

- shkresën nr. 2707/22 prot., datë 20.06.2024, të firmosur nga konceptuesit dhe miratuesi i shkresës, ndjekur nga firma e Zëvendësministrit;
- “Memon” e datës 26.08.2025 me nr. 4934/1, me lëndë: “Në lidhje me observacionet për projekt raportin e KLSH për Fondin e Ekselencës”, e firmosur nga konceptuesit, konfirmuesi dhe drejtuar znj. A.K, Zëvendësministër;
- shkresën nr. 4934/2 prot., e datës 26.08.2025, me lëndë: ”Kthim përgjigje mbi Projekt Raportin e Zbatimit të Rekomandimeve...”, të firmosur nga konceptuesit dhe miratuesi i shkresës, ndjekur nga firma e Zëvendësministrit

### **Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

-Lidhur me pretendimin e MAS mbi mënyrën se si është administruar procesi i auditimit nga grupi i mëparshëm i auditimit, i cili ka përgatitur raportin përfundimtar në qershor 2024, sqarojmë se, “Program auditimi tematik”, nr, 684 prot., datë 17.06.2025, ka si objekt ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna në Raportin e Auditimit të Performancës me temë: “Mbështetja financiare e studentëve të shkëlqyer dhe nëpunësve civilë të administratës shtetërore” (Fondi i ekselencës), përcjellë me shkresën nr. 583/10 prot., datë 03.06.2024.

-Lidhur me qëndrimin e MAS, nëpërmjet shkresës së Zv. Ministres mbi moskonsiderimin e masave disiplinore të lëna sqarojmë se, vetëm ky rekomandim i drejtohet drejtpërdrejtë Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe si i tillë vlerësimi dhe vendimmarrja për të nuk mund të delegohej, por duhet të ishte adresuar nga vetë Ministri.

Urdhri nr. 113, datë 26.03.2024. i Ministrit të Arsimit dhe Sportit, e mundëson delegimin e ushtrimit të disa prej kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, por në asnjë rast ai nuk shprehet për delegim të vendimmarrjes, aq më tepër kur rekomandimi i drejtohet drejtpërdrejtë Ministrit.

Nga ana tjetër, konceptues dhe nënshkrues të shkresës 2707/22 prot., datë 20.06.2024 të përcjellë nga MAS me firmë e Zv. Ministrit, janë punonjës ndaj të cilëve janë rekomanduar masa disiplinore nga ana e KLSH – së në Raportin e Auditimit. Si të tillë ata paraqiten në kushtet e konfliktit të interesit, duke qenë se rekomandimi ndikon drejtpërdrejtë me pasoja ndaj tyre. Në të njëjtën mënyrë, koordinimi nuk mund të bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili ndodhet po në të njëjtën situatë.

Në vijim të takimit të mirëkuptimit të zhvilluar në KLSH, përfaqësuesit e MAS nuk paraqitën asnjë dokument i cili të vetëtonte njohjen zyrtare, apo vullnetin e Ministrit me konkluzionet e Raportit të Auditimit dhe orientimet e tij lidhur me zbatimin e rekomandimeve.

*Për aq kohë sa Ministri i Arsimit dhe Sportit nuk është shprehur mbi mospranimin e rekomandimit, ai **konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar**, ndaj dhe ri-rekomandohet.*

## **2.3 PËR AUDITIMIN E PERFORMANCËS ME TEMË: “RESPEKTIMI I STANDARDEVE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE, SFIDË E QËNDRUESHME NË ZVOGËLIMIN E NDOTJES SË MJEDISIT DHE MBROJTJEN E SHËNDETIT TË POPULLSISË”**

### **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

#### **I. 1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit Nr. 684 prot. datë 17.06.2025 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitin 2024”, ushtroi auditim në 4 (katër) subjektet pjesë e Auditimit të Performancës me temë: “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”, përkatësisht në Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë e Korçë.

Auditimi i kryer në vitin 2023-2024, kishte si periudhë auditimi vitet 2020 - 2023 dhe gjetjet e rekomandimet e tij janë miratuar me **Vendimin Nr. 124, Datë 25.06.2024 të Kryetarit të KLSH-së** si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 969/11/12/13/14 prot., datë 26.06.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a.** Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b.** Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c.** Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet objekt auditimi u mbajtën Akt-Konstatimet përkatëse të cilat janë regjistruar përkatësisht:

- Në Bashkinë Shkodër me nr. 12196/2, prot, datë 16.07.2025;
- Në Bashkinë Durrës me nr. 7352/1 prot, datë 17.07.2025;
- Në Bashkinë Vlorë me nr. 9724 prot. datë 17.07.2025;
- Në Bashkinë Korçë me nr. 5954 prot, darë 18.07.2025.

#### **I. 2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**

Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi se:

1. Bashkia Shkodër ka dërguar me shkresën nr. . 16662, prot, datë 09.08.2024; planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së.
2. Bashkia Durrës nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave 20 ditor.
3. Bashkia Vlorë nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave 20 ditor.
4. Bashkia Korçë nuk ka përgatitur dhe dërguar në KLSH planin e masave 20 ditor.

#### **I. 3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**

Për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", përcaktohet se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”.

Nga verifikimi i respektimit të këtij afati rezultoi se:

1. Bashkia Shkodër nuk ka hartuar dhe dërguar raportimin 6 mujor në KLSH sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
- 2 Bashkia Durrës nuk ka hartuar dhe dërguar raportimin 6 mujor në KLSH sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.  
e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së.
3. Bashkia Vlorë nuk ka hartuar dhe dërguar raportimin 6 mujor në KLSH sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.
4. Bashkia Korçë nuk ka hartuar dhe dërguar raportimin 6 mujor në KLSH sa i takon ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

### **I. 3. Statusi i pranimit të rekomandimeve**

Sipas shkresave përcjellëse me nr. 969/11/12/13/14, prot., datë 26.06.2024 të Raportit Përfundimtar të Auditimit janë rekomanduar gjithsej:

#### **✓ Masa organizative 10 rekomandime**

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella nga subjektet KLSH, referuar planit të masave lidhur me rekomandimet e lëna rezulton se:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i rekomandimit</b>	<b>Rekomanduar</b>	<b>Pranuar</b>	<b>Pa pranuar</b>
1	Organizative	10	10	0

## **II. HYRJA**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 13.06.2021.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit Nr. 684 prot. datë 17.06.2025 “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtëmujorin e parë të vitin 2023”. Rekomandimet e lëna në Raporti Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm me temë “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë” me konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin Nr. 124, Datë 25.06.2024 të Kryetarit të KLSH-së dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresat nr. 969/11/12/13/14, prot., datë 26.06.2024.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

- 1.A. G, përgjegjës grupi.
- 2 R. L, anëtar.
- 3.A. Ç, anëtare.

### **II. 1. Objekti i auditimit**

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara Bashkinë Shkodër, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Korçë me shkresat nr. 969/11/12/13/14, prot., datë 26.06.2024, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

## II. 2. Qëllimi auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

## II. 3. Metodologjia e auditimit

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

## II. 4. Konkluzioni

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Shkodër, Bashkia Durrës, Bashkia Vlorë dhe Bashkia Korçë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat nr. 969/11/12/13/14, prot., datë 26.06.2024, rezulton se nga **10 (dhjetë) masa të rekomanduara**, janë pranuar **10 (dhjetë)** Nga këto masa:

- ✓ janë zbatuar pjesërisht **5 rekomandime** ose 50 % e tyre,
- ✓ gjenden në proces zbatimi **3 rekomandime** ose 30 % e tyre,
- ✓ nuk janë zbatuar **2 rekomandime** ose 20% e tyre.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
	Masa organizative	10		5	3	2
	<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>		<b>5</b>	<b>3</b>	<b>2</b>

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave organizative	Në numër	Në %
1	Totali	10	
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	10	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	- Zbatuar Plotësisht		
2	- Zbatuar pjesërisht	5	50%
3	- Në proces zbatimi	3	30%
4	- Pa zbatuar	2	20%

## II. 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna

Nisur nga niveli shumë i ulët i zbatimit të plotë të rekomandimeve, nuk janë marrë masat e duhura për rishikimin, ndryshimin dhe përditësimin të situatës problematike lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane dhe zbutjes së ndikimeve financiare që ky proces ka në menaxhimin e shpenzimeve dhe buxhetit të shtetit. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna.

### III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

#### A. MASA ORGANIZATIVE

#### **Pyetja e auditimit: Si është situata e menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë?**

*Nënpyetja 1.1* A i ka shërbyer skema e organizimit të menaxhimit të mbetjeve, optimizmit të kostove të tyre në bashkitë nën auditim? (Trajtuar më hollësisht në fq. 19-33 të Raportit Përfundimtar )

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Vlorë dhe Korçë, në Planet Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM), nuk kanë përlogaritur numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së të dhënave të popullsisë. Ky koeficient përdoret nga Ministria e Financave për të përlogaritur transfertën e pakushtëzuar kundrejt NJVQV-ve. Konkretisht, Bashkia Korçë në PVMIM ka përlogaritur popullsinë totale 103,500 banorë, ndërkohë sipas formulës së Ministrisë së Financave rezulton që popullsia për vitin 2023 të jetë 91,930 banorë. Po kështu edhe në PVMIM të Bashkisë Vlorë popullsia është përlogaritur në 140,514 ndërkohë sipas formulës së Ministrisë së Financave rezulton që popullsia për vitin 2023 të jetë 134,980 banorë.

#### **1.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të përlogarisin numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së të dhënave të popullsisë të miratuar nga Ministria e Financave për hartimin e dokumenteve zyrtare të menaxhimit të mbetjeve urbane.

**Në vazhdimësi**

#### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

**Nga Bashkia Vlorë:** Lidhur me përlogaritjen e popullsisë për shërbimin e mbetjeve urbane Bashkia Vlorë ka përfshirë në Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak, metodologjinë për llogaritjen e popullsisë së mbuluar nga shërbimi i mbetjeve urbane. Llogaritja është bërë në përputhje me koeficientët e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe mbështetet në të dhënat zyrtare të INSTAT. Për vitin 2023 popullsia e mbuluar rezulton të jetë rreth 134,980 banorë.

Viti	2020	2021	2022	2023
Bashkia Vlorë	134,216	134,447	134,980	134,980

Në vazhdimësi do të përlogarisin numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së të dhënave të popullsisë të miratuar nga Ministria e Financave për hartimin e dokumenteve zyrtare të menaxhimit të mbetjeve urbane.

#### **Nga bashkia Shkodër:**

Gjatë përlogaritjes së kostos për shërbimin e pastrimit në tre zonat funksionale: Qytet, Perëndimore, Lindore, Bashkia Shkodër ka përlogaritur numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së të dhënave të popullsisë të miratuar nga Ministria e Financave.

Zona

Lindore

	Formula e llogaritjes se popullsisë			
	census+(regjister gjendjes civile - census)*30%			
	Census	Gjendje civile	Llogaritja e pop sipas MFE	
Zona 1	77075	116593	88930	85057
Zona 2/pedonale	1542	2332	3873	3873
	77075	116593		88930

Zona Lindore

	Formula e llogaritjes se popullsisë			
	census+(regjister gjendjes civile - census)*30%			
	Census	Gjendje civile	Llogaritja e pop sipas MFE	
Zona 1	36353	52319	41143	
Turiste Theth			1800	

Zona Perendimore

	Formula e llogaritjes se popullsisë			
	census+(regjister gjendjes civile - census)*30%			
	Census	Gjendje civile	Llogaritja e pop sipas MFE	
Zona 1	18547	35121	23519	

**Nga Bashkia Durrës:** Popullsia e një NJVV-je, përbëhet nga banorët rezidentë (të përhershëm), sipas gjendjes civile dhe banorët sezonalë që nuk banojnë aty për një periudhë më shumë se 6 muaj në vit, (turistë/vizitorë), të cilët duhet të merren në konsideratë më vete. Për shkak të problematikës së llogaritjes së numrit të banorëve, pasi të dhënat e Census-it më të fundit, në krahasim me popullsinë sipas Regjistrit të Gjendjes Civile, ka rezultuar me e ulët se ajo për të cilin jepet shërbimi në fjalë, Bashkia Durrës ka zgjedhur të operojë me popullsinë sipas Regjistrit të Gjendjes Civile.

**Nga Bashkia Korçë:** Bashkia Korçë e përlogarit numrin e familjeve (efektive) bazuar mbi informacionet që përditësohen nga rajonet administrative, njësitë administrative si dhe informacioneve mujore të përcjella nga zyra e Gjendjes Civile.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson rekomandimin si **të pranuar dhe zbatuar pjesërisht**, pasi vetëm Bashkia Shkodër dhe Vlorë ka ndërmarrë hapa konkret mbi këtë rekomandim.

#### **Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

**2.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Durrës nuk ka garantuar qëndrueshmëri financiare në menaxhimin e mbetjeve urbane duke qenë se përqindja e kostove totale të menaxhimit të mbetjeve kundrejt buxhetit total të saj në vitin 2022 ka qenë 29.3 %. Qëndrueshmëria financiare në menaxhimin e mbetjeve urbane sipas Kombeve të Bashkuara garantohet kur ky tregues është në intervalin 3-15 %. Nga ana tjetër, edhe nëse e krahasojmë këtë tregues (për vitin 2022) të Bashkisë Durrës me bashkitë e tjera subjekt auditimi ai rezulton të jetë 3-4 herë më i lartë.

**3. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Vlorë, përqindja e kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane kundrejt buxhetit total të saj ka lëvizur nga 4 deri në 11.3 %. Pavarësisht se ky tregues është brenda qëndrueshmërisë financiare të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara, Bashkia Vlorë nuk ka

garantuar të njëjtin cilësi shërbimi në menaxhimin e mbetjeve urbane si në rastin e bashkive të tjera. Kjo mungesë cilësie vjen si rrjedhojë e mos depozitimit të mbetjeve urbane në një lëndfill të miratuar që respekton standardet ligjore e mjedisore. Në këtë situatë, Bashkia Vlorë nuk ka arritur një menaxhim eficient të fondeve të dedikuara për menaxhimin e mbetjeve urbane.

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Durrës, për 1 ton të menaxhuar të mbetjeve urbane (viti 2022) është shpenzuar 15,300 lekë në vit, afërsisht 3 herë më shumë se në bashkitë e tjera. Kjo situatë është krijuar që kur mbetjet kanë filluar të depozitohen në lëndfillin e Sharrës. Për rrjedhojë Bashkisë Durrës (që prej tetorit të 2021) i është shtuar tarifa e depozitimit të mbetjeve (e cila në lëndfillin e Sharrës është 29 euro/ton). Aktualisht tarifa e depozitimit të mbetjeve urbane në lëndfill për Bashkinë Durrës është afërsisht 2 herë më e lartë se në Bashkitë Shkodër e Korçë. Gjithashtu, edhe distanca e transportimit të mbetjeve urbane për në lëndfill në rastin e Bashkisë Durrës është rreth 40 km, ose 2-3 herë më e lartë se në Bashkitë Shkodër e Korçë.

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Durrës të ngrejë grup pune për të analizuar kostot e larta të menaxhimit të mbetjeve urbane që rëndojnë financat e saj, duke u orientuar drejt reduktimit të sasisë së mbetjeve që shkojnë në lëndfill, investimit në infrastrukturë për riciklim, si dhe të shqyrtojë alternativa të tjera të depozitimit të mbetjeve me distancë më të afërt.

**Brenda vitit 2024**

#### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

**Nga Bashkia Durrës :** Menaxhimi i mbetjeve ne Bashkine Durres eshte nje proces qe perfshin grumbullimin, pastrimin, transportin dhe depozitimin ne piken fundore, e cila sipas nje procedure prokurimi eshte Zona e Menaxhimit te Mbetjeve Tirane-Durres, nepermjet nje marreveshje kuader me operatorin I. E. BV SPV shpk administrator i landfillit të Sharrë, Tirane në zbatim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01, datë 13.01.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta”, Vendimin Nr. 438, datë 15.07.2021 “Për Mbështetjen financiare për menaxhimin e mbetjeve në Bashkitë e Qarkut Durrës”, VKM nr. 496, datë 30.07.2021 “Për Miratimin e kërkesës së Bashkisë Durrës për mbështetje financiare nga Qeverisja qëndrore për menaxhimin e mbetjeve”. Parashikimi buxhetor per menaxhimin e mbetjeve urbane sipas VKM-se nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” rezulton ne nje vlere pak te larte per shkak te qelizave qe perfshin formulari i VKM-se se sipercituar. Nder to eshte dhe transporti, distanca nga secili vendgrumbullim deri ne piken fundore, por dhe gjendja e mjeteve teknologjike te cilat jane shum te amortizuara, por dhe mirembajtja e tyre ndikojne ndjeshem ne vleren perfundimtare.

Eshte menduar ndryshimi i flotes se mjeteve teknologjike por qe ngelet nje investim i ardhshem.

Gjithashtu ngritja e nje stacioni Transferimi nga qeveria shqiptare do te ndihmonte shume ne uljen e koston pasi nuk do te pershruhen rreth 40 km cdo dite per depozitim.

Se fundi jo per nga rendesia, por investimi ne infrastrukture menjehere pas ndertimit te stacionit te transferimit do jete nje zgjidhje e problemit te koston, pasi ndarja ne burimin e mbetjeve do te ule shume sasine e mbatjeve perfundimtare qe do te depozitohen ne piken fundore.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson rekomandimin si të pa zbatuar duke qenë se nga përgjigja e Bashkisë Durrës, deri më sot nuk faktohet asnjë masë për analizimin e kostove të larta që rezultojnë nga procesi i menaxhimit të mbetjeve urbane nga kjo bashki.

**Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar**

*Nënpyetja 1.2* A mbulojnë Bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e përfituara prej tyre? (Trajtuar më hollësisht në fq. 34-40 të Raportit Përfundimtar)

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Durrës për periudhën 2020-2021 nuk ka arritur të mbulojë shpenzimet për menaxhimit e mbetjeve urbane me të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e pastrimit. Të ardhurat e krijuara nga mbledhja e tarifës së pastrimit përgjatë periudhës 2020-2023 kanë qenë mesatarisht në nivelin 63 %. Megjithatë, edhe nëse do të arrihej mbledhja e tyre në nivelin 100 %, përsëri Bashkia Durrës nuk do të mund të mbulonte shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane. Për vitin 2020 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (112,713,000 lekë), Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 30 % të kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 257,440,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar. Për vitin 2021 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (205,414,000 lekë), Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 50 % të kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 232,012,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar.

Po kështu edhe për vitet 2022 dhe 2023 Bashkia Durrës nuk ka arritur të mbulojë kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara prej saj. Për këto dy vite, përveç grantit të pakushtëzuar, Bashkia Durrës është mbështetur edhe me grant të kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbane. Për vitin 2022 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (186,552,000 lekë), si dhe grantit të kushtëzuar (221,600,000 lekë) Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 42 % të kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 557,000,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar. Për vitin 2023 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (203,658,000 lekë), si dhe grantit të kushtëzuar (236,000,000 lekë) Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 46 % të kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 522,000,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar. Përdorimi i grantit të pa kushtëzuar në mbulimin e shpenzimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane riskon arritjen dhe mbulimin e aktiviteteve të tjera të Bashkisë Durrës që do të duheshin të mbuloheshin me anë të grantit të pa kushtëzuar.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të ngrenë grup pune për të analizuar tarifën e pastrimit për kategoritë e familjes dhe biznesit duke pasur në konsideratë madhësinë e familjes dhe sipërfaqen në të cilën ajo banon si dhe sipërfaqen në të cilën biznesi ushtron aktivitetin e tij.

**Në vazhdimësi**

**Komentet e Subjektit të auditimit:**

**Nga Bashkia Vlorë:** Në fund të vitit 2020, u miratua **Vendimi nr. 88**, datë 24.12.2020, për faturimin e taksave dhe tarifave vendore, i cili përfshinte edhe tarifën për “shërbimin e ndriçimit, pastrimit dhe gjelbërimit” për të gjitha kategoritë (familje dhe biznese). Në VKB nr.96 datë 07.12.2023 për vitin 2024 përmbushi rekomandimet për përmirësime **të strukturës tarifore**.

**Nga Bashkia Shkodër:** Bashkia Shkodër ka objektiv të analizoje tarifën e pastrimit për të gjitha kategoritë taksapaguese, kjo e shprehur edhe në PLMMNU. Në këtë kuader ka realizuar takime të brendshme me përfaqësues nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Taksave, Drejtoria Juridike, Administratori të Njësisë dhe ka nisur procesin e rishikimit të tarifave duke zbatuar modelin e tarifave për menaxhimin e mbetjeve. Ky proces po mbështetet nga

organizata nderkombetare, konkretisht Projekti Bashki të forta, me te cilet jane realizuar edhe takime te perbashketa.

**Nga Bashkia Durrës:** Tarifa per pastrimin është realizuar nga drejtoria e taksave pranë institucionit tone bazuar ne VKM-se nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, por duke mos u realizuar çdo kriter i kësaj vkm-je nuk është akoma ne zbatim te plote neni 12 Parimi “Ndotësi paguan” i Ligjit nr 10431 date 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili sjell mos grumbullimin e plote te kesaj tarife, pasi nuk paguhet nga te gjitha familjet, çka sjell mos përputhje te vlerës se investuar me atë te grumbulluar.

**Nga Bashkia Korçë:** Bashkia Korçë, është duke punuar dhe mbledhur informacion për te analizuar tarifat e pastrimit për kategoritë e familjes dhe biznesit duke pasur konsiderate madhësinë e familjes dhe sipërfaqen ne te cilën ajo banon ose biznesin ne te cilin ushtron aktiviteti. Për të përfunduar rekomandimet tuaja duhet kohe për të përfunduar këtë proces te cilin e kemi filluar.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Së pari theksojmë edhe një herë që ky rekomandim bazohet në praktika të mira ndërkombëtare që argumentojnë se tarifat e pastrimit (menaxhimit të mbetjeve) duhet të vendosen duke marrë në konsideratë madhësinë e familjes si dhe sipërfaqen në e rezidencës apo pronës që ata jetojnë.

Bashkia Shkodër me anë të observacionit dërguar me nr 12196/4 datë 31.07.2025 dhe protokolluar në KLSH me nr 684/17 datë 04.08.2025 thekson se ka nisur punën për rishikimin e tarifave vendore duke realizuar takime nga Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publik, Drejtoria e Taksave, Drejtoria Juridike. Ky proces po mbështetet nga Projekti Bashki të forta me të cilët po komunikohet në mënyrë direkte dhe elektronike. Bashkëngjitur kësaj shkrese janë vendosur gjithashtu edhe kopje të komunikimeve që faktojnë këtë proces. Duke qenë se Bashkia Shkodër ka filluar dhe ka nisur punën për rishikimin e tarifave vendore, siç u theksua edhe më sipër ky rekomandim do të konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

#### **Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Vlorë për vitet 2020 dhe 2022 nuk ka arritur të mbulojë shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit. Në vitin 2020, diferenca e kostos (161,371,000 lekë) është financuar nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm. Në vitin 2022, diferenca e kostos (132,330,000 lekë) është mbuluar tërësisht nga buxheti i shtetit nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm (125,574,000 lekë) dhe grantit të kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbane (22,600,000 lekë). Pra, për këtë vit, Bashkia Vlorë për menaxhimin e mbetjeve urbane ka përdorur të gjitha të ardhurat nga tarifa e pastrimit, grantin e kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve dhe 87.4% të grantit të pakushtëzuar.

**3. Gjetje nga auditimi:** Ndryshe nga praktika e Italisë, bashkitë subjekt auditimi, në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit nuk marrin në konsideratë madhësinë e familjes dhe sipërfaqen në të cilën familja jeton. Gjithashtu edhe për tarifat e vendosura për biznesin, ato nuk marrin në konsideratë sipërfaqen në të cilin biznesi ushtron aktivitetin e tij.

**2.1 Rekomandimi:** Bashkitë Durrës dhe Vlorë të hartojnë dhe miratojnë një plan lokal të mirë detajuar për të rritur mbledhjen e tarifës së pastrimit, uljen e debitorëve dhe në bashkëpunim me Ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizime Durrës dhe Vlorë të rrisin arkëtimet e kësaj tarife.

**Dhjetor 2024**

### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

**Nga Bashkia Vlorë:** Sipas VKB nr. 109/2019 e vijuar në VKB nr. 88/2020 dhe në VKB nr. 96/2023, është specifikuar: “Ngarkohet për mbledhjen e kësaj tarife, Shoqëria ‘Ujësjiellës–Kanalizime’ sh.a. Vlorë, duke e vendosur në faturën e ujit, ... në mbledhjen e kësaj tarife, kjo ndërmarrje do të luajë rolin e agjentit tatimor, duke përfituar 3 % të shumës së arkëtuar.” Sipas kesaj VKB, UK Vlorë mbledh tarifën e pastrimit direkt përmes faturës së ujit, duke e bërë procesin më të centralizuar. Kjo gjë ka sjellë raportim më të mirë të arkëtimit dhe ulje të debitorëve, pasi pagesa bëhet përsëritshëm dhe e monitoruar. Duke qënë se tarifa paguhet çdo muaj, dhe nuk është e ndarë nga furnizimi i ujit, UK Vlorë si agjent tatimor ka fuqi bllokueshmërie duke shfrytëzuar instrumentet administrative për mosshlyerje.

**Nga Bashkia Durrës:** Nje nga objektivat e Planit vendor per menaxhimin e mbetjeve eshte zbatimi i plote i VKM-se nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve” Respektimi i parimeve baze si transparenca, barazia duhet të jetë objektiv ne perlllogaritjen e tarifës, edhe pse ajo mund të jetë e kufizuar nga disponueshmëria e të dhënave, përpos çështjeve të tjera. Kështu, Plani vendor duhet të gjeje një kompromis mes këtyre parimeve të ndryshme dhe racionalitetit të aplikimit të tyre. Duke marrë në konsideratë kapacitetet e NJVV, vendosja e tarifave qe i perafrohen realitetit te saj dhe përdorimi i manualit vene ne dispozicion nga Vkm-ja e sipercituar është i lidhur me zyrën e taksave. Sidoqoftë, ai do të jetë i koordinuar në mënyrë shumë efikase dhe me sektorin e ofrimit të shërbimeve, në mënyrë që të sigurohet përditësimi i sistemit dhe i mbledhjes së informacionit dhe efikasiteti i zbatimit te tij.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Duke marrë në konsideratë argumentin e subjekteve të mësipërme ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi duke qënë se është një proces në vazhdimësi e sipër.

**Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

## **Pyetja 2. A është hartuar dhe zbatuar baza ligjore e nënligjore për menaxhimin e mbetjeve urbane nga bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë?**

***Nënpyetja 2.1 A kanë zbatuar subjektet nën auditim kuadrin ligjor e nënligjor mbi menaxhimin e mbetjeve? (Trajtuar më hollësisht në fq 40-45 të Raportit Përfundimtar)***

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shkodër, që prej vitit 2023 e deri më sot nuk ka një Plan Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Gjithashtu edhe Bashkia Durrës, pavarësisht se ka hartuar Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për periudhën 2010-2025, nuk e ka miratuar me VKB. Për më tepër, periudha e gjatë e mbulimit të këtij plani dhe ndryshimet e rëndësishme të politikave dhe kuadrit ligjor kombëtar të menaxhimit të mbetjeve si dhe organikës së Bashkisë Durrës e bëjnë këtë plan të pa zbatueshëm.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkitë Durrës dhe Shkodër të marrin masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin me VKB të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane respektive.

**Brenda vitit 2024**

### **Komentet e Subjektit të auditimit:**

**Nga Bashkia Shkodër:** Bashkia Shkodër ka marrë masat për rishikimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane. Gjatë vitit 2024, grupi I punës ka rishikuar/hartuar “Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane në Territorin Administrativ të Bashkisë

Shkodër 2024-2029”, për të cilin i është kërkuar mendim edhe institucioneve të tjera, dhe ka kaluar në dëgjese publike. Plani është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 62, datë 30.09.2024. <https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/VKB-nr.62-dt.30.9.24.pdf>  
<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Pr.vendim-plani-i-mbetjeve-te-ngurta.pdf>  
<https://bashkiashkoder.gov.al/wp-content/uploads/Plani-lokal-i-mbetjeve-te-ngurta.pdf>

**Nga Bashkia Durrës:** Bashkia Durrës, në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Urbane dhe Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, janë në fazën e zbatimit të projektit “Mbrotja e Mjedisit nëpërmjet Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Durrës”/“Protection of environment through Integrated Waste Management in Durrës Municipality”. Ky projekt zbatohet me mbështetjen financiare të programit Italo-Shqiptar të Konvertimit të Borxhit, IADSA II. Projekti synon të fuqizojë Bashkinë Durrës në mbrotjen efektive të mjedisit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve urbane. Përmes zbatimit të metodave inovative dhe përfshirjes aktive të aktorëve lokalë, ai do të ndihmojë bashkinë të përmbushë detyrimet e saj, siç përcaktohet në Dokumentin e Politikave Strategjike të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2022-2035, Planin Sektorial Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta dhe politikat kombëtare për mjedisin.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson si pjesërisht të zbatuar duke qenë se vetëm Bashkia Shkodër ka hartuar dhe miratuar me VKM Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane.

**Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2020-2023, Bashkitë Shkodër, Durrës dhe Vlorë nuk kanë raportuar në Këshillin e Qarkut përkatës për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane me përjashtim të Bashkisë Korçë e cila ka raportuar vetëm në vitin 2023.

### **2.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë të marrin masa dhe të raportojnë çdo vit në Këshillin e Qarkut përkatës lidhur me zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

**Në vazhdimësi**

### **Komente nga subjektet**

**Nga Bashkia Vlorë:** Në 14 shkurt 2023, Këshilli Bashkiak i Vlorës miratoi “Plani Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2023–2028”. Bashkia Vlorë ka përmbushur përgjegjësinë ligjore për hartimin dhe miratimin e planit vendor. Bashkia Vlorë ka përmbushur hartimin e planit Vendor për menaxhimin e mbetjeve dhe ka bërë procedurat zyrtare (dëgjese, plane), por nuk ka kryer raportimin e domosdoshëm vjetor në Këshillin e Qarkut, dhe zbatimi praktik ka dështuar, veçanërisht në trajtimin e mbetjeve. Për këtë rekomandim, hapi i ardhshëm është transparenca në raportim dhe realiteti operativ në terren.

**Nga Bashkia Shkodër:** Plani lokal i menaxhimit të integruar të mbetjeve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak me datë 30.09.2024 dhe ne vazhdim do behet raportimi në Këshillin e Qarkut Shkodër nga strukturat përkatëse.

**Nga Bashkia Durrës:** Bashkia Durrës, në bashkëpunim me Institutin e Kërkimeve Urbane dhe Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, janë në fazën e zbatimit të projektit “Mbrotja e Mjedisit nëpërmjet Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Bashkinë Durrës”/“Protection of environment through Integrated Waste Management in Durrës Municipality”. Ky projekt zbatohet me mbështetjen financiare të programit Italo-Shqiptar të Konvertimit të Borxhit, IADSA II. Pas përfundimit të realizimit të Planit do të kalojë në të gjitha hallkat për miratimin e tij. Pas miratimit

ne këshill bashkiak sipas strukturave të varësisë do të operohet me monitorimin e planit dhe raportimin e produkteve të tij.

**Nga Bashkia Korçë:** Raportimi në Këshillin e Qarkut kryhet në vazhdimësi. Shkresa drejtuar Këshillit të Qarkut me nr.6462 prot, datë 02.07.2025.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Duke marrë në konsideratë argumentin e subjekteve të mësipërme ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi duke qenë se është një proces në vazhdimësi e sipër.

**Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk i kanë shoqëruar Planet e Menaxhimit Lokal me VSM referuar ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor, ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në cilësinë e autoritetit kompetent vendos nëse një Bashki duhet t'i nënshtrohet apo jo procesit të vlerësimit strategjik mjedisor gjatë hartimit të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve.

### **3.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të marrin masa që projekt-planet vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane që do të hartojnë dhe miratojnë në të ardhmen t'i nënshtrohen kryerjes së procesit të vlerësimit strategjik mjedisor.

**Në vazhdimësi**

### **Komente nga subjektet**

**Nga Bashkia Vlorë:** Bashkia Vlorë ka ndërmarrë disa hapa dhe procedura për të siguruar që planet vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane të t'i nënshtrohen procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), për të zbatuar rekomandimin për masat mjedisore:

1. Miratimi i Planit Vendor për Menaxhim Mbetjesh 2023–2028, më 14 shkurt 2023, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve të integruar.

2. Procedura e Konsultimit Publik dhe Vlerësimit Mjedisor- u zhvillua një dëgjese publike (9 qershor – 29 qershor 2022) për planin vendor, pjesë e procesit të VSM, siç paraqitet në Regjistrin elektronik të konsultimeve publike. Edhe në tetor 2023 është shpallur një tjetër dëgjese për procedurën mjedisore të lejes së landfillit në Sherishtë . Të gjitha këto dëgjese janë pjesë përbërëse e procedurës zyrtare të VSM: njoftim, dëgjese, raporte, shpallje publike, sipas normave ligjore.

3. Zbatimi i VSM brenda planeve vendore- Plani i menaxhimit vendor ka përfshirë institucionet përgjegjëse që duhen për VSM, si Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve, Nën-ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe MIM Vlorë — të ngarkuara në vendim për zbatim

Pavarësisht procedurave formale, zbatimi praktik varet ende nga infrastrukturat që nuk janë operacionale – landfilli dhe impiantet janë ende në proces, ndërsa veprime të tilla si kompostim apo riciklim ende mungojnë .

**Nga Bashkia Shkodër:** Gjatë hartimit të PLMMNU janë dërguar shkresat për marrje mendimi institucioneve të tjera sipas shkresës me nr. Prot 15131, date 16.7.2024 (bashkangjitur). Bashkia Shkodër ka vullnetin për ta realizuar procesin e VSM nese eshte e nevojshme në vazhdim.

**Nga Bashkia Durrës:** Bashkia Durrës ka nisur procesin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) me shkresën me Nr. 4043/1 date 18.06.2025 protokolluar me tonen me Nr. 6330/1 date 19.06.2025 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Pas permbylljes së fazave ligjore të hartimit të VSM-se do të angazhohemi në miratimin e saj si pjesë përbërëse e dokumentacionit për planin vendor.

**Nga Bashkia Korçë:** Bashkia Korçë, ka një plan vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane, por që nuk ka vlerësim të ndikimit në mjedis. Ndërkohë, jemi duke punuar për një plan të ri vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane, i cili do të ndjek të gjitha proceset ligjore deri në miratimin e tij, përfshirë këtu edhe vlerësimin strategjik mjedisor.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Plani për menaxhimin e mbetjeve i nënshtrohet procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor në përputhje me Ligjin nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Megjithatë, nëse planet lokale të menaxhimit të mbetjeve (PLMM) parashikojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel vendor dhe/apo ndryshime jo thelbësore krahasuar me planin e kaluar, është MTM institucioni që vendos nëse është e nevojshme që PLMM të shoqërohet me VSM. Duke qenë se bashkitë e mësipërme kanë marrë disa hapa për pajisjen e planeve lokale të menaxhimit të mbetjeve me raportin e VSM-së, ky rekomandim do të konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

Bashkia Shkodër me anë të observacionit dërguar me nr 12196/4 datë 31.07.2025 dhe protokolluar në KLSH me nr 684/17 datë 04.08.2025 thekson përsëri se ka vullnetin për të realizuar procesin e VSM nëse është e nevojshme, megjithatë ajo ende nuk i është drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

**Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë marrë asnjë masë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio duke mos mundur kështu procesin e kompostimit dhe tretjes së këtyre mbetjeve. Afati maksimal për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike ka qenë viti 2018. Sa i përket reduktimit të mbetjeve bio, deri në vitin 2021 bashkitë subjekt i këtij auditimi do të duhej të reduktonin me 50 % sasinë e mbetjeve bio (krahasuar me 2014) që depozitojnë në lëndfill. Duke pasur në konsideratë që mbetjet bio përbëjnë gjysmën e totalit të mbetjeve që gjenerohen nga bashkitë mund të themi se nëse do të arrihej objektivi i përcaktuar mbi reduktimin e mbetjeve bio bashkitë do të mund të kursenin afërsisht rreth  $\frac{1}{4}$  e tarifës së depozitimit total të mbetjeve në lëndfill.

#### **5. Gjetje nga auditimi:**

Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë arritur të realizojnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve për rrymat letër, plastikë, metal e qelq duke mos arritur një ndër objektivat kryesorë të ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Në këtë mënyrë Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë arritur ripërdorimin/riciklimin e mbetjeve të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit sipas objektivit të përcaktuar në VKM-në nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1.

#### **4.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë të marrin masa të fillojnë procesin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për ripërdorimin/riciklimin e letrës, plastikës, metalit dhe qelqit si dhe kryerjen e procesit të kompostimit lidhur me mbetjet bio.

**Brenda vitit 2024**

#### **Komente nga subjektet**

**Nga Bashkia Vlorë:** Bashkia Vlorë ka nisur procesin teknik për riciklim dhe kompostim – duke ndërtuar infrastrukturën. Megjithatë, mbledhja e diferencuar dhe zbatimi ende nuk janë realizuar

plotësisht — kontenierët për grumbullim e diferencuar në komunitet, fushata ndërgjegjësimit dhe operimi praktik i mbledhjes nuk janë zbatuar ende.

**Nga Bashkia Shkodër:** Bashkia Shkodër, sic është përmendur në PLMMNU, parashikon të nisë procesin e mbledhjes së materialeve të riciklueshme dhe të realizojë kompostimin e mbetjeve të gjelbërta brenda afatit të planit. Aktualisht, Bashkia Shkodër është fokusuar në trajnimin e stafit për skemat e grumbullimit të diferencuar dhe kompostimit, si dhe sigurimin e një hapësire në territorin e Bashkisë për realizimin e investimeve infrastrukturore në këtë kuadër. Rrjedhimisht, është kërkuar transferimi i pronës nr.429, “Ish-Repart Ushtarak” në Berdice, nga Ministria e Mbrojtjes, dhe pritet miratimi me VKM për këtë transfertë. Në kuadër të marrëveshjes me G.. A... (bashkangjitur), është bërë një studim fizibiliteti (bashkangjitur) për projektin e kompostimit të mbetjeve të gjelbërta, dhe Bashkisë i janë dhuruar disa mjete cilat janë të nevojshme për investimin që do kryhet për qendren e kompostimit të mbetjeve të gjelbërta.

**Nga Bashkia Durrës:** Janë ndermarre hapa për nisjen e procesit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve urbane. Është planifikur faze pilot për të grumbulluar mbetjet plastike dhe të letres si dhe për kompostimin e mbetjeve organike. Problematike është sensibilizimi i popullsisë.

Në lidhje me masat e marra për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve Ndermarrja Sherbim Komonale Durres i ka propozuar Bashkisë rritjen e shkallës së investimeve në infrastrukture (Mjete dhe Kazane)-Ndergjegjesimin e komunitetit nepermjet propagandes ne mediat lokale.

Angazhimin e grupeve shoqërore sic janë shkollat dhe UAMD që deri tani kanë dhënë rezultatet e para, duke ndarë mbetjet plastike me anë të nxënësve të shkollave. Shpresojmë që me përfundimin e një projekti që ka filluar para 6 muajsh nga Instituti urban i mbetjeve (financime Italiane), mendohet që në fund të vitit të mbyllet i gjithë projekti duke bërë dhe propozimet përkatëse për rifreskimin e infrastrukturës si dhe për ngritjen e një stacioni transferimi ku mund të bëhet ndarja e mbetjeve dhe riciklimi i tyre.

**Nga Bashkia Korçë:** Bashkia Korçë, e ka filluar procesin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për ripërdorimin/riciklimin e letrës, plastikës, metalit dhe qelqit, në lagjet 1, 2, 3, 11 dhe 12, ndërkohë e ka shtrirë këtë proces edhe në lagjet 4, 5, 13. Mbetjet grumbullohen nga kompania e pastrimit që ka lidhur kontratë me Bashkinë Korçë. Bashkia nuk ka kapacitete për ta kryer riciklimin (bën vetëm grumbullim të materialeve të riciklueshëm), por ndërkohë po punon për të gjetur mundësi për ta realizuar.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Duke qenë se bashkitë e mësipërme kanë marrë disa hapa për pajisjen e planeve lokale të menaxhimit të mbetjeve me raportin e VSM-së, ky rekomandim do të konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

**Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar**

**Nënpyetja 2.2** A kanë vendosur dhe zbatuar bashkitë objektivat e duhura në funksion të kuadrit ligjor? *(Trajtuar më hollësisht në fq 45-51 të Raportit Përfundimtar)*

**1. Gjetje nga auditimi:** Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Korçë i miratuar në vitin 2023 nuk ka të përcaktuar objektiva të qartë e të matshëm pasi nuk është shoqëruar me indikatorë apo tregues për matjen e tyre. Konkretisht ky plan nuk vendos objektiva specifike mbi përqindjen e synuar të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve urbane si dhe nuk mbulon komunikimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, monitorimin e ecurisë së tij. Ai trajton vetëm aspektin operacional të kryerjes së grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve duke anashkaluar kështu objektiva apo synime që duhen arritur në periudhën e tij të mbulimit.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkitë Korçë, Shkodër, Durrës në fazën e përgatitjes së planeve të reja vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane të specifikojnë qartë me objektiva konkrete e të matshëm sasinë e mbetjeve që do të reduktohen, ripërdoren e riciklohen si dhe të parashikojnë qartë strukturat monitoruese e raportuese. Gjithashtu, këto plane të përfshijnë aktivitete për edukimin, ndërgjegjësimin etj., të publikut për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane.

### **Gjatë hartimit të Planeve të reja të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane**

#### **Komente nga subjektet:**

**Nga Bashkia Shkodër:** Në ‘Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane në Territorin Administrativ të Bashkisë Shkodër 2024-2029’ (<https://bashkiashkoder.gov.al//ep-content/uploads/Plani-lokal-i-mbetjeve-te-ngurta.pdf>) janë paraqitur objektivat e qarta të Bashkisë Shkodër në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve. Duke marrë parasysh situatën, janë parashikuar skemat dhe hapat që duhet të ndërmarrë Bashkia Shkodër për të nisur realizuar mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme dhe të gjelbërta, si dhe janë përllogaritur sasinë e parashikuara të këtyre mbetjeve. Gjithashtu në plan përfshihen lloje aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut për menaxhimin e duhur të mbetjeve.

**Nga Bashkia Durrës:** Në lidhje me percaktimin e sasisë së mbetjeve që mund të riciklohen nuk kemi ndonjë të dhënë të sakte, por në bazë të disa statistikave, mendojmë që do të jete rreth 7 % të mbetjeve urbane të gjeneruar në një vit, ose përafërsisht rreth 4-5 mijë ton në vit.

**Nga Bashkia Korçë:** Bashkia Korçë, është duke punuar për një plan të ri vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane, në të cilin do të përcaktojë objektivat konkrete e të matshëm për sasinë e mbetjeve që do të kalojnë në proceset e reduktimit, ripërdorimit e riciklimit. Në plan do të përcaktojë qartë edhe strukturat përgjegjëse për monitorim e raportim. Plani do të përfshijë edhe aktivitete sensibilizuese për ndërgjegjësimin e komunitetit, të cilat nuk kanë munguar. Një ndër aktivitetet e zhvilluara është:

K..., në bashkëpunim me Bashkinë Korçë dhe Qytezën e Fëmijëve pranë Bashkisë Korçë zhvilluan një “Open Day” të Landfillit të Maliqit. Një aktivitet informues dhe ndërgjegjësuës, organizuar me qëllim edukimin e fëmijëve mbi rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit.

Fëmijët u njohën nga afër me procesin e trajtimit të mbetjeve, ndarjen në burim, si dhe funksionimin e impiantit të përpunimit. Aktiviteti u shoqërua edhe me lojëra edukative dhe materiale informuese, që i ndihmuan të kuptojnë më mirë vlerën e riciklimit dhe ndikimin që sjelljet e përditshme kanë në mjedis.

Një ditë e veçantë, që bashkoi edukimin me përvojën konkrete, për të mbjellë te brezi i ri kulturën e kujdesit për natyrën. (Postuar në faqen zyrtare të kryetarit të Bashkisë Korçë, më datë 14 shtator 2024).

**Qëndrimi i grupit të auditimit: Ky rekomandim do të konsiderohet në proces zbatimi.**

#### **Statusi i rekomandimit: Në proces zbatimi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shkodër nuk ka arritur të zbatojë objektivin e përcaktuar në Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane 2017-2022 lidhur me minimizimin me 30 % të mbetjeve që shkojnë në Landfillin e Bushatit në vitin 2022 krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2017 Bashkia Shkodër ka depozituar në Landfillin e Bushatit 39,461 tonë, ndërsa në vitin 2022 ka depozituar 34,748 tonë. Objektivi me minimizimin e 30 % të sasisë së mbetjeve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2017 do të thotë që sasia e mbetjeve të depozituara në vitin 2022 do të duhej të ishte reduktuar në rreth 27,000 tonë.

**3. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Shkodër, Durrës, Korçë e Vlorë nuk aplikojnë konteinerë të veçuar për konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit prej  $1.1 \text{ m}^3$ . Një ndër arsyet kryesore që konteinerë të caktuar mbushen me shpejtësi në momente të caktuara është se konsumatorët jo banorë (bizneset) i hedhin mbetjet e tyre në konteinerë të destinuar për të mbledhur mbetjet familjare.

**2.1 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Durrës, Korçë e Vlorë të identifikojnë të gjithë konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit të konsumatorit banor prej  $1.1 \text{ m}^3$  si dhe të vendosin konteinerë të tjerë për ta.

**Në vazhdimësi**

**Komente nga Subjekti:**

Nga Bashkia Vlorë nuk ka përgjigje.

**Nga Bashkia Shkodër:** Në Bashkinë Shkodër, konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit janë kryesisht biznese të tipit bar/restorant, dhe disa kanë konteniere të vecanta në ambinetet e tyre. Bizneset tip supermarket, kanë kontenierte të tyre brenda hapësirave private për mbledhjen e mbetjeve tip ambalazh, për të cilat përgjegjësia e menaxhimit i bie prodhuesit të mbetjeve, të cilat i mbledhin/riciklojnë me anë të operatorëve të tretë. Janë realizuar disa fushata ndërgjegjësuese në biznese me anë të inspektorëve të lagjeve dhe specialistëve të shërbimeve, për t' shpjeguar mënyrën e menaxhimit të mbetjeve nga ana e tyre. Menaxhimi i mbetjeve për konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbetje urbane mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit është një aktivitet në proces, tek i cili kontribuojnë përfaqësues nga Drejtori të ndryshme të Bashkisë Shkodër.

**Nga Bashkia Durrës:** Dorëzimi i mbetjeve urbane është një detyrim i pa ndryshuar i prodhuesit dhe duhet të kryhet sipas mënyrave, ditëve dhe orëve të përcaktuar nga bashkia, si dhe mbështetur në kategorizimin e mbetjeve dhe prodhuesve, gjë e cila u realizua sipas përcaktimeve të kryera në Vendimin e kb-së nr. 41, datë 09.05.2022 “për miratimin e rregullores së administrimit të mbetjeve në bashkinë Durrës”. shkelja e çdo kriteri ligjor nga individë të papërgjegjshëm përben shkelje administrative, ku sipas rregullores në fuqi është përgjegjësi e strukturës së policisë bashkiake për kontroll të vazhdueshëm, ndër to është dhe mbshja e me shume se  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit të konsumatorit.

**Nga Bashkia Korçë:** Bashkia Korçë, ka marrë masa dhe po analizon bizneset të cilat konsumojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit, dhe pas kësaj ka vendosur kontenierte të veçantë për to. Pothuajse në çdo biznes janë vendosur kontenierte për grumbullimin e mbetjeve dhe zgara metalike për grumbullimin e kartonëve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Bashkitë e mësipërme nuk kanë vënë në dispozicion dokumentacion faktik mbi identifikimin e konsumatorëve jo banorë të cilët gjenerojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit, si dhe për vendosjen e konteinerëve të tjerë. Dhe pse Bashkia Shkodër me anë të observacionit dërguar me nr 12196/4 datë 31.07.2025 dhe protokolluar në KLSH me nr 684/17 datë 04.08.2025 thekson se janë realizuar disa fushata ndërgjegjësuese në biznese me anë të inspektorëve për t' shpjeguar mënyrën e menaxhimit të mbetjeve nga ana e tyre. Menaxhimi i mbetjeve për konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbetje urbane mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit është një aktivitet në proces, tek i cili kontribuojnë përfaqësues nga Drejtori të ndryshme të Bashkisë Shkodër. Në relacionin e përgatitur për rishikimin e tarifave, është cituar edhe nevoja e ngritjes së grupit të punës për të matur gjenerimin e mbetjeve në biznese të ndryshme. Pra,

pavarësisht argumentimin të Bashkisë Shkodër e cila pranon dhe zotohet në realizimin e këtij rekomandimi, ai deri më tani vlerësohet i pa zbatuar.

#### **Statusi i rekomandimit: I pa zbatuar**

Bashkia e Durrësit ka dorëzuar në KLSH shkresën me nr 7352/3 datë 01.09.2025 e cila është protokolluar në KLSH me nr 684/36 datë 04.09.2025. Në këtë shkresë, Bashkia Durrësit thekson njohjen me Projekt Raportin e auditimit të zbatimit të rekomandimeve dërguar nga KLSH në Bashkinë e Durrësit me shkresën nr 684/8 datë 01.08.2025.

#### **IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit **ri-kërkojmë** nga Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë e Korçë, zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dërguar me shkresën nr. nr. 969/11/12/13/14 prot., datë 26.06.2024, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë, ”të cilat rezultojnë me statusin të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi.

**Nënpyetja 1.1 A i ka shërbyer skema e organizimit të menaxhimit të mbetjeve, optimizmit të kostove të tyre në bashkitë nën auditim? (Trajtuar më hollësisht në fq. 19-33 të Raportit Përfundimtar )**

**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Vlorë dhe Korçë, në Planet Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM), nuk kanë përllogaritur numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së të dhënave të popullsisë. Ky koeficient përdoret nga Ministria e Financave për të përllogaritur transfertën e pakushtëzuar kundrejt NJVQV-ve. Konkretisht, Bashkia Korçë në PVMIM ka përllogaritur popullsinë totale 103,500 banorë, ndërkohë sipas formulës së Ministrisë së Financave rezulton që popullsia për vitin 2023 të jetë 91,930 banorë. Po kështu edhe në PVMIM të Bashkisë Vlorë popullsia është përllogaritur në 140,514 ndërkohë sipas formulës së Ministrisë së Financave rezulton që popullsia për vitin 2023 të jetë 134,980 banorë.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të përllogarisin numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së të dhënave të popullsisë të miratuar nga Ministria e Financave për hartimin e dokumenteve zyrtare të menaxhimit të mbetjeve urbane.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Durrës nuk ka garantuar qëndrueshmëri financiare në menaxhimin e mbetjeve urbane duke qenë se përqindja e kostove totale të menaxhimit të mbetjeve kundrejt buxhetit total të saj në vitin 2022 ka qenë 29.3 %. Qëndrueshmëria financiare në menaxhimin e mbetjeve urbane sipas Kombeve të Bashkuara garantohet kur ky tregues është në intervalin 3-15 %. Nga ana tjetër, edhe nëse e krahasojmë këtë tregues (për vitin 2022) të Bashkisë Durrës me bashkitë e tjera subjekt auditimi ai rezulton të jetë 3-4 herë më i lartë.

**3. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Vlorë, përqindja e kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane kundrejt buxhetit total të saj ka lëvizur nga 4 deri në 11.3 %. Pavarësisht se ky tregues është brenda qëndrueshmërisë financiare të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara, Bashkia Vlorë nuk ka

garantuar të njëjtin cilësi shërbimi në menaxhimin e mbetjeve urbane si në rastin e bashkive të tjera. Kjo mungesë cilësie vjen si rrjedhojë e mos depozitimit të mbetjeve urbane në një lëndfill të miratuar që respekton standardet ligjore e mjedisore. Në këtë situatë, Bashkia Vlorë nuk ka arritur një menaxhim eficient të fondeve të dedikuara për menaxhimin e mbetjeve urbane.

**4. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Durrës, për 1 ton të menaxhuar të mbetjeve urbane (viti 2022) është shpenzuar 15,300 lekë në vit, afërsisht 3 herë më shumë se në bashkitë e tjera. Kjo situatë është krijuar që kur mbetjet kanë filluar të depozitohen në lëndfillin e Sharrës. Për rrjedhojë Bashkisë Durrës (që prej tetorit të 2021) i është shtuar tarifa e depozitimit të mbetjeve (e cila në lëndfillin e Sharrës është 29 euro/ton). Aktualisht tarifa e depozitimit të mbetjeve urbane në lëndfill për Bashkinë Durrës është afërsisht 2 herë më e lartë se në Bashkitë Shkodër e Korçë. Gjithashtu, edhe distanca e transportimit të mbetjeve urbane për në lëndfill në rastin e Bashkisë Durrës është rreth 40 km, ose 2-3 herë më e lartë se në Bashkitë Shkodër e Korçë.

#### **2-3-4.1 Rekomandimi:**

Bashkia Durrës të ngrejë grup pune për të analizuar kostot e larta të menaxhimit të mbetjeve urbane që rëndojnë financat e saj, duke u orientuar drejt reduktimit të sasisë së mbetjeve që shkojnë në lëndfill, investimit në infrastrukturë për riciklim, si dhe të shqyrtojë alternativa të tjera të depozitimit të mbetjeve me distancë më të afërt.

**Brenda vitit 2024**

***Nënpyetja 1.2 A mbulojnë Bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e përfituara prej tyre? (Trajtuar më hollësisht në fq. 34-40 të Raportit Përfundimtar)***

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Durrës për periudhën 2020-2021 nuk ka arritur të mbulojë shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane me të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e pastrimit. Të ardhurat e krijuara nga mbledhja e tarifës së pastrimit përgjatë periudhës 2020-2023 kanë qenë mesatarisht në nivelin 63 %. Megjithatë, edhe nëse do të arrihej mbledhja e tyre në nivelin 100 %, përsëri Bashkia Durrës nuk do të mund të mbulonte shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane. Për vitin 2020 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (112,713,000 lekë), Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 30 % të kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 257,440,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar. Për vitin 2021 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (205,414,000 lekë), Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 50 % të kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 232,012,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar.

Po kështu edhe për vitet 2022 dhe 2023 Bashkia Durrës nuk ka arritur të mbulojë kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara prej saj. Për këto dy vite, përveç grantit të pakushtëzuar, Bashkia Durrës është mbështetur edhe me grant të kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbane. Për vitin 2022 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (186,552,000 lekë), si dhe grantit të kushtëzuar (221,600,000 lekë) Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 42 % të kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 557,000,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar. Për vitin 2023 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (203,658,000 lekë), si dhe grantit të kushtëzuar (236,000,000 lekë) Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 46 % të kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 522,000,000 lekë është mbuluar nga granti i pa

kushtëzuar. Përdorimi i grantit të pa kushtëzuar në mbulimin e shpenzimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane riskon arritjen dhe mbulimin e aktiviteteve të tjera të Bashkisë Durrës që do të duheshin të mbuloreshin me anë të grantit të pa kushtëzuar.

**5.1 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të ngrënë grup pune për të analizuar tarifën e pastrimit për kategoritë e familjes dhe biznesit duke pasur në konsideratë madhësinë e familjes dhe sipërfaqen në të cilën ajo banon si dhe sipërfaqen në të cilën biznesi ushtron aktivitetin e tij.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Vlorë për vitet 2020 dhe 2022 nuk ka arritur të mbulojë shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit. Në vitin 2020, diferenca e kostos (161,371,000 lekë) është financuar nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm. Në vitin 2022, diferenca e kostos (132,330,000 lekë) është mbuluar tërësisht nga buxheti i shtetit nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm (125,574,000 lekë) dhe grantit të kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbane (22,600,000 lekë). Pra, për këtë vit, Bashkia Vlorë për menaxhimin e mbetjeve urbane ka përdorur të gjitha të ardhurat nga tarifa e pastrimit, grantin e kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve dhe 87.4% të grantit të pakushtëzuar.

**7. Gjetje nga auditimi:** Ndryshe nga praktika e Italisë, bashkitë subjekt auditimi, në përlogaritjen e tarifës së pastrimit nuk marrin në konsideratë madhësinë e familjes dhe sipërfaqen në të cilën familja jeton. Gjithashtu edhe për tarifën e vendosura për biznesin, ato nuk marrin në konsideratë sipërfaqen në të cilin biznesi ushtron aktivitetin e tij.

**6-7.1 Rekomandimi:** Bashkitë Durrës dhe Vlorë të hartojnë dhe miratojnë një plan lokal të mirë detajuar për të rritur mbledhjen e tarifës së pastrimit, uljen e debitorëve dhe në bashkëpunim me Ndërmarrjet e Ujësjetës Kanalizime Durrës dhe Vlorë të rrisin arkëtimet e kësaj tarife.

**Qershor 2025**

**Pyetja 2. A është hartuar dhe zbatuar baza ligjore e nënligjore për menaxhimin e mbetjeve urbane nga bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë?**

**Nënpetja 2.1 A kanë zbatuar subjektet nën auditim kuadrin ligjor e nënligjor mbi menaxhimin e mbetjeve? (Trajtuar më hollësisht në fq 40-45 të Raportit Përfundimtar)**

**8. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shkodër, që prej vitit 2023 e deri më sot nuk ka një Plan Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Gjithashtu edhe Bashkia Durrës, pavarësisht se ka hartuar Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për periudhën 2010-2025, nuk e ka miratuar me VKB. Për më tepër, periudha e gjatë e mbulimit të këtij plani dhe ndryshimet e rëndësishme të politikave dhe kuadrin ligjor kombëtar të menaxhimit të mbetjeve si dhe organikës së Bashkisë Durrës e bëjnë këtë plan të pa zbatueshëm.

**8.1 Rekomandimi:** Bashkitë Durrës dhe Shkodër të marrin masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin me VKB të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane respektive.

**Qershor 2025**

**9. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2020-2023, Bashkitë Shkodër, Durrës dhe Vlorë nuk kanë raportuar në Këshillin e Qarkut përkatës për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane me përjashtim të Bashkisë Korçë e cila ka raportuar vetëm në vitin 2023.

**9.1 Rekomandimi:** Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë të marrin masa dhe të raportojnë çdo vit në Këshillin e Qarkut përkatës lidhur me zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk i kanë shoqëruar Planet e Menaxhimit Lokal me VSM referuar ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor, ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në cilësinë e autoritetit kompetent vendos nëse një Bashki duhet t'i nënshtrohet apo jo procesit të vlerësimit strategjik mjedisor gjatë hartimit të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve.

**10.1 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të marrin masa që projekt-planet vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane që do të hartojnë dhe miratojnë në të ardhmen t'i nënshtrohen kryerjes së procesit të vlerësimit strategjik mjedisor.

**Në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë marrë asnjë masë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio duke mos mundur kështu procesin e kompostimit dhe tretjes së këtyre mbetjeve. Afati maksimal për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike ka qenë viti 2018. Sa i përket reduktimit të mbetjeve bio, deri në vitin 2021 bashkitë subjekt i këtij auditimi do të duhej të reduktonin me 50 % sasinë e mbetjeve bio (krahasuar me 2014) që depozitojnë në lëndfill. Duke pasur në konsideratë që mbetjet bio përbëjnë gjysmën e totalit të mbetjeve që gjenerohen nga bashkitë mund të themi se nëse do të arrihej objektivi i përcaktuar mbi reduktimin e mbetjeve bio bashkitë do të mund të kursenin afërsisht rreth ¼ e tarifës së depozitimit total të mbetjeve në lëndfill.

**12. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë arritur të realizojnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve për rrymat letër, plastikë, metal e qelq duke mos arritur një ndër objektivat kryesorë të ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Në këtë mënyrë Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë arritur ripërdorimin/riciklimin e mbetjeve të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit sipas objektivit të përcaktuar në VKM-në nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1.

**11-12.1 Rekomandimi:** Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë të marrin masa të fillojnë procesin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për ripërdorimin/riciklimin e letrës, plastikës, metalit dhe qelqit si dhe kryerjen e procesit të kompostimit lidhur me mbetjet bio.

**Qershor 2025**

**Nënpyetja 2.2 A kanë vendosur dhe zbatuar bashkitë objektivat e duhura në funksion të kuadrit ligjor? (Trajtuar më hollësisht në fq 45-51 të Raportit Përfundimtar)**

**13. Gjetje nga auditimi:** Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Korçë i miratuar në vitin 2023 nuk ka të përcaktuar objektiva të qartë e të matshëm pasi nuk është shoqëruar me indikatorë apo tregues për matjen e tyre. Konkretisht ky plan nuk vendos objektiva specifike mbi përqindjen e synuar të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve urbane si dhe nuk mbulon komunikimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, monitorimin e ecurisë së tij. Ai trajton vetëm aspektin operacional të kryerjes së grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve duke anashkaluar kështu objektiva apo synime që duhen arritur në periudhën e tij të mbulimit.

**13.1 Rekomandimi:** Bashkitë Korçë, Shkodër, Durrës në fazën e përgatitjes së planeve të reja vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane të specifikojnë qartë me objektiva konkrete e të matshëm sasinë e mbetjeve që do të reduktohen, ripërdoren e riciklohen si dhe të parashikojnë qartë strukturat monitoruese e raportuese. Gjithashtu, këto plane të përfshijnë aktivitete për edukimin, ndërgjegjësimin etj., të publikut për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane.

### **Gjatë hartimit të Planeve të reja të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane**

**14. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Shkodër nuk ka arritur të zbatojë objektivin e përcaktuar në Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane 2017-2022 lidhur me minimizimin me 30 % të mbetjeve që shkojnë në Lendfillin e Bushatit në vitin 2022 krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2017 Bashkia Shkodër ka depozituar në Lendfillin e Bushatit 39,461 tonë, ndërsa në vitin 2022 ka depozituar 34,748 tonë. Objektivi me minimizimin e 30 % të sasisë së mbetjeve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2017 do të thotë që sasia e mbetjeve të depozituara në vitin 2022 do të duhej të ishte reduktuar në rreth 27,000 tonë.

**15. Gjetje nga auditimi:** Bashkitë Shkodër, Durrës, Korçë e Vlorë nuk aplikojnë konteinerë të veçuar për konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit prej 1.1 m<sup>3</sup>. Një ndër arsyet kryesore që konteinerë të caktuar mbushen me shpejtësi në momente të caktuara është se konsumatorët jo banorë (bizneset) i hedhin mbetjet e tyre në konteinerët e destinuar për të mbledhur mbetjet familjare.

**14-15.1 Rekomandimi:** Bashkitë Shkodër, Durrës, Korçë e Vlorë të identifikojnë të gjithë konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit të konsumatorit banor prej 1.1 m<sup>3</sup> si dhe të vendosin konteinerë të tjerë për ta.

**Në vijimësi**

## 2.4 PËR AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT FIER, VLORË DHE GJIROKASTËR, SI DHE AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT TIRANË.

### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

#### 1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit tematik me Nr. 684 prot., datë 17.06.2025 dhe objekt, “*Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara nga Departamenti i Auditimit të Performancës në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2024*”, ushtroi auditim në subjektet pjesë e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë, përkatësisht: në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit Tiranë.

Auditimi i kryer në vitin 2024, kishte si periudhë auditimi veprimtarinë nga data nga 01.01.2021 deri në 31.12.2023 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me **Vendimin nr. 123, datë 25.06.2024 të Kryetarit të KLSH-së** si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat Nr.108/8 Prot., dhe Nr.108/9 Prot. datë 26.06.2024. Auditimi u krye nga data 20.06.2025 deri më datë 18.07.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet e audituara Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë dhe Agjencia Kombëtare të Mjedisit Tiranë, janë dërguar Projekt Raportet e Auditimit sipas shkresës me nr.684/1 prot, datë 04.08.2025.

Për sa më sipër, në përgjigje të Projekt Raportit të Auditimit, në institucionin e KLSH-së janë administruar këto praktika dokumentare (shkresore ose email):

- Shkresa e dërguar nga ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë me nr. 2241 prot, datë 29.09.2025 “*Shpjegime mbi projekt raportin e auditimit tematik*”, administruar në KLSH me nr. 684/35, datë 03.09.2025.
- “*Kthim përgjigje projekt-raportit të auditimit; Sektori i burimeve natyrore ujërave*”, sipas mail-it zyrtar të KLSH-së më datë 05.0.2025, ora 12.31.
- “*Kundërshtimet lidhur me Projekt Raportin e Auditimit të KLSH-se me nr 684/11prot date 01.08.2025*”, dërguar në mail-in zyrtar të KLSH-së më datë 01.09.2025, ora 16.10. .

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh**, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga auditimi rezultoi se:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë nuk ka hartuar Program Pune për masat në zbatim të rekomandimeve të lëna, dhe rrjedhimisht nuk ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit.
- Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi masat që do të merren për zbatimin e rekomandimeve, sipas shkresës nr. 1907 prot, datë

12.07.2024, të cilën e ka dërguar në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe për dijëni Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

**3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh**, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve.

- Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 3643 Prot., datë 27.12.2024 "Njoftim i akteve të mbajtura", protokolluar në KLSH me nr. 108/11, datë 31.12.2024

### 3. Statusi i rekomandimeve të lëna:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. Nr.108/8 Prot. dhe Nr.108/9 Prot., datë 26.06.2024, janë rekomanduar gjithsej 59 masa:

Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore, 0 rekomandime.

Masa organizative, 32 rekomandime.

Masa shpërblim dëmi, 2 rekomandime.

Masa disiplinore, 25 rekomandime.

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella në KLSH mbi planin e masave si dhe shpjegimet e paraqitura për secilin rekomandim në fazën e verifikimit të tyre, rezultojnë se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore	0	0	0
2	Masa organizative	32	32	0
3.	Masa shpërblim dëmi	2	2	0
4	Masa disiplinore	25	25	0
	<b>Gjithsej</b>	<b>59</b>	<b>59</b>	<b>0</b>

## II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të evaduar në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve" miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit Nr. 684 prot., datë 17.06.2025 dhe objekt, "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar nga Departamenti i Auditimit të

*Performancës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024*”, për auditimin e përputhshmërisë “Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastër për veprimtarinë e periudhës 2021-2023”. Konkluzionet përkatëse janë miratuar me **Vendimin nr. 123, datë 25.06.2024 të Kryetarit të KLSH-së**, si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat Nr.108/8 Prot., dhe Nr.108/9 Prot., datë 26.06.2024.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së, me përbërje:

1. Z. Q. C. -përgjegjës grupi,
2. Znj.Sh. H. - anëtare,

Auditimi ka filluar më, 20.06.2025

Auditimi ka përfunduar më, 18.07.2025

### **II.1. Objekti i auditimit:**

Zbatimi i masave të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar në subjektet Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastër, (pjesa e rekomandimeve për masat organizative dhe të shpërblimit të dëmit), si dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë (për kompetencën e masave disiplinore).

### **II.2. Qëllimi i auditimit:**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### **II.3. Metodologjia e auditimit:**

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

### **II.4. Konkluzioni:**

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastër dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat e sipërcituara, rezulton se 59 (pesëdhjetë e nëntë) masa të rekomanduara gjithsej janë pranuar nga subjektet e audituara.

Nga masa e pranuar:

- janë zbatuar 19 rekomandime, ose 32% e tyre.
- janë zbatuar pjesërisht 8 rekomandime ose 14 % e tyre.
- gjenden në proces zbatimi 28 rekomandime, ose 47 % e tyre.
- gjenden pa zbatuar 4 rekomandime, ose 7 % e tyre.

Tabela nr.1, Përmbledhje e statusit të zbatimit të masave të rekomanduara

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht <sup>12</sup>	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Përmirësim Ligjor	-	-	-	-	-
2	Organizative	32	12	8	8	4
3	Shpërblim dëmi	2	-	-	2	-
4	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	-	-	-	-	-
5	Masa Disiplinore	25	7	-	18	0
	<b>Gjithsej masa</b>	<b>59</b>	<b>19</b>	<b>8</b>	<b>28</b>	<b>4</b>

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.2, Përmbledhje analitike e statusit të masave të rekomanduara, sipas kategorive:

Nr.	A.Statusi i masave Organizative	Në numër	Në % brenda grupit
1	Totali	32	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	32	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar Plotësisht	12	37 %
2	Zbatuar pjesërisht	8	25 %
3	Në proces zbatimi	8	25 %
4	Pa zbatuar	4	13 %

Nr.	B. Statusi i masave shpërblim dëmi	Në numër	Në % brenda grupit
1	Totali	2	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	2	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar Plotësisht		
2	Zbatuar pjesërisht		
3	Në proces zbatimi	2	100%
4	Pa zbatuar		

Nr.	C.Statusi i masave disiplinore	Në numër	Në % brenda grupit
1	Totali	25	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	25	100%
	<b>Nga të pranuarat:</b>		<b>Në % ndaj të pranuarave</b>
1	Zbatuar Plotësisht	7	28 %
2	Zbatuar pjesërisht		
3	Në proces zbatimi	18	72 %
4	Pa zbatuar		

<sup>12</sup> -Përfshirë dhe dy masat disiplinore të ezazuara, nga dalja në pension dhe lirimi nga detyra e një punonjësi.

## **II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:**

Pavarësisht nga puna e bërë dhe masat e marra, niveli i zbatimit të plotë të rekomandimeve është i ulët rreth 32%. Për disa nga masat e lëna (institucionet) nuk kanë mundur realizimin e tyre. Rëndësia dhe ndjeshmëria e institucioneve dhe çështjeve objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna në drejtim të garantimit të një sistemi sa më të përshtatshëm për mbrojtjen e mjedisit.

## **III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:**

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit prej subjekteve të audituara, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacionit të tyre, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, rezultoi se nuk janë dërguar Kërkesat Buxhetore PBA 2021-2023 dhe PBA 2023-2025 në Ministrinë përgjegjëse për financat, në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në kundërshtim me Nenin 24, 27 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Udhëzimin plotësues nr.28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”, neni 27 dhe Udhëzimin të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 28.02.2022 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, pika 4, 9 e tij.,

-Kërkesat buxhetore për PBA 2022-2024 nuk janë dërguar në mënyrë elektronike në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS); nuk janë të shoqëruara me relacionin shpjegues, si dhe dërguar jashtë afateve ligjore të përcaktuara (40 ditë më vonë), në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit plotësues nr. 8, datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, pika 4, 9, 10 si dhe me Udhëzimin Nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standard të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” 2.5. Përgjegjësitë e Drejtuesit të Ekipit të Menaxhimit të Programit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 7-8-18 të Raportit të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të marrë masa të hartojë Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetur në shqyrtimin e shpenzimeve të mëparshme dhe në përcaktimin e nevojave për të ardhmen në bazë të aktivitetit të planifikuar.

**Në vijimësi**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, mbështetur në shkresën e Ministrisë së Financave me nr.4073/1 prot., të datës 28.02.2025, mbi Udhëzimin Vjetor për Përgatitjen e PBA 2026-2028, ka përfunduar PBA duke filluar analizën qysh nga viti 2024, sipas tabelave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave. PBA është dërguar në AKM me shkresën me Nr. prot.1216, datë 23.04.2025.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të dhëna nga ana e Institucionit, (nëpunësi zbatues i ARM-së), rezulton se janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. *Më hollësisht:*

Bazuar në verifikimet e kryera nga ana e KLSH-së rezulton se, nga ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2025 “Për përgatitjen

e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, (dërguar me shkresën e kësaj ministre me nr. 4073/1, datë 28.02.2025), është hartuar PBA 2026-2028, e cila është mbështetur në tavanet buxhetore të miratuara nga VKM nr. 119, datë 26.02.2025.

PBA është hartuar duke u mbështetur në treguesit faktikë të buxhetit të kësaj njësie shpenzuese gjatë vitit 2024, në treguesit e pritshëm për vitin 2025 dhe projeksionet / parashikimet për vitet 2026 dhe 2027.

PBA 2026-2028 e hartuar nga ARM i është dërguar institucionit epror (AKM Tiranë) me shkresën nr. 4216 prot., datë 23.04.2025 dhe kjo e fundit e ka dërguar versionin e konsoliduar në trajtë shkresore dhe elektronike në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar (AFMIS) / MF. Evidentohet se, programi buxhetor afatmesëm, është dërguar në AKM Tiranë brenda afateve ligjore të përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi, (ku afati përfundimtar është data 01.05.2025, referuar paragrafit nr. 5/a të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.7, datë 28.02.2025)

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë është paraqitur kërkesë për shpenzime për investime për shumën 3,770 mijë lekë në PBA 2022-2024, e cila nuk është miratuar në buxhetin vjetor të shpenzimeve. Mosmiratimi i fondeve për investime çon në mos ushtrimin e mos funksionimin normal dhe me efektivitet të aktivitetit të institucionit.

-Nga auditimi rezulton se NA dhe NZ, për të tre vitet objekt auditimi, nuk janë dërguar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të buxhetit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të cilat dërgohen në MTM. Mungesa e raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore, si dhe relacioneve shpjeguese cenojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III dhe 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1. faqet 14-15 të Raportit të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të identifikojë prioritetet kryesore për investime në bazë të një analize të detajuar për të siguruar që ato të jenë të përshtatshme dhe të qëndrueshme në shërbim të aktivitetit të institucionit.

**2.2.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të marrë masa të hartojë raportet e monitorimit 4, 8 dhe 12 mujore, të realizimit të treguesve në raport me parashikimet pritshme si dhe në raportin 8 mujor të ofrojë informacion shtesë në përputhje me planin fillestar të parashikuar.

**Në vijimësi**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, ka paraqitur PBA-të që kanë si vit 2024, 2025, 2026, 2027 dhe 2028, në të cilat, ka paraqitur edhe kërkesat për Investime (zëri 231) pasi një pjesë e pajisjeve janë të viteve 2014-2016.

Përsa u përket raporteve të monitorimit 4, 8 dhe 12 mujore, ARM përgatit çdo muaj situacionin e shpenzimeve që e dërgojmë në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe bazuar në verifikimet e kryera nga ana e KLSH-së rezulton se nga ana e Institucionit janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, analizuar në vijim:

#### **Në lidhje me zbatimin Rekomandimit nr. 2.1:**

Nga ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave me nr.7, datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, (dërguar nga MF me shkresën nr. 4073/1, datë 28.02.2025), është hartuar PBA 2026-2028, e cila është mbështetur në tavanet buxhetore të miratuara nga VKM nr. 119, datë 26.02.2025.

ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë ka paraqitur në Tabelën nr.11 të PBA-së (dërguar zyrtarisht AKM Tiranë), prioritetet kryesore për investime publike me financim të brendshëm, ku sipas analizës së kryer, rezulton të jenë programuar shpenzime për investime në llogarinë ekonomike 231 “Investime për aktivet afatgjata materiale”, me destinacion për blerje kompjutera, printera dhe fotokopje në vitet 2025, 2026 dhe 2027, përkatësisht në shumat e programuara prej 3,000,000 lekë, 500,000 lekë dhe 500,000 lekë.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

#### **Në lidhje me zbatimin Rekomandimit nr. 2.2:**

U verifikuan me zgjedhje raportet / situacionet periodike të shpenzimeve buxhetore të dërguara në AKM Tiranë, që përmbajnë të dhënat dhe analizat mbi planin vjetor, limitin buxhetor progresiv dhe faktin progresiv (realizimin). Sipas periudhave, në lidhje me 5 (pesë) praktikat e testuara nga audituesit e autorizuar të KLSH-së, evidentohet se janë përgatitur dhe përcjellë në institucionet shtetërore sipas shkresave të mëposhtme, këto raporte:

- ✓ Për periudhën Janar-Maj 2024, dërguar në AKM me shkresën nr. 1879, datë 09.07.2024, ku është bashkëlidhur dhe situacioni 5-mujor i Degës së Thesarit, datë 19.06.2024, i nënshkruar nga përfaqësuesit e ARM-së dhe të Degës së Thesarit Fier.
- ✓ Për muajin Janar 2025, dërguar me shkresën nr. 671, datë 05.03.2025 në MTM, ku është bashkëlidhur dhe situacioni mujor, datë 05.03.2025, i nënshkruar nga përfaqësuesit e ARM-së dhe të Degës së Thesarit Fier.
- ✓ Për muajin Shkurt 2025, dërguar me shkresën nr. 1159, datë 16.04.2025 në MTM, ku është bashkëlidhur dhe situacioni 2 mujor, i nënshkruar nga përfaqësuesit e ARM-së dhe të Degës së Thesarit Fier.
- ✓ Për muajin Prill 2025, dërguar me shkresën nr. 1486, datë 20.05.2025 në MTM, ku është bashkëlidhur dhe situacioni progresiv, datë 20.05.2025, i nënshkruar nga përfaqësuesit e ARM-së dhe të Degës së Thesarit Fier.
- ✓ Për muajin Maj 2025, dërguar me shkresën nr. 1671, datë 11.06.2025 në MTM, ku është bashkëlidhur dhe situacioni progresiv, rakorduar me datë 10.06.2025, i nënshkruar nga përfaqësuesit e ARM-së dhe të Degës së Thesarit Fier.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastrë, mbi pasqyrat financiare rezultoi si më poshtë:

1.Pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Fier nëpërmjet sistemit C@ts, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar,

pika 3.12. “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit” në lidhje me depozitimin on-line të pasqyrave financiare brenda afateve ligjore deri me 31 mars të çdo viti pasardhës.

2.Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin, në mosrespektim të kërkesave të Nenit 3, pika 1 të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Kreu II, Dispozita të Përgjithshme mbi Dokumentet Kontabël dhe Pasqyrat Financiare Neni 6, Mbajtja e kontabilitetit, Neni 7 Dokumenti kontabël; Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II, 2.1 “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 2.2; Kreu III Paragrafi 43.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike në *excel* me vlera, por nuk janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës, etj, në të cilat regjistrohen të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike të marra nga dokumentet bazë të bankës, magazinës; nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë.

-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël, të cilat shërbejnë si bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike, të marra nga dokumentet vërtetuese.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 17 të Raportit të Auditimit)

**3.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të sigurojë regjistrimin e të gjitha transaksioneve financiare në kohë dhe me saktësi, për të siguruar kronologjinë dhe gjurmët e veprimeve ekonomike në informacionin financiar të raportuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Sektori i Financës (sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja), ka plotësuar Librat e Punonjësve, Librin e Bankës dhe Librin e Materialeve.

Pasqyrat Financiare (Bilanci 2024) janë dorëzuar në degën e thesarit me numër protokolli 927, datë 28.03.2025.

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit që është vendosur në dispozicion të KLSH-së si dhe argumentimeve nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë disa masa pjesore në kuadër të zbatimit të këtij rekomandimi.

Audituesit e KLSH-së kryen testime të transaksioneve, për të verifikuar nëse janë mbajtur regjistrat centralizator, librat e llogarisë/ ditarët e bankës, magazinës, etj., në të cilat regjistrohen të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike të marra nga dokumentet bazë të bankës, magazinës, etj.

Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore për vitin 2024 të ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastër, sipas shkresës me nr. 927, datë 28.03.2025 janë dërguar në institucionet shtetërore, si në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit Tiranë, në Drejtorinë e Statistikës Fier, Drejtorinë e Tatimeve Fier dhe në Degën e Thesarit Fier.

Rezulton se nga ana e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse janë plotësuar regjistrimet për aktivitetin në dokumentet:

- ✓ Libri i Pagave të Punonjësve, që fillon në vitin 2024 me pasqyrimin e pagave mujore te punonjësve duke filluar me z. P. T. dhe përfundon me z. P. D.
- ✓ Libri i Magazinës, fillon me artikullin toner lexmark dhe vijon me zërat /artikujt e tjerë.

- ✓ *Ka një ecure të ngadaltë në plotësimin e librave sintetikë të llogarisë që janë baza për hartimin e bilancit vërtetues (verifikues) para plotësimit të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore të ARM-së. Kjo ecure është ndikuar edhe nga mungesa e specialistes së financës (me leje lindjeje), gjë që kërkon veprime të strukturave menaxheriale me qëllim shmangien e vonesave për plotësimin në afat të librave bazë sintetikë të llogarive (mastro ose centralizator), si dhe në ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi.*

Statusi: **i pranuar, në proces zbatimi.**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e bërë për saktësinë e paraqitjes së llogarisë 31 “Materiale” rezultoi se në mbyllje të vitit 2022 paraqitet e pandryshuar në vlerën 61,469 lekë, krahasuar me periudhën e mëparshme.

-Nga verifikimi dhe kontrolli i dokumentacionit vërtetues (fletëhyrje dhe fletëdalje) rezultoi se, në mbyllje të vitit 2022 gjendja kontabël e llogarisë 31 “Materiale” paraqitet në vlerën 560,187 lekë, vlerë e cila rakordoi me gjendjen fizike të materialeve gjendje në magazinë, bazuar në kontrollin e ushtruar në magazinën e institucionit, dhe se kjo vlerë nuk rezulton e pasqyruar në bilanc.

-Nuk ka akt rakordim në fund të çdo muaji/viti të mbajtur midis magazinierit dhe përgjegjësit të financës për gjendjen për çdo zë të këtyre aktiveve, duke ndikuar kështu në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar të klasës 3, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 pika 52, 53.

-Nga verifikimi i shënimeve shpjeguese në lidhje me këto zëra, nuk ka të dhëna në lidhje me politikat që përdoren nga ana e subjekteve për vlerësimin e tyre, ashtu siç përcaktohet në SKK 4 “Inventarët”.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 18-19 të Raportit të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për të evidentuar gjendjen reale të llogarisë 31 “Materiale” dhe llogarisë 32 “Inventari i imët” dhe të reflektojë këtë vlerë në kontabilitet nëpërmjet veprimeve korigjuese.

**Menjëherë**

#### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Sektori i financës evidentoi gjendjen reale të llogarisë 31 “Materiale” dhe të llogarisë 32 “Inventar i imët” dhe janë pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2024.

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e institucionit, rezulton se janë marrë disa masa pjesore në kuadër të zbatimit të këtij rekomandimi.

1. U verifikua gjendja kontabël e llogarisë 31 “Materiale”, që paraqitet në fund të vitit 2023 në bilanc (*Formati nr.1*), si tepriçë e ushtrimit të mëparshëm në vlerën 61,469 lekë, e cila është zero në datën 31.12.2024, sipas pasqyrimit të saj në Bilancin Kontabël.
2. *U verifikua nëse janë mbajtur akt rakordimet në fund të çdo muaji /viti, midis magazinierit dhe përgjegjësit të financës për gjendjen për çdo zë të këtyre aktiveve dhe rezultoi se librat e magazinës / kartelat nuk janë kundërfirmosur nga sektori i financës dhe përgjegjësi material (magazinieri).*
3. U bë verifikimi në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore 2024 për të testuar nëse ka të dhëna mbi politikat kontabile që përdoren nga ana e ARM-së për vlerësimin e zërave të bilancit dhe rezultoi se janë trajtuar e dhënë shpjegimet e nevojshme në formatin përkatës, (*Pasqyra nr. 5, “Shënime shpjeguese pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore*).

Statusi: **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

## **5.Gjetje nga auditimi:**

Nga analiza e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” del se, në mbyllje të vitit 2021 dhe vitit 2022 është 0 lekë. Nga verifikimi i bërë dhe nga analizimi e kësaj llogarie rezulton se në mbyllje të bilancit vjetor 2020 është 83,180 lekë dhe paraqet detyrimin e dëmit ekonomik lënë nga Raporti i Auditimit të KLSH-së viti 2018 dhe i përket 2 ish-punonjësve (2x 41,590 lekë), të cilët rezultojnë të larguar para periudhës 2018 dhe konfirmohet se janë detyrime të pa likuiduara edhe gjatë periudhës së auditimit. Si rrjedhim, vlera e detyrimit nga të tretët rezulton e hequr padrejtësisht nga kontabiliteti i njësisë dhe duhet pasqyruar në periudhën në vijim. Veprimi në kundërshtim me UMFJE nr.8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Kreu III 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 32. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 19-20 të Raportit të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të ri paraqesë në llog.468 “*Debitorë të ndryshëm*” vlerën 83,180 lekë, e cila nuk është paraqitur në pasqyrat financiare të viteve 2021-2022 dhe të marrë masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës.

**Menjëherë**

## **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Sektori i Financës paraqiti në pasqyrat financiare të vitit 2024, llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” dhe vlerën 83,180 lekë që u paraqit në Bilancin e vitit 2024.

## **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion nga ana e Institucionit, (përgjegjësi i sektorit të financës / nëpunësi zbatues i ARM-së), teprica e Llog. 468 “*Debitorë të ndryshëm*” me datën 31.12.2024 paraqitet në shumën 932,704 lekë, shumë kjo në ngarkim të 21 personave, dhe u referohet rezultateve të dy Raporteve Përfundimtare të Auditimit, të dërguara në ARM, (përkatësisht në vitin 2018 dhe 2024).

- Vlera sipas rekomandimit të mëparshme të KLSH-së, prej 83,180 lekë, (lënë nga Raporti i Auditimit të KLSH-së viti 2018), u përket 2 ish-punonjësve (2x41,590 lekë), të cilët rezultojnë të larguar para periudhës 2018 dhe konfirmohet se janë detyrime të pa arkëtuara edhe gjatë periudhës së auditimit. Konstatohet se detyrimi është kontabilizuar për z. A. V dhe z.E. L, (2 persona x 36,090= 72,180 lekë). Pra, është pasqyruar më pak detyrimi për 11,000 lekë, e cila përmes një artikulli rregullues duhet të sistemimet në kontabilitet dhe të përfshihet në pasqyrat financiare të vitit 2025.

Rezulton se është kontabilizuar shuma prej 72,180 lekë dhe jo shuma 83,180 lekë sipas rekomandimit të KLSH-së për ri-paraqitjen e këtij detyrimi në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore të vitit 2024.

Në Pasqyrat Financiare Vjetore të mbyllura me datën 31.12.2024, teprica e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në rreshtin nr. 32 të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, (Formati nr.1), viti 2024, paraqitet në shumën prej 932,704 lekë më datë 31.12.2024, (përfshirë dhe shuma 72,180 lekë), kurse më datë 31.12.2023 teprica e kësaj llogari ishte zero.

Statusi: **i pranuar, në proces zbatimi.**

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 212 “*Ndërtime konstruksione*” rezultoi se, përbëhet nga vlera e 5 godinave në kosto historike në total për 9,512,610 lekë marrë nga ISHMPUT Fier nga procesi i ristrukturimit sipas Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së “*Kalim në*

*përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM” dhe se nuk është pasqyruar realisht vlera e aktiveve në pronësi të subjektit pasi:*

a) Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” përfshihen tre godina në kosto historike vlerë 5,652,686 lekë, të cilat duhet t’i kishin kaluar IKMT-së, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së. Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë janë bërë kërkesa për kalimin e 3 godinave, referuar Urdhrit të Ministrit të MTM-së, por nuk është sqaruar përfundimisht.

Nga ana e Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë nuk është insistuar më për sqarimin me ministrinë përgjegjëse nga ajo varet, me MTM, në lidhje me zbatimin e Urdhrit të Ministrit të MTM-së Nr.54 datë 24.02.2020, në mosrespektimin me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kreu (II), pika (16): Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik pika 16.

b) Nga verifikimi i titujve të pronësisë të këtyre aktiveve, rezultoi se nuk ka Certifikata për vërtetim pronësie e për rrjedhje kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur dhe nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 21-22 të Raportit të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të saktësojë dhe kalojë në pronësi të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, tre godina me kosto historike në vlerën 5,652,686 lekë, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, duke bërë dhe sistemimin kontabël të kësaj vlere në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.

**6.2.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të ngrëjë grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi e në përdorim dhe të realizojë regjistrimin e pronave në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

**Menjëherë**

#### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë e Gjirokastrë në bashkëpunim me AKM ka bërë pagesën e Aplikimit për Certifikatën e Zyrove Qendrore në Fier. Numri i kërkesës për aplikim 19752 dhe paguar me urdhër - shpenzimi nr. 92, datë 09.10.2024.

Për kalimin e zyrove të Lushnjës dhe Mallakastrës të IKMT Fier jemi në proces .

Për këto tre objekte kemi komunikuar edhe me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit .

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë disa masa pjesore në kuadër të zbatimit të këtij rekomandimi.

**Për rekomandimin nr. 6.1:** Nga ana e ARM Fier në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, janë bërë kërkesa/shkresa zyrtare<sup>13</sup> për kalim kapital të 3 (tre) godinave, si vijon:

<sup>13</sup> -Referuar Aktit të Konstatimit të KLSH-së, nr. 2, datë 27.03.2024, mbajtur në ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, protokolluar në këtë institucion me nr. 900/1 prot., datë 29.03.2024.

- Shkresa dërguar IKMT-së me nr. 620 prot, datë 26.01.2021, për të cilën *nuk ka kthim përgjigje nga IKMT.*
- E-mail zyrtar drejtuar MTM-së datë 29.05.2023, ku është kthyer përgjigje se, *”kalimi i godinave IKMT-së ka qenë vetëm për efekt përdorimi dhe jo për kalim në inventar dhe vlerë kontabël ...”*

Për kalimin e *tre godinave / zyrave të ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë*, në pronësi të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, *(përkatësisht 2 për IKMT Lushnje dhe 1 për IKMT Mallakastër)*, me kosto historike prej 5,652,686 lekë, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, nga ana e ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë janë zhvilluar disa takime edhe në AKM, por kjo procedurë e kalimit kapital në përgjegjësi të IKMT Lushnjë dhe Ballsh nuk është finalizuar ende dhe praktikat janë në proces.

Statusi: **i pranuar, proces zbatimi.**

### **Për rekomandimin nr. 6.2:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë e Gjirokastrë sipas Urdhër Shpenzimit Nr. 92, datë 9.10.2024 ka likuiduar për llogari të Drejtorisë Vendore të ASHK Fier shumën prej 9,500 lekë në lidhje me kërkesën me nr. 19752 dhe datë kërkesë 03.10.2024, si pagesë e tarifës së aplikimit nga ana e Agjencisë Rajonale e Mjedisit dhe Pyjeve për certifikatën e regjistrimit të zyrave qendrore në Fier.

Statusi: **i pranuar, në proces zbatimi.**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e vlerës së Llogarisë 214 *“Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”* rezultoi se në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë për çdo aktiv pasi: -Vlera kontabël e këtij zëri në aktiv të bilancit paraqitet më pak në total në shumën 50,969 lekë, diferencë që vjen nga paraqitja gabim në çelje në kosto historike e vlerës së këtij zëri (paraqitur më shumë për 110,304 lekë) në Formatin 7/b, *“Gjendja dhe Ndryshimet e AAGJ (Vlerë neto)”*, krahasuar me paraqitjen e tij në Formatin 7/a *“Gjendja dhe Ndryshimet e AAGJ (Kosto historike)”* dhe e përdorimit gabim të normës së amortizimit (në shumën 161,273 lekë), gjë e cila ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të vlerës së aktiveve neto në pasqyrën e Pozicionit financiar si dhe në vlerën e fondit neto të institucionit, në kundërshtim me Urdhër nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”* pika 36, e analizuar sipas tabelës nr.4.

- Nuk është llogaritur amortizimi (11,030 lekë) për shtesat e vitit 2022 me vlerë 110,304 lekë, marrë aktive pa pagesë nga transferimet e brendshme, me Urdhër të brendshëm nr.155, datë 12.07.2022 të Drejtorit të përgjithshëm të AKM-së.

-Një pjesë e aktiveve të regjistruar në këtë llogari janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë, të cilat duhet të kalojnë në llogarinë 218 *“Inventar ekonomik”*, pa ndikim material në pasqyrat financiare pasi amortizimi vjetor është përlllogaritur drejt me normën 25 % dhe jo 20%, duke mos iu referuar kështu nomenklaturës së llogarive të planit kontabël publik (sipas tabelës anekse nr.5 të RPA). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 22-23 të Raportit të Auditimit)*

**7.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për ri paraqitjen e saktë të llogarisë 214 *“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”* dhe të bëhet korrigjimi në klasifikimin e zërave me kosto historike 1,399,746 lekë e cila duhet të paraqitet në llog. ekonomike 218 *“Inventar ekonomik”*.

**Menjëherë**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Spektori i Financës në Pasqyrat Financiare të vitit 2024 ka korrigjuar vlerën prej 1,399,746 lekë duke e kaluar nga llogaria 214, tek llogaria 218.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga subjekti si dhe verifikimeve të kryera nga ana e audituesve të KLSH-së, konstatohet se:

Në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore 2024, (të dërguara në MTM dhe AKM me shkresën nr. 937, datë 28.03.2025), teprica neto e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” në rreshtin nr. 52 të Pasqyrës së Pozicionit Financiar 2024, (Formati nr.1), paraqitet në shumën prej 1,802,915 lekë më datë 31.12.2024, shumë kjo e barabartë me tepricën e kësaj llogarie më datë 31.12.2023.

Teprica e llogarisë 218 “*Inventar Ekonomik*” në rreshtin nr. 66 të Pasqyrës së Pozicionit Financiar 2024, (Formati nr.1), paraqitet në shumën prej 506,182 lekë më datë 31.12.2024, kurse më datë 31.12.2023 paraqitet 844,382 lekë.

Nga Spektori i Financës së ARM-së, në Pasqyrën Nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me kosto historike”, të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore 2024, janë kryer këto veprime si më poshtë: Në kolonën nr.5 “*Lëvizje brenda aktiveve*” të Formatit nr.7/a, janë bërë shtesa në llogarinë 218, “*Inventar ekonomik*” (numër rreshti 14), vlera prej 1,399,746 lekë; si dhe janë bërë pakësime në kolonën nr.9 “*Pakësime të tjera*”, (rreshti nr. 10, llogaria ekonomike 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune*”), sa zbaritur vlera prej 1,399,746 lekë.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e vlerës së llogarisë 215 “*Mjete Transporti*” rezultoi se, në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e saktë e aktivitetit për automjetin i kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, në mos respektim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit.

- Në llogarinë 215 “*Mjete transporti*” nuk është shtuar vlera (për pjesë këmbimi-motor për automjetin AA...NS), që rezultoi nga shërbimi i përgjithshëm i kryer në vitin 2021, në shumën 362,400 lekë, sipas Faturës tatimore nr.33 datë 19.08.2021 dhe Fletëhyrjes nr.10, datë 19.08.2022, në kundërshtim me SKK Nr. 5 – Aktivitet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale - Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja, paragrafi 4 dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2019 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, “*Aktivitet afat gjata*”, përbërja dhe trajtimi kontabël, germa “b”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 24-25 të Raportit të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrin masa për saktësimin e procedurës ligjore të automjetit me targë TR...H tip *Land Rover defender*, që ka kaluar tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020, të Ministrisë së Turizmit dhe të bëhet sistemimi kontabël në llogarinë 215 “*Mjete Transporti*”.

**Menjëherë**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë ka kaluar te Regjistri i Aktiveve Afatgjata, vlerën e riparimit të makinës “Hyundai” me targë TR....H prej 362,400 lekë. Po kështu, kemi plotësuar gjithë dokumentacionin për kalimin e kësaj makine tek Zonat e Mbrojtura Divjakë dhe e kemi shkarkuar te Bilanci Financiar i vitit 2024.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (nëpunësi zbatues i ngarkuar për zbatimin e rekomandimit), rezulton se janë marrë këto masa dhe veprime për zbatimin e rekomandimit:

- Veprimi i shkarkimit të vlerës së automjetit nga kontabiliteti, është bërë sipas Fletë Daljes së ARM Fier, nr. 19, datë 11.12.2023 me vlerë 3,391,347 lekë.
- Mbështetur në të dhënat e inventarëve të vëna në dispozicion nga ana e subjektit, rezulton se në llogarinë 215 “Automjete” të këtij institucioni është kontabilizuar vlera e 4 (katër) automjeteve, me targë AA....NE, TR...D, TR....J dhe AA....NS.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i vlerës së llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” rezulton të jetë paraqitur me vlerë më pak për 110,304 lekë.

-Pakësimet në vlerën 241,920 lekë të cilat janë ç’regjistruar nga kontabiliteti, më parë se nga data e bërjes dalje të këtij aktivi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” pika 32; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 39.

-Nga llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” janë transferuar (pa pagesë) aktive në shumën 769,424 lekë tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, të cilat sipas listës rezultojnë në kontabilitetin e njësisë, nuk janë bërë dalje, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, në kundërshtim me pikat 34, 39,43,55.

-Një pjesë të aktiveve të regjistruar në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë të cilat janë përlllogaritur drejt me 25%, por jo në llogarinë 218 “*inventar ekonomik*”. Gjithashtu në këtë zë të aktivitetit rezultojnë pajisje kompjuterike në vlerën prej 3,328,098 lekë, për të cilat nuk është zbatuar norma e amortizimit 25%, por janë llogaritur në grup me 20%, në mosrespektim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,2. faqet 25-27 të Raportit të Auditimit)

**9.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për ri paraqitjen e saktë të llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*”.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Sektori i Financës ka ri-paraqitur saktë llogaritë 218 dhe 214, si dhe i ka paraqitur në bilancin e vitit 2024.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, rezulton se janë marrë disa masa për zbatimin e rekomandimit,

Nga llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” janë transferuar (pa pagesë) aktive në shumën 769,424 lekë tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, të cilat sipas listës rezultojnë në kontabilitetin e njësisë, dhe në zbatim të rekomandimit të KLSH-së janë bërë dalje sipas dokumentit Fletë Dalje nr.18, datë 11.12. 2023.

*Sa evidentuar më sipër, rekomandimi për këtë çështje konsiderohet i realizuar.*

Sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, një pjesë të aktiveve të regjistruara në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë të cilat janë përlllogaritur drejt me 25%, por jo në llogarinë 218 “*inventar ekonomik*”. Gjithashtu në këtë zë të aktivitet rezultojnë pajisje kompjuterike në vlerën prej 3,328,098 lekë, për të cilat nuk është zbatuar norma e amortizimit 25%, por janë llogaritur në grup me 20%, në mosrespektim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, pika 36.

*Sa trajtuar më sipër, nuk janë bërë korrigjimet e nevojshme për këtë pjesë të rekomandimit.*

**Statusi: i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastrë, në 5 raste u konstatuan parregullsi në sistemin E-inspektim, në dokumentacionin bashkëlidhur, konkretisht:

-2 subjekte mungon plani i rehabilitimit;

-1 rast raportet e vet monitorimit/monitorimit vjetor;

-2 raste dokumentacioni bashkëlidhur pa nr. protokollin pranë AKM-së, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “*Për Mbrojtjen e Mjedisit*” Seksioni 2, Neni 62-66 “*Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit*” si dhe me Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqet 57-58- të Raportit të Auditimit).

### **10.1.Rekomandimi:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sektori i Mjedisit të hartojë programe inspektimi për subjektet që nuk kanë paraqitur dokumentacionin bashkëlidhur në sistem dhe në rast mosplotësimi të marrë masa administrative me gjobë ndaj subjekteve.

**Menjëherë**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Në lidhje me këtë rekomandim, shpjegojmë se nga Sektori i Inspektimit Mjedisor janë inspektuar subjektet “A... G...”, në datë 13.12.2024 me nr. çështje AKM-FR-20024-000293 dhe ka rezultuar në përputhje me legjislacionin mjedisor. “C...” nuk është inspektuar nga ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë pasi kemi konflikt interesi.

”M.....i” ka bërë kërkesë për revokim të lejes mjedisore. Subjekti “N.... 2010” është inspektuar me nr. çështje AKM-FR-2025-000002 dhe ka rezultuar në përputhje me legjislacionin mjedisor. Ndërsa subjekti “A.....” është inspektuar nga Inspektorati Qendër.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht për subjektet e konstatuara N.-2010 sh.p.k, A. G. sh.p.k, janë kryer inspektimet përkatëse. Për subjektin M. sh.p.k është bërë një verifikim nga

sektori i inspektimit të mjedisit, ku cilësohet se subjekti nuk e ushtron veprimtarinë. Ndërsa, për subjektin "C." nuk është kryer inspektim për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Sektorin e Mjedisit u konstatua se në 6 subjekte, nga të cilat 4 subjekte për nxjerrjen e mineraleve, rërë-argjilës nga karrierat në qiell të hapur dhe nga guroret si dhe 2 subjekte me veprimtari të ndryshme, inspektorët në procesverbal kanë cituar se: “*subjekti u gjend i mbyllur*”, ose nuk kryen aktivitetet. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit.

-Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKB-së;

-Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe me institucione të tjera, veprime jo në përmbushje të Nenit 36- *Detyrimet e subjektit të inspektimit*, pika “d”; të Ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” Seksioni 2, neni 62-66 “*Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit*” si dhe me Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, Nenin 45-48; Nenin 11 “*Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi*” të Ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011“*Për Mbrojtjen e Mjedisit*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2, faqe nr.60-62, të Raportit të Auditimit).

**11.1.Rekomandimi:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB me qëllim që të hartojnë dhe nxjerrjen e autorizimeve për kryerjen e inspektimeve ndaj subjekteve, nëse janë aktiv si subjekte ose në të kundërt të merren masa administrative (gjobë) sipas legjislacionit në fuqi.

**Menjëherë**

#### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Në rastet kur subjekti është konstatuar i mbyllur, referuar ligjit “Për inspektim në Republikën e Shqipërisë”, subjekti fotografohet nga trupa inspektuese dhe procedura ngarkohet në sistem. Kryhen verifikimet sipas rastit në sistem sipas rastit dhe raportuar në fund të çdo muaji në AKM. Është përditësuar regjistri në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatimeve dhe janë ndjekur procedurat për verifikim në QKB.

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. *Konkretisht*, Agjencia Rajonale e Mjedisit ka dërguar raportime mujore (regjistër të inspektimeve në sektorin e mjedisit) në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, por nuk është mbajtur një regjistër me subjektet e konstatuara të mbyllura. Grupi i auditimit ka shqyrtuar 2 raportime për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit: për muajin tetor 2024, regjistri mbyllet me nr. rendor 15, ndërsa për muajin janar 2025 regjistri mbyllet me nr. rendor 24.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

**12.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga Sektorit i Burimeve Natyrore (Ujërave) rezultoi se, për 3 subjekte nuk janë hartuar vendimet përfundimtare sipas procesverbaleve të shkeljeve të konstatuar, në kundërshtim me Ligjit Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i ndryshuar, si dhe Nenin 23 të Ligjit nr. 9115/2003 “Për Trajtimin Mjedisor të

*Ujërave të ndotur’’, Neni 42-46 (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.66-67 të Raportit të Auditimit).*

**12.1.Rekomandimi:** Sektori i inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) për shkeljet e konstatuara të hartojnë vendimet përfundimtare për subjektet: “K.” me Nipt K.....A; “A. M.” me Nipt L.....B; “L. K.” me Nipt L....G, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

**Menjëherë**

**Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Për subjektet K., me Nipt K....; A. M., me Nipt L.....B; L. K. me Nipt L....G, bashkëngjitur vendimet përfundimtare të subjekteve të sipërcituara. Përsa i përket subjektit K. nuk është realizuar akoma inspektimi për shkak të ngarkesës. Ky subjekt do të futet në planet e ardhshme të inspektimit. ***Bazuar në komentet për Projekt Raportin e Auditimit, nga Sektori i Burimeve Natyrore (Ujërave) janë dërguar komentet mbi masat organizative të marra në lidhje me gjetjet nr.5, 6 dhe 7 si dhe rekomandimet përkatëse.***

-Raportimin pranë AKM -së për muajin qershor dhe korrik 2025 nga përgjegjësi i sektorit të burimeve natyrore (ujërave). (dërguar me email nga Drejtori, pranë Zj.J. C., Përgjegjëse e Sektorit Burimeve Natyrore pranë AKM -së)

Autorizimin për inspektim për Subjektin “K. C.”;

Njoftimin për fillimin e inspektimit dërguar subjektit “K. C.”;

Në lidhje me raportimin mujor nga Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Natyrore Ujrave kryhet raportimi mujor pranë Drejtorit i cili më pas i dërgohet pranë sektorit përkatës në AKM nëpërmjet emailit.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Nga shqyrtimi i vendimeve përfundimtare për subjektet e mësipërme, subjekti K. nuk është inspektuar.

Pas dërgimit të projektit raportit të KLSH-së, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë ka marrë masa për fillimin e procedurës së inspektimit për subjektin “ K. C.”.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Sektori i Mjedisit, në 6 raste ndaj subjekteve me veprimtari të ndryshme ka dhënë masa administrative me dënim kryesor *Paralajmërim*, për mosparaqitje dhe zbatim të kushtit 3.29. Monitorimi, për Vlerësim me Ndikim në Mjedis VNM pranë AKM-së, (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr.61 të Raportit të Auditimit).

**13.1.Rekomandimi:** Sektori i Mjedisit të planifikojë inspektime për zbatimin e detyrave të lëna për plotësimin e kushteve të lejes mjedisore, për subjektet: H. S., Nipt K.....3O; I., Nipt J.....0D; L, Nipt K5.....K; M&K. Nipt L.....E; Bashkia Lushnje, Nipt K.....L; A. M., Nipt K.....1U.

**Menjëherë**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Në lidhje me këtë rekomandim, sqarojmë se masa “paralajmërim” ndaj këtyre subjekteve është marrë për mos-raportim në AKM të monitorimeve. Veprimtaritë e këtyre subjekteve janë në fushën e ndërtimit dhe janë përfunduar dhe në këtë rast nuk mund të kryhen raporte vetëmonitoruese, pasi objekti ka përfunduar.

### ***Në lidhje me Projekt Raportin e Auditimi nga ana e Përgjegjës të Sektorit të Inspektimit z.A. H. janë dërguar këto objeksione, si më poshtë vijon:***

**H. S.** me numër çështje AKM-FR-2023-000200, inspektimi është kryer nga A. H. dhe A.Ç.. Është konstatuar se operatori e ka përfunduar zhvillimin e projektit dhe nuk është parë e arsyeshme që të kërkohej kryerja e monitorimeve pasi projekti kishte përfunduar zhvillimin e tij në terren dhe logjikisht nuk mund ti kërkohej kryerja e raportit të monitorimeve kur veprimtaria ka përfunduar, për këtë arsye është marr masa administrative “Paralajmërim”. Theksojmë se inspektimet për VNM janë kryer për herë të parë dhe subjektet si fillim janë këshilluar për zbatueshmërinë e kushteve të VNM-së. Nuk mund të lihet ri-inspektimi sipas rekomandimit të KLSH, pasi projekti ka përfunduar zhvillimin e tij në terren dhe ka mbaruar afati 2 vjeçar i vlefshmërisë së VNM-së. Kjo vërtetuar dhe me foto gjatë inspektimit për VNM të kryera në subjektin hotel “S.” dhe të ngarkuara në çështjen e inspektimit Nr. AKM-FR-2023-000200.



**I.** me numër çështje AKM-FR-2023-000200 inspektimi është kryer nga A. H. dhe A. Ç.. Është konstatuar se operatori e ka përfunduar zhvillimin e projektit dhe nuk është parë e arsyeshme që të kërkohej kryerja e monitorimeve pasi projekti kishte përfunduar zhvillimin e tij në terren, dhe logjikisht nuk mund ti kërkohej kryerja e raportit të monitorimeve kur veprimtaria ka përfunduar, për këtë arsye është marr masa administrative “Paralajmërim”. Theksojmë se inspektimet për VNM janë kryer për herë të parë dhe subjektet si fillim janë këshilluar për zbatueshmërinë e kushteve të VNM-së. Nuk mund të lihet ri-inspektimi sipas rekomandimit të KLSH pasi projekti ka përfunduar zhvillimin e tij në terren dhe ka mbaruar afati 2 vjeçar i vlefshmërisë së VNM-së. Kjo vërtetuar dhe me foto gjatë inspektimit për VNM të kryera në subjektin I. dhe të ngarkuara në çështjen e inspektimit Nr. AKM-FR-2023-000200.




**M&K** me numër çështje AKM-FR-2023-000196 është inspektuar nga A. H. dhe A. Ç.. Është konstatuar se operatori e ka përfunduar zhvillimin e projektit dhe nuk është parë e arsyeshme që të kërkohen kryerja e monitorimeve kur projekti ka përfunduar zhvillimin e tij në terren, dhe logjikisht nuk mund ti kërkohet kryerja e raportit të monitorimeve kur veprimtaria ka përfunduar për këtë arsye është marr masa administrative “Paralajmërim”. Theksojmë se inspektimet për VNM janë kryer për herë të parë dhe subjektet si fillim janë këshilluar për zbatueshmërinë e kushteve të VNM-së. Nuk mund të lihet ri-inspektimi sipas rekomandimit të KLSH pasi projekti ka përfunduar zhvillimin e tij në terren dhe ka mbaruar afati 2 vjeçar i vlefshmërisë së VNM-së. Kjo vërtetuar dhe me foto gjatë inspektimit për VNM të kryera në subjektin M&K. dhe të ngarkuara në çështjen e inspektimit Nr. AKM-FR-2023-000196.



**Bashkia Lushnjë** me numër çështje AKM-FR-2023-000195 është inspektuar nga A. H. dhe A. Ç. Është konstatuar se operatori e ka përfunduar zhvillimin e projektit dhe nuk është parë e arsyeshme që të kërkohen kryerja e monitorimeve kur projekti ka përfunduar zhvillimin e tij në terren, dhe logjikisht nuk mund ti kërkohet kryerja e raportit të monitorimeve kur veprimtaria ka përfunduar për këtë arsye është marr masa administrative “Paralajmërim”. Theksojmë se inspektimet për VNM janë kryer për herë të parë dhe subjektet si fillim janë këshilluar për zbatueshmërinë e kushteve të VNM-së. Nuk mund të lihet ri-inspektimi sipas rekomandimit të KLSH pasi projekti ka përfunduar

zhvillimin e tij në terren dhe ka mbaruar afati 2 vjeçar i vlefshmërisë së VNM-së. Kjo vërtetuar dhe me foto gjatë inspektimit për VNM të kryera në subjektin Bashkia Lushnjë dhe të ngarkuara në çështjen e inspektimit Nr. AKM-FR-2023-000195.



**A. M.** me numër çështje AKM-FR-2023-000191 inspektuar nga A. Ç. dhe A. H. Është konstatuar se operatori është në zhvillimin e projektit dhe është keshilluar të kryej monitorimin sipas kushtit të VNM-së, brenda afatit 30 ditë nga marrja e procesverbalit të inspektimit nga ana e subjektit afati deri në mbylljen e procedurës me vendim përfundimtar inspektimi, operatori ka kryer raport monitorimi dhe e ka dorëzuar dhe protokolluar zyrtarisht në AKM Tiranë, të cilin më pas e kemi ngarkuar në sistemin zyrtar online [www.e-Inspektimi.gov.al](http://www.e-Inspektimi.gov.al), për këtë arsye është marr masa administrative “Paralajmërim”. Për këtë arsye nuk është kryer ri-inspektim sepse subjekti e ka zbatuar detyrën e lënë në procesverbalin e inspektimit brenda afatit 30 ditë nga marrja e procesverbalit të inspektimit deri në mbylljen e procedurës me vendim përfundimtar inspektimi. Aktualisht nuk mund të kryhet ri-inspektim pasi VNM është miratuar më datë 19.03.2021 dhe ka mbaruar afati 2 vjeçar i vlefshmërisë të saj. Theksojmë se inspektimet për VNM janë kryer për herë të parë dhe subjektet si fillim janë keshilluar për zbatueshmërinë e kushteve të VNM-së. Kjo vërtetuar dhe me foto të raportit të monitorimit për VNM që është dorëzuar zyrtarisht nga subjekti në AKM Tiranë dhe ky raport është ngarkuar në çështjen e inspektimit Nr. AKM-FR-2023-000191.

	SUBJEKTI "AQUA MARIN" ADJENCI K. KOMBETARE N. S. 1517 N. S. 1517 DATE 28/3/2024
<b>RAPORT – VETMONITORIMI</b>	
MBI TREGUESIT MJEDISOR TË PROJEKTI TË VNM PARAPRAKË	
<b>"STRUKTURË ME FUNKSION HOTELERI ME 2 KATE                  MBI TOKË DHE 2 KATE NËNTOKË"</b>	
SUBJEKTI "AQUA MARIN" VENDNDODHJA: ZONA KADASTRALE 1739, NR.PASURIE 68/141, NË AFËRSI TË RRUGËS SË PLAZHIT PALASË, PALASË, HIMARË, VLORË.	
PËRGATITI RAPORTIN TEKNIK TË VETMONITORIMIT DHE RAPORTIN E REZULTATIT TË ANALIZAVE LABORATORI "STUDIO EKO-KESHILLIM", I AKREDITUAR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT SIPAS LEGHSLACIONIT NË FUQI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	
<b>JANAR 2024</b>	
<small>Reporti Teknik Vetmonitorimi korrik 2023 – Janar 2024</small>	
	

**L.** me numër çështje AKM-FR-2023-000197 është inspektuar nga A. H. dhe A. Ç. Është konstatuar se operatori është në zhvillimin e projektit dhe është keshilluar të kryej monitorimin sipas kushtit të VNM-së, brenda afatit 30 ditë nga marrja e procesverbalit të inspektimit nga ana e subjektit afati

deri në mbylljen e procedurës me vendim përfundimtar inspektimi, operatori ka kryer raport monitorimi dhe e ka dorëzuar dhe protokolluar zyrtarisht në AKM Tiranë, gjë të cilin e kemi ngarkuar në sistemin zyrtar online [www.e-Inspektimi.gov.al](http://www.e-Inspektimi.gov.al) për këtë arsye është marr masa administrative “Paralajmërim”. Për këtë arsye nuk është kryer ri-inspektim sepse subjekti e ka zbatuar detyrën e lënë në procesverbalin e inspektimit brenda afatit 30 ditë nga marrja e procesverbalit të inspektimit deri në mbylljen e procedurës me vendim përfundimtar inspektimi. Aktualisht nuk mund të kryhet ri-inspektim pasi VNM është miratuar më datë 13.04.2021 dhe ka mbaruar afati 2 vjeçar i vlefshmërisë të saj. Theksojmë se inspektimet për VNM janë kryer për herë të parë dhe subjektet si fillim janë këshilluar për zbatueshmërinë e kushteve të VNM-së. Kjo vërtetuar dhe me foto të raportit të monitorimit për VNM që është dorëzuar zyrtarisht nga subjekti në AKM Tiranë dhe ky raport është ngarkuar në çështjen e inspektimit Nr. AKM-FR-2023-000197.

SUBJEKTI "LAZAJ 2002"      AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

**RAPORT – VETMONITORIMI**

MBI  
TREQUESIT MJEDISOR TË PROJEKTTË VNM PARAPRAKË

**"OBJEKT BANIMI DHE SHERBIMESH 2-8-10 DHE 2 KATE PARKIM"**

SUBJEKTI "LAZAJ 2002"  
VENDNDODHJA: LAGJIA "HAJRO ÇAKERRI, RRUGA "ALI DEMIRI", OBJEKT BANIMI DHE SHERBIMESH 2-8-10 DHE 2 KATE PARKIM, NR. PAS 16/201, 16/163/2, 16/204, ZK. 8601, VLORË

PËRGATITI RAPORTIN TEKNIK TË VETMONITORIMIT DHE RAPORTIN E REZULTATIT TË ANALIZAVE LABORATORI "STUDIO EKO-KESHILLIM", I AKREDITUAR NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHEME E AKREDITIMIT SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

DHJETOR 2023

Raport Teknik Vetmonitorimi Qershor 2023 – Dhjetor 2023      

### 1. Mbi statusin e veprimtarisë së subjekteve

- Subjektet e listuara kanë ushtruar veprimtari të karakterit ndërtimor dhe objektet përkatëse kanë përfunduar.
- Në përputhje me nenin 4, pika 12 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, “veprimtari me ndikim në mjedis” është çdo aktivitet që zhvillohet dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në mjedis. Në mungesë të zhvillimit të aktivitetit, nuk ekziston subjekt inspektimi. Prandaj dhe nuk mund të kryhen inspektime.

### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Sipas legjislacionit në fuqi<sup>14</sup>, Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit e të ndikimeve të rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM paraprake.

Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Nga ana e ARM-së Fier, Vlorë, Gjirokastër nuk ka një korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për vlefshmërinë e vendimeve të mësipërme.

Statusi: **i pranuar, i pazbatuar.**

<sup>14</sup> Ligji nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, neni 25/1

**14. Gjetje nga auditimi:** Në inspektimet e kryera në terren, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacioni i nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të gjitha mangësitë e konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve, nuk ka përkrahje specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore, konstatimet e inspektorëve janë të përgjithshme dhe për rrjedhim detyrat e lëna kufizohen në plotësim të dokumentacionit, si dhe kryerjen e dërgimin e vet monitorimeve, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011“*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*” nenin 45-48. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe 56-59 të Raportit të Auditimit*).

**14.1.Rekomandimi:** Inspektorët e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të marrë masa që në çdo inspektim të kryer në terren të plotësojnë sipas formatit procesverbalin e inspektimit, mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore.

**Menjëherë**

**Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Në formatin e listës së verifikimit plotësohen të gjitha rubrikat e saj me sqarimet e nevojshme. Në procesverbal pasqyrohen situata dhe faktet e konstatuara në terren. Në sistem ngarkohen foto dhe video si dhe dokumentacioni provues për çdo rast.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka shqyrtuar praktikën për subjektet: A. sh.p.k, S. sh.p.k, Gj. sh.p.k.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se përgjegjësi i Sektorit të Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore (Ujërave) nuk ka hartuar dhe paraqitur periodikisht pranë Titullarit një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, për verifikimin e detyrave të lëna. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2,4, faqe 62-64 të Raportit të Auditimit*).

**15.1. Rekomandimi:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të marrë masa që në çdo fund muaji të hartojnë dhe të paraqesin periodikisht pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, me qëllim miratimin e planeve mujore për verifikimin e detyrave të lëna.

**Menjëherë**

**Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë raporton në fund të çdo muaji mbi gjetjet dhe problematikat për të gjithë subjektet e inspektuara, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Përgjegjësi i Sektorit të Mjedisit e ka dërguar raportimin mujor pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit duke e informuar dhe vënë në dijeni edhe titullarin e institucionit, ndërsa përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Natyrore ia ka dërguar informacionin mujor

titullarit të institucionit. Grupi i auditimit shqyrtoi raportimet për muajin Tetor 2024 dhe Mars 2025 (të kryera nga sektori i Burimeve Natyrore). Në vijim titullari i institucionit nuk e ka dërguar raportimin në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për raportimet e kryera nga sektori i Burimeve Ujore.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar pjesërisht.**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, nga inspektorët nuk janë plotësuar në çdo rast listë-verifikimet sipas nenit 39, 41 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 "*Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë*", si dhe Ligjit nr.52/2020 "*Për Lejet e Mjedisit*" shtojca 4.1 etj...sipas aktiviteteve që kryejnë subjektet. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe. 62-64 të Raportit të Auditimit*).

**16.1. Rekomandimi:** Inspektorët e Sektorit të Mjedisit dhe Sektorit të Burimeve Natyrore (Ujëra) të marrin masa që në çdo inspektim të plotësojnë të gjitha rubrikat që përmban listë-verifikimi për identifikimin e veprimtarisë që kryen subjekti sipas ligjit të sipërcituar.

**Menjëherë**

**Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Inspektorët e Sektorit të Mjedisit dhe Burimeve Natyrore plotësojnë formatin e listës së verifikimit me të gjitha rubrikat e saj duke dhënë sqarimet e nevojshme.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të dhëna nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Nga ana e grupit të auditimit u shqyrtuan procedurat dokumentare dhe dokumentacioni për 5 subjekte inspektimi dhe rezultoi se dokumentacioni është në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht për subjektet: "A." sh.p.k, "S." sh.p.k, "Gj." sh.p.k, "E." sh.p.k, "P. K. L. K." sh.p.k.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**


**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, nuk ka bazë të dhënash të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit bazuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut, në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 "*Për Mbrojtjen e Mjedisit*" seksioni 2, nenet 62-66 "*Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit*". Po ashtu, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut dhe frekuencën e inspektimit gjatë një viti të subjekteve që do të inspektohen. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2.faqe nr. 63-66 të Raportit të Auditimit*).

**17.1.Rekomandimi:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim me sektorin e Mjedisit dhe të sektorit të Burimeve Natyrore (Ujëra), të marrë masa për krijimin e regjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt në sistem e-Inspektim.

**Menjëherë**

## Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:

Nga ana e ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër është krijuar baza e të dhënave dhe klasifikimi i subjekteve sipas metodologjisë së vlerësimit të riskut, si dhe planet mujore dërgohen mbi bazë risku në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.



***Në lidhje me gjetjen e konstatuar dhe realizimin e rekomandimit nga KLSH, Përgjegjësi i Sektorit të Inspektimit Mjedisor në ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër z.A. H. ka dërguar observacione ku ka shprehur se:***

-Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër disponon bazë të dhënash të subjekteve me leje mjedisore, e cila është ndarë sipas tipit të lejes, fushës së aktivitetit dhe riskut të mundshëm mjedisor. Kjo bazë të dhënash dërgohet me e-mail nga AKM herë pas here. Bashkëngjitur e-mail. Çdo subjekt ka dosjen e tij elektronike në sistemin E-Inspektim, ku përfshihen automatikisht:

-Procesverbalet dhe listat e verifikimit;

- Aktet e inspektimit;

- Masat administrative dhe historiku i kontrolleve.

Këto të dhëna gjenerohen automatikisht nga sistemi në rubrikat “Historiku” dhe “Dosja”, në momentin kur subjekti inspektohet, në përputhje me strukturën dhe funksionin e sistemit E-Inspektim të miratuar nga Inspektorati Qendror.

## **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër është bashkëngjitur regjistri i lejeve që është dërguar me email (herë pas here...-*cituar në observacionet e ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër*) nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe nuk mbajtur një regjistër, i përditësuar çdo muaj nga ana e ARM Fier, Vlorë, Gjirokastër.

**Statusi: i pranuar, i pazbatuar.**

**18.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga sektori i Burimeve Natyrore (Ujëra) u konstatua se:

-Në 5 subjekte nuk janë kryer inspektimet për arsye pengimi nga subjekti i inspektuar.

-Në 3 subjekte nuk është finalizuar me marrjen e masës për mbyllje të aktiviteti, në kundërshtim me Ligjin nr.9115 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të ndotura”, Neni 23, ç; Ligji nr.111/2012, datë 11/15/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, Neni 97, pika 1 “Shkarkimi në mjedis i ujërave të përdorura”. (Më hollësisht trajtuar në pikën,4.2. faqe nr.67-67 të Raportit të Auditimit).

Nr.	Emri i subjektit	Aktiviteti	Vlera e gjobës 000/në lekë	Nr.Seri sipas Proc.Verb. të dënimit me gjobë	Data e Vendimit të dënimit me gjobë
1.	D... F...	Prodhim dhe tregtim të materialeve inerte	10,000	AKM-FR-2021-000057	30/06/2021
2.	T.. A...	Mbarëshkrimi i kafshëve në fermat	100,000	AKM-FR-2021-000045	09/06/2021
3.	E...	Ndërtim dhe rikonstruksion	10,000	AKM-FR-2021-000061	21/06/2021
4.	K....K.....	Akuakulturë	100,000	AKM-FR-2021-000146-	18.10.2021
5.	M.... E....	Hec	100,000	AKM-FR-2021-000146-	13.08.2021

**18.1.Rekomandimi:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Natyrore të inspektojnë 5 subjektet për të cilat janë marrë masa administrative (gjobë) për pengim të inspektimit si dhe të njoftojnë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

**Menjëherë**

**Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë ka bërë ri-inspektime për 5 subjektet, me përjashtim të një subjekti (“K. K.”), të cilin e kemi planifikuar në vazhdim.

Sipas shkresës së ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë me nr. 2072/1 datë 4.8.2025 “Njoftim”, drejtuar subjektit “K. K.” është njoftuar për kryerjen e inspektimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi dhe Autorizimit me nr. 207, datë 04.08.2025, nga grupi i inspektimit me përbërje A. B., M. H. dhe E. H.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezultojnë se janë marrë masa e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

**Statusi: i pranuar, zbatuar pjesërisht.**

**19.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga sektori i Burimeve Natyrore (Ujëra) rezultoi se, në sistemin E-inspektim *on-line* mungon dokumentacioni i duhur ligjor për 33 subjekte të konstatuara me shkelje, në kundërshtim me Ligjin nr.9115 “Për trajtimin mjedisor të Ujërave të ndotura”, datë 07.04.2003, Ligjin Nr.111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", neni 30 "Shkarkimet industriale dhe trajtimi i tyre".(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr.67-70 të Raportit të Auditimit).

**19.1.Rekomandimi:** Drejtori i Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Natyrore (Ujëra) të nxjerrë autorizimet për inspektimin e 33 subjekteve të trajtuara në Raport të Auditimit, të cilat nuk kanë dokumentacionin e plotë ligjor në sistemin E-inspektimit.

**Menjëherë**

**Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Referuar Udhëzimit nr.1, datë 1.2.2024, pika 2 *“Për miratimin e rregullores teknike mbi standardet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura dhe të patrajuara pranë ose në ujëra larëse”* është ngarkuar për zbatimin e këtij udhëzimi, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës–Kanalizimeve, Task-Forca dhe subjektet që do monitorohen sipas Aktit Normativ nr.8, date 28.12.2023, *“Për marrjen e masave urgjente për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”*.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar argumentimeve të dhëna nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Udhëzimi i mësipërm (i cituar në komentin e subjektit) nuk i është vendosur në dispozicion grupit të auditimit, gjatë auditimit të përputhshmërisë, realizuar përgjatë periudhës janar-mars 2024.

*Për sa më lartë*, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë duhet të kishte marrë masa për të përcjellë listën me 33 subjekte (trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit) pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, për të kryer inspektimet përkatëse krahas monitorimeve sipas aktit normativ nr. 8, datë 28.12.2023, *“Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”*. Qëllimi duhet të jetë përfshirja e këtyre subjekteve në programet e inspektimit të *Task Forcës* së ngritur sipas Udhëzimit të Përbashkët nr. 1, datë 01.02.2024 të MIE dhe MTM për monitorimin dhe inspektimin e zbatueshmerisë së standardeve mjedisore të ujërave. Nga ana tjetër, në funksion të zbatimit të përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi në këtë fushë, nga ana e ARM-së duhet të merren masat që të koordinohen veprimet me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Task Forcë-n e ngritur, referuar edhe përcaktimeve të shkresës së Inspektoratit Qendror me nr. 374/1, datë 30.08.2023 *“Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushë veprimtarinë inspektuese të mjedisit, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”*, në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Inspektimit Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Statusi: **pranuar, i pazbatuar.**

**20.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se nga Sektori i Mjedisit dhe Burimeve Natyrore (Ujërat), në 19 subjekte të inspektuara, nuk ushtrojnë aktivitetet dhe se në sistemin online nuk është hedhur dokumentacioni informues dhe vërtetues, si rezultatet e marra nga QKB, statusi (foto) etj., këto veprime bien në kundërshtim me Nenin 36-*Detyrimet e subjektit të inspektimit, pika “d”*, të Ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 *“Për Mbrojtjen e Mjedisit”*, Seksioni 2, Neni 62-66 *“Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”* si dhe me Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*, Neni 42-46, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr. 70-72 të Raportit të Auditimit)*.

**20.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të verifikojë statusin e subjekteve që inspektohen në QKB si dhe në Degët Rajonale të Tatimeve, përpara hartimit të

planeve të punës dhe në rastet kur ato nuk ushtrojnë aktivitetet t'i përcillen Agjencisë Kombëtare së Mjedisit, për heqje të lejeve mjedisore.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

#### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Është miratuar një praktikë standarde për verifikimin e statusit të çdo subjekti përpara përfshirjes në planin mujor të inspektimeve. Sistemi e-inspektimi nuk lejon hedhjen e subjekteve për inspektim që janë me status pezulluar/çregjistruar.

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**21.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për dhënien e mendimit të VNM-ve paraprahe/të thelluar u konstatua se mendimi dërgohet elektronikisht nga specialisti në adresën e drejtuesit të institucionit për t'u nënshkruar elektronikisht dhe për t'u ngarkuar më tej në sistemin E-Leje. Si pasojë e sulmit kibernetik të ndodhur në Shqipëri në muajin korrik 2022, çdo korrespondencë në formë elektronike (specialistë-titullar institucioni) para kësaj periudhe është fshirë (konfirmuar me e-mail nga 20 shkurt 2024), veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 43/2023 "Për qeverisjen elektronike", Neni 17/b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.36-38 të Raportit të Auditimit).*

**21.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të marrë masa që specialistët e lejeve mjedisore të aplikojnë në *sistemin e-albania*, për tu pajisur me nënshkrim elektronik, me qëllim plotësimin e strukturës së dokumentit elektronik.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

#### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Specialistët e lejeve mjedisore dhe VNM-ve: zj.F. Z., z.T. Z., z.K. L., J. V., zj.S. T. dhe z.E. B. (tashmë i emëruar në një sektor tjetër që prej datës mars 21.03.2025) janë pajisur me nënshkrim elektronik. Z.B. F. është në proces për pajisjen me nënshkrim elektronik. Bashkëlidhur shkresa nr.3549 prot., datë 18.12.2024 "Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH për Sektorin e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve."

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Statusi: **i pranuar, në proces zbatimi.**

**22.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 43 praktikave për leje mjedisi Tipi A/B, janë dhënë mendime pozitive nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të përcjella Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe pse rezultojnë me mangësi në dokumentacion.

-Gjithashtu për 17 aplikime është tejkalluar afati 10 ditor për dhënien e mendimit, veprime në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja", Kreu III, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.38-52 të Raportit të Auditimit).*

**22.1.Rekomandimi:** Sektori i Lejeve pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të rishqyrtojë dokumentacionin për dhënie mendimi Leje Mjedisore të Tipit A/B, për 43 rastet e trajtuara në Raportin e Auditimit, në respektim të kriterëve dhe afateve të legjislacionit në fuqi dhe në përfundim të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Lidhur me gjetjen nr.22 dhe rekomandimin nr.22.1, faqe 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit ju bëjmë me dije se bazuar në legjislacionin mjedisor në fuqi ashtu siç e kemi paraqitur edhe në observacionet tona ndaj Projekt-Raportit të Auditimit, shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e aplikimit për Leje Mjedisore Tipi A/B është kompetencë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, e cila pas verifikimit të saktësisë së tij dhe mbledhjes së mendimeve të publikut dhe institucioneve të konsultuara (një ndër të cilët është edhe ARM) vijon me hartimin e akt miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit shoqëruar me argumentet përkatëse dhe e dërgon tek ministri. Lidhur me këtë rekomandim ju ritheksojmë se e kemi kundërshtuar si gjetje në të gjitha hallkat e procesit, duke filluar që nga akt-konstatimet e lëna nga grupi i auditimit dhe projekt-raporti. Për më tepër shkresa nr.3549 prot., datë 18.12.2024 "Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH për Sektorin e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve".

***Nga ana e subjektit ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë, sipas shkresës me nr.2241, datë 29.08.2025, (administruar në KLSH me nr. 684/35, datë 0309.2025), janë dërguar këto objeksione, si më poshtë trajtuar:***

Referuar shkresës me nr.684/1 prot., datë 01.08.2025 me lëndë "Dërgohet Projekti Raporti i Auditimit", protokolluar me tonën me nr.2062 prot., datë 04.08.2025, ju bëjmë me dije se:

Në Projekt Raportin e Auditimit Tematik të vënë në dispozicion nga grupi auditues në përfundim të periudhës së auditimit për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë me objekt "Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduar nga Departamenti i Auditimit të Performancës në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024", referuar gjetjes nr.22 të auditimit trajtuar në faqen 24 të Projektit Raportit, ju bëj me dije se procedura e dhënies së mendimeve për Leje Mjedisore Tipi A/B për aplikimet e ardhura pranë ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë është në përputhje me: Ligjin Nr.10 448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar; Ligjin Nr. 52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10 448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", të ndryshuar; VKM Nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore të Tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja", të ndryshuar.

Lidhur me gjetjen nr.22 (faqja 24 e Projekt Raportit) të grupit të auditimit mbi aplikimet e Lejeve Mjedisore dhe mendimet përkatëse ku u rinxorën këto konkluzione nga grupi i auditimit: "Nga auditimi rezultoi se mendimet për leje mjedisore Tipi A dhe B nuk janë dhënë konform legjislacionit mjedisor. Të gjitha praktikat e audituara kane qenë me mangësi në dokumentacion dhe pavarësisht kësaj, mendimet e ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë janë dhënë pozitive, veprime këto që bien ndesh me VKM Nr.419, datë 25.06.2014 dhe me pikë 5 dhe 9, kreun VII të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr.120 prot, datë 12.01.2021 "Rregullore e brendshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" " sqarojmë se dhënia e mendimit për aplikimet për leje mjedisore të Tipit A dhe B nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë bazohet në Ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, Ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar, si dhe VKM Nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të

posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të Tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishtme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në Iëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja", të ndryshuar, jep mendimin e vet mbi aplikimet për leje mjedisi të Tipit A dhe B, konkretisht Kreu II "Procedurat për shqyrtimin e kërkesave dhe përcaktimi i kushteve për leje mjedisi të Tipit A, Pika 2 c: "2.AKM-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit për leje mjedisi të Tipit A nga QKL-ja, dërgon një kopje të aplikimit institucionet e mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre, me shkrim dhe në formë elektronike, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune: c) Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM)" Ky vendim në asnjë pikë të vetëm nuk i dikton në formë taksative ARM-së si institucion të cilit i kërkohet mendim, shprehjen e një mendimi pozitiv apo negativ në përmbajtjen e vet.

Po, në këtë Vendim, Kreu II, Pika 4 "AKM-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të tipit A dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të tipit A, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri" dhe Kreu III, Pika 4: "AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune, pas verifikimit për saktësinë e dokumentacionit të aplikimit për lejen e mjedisit të Tipit B dhe mbledhjes së mendimeve nga publiku e institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij kreu, harton aktin e miratimit/refuzimit për dhënien ose jo të lejes së mjedisit të Tipit B, të shoqëruar me argumentet përkatëse, dhe e dërgon tek ministri."

Për sa më sipër është kompetencë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi i saktësisë së tij në aplikimin për leje mjedisi të Tipit A/B. ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë bazuar në legjislacionin mjedisor, ka përmbushur detyrimet e veta ligjore që rrjedhin prej tij duke shprehur dhe pasqyruar objektivisht në dhënien e mendimeve të veta, gjendjen reale dhe faktike të situatës së evidentuar në momentin e kryerjes së verifikimit në terren. Rast pas rasti, janë dhënë komente dhe sugjerime në përmirësim të situatës. Pra ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë në mendimet e veta nuk shprehet pozitivisht apo negativisht por bën konstatimin e faktit në terren dhe sipas rastit jep sugjerimet përkatëse.

Lidhur me *rekomandimin nr.22.1*, faqja 24: Sektori i Lejeve pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të rishqyrtojë dokumentacionin për dhënie mendimi Leje Mjedisore të Tipit A/B, për 43 rastet e trajtuara në Raportin e Auditimit, në respektim të kriterëve dhe afateve të legjislacionit në fuqi dhe në përfundim të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, ku qëndrimi i audituesve të KLSH-se mbi statusin e rekomandimit cilësohet si i pranuar, por i pazbatuar, ju bëjmë me dije se nga Sektori i Lejeve pranë ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë kjo gjetje është kundërshtuar në të gjitha hallkat e procedurës së auditimit, duke nisur që nga observacionet ndaj akt konstatimeve, projekt raportit e raportit përfundimtar, sic u është vendosur në dispozicion grupit auditues.

Për të 43 rastet e trajtuara nga grupi i auditimit për të cilat kanë lënë rekomandim mbi rishqyrtimin e tyre nga ana jonë dhe njoftimin e AKM-së për këtë fakt, ju cilësojmë se kjo do të ishte inefektive dhe nuk do të sillte një vlerë të mirëfilltë në përmirësim të faktit, duke qenë se AKM-ja për të gjitha rastet e trajtuara, ka dalë me një vendim në respektim të kriterëve dhe afatave ligjore, pra ka zbardhur aktet përkatëse (bëhet fjalë për periudhën 2021-2023), qoftë akt miratim apo akt refuzim. Për më tepër, rishqyrtimi i dokumentacionit nga ana jone nuk do të kishte fuqi prapavepruese pasi procedura e plotë është zhvilluar në të gjitha hallkat e saj, duke përfshirë dhënien e mendimit për Leje Mjedisit Tipi A/B dhe përcjelljen e tij pranë AKM-se si dhe marrjen parasysh të këtij mendimi gjatë fazës së shqyrtimit të dosjes së aplikimit për leje mjedisi në komisionet përkatëse të ngritura nga organi kompetent, pra Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Gjithashtu, nga ana procedurale nuk do të ishte e mundur zbatimi i këtij rekomandimi vetë për faktin se është ezauruar shqyrtimi i dosjeve me një numër unik aplikimi LC si dhe afatet ligjore të cilat kanë përfunduar, që prej vitit 2021 deri në 2023. Ju theksojmë se në ndryshim nga sa është shprehur grupi i auditimit mbi dhëniet e mendimeve për leje mjedisi të ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë për 43 rastet e sipërpërmendura, të cilat i ka cilësuar si "pozitive", institucioni ynë në keto mendime nuk shprehet pozitivisht apo negativisht, por bën konstatimin e faktit në terren dhe sipas rastit jep sugjerimet përkatëse.

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Sipas Rregullores së Brendshme me nr. 120 prot., datë 12.01.2021 "*Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit*", (nëpunësit e ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë janë njohur me rregulloren e AKM nëpërmjet email, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit), në detyrat funksionale të sektorit të lejeve mjedisore është rishikimi i dokumentacionit mbështetës të kërkesës për leje mjedisore dhe kërkimi i informacionit shtesë nëse del e nevojshme gjatë aplikimit.

Ndërsa për sa i përket rekomandimit 22.1, grupi i auditimit ka trajtuar 43 praktika (në raportin përfundimtar të auditimit), të cilat kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion. Ndërkohë, për këto praktika, mendimi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë ka qenë pozitiv.

**Statusi: i pranuar, i pazbatuar.**

**23.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë për periudhën janar 2021 - dhjetor 2023 ka dhënë mendime për VNM paraprake/ të thelluar dhe për leje mjedisore të Tipit A, B duke i përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Si palë e përfshirë në proces, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë nuk ka marrë informacione për vendimet e marra nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, veprime në kundërshtim me Rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr. 120 prot., datë 12.01.2021, kreu II.V pika 9, faqe 45-56. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.39-47 të Raportit të Auditimit*).

**23.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të kërkojë informacione periodike nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për vendimet e marra për VNM paraprake / të thelluar të Tipit A/B dhe të bëjë përditësimin e tyre në Regjistrin Elektronik të lejeve të tipit A/ B dhe VNM-ve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Lidhur me gjetjen nr.23 dhe rekomandimin nr.23.1, faqe 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit ju bëjmë me dije se sektori i lejeve mjedisore dhe VNM-ve ka hartuar një shkresë drejtuar AKM-së mbi zbatimin e këtij rekomandimi. Për më tepër shkresa nr.3549 prot., datë 18.12.2024 "Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për Sektorin e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve". Bashkëlidhur gjeni informacionin e fundit periodik të dërguar nga AKM-ja.

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka shqyrtuar korrespondencën

në rrugë elektronike të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, në muajin maj 2025, duke i vendosur në dispozicion databazën e lejeve dhe VNM-ve, të lëshuara deri në prill 2025.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**24.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në 32 raste raportet e posaçëm (procesverbali) nga ana e specialistëve të ARM-së Fier, Vlorë, Gjirokastrë, nuk janë mbajtur në ditën që është zhvilluar dëgjesa më publikun, por është dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit pas 10-20 ditësh nga zhvillimi i procedurës, veprime në kundërshtim me Rregulloren nr.1, datë 03.03.2017 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit “*Për zbatimin e procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*” pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.57-60 të Raportit të Auditimit).

**24.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të marrë masat për respektimin e afateve kohore, në përgatitjen e raportit të dëgjësës me publikun.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Lidhur me gjetjen nr.24 dhe rekomandimin nr.24.1, faqe 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, ju bëjmë me dije se këtë gjetje e kemi kundërshtuar pasi mbajtja ose protokollimi i raportit të dëgjësës (*procesverbalit*) në ditën që është zhvilluar dëgjesa referuar qëndrimin të grupit auditues, nuk është detyrim ligjor i përcaktuar në bazën ligjore me anë të së cilës rregullohet veprimtaria e institucionit tonë në tërësi dhe sektorit tonë në veçanti. Megjithatë në vijimësi sektori ynë ka përshpejtuar afatet në protokollimin e raportit të dëgjësës brenda afatit 5 ditor. Për më tepër shkresa nr.3549 prot., datë 18.12.2024 "Mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH për Sektorin e Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve".

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit, konkretisht grupi i auditimit ka shqyrtuar 2 subjekte dhe rezultoi se dokumentacioni është në përputhje me legjislacionin në fuqi: subjekti “V.” sh.p.k, “I.” sh.p.k.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inventarizimit të pronës shtetërore u konstatua se, për asnjë vit të periudhës audituese nuk është kryer inventarizimi i aktiveve dhe pronës publike për Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastrë, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr.32-39 të Raportit të Auditimit).

**25.1.Rekomandimi:** Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim më përgjegjës të Sektorit të Shërbimit dhe Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve, dhe paraqitjen e saktë të tyre në pasqyrat financiare të njësisë. Nëpunësi zbatues të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrimit të aktiveve të institucionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Sipas rekomandimeve të KLSH-së, kemi ngritur Komisionin e Inventarëve me shkresën me nr. 3178, datë 25.10.2023. Ky Komision ka filluar punën për inventarizimin dhe në përbërjen e tij janë gjithë Përgjegjësit e Sektorëve.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, rezulton se *janë marrë pjesërisht masat për zbatimin e rekomandimit, mirëpo janë ndaluar përpjekjet për finalizimin e tij.*

Bazuar në shkresën nr. 3178, datë 25.10.2023 (Urdhër i Brendshëm nr. 22, datë 25.10.2023) nënshkruar nga ana e ish-Drejtorit të ARM-së z.D. V., është ngritur Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve të ARM-së Fier me këtë përbërje: A. H. - Kryetar; A. B., I.M., K. L. dhe A. G. - anëtarë.

Procesi i inventarizimit ka zgjatur jashtë afateve ligjore dhe është finalizuar me procesverbalin me nr. 3411, datë 05.12.2024. Në praktikat e vendosura në dispozicion të audituesve të KLSH-së mungojnë nënshkrimet e magazinierëve në çdo rast dhe procesverbalet e inventarizimit. Në urdhrin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të ARM-së nuk është përcaktuar afati i përfundimit të inventarizimit. Nuk është kryer vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale dhe nuk është hartuar raportit përfundimtar mbi sqarimin e procedurës sipas përcaktimeve të paragrafit nr. 85/ c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, që kërkon nga Komisioni, (cituat): *”Të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues”.* Konstatohet se nuk është vijuar me procedurat e nxjerrjes nga përdormi të aktiveve të amortizuara dhe të dëmtuara që janë jashtë funksionit.

Statusi: **i pranuar, zbatuar pjesërisht.**

**26.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi kryer në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, mbi rregullshmërinë e veprimeve në magazinë rezultoi se: detyra e magazinierit prej krijimit të njësisë e në vazhdim me urdhër të titullarit të njësisë i është deleguar 4 punonjësve me pozicion specialistë në Sektorin e Monitorimit dhe Lejeve, në moszbatim me Rregulloren Nr.120 prot., datë 12.01.2021“, pika 4,13 ku përcakton qartë se detyra e magazinierit është përfshirë në detyrat funksionale të specialistit të Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivë -Magazinë.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave hyrje-dalje në magazinë rezultoi se gjendja fizike në mbyllje të vitit 2022 paraqitej në vlerën 560,187 lekë, e cila rakordon me gjendjen kontabël (të bërë sipas fletëhyrje-fletëdalje të vitit 2022) dhe nuk rezulton e pasqyruar në bilanc, veprime në kundërshtim UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.82-84 të Raportit të Auditimit).

**26.1.Rekomandimi:** Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të ngarkojë me detyrën e magazinierit specialistin e Burimeve Njerëzore ose të Protokoll-Arkiv si dhe dokumentimi i hyrjeve-daljeve në magazinë të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore të kontabilitetit në menaxhimin e aktiveve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Lidhur me rekomandimin nr.27.1, për plotësimin e vendeve vakant, theksojmë se me shkresën Nr.2858, datë 16.10.2024, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë e Gjirokastrë, ka ardhur struktura e re e Institucionit. Kjo strukturë është e përberë nga 35 specialistë me statusin e Nëpunësit Civil, plus dy punonjës me kontrate. Sot që po ju kthejmë përgjigje ne si institucion kemi vetëm 3 (tre) vende vakant.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (*personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve*) rezultojnë se janë ndjekur procedurat për zbatimin e rekomandimit, por ka patur vonesa në hartimin e praktikave shkresore dhe delegimin e kësaj detyre. *Më konkretisht,*

- Me Urdhrin nr.2, datë 22.02.2023, të ish-Drejtorit Rajonal të ARM, z.D. V., është ngarkuar punonjësi i Sektorit të Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, Z. G. Zh. të kryejë edhe detyrat e magazinierit për ARM-në.
- Për kryerjen e detyrës së magazinierit, specialisti i Burimeve Njerëzore ose Protokoll-Arkiv ka kërkuar të marrë trajnimin e nevojshëm, për të cilën nga ana e ARM-së është komunikuar me AKM për ndërtimin e një grafiku për trajnimin mbi aspekte të tilla si, mbajtjen e librave dhe ditarëve të magazinës, rakordimi periodik i kartelave të magazinës, etj.
- Me Urdhrin nr.19, datë 08.07.2025, të Drejtorit Rajonal të ARM z.A. T., është ngarkuar znj.P. V., me detyrë specialiste e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Magazinës, me kryerjen e detyrës së magazinierit. Ka filluar puna që së bashku me Komisionin e Kalimit të Inventarit tek magazinieri, (ngritur me urdhrin nr. 20, datë 03.07.2025 të Drejtorit të ARM-së, me përbërje A.H., F.Z. dhe A.Gj.), të verifikojë gjendjen fizike të aktiveve në magazinë dhe ti pasqyrojë në procesverbalin e përbashkët, brenda datës 11.7.2025.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**27.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i të dhënave, në lidhje me strukturën e miratuar sipas Urdhrit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*”, Rregullores nr.120 prot, datë 12.01.2021, rezultojnë se: Në fund të vitit 2021, struktura paraqitet me realizim në masën 87,5% dhe numri i vendeve të lira 6; në fund të vitit 2022, struktura paraqitet me realizim në masën 75% dhe numri i vendeve të lira 12; në fund të vitit 2023 struktura paraqitet me realizim në masën 69% dhe numri i vendeve të lira 15, pra kjo drejtori ka vepruar vetëm me rreth 77% të kapacitetit të saj, duke sjell ulje të efektivitetit dhe efikasitetit në punë për njësinë.

b) Në lidhje me auditimin e ushtruar për plotësimin e dosjeve të personelit, u përzgjedhën 15 dosje ku rezultoi se dosjet e personelit nuk kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit*” II. Dosja e personelit.- Nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen sipas inventarit si edhe mënyrës së mbajtjes pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.

-Për punonjësit e larguar mungonte akti i dorëzimit të dokumentacionit dhe punës përpara largimit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.85-89 të Raportit të Auditimit*).

**27.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrin masa për plotësimin e vendeve të lira të punës si dhe specialisti i burimeve njerëzore, të plotësojë mangësitë e dosjeve të personelit.

**Në vijimësi**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Lidhur me rekomandimin 27.1, për plotësimin e vendeve vakante, theksojmë se me shkresën nr. 2858, datë 16.10.2024, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, ka ardhur struktura e re e Institucionit. Kjo strukturë është e përberë nga 35 specialistë me statusin e Nëpunësit Civil plus dy punonjës me kontratë. Sot që po ju kthejmë përgjigje ne si institucion kemi vetëm 3 (tre) vende vakante.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (*personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve*), rezulton se janë marrë masa për zbatimin e rekomandimit, por kërkohet një impenjim i vazhdueshëm për plotësimin e pozicioneve vakante në ARM.

- Me shkresën e DAP nr. 2933, datë 22.05.2025, protokolluar në ARM me nr. 5868, datë 22.05.2025 është emëruar Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, z. **A. T.**
- Me shkresën e DAP nr. 1927, datë 19.03.2025, protokolluar në ARM me nr.3247 datë 20.03.2025 është emëruar Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të të Dhënave dhe Përpunimit të Informacionit, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë z. **E. B.**
- Me shkresën e DAP nr. 2095, datë 25.03.2025, protokolluar në ARM me nr.3736, datë 27.03.2025 është emëruar Specialistja e Financës në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë **znj.K. M.**

Statusi: **i pranuar, në proces zbatimi.**

**28.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi rregullshmërinë e listë prezencave, si dhe i përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë rezultuan parregullsi në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse, si më poshtë:

-Për vitin 2021, 2022 listë prezencat nuk janë nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit përkatës, ndërsa për vitin 2023 janë nënshkruar korrekt nga përgjegjësi i sektorit përkatës. Përmbledhësja e listë pagesave gjithashtu nuk është nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, duke shkelur përcaktimet e pikës 69 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2021, "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

-Llogaritja e përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar me raport mjekësor deri në 14 ditë, në disa raste nuk është bërë me 80% , sipas nenit nr.130 pika 1 të Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar dhe nenit 25, të ligjit nr. 7703, datë 11/05/1993, të ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 , faqe nr.85-87 të Raportit të Auditimit*).

**28.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të përllogarisë saktë përfitimet për paaftësi të përkohshme në punë, për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar kjo me raport mjekësor deri në 14 ditë, në çdo rast.

**Në vijimësi**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Përsa i përket rekomandimit nr.28.1 theksojmë se edhe sipas detyrave të KLSH-së në përgatitjen e borderove të pagave dhe listë-pagesave, prezencat bëhen dhe firmosen nga çdo përgjegjës Sektori dhe pastaj bëhet listë-prezenca përmbledhëse. Po kështu, edhe pagesat për paaftësi dhe raporte –

mjekësore bëhen nga institucioni për 14 ditë dhe pjesa tjetër për në sigurimet shoqërore bëhet elektronikisht.

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (nëpunësi zbatues dhe sektori i burimeve njerëzore), rezultoi se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Nga ana e grupit të auditimit u testuan me zgjedhje 3 (tre) raste të pagesave të kryera për përfitimet afatshkurtra, dhe u konstatua sa vijon:

- Për **znj. K. M.**, përlllogaritur në masën 80 %, periudha 02.05.2025 deri 04.07.2025, bazuar në tarifën e aplikuar, sipas kolonës nr.10, me emërtim “% e llogaritjes së përfitimit”, të Formularit PP-1 të depozituar në Agjencinë Rajonale të ISSH Fier;
- Për **znj. L. K.**, përlllogaritur në masën 80 %, (raporti 1533/1916 ku kjo e fundit është baza e vlerësuar), periudha 30.11.2022 deri 30.12.2022, bazuar në tarifën e aplikuar, sipas kolonës nr 10, me emërtim “% e llogaritjes së përfitimit”, të Formularit PP-1 të depozituar në Agjencinë Rajonale të ISSH Fier;
- Për **z.A. H.**, përlllogaritur në masën 80 %, (raporti shumë së përlllogaritur kundrejt bazës së vlerësuar, 1533 lekë /1916 lekë), periudha e testuar 28/10/2022 deri 27/11/2022, tarifa e aplikuar është 2085 lekë që është paga ditore x 80% = 1668 lekë x 22 ditë= 36,696 lekë, edhe bazuar në tarifën e aplikuar, sipas kolonës nr. 10, me emërtim “% e llogaritjes së përfitimit”, të Formularit PP-1 të depozituar në Agjencinë Rajonale të ISSH Fier;

U testua nëse janë kryer nënshkrimet në listë pagesat e kaluara në Degën e Thesarit dhe për listë pagesën e muajit Qershor 2025, (kaluar në degën e Thesarit Fier), evidentohet se listë pagesa është nënshkruar nga Sektori i Financës (z. P. T.), nga Sektori i Burimeve Njerëzore (zj. P. V.) dhe nga Drejtori i ARM-së Fier, Vlorë, Gjirokastrë, z. A.T.

Statusi: **i pranuar, i zbatuar plotësisht.**

**29.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 14 procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në 13 prej tyre, të realizuara në rrugë shkresore kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion:

-në 6 raste mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim, ndërsa në 7 raste të tjera procesverbalet përkatëse nuk janë të nënshkruara, nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim, kjo në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, pikat 43,47,54.

Si edhe 1 procedurë e prokurimit publik e realizuar në sistemin elektronik rezultoi se kriteret e përgjithshme dhe specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit 162/2020 “*Për prokurimin publik*” si dhe të VKM-së nr.285 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”.

**29.1.Rekomandimi:** Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të ngrejë grup pune për analizimin e **14 rasteve në shkëlqje të proceduarve të prokurimit me blerje të vogël**, nëpërmjet rivlerësimit të dokumentacionit, për të siguruar në vijueshmëri përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret në fuqi dhe të propozoj masa konkrete për anëtarët e komisionit të prokurimit.

**29.2.Rekomandimi:** Titullari i Institucionit të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve që zhvillon ASPA, me qëllim përmirësimin e punës së Njesisë së Prokurimit për hartimin e dokumentacionit dhe zbatimin e procedurave konform rregullave të prokurimit publik.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Lidhur me Rekomandimin 29.1 dhe 29.2 theksojmë se janë rikontrulluar të gjitha Procedurat e Prokurimit me Vlerë të Vogël, dhe janë nisur disa shkresa të shkolla të administratës publike (ASPA) dhe ka filluar trajnimi për njësinë e prokurimit.

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë pjesërisht masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

**Në lidhje me rekomandimin nr.29.1:** Nga ana e titullarit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, deri në datën e kryerjes së auditimit në këtë institucion nuk ishte ngritur grup pune për analizimin e 14 rasteve të pasqyruara në Raportin e Auditimit me shkelje të procedurave të prokurimit me blerje të vogël, nëpërmjet rivlerësimit të dokumentacionit, për të siguruar në vijueshmëri përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret në fuqi dhe për rrjedhojë nuk janë propozuar masa konkrete për anëtarët e komisionit të prokurimit.

Sipas informacioneve të dërguara nga ARM përmes emailit zyrtar, rezulton se sipas urdhrimit nr.21, datë 17.07.2025 të Drejtorit të ARM z.A. T. është ngritur Grupi i Punës sipas gjetjes nr. 29 dhe rekomandimit nr. 29.1 të raportit Përfundimtar dhe përfundimeve të KLSH-së me përbërje: z.K. L, z.L.I. dhe z.G.Zh. për analizimin e 14 rasteve të mësipërme nëpërmjet analizimit të dokumentacionit. Sa më sipër, grupi punës ka hartuar Raportin me nr. 1974/1 datë 21.07.2025 “Raport përfundimtar i grupit të punës për analizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në zbatim të urdhrimit të brendshëm nr.21, datë 17.07.2025”, të cilin ia ka dërguar Drejtorit të ARM-së, i cili në përputhje me rekomandimin e KLSH-së, duhet të procedojë me marrjen e masave konkrete për anëtarët e komisionit të prokurimit.

Statusi: **i pranuar, në proces zbatimi.**

**Në lidhje me rekomandimin nr.29.2:** Nga verifikimet del se nga ana e Institucionit është mbajtur një korrespondencë me APP dhe ASPA për trajnimin e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve që zhvillon ASPA, në ndjekje të kërkesave të shkresës së APP me nr 6067 prot datë 03.09.2024 dërguar Autoriteteve/Enteve Kontraktore.

Referuar korrespondencës shkresore të mbajtur me APP dhe Ministrinë e Turizmit (*e-mail-et përkatës të datave 3.9.2024, 4.9.2024, 26.9.2024*) janë dërguar emrat e personave të ngarkuar me realizimin e procedurave të prokurimit publik në ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë dhe po ndiqen në vijimësi procedurat për ndjekjen e trajnimeve me qëllim përmirësimin e punës së Njesisë së Prokurimit për hartimin e dokumentacionit dhe zbatimin e procedurave dhe të rregullave të prokurimit publik.

Statusi: **i pranuar, në proces zbatimi.**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nga Titullari i Institucionit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, sipas rasteve. Nëpunësi zbatues të

ndjekë procesin dhe të bëjë sistemimet e veprimeve ekonomike për detyrimet e dëmit në vlerën **860,524 lekë**, e cila vjen nga:

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve me bankë kanë rezultuar shkelje dhe parregullsi të kuadrit ligjor përkatësisht, si më poshtë:

1. Në shumën e përllogaritjeve për pagën e z. M. H., rezulton se është paguar **16,398 lekë** më shumë se sa duhet. Kjo diferencë duhet të rikthehet në llogarinë e institucionit, në mosrespektim me Udhëzimin Nr. 1, datë 21.05.2021 “Për formën, elementët dhe plotësimin e liste pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 13.

2. Në periudhën 2021-2023, janë likuiduar gjoba në shumën e 80,000 lekë (16x5,000 lekë) për deklaram të vonuar të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të gjeneruara automatikisht nga sistemi elektronik i tatimeve. Shuma prej **80,000 lekë** ka rënduar padrejtësisht buxhetin e institucionit, pasi vjen si rezultat i neglizhencës së NZ dhe duhet të kthehet në llogarinë e institucionit, veprim ky në kundërshtim me Nenin 35 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. (sipas tabelës anekse nr.36).

3. Janë likuiduar detyrime të prapambetura për energji elektrike për periudhën 2020-2023 në shumën 614,107 lekë, nga e cila shuma prej 139,532 lekë rezulton kamatë vonesë. Likuidimi i tyre është rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve ligjore për pagesën e detyrimeve për energji elektrike, siç parashikohet në pikën 151 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", dhe në Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", pika 3, Shuma e kamatës **139,532 lekë**, konsiderohet dëm dhe duhet kthyer në llogarinë e institucionit, përgjegjësi e së cilës janë drejtori aktual, z. D. V. dhe përgjegjësi e financës, z. P. T.

4. Janë likuiduar detyrime për marrje ambienti me qira në shumën **66,000 lekë** (56,600 lekë detyrim+9,900 lekë Tatim i mbajtur në burim) sipas Kontratës së qirasë nr.1036 prot., datë 28.07.2020 për një ambient, mjedis pune në Gjirokastrë, e cila nuk përmbush elementët ligjorë të një kontrate të vlefshme, pasi nuk është nënshkruar nga pala qiradhënëse, në kushte të mosrespektimit të nenit 801 të Kodit Civil. Gjithashtu likuiduar edhe tatimi i mbajtur në burim, ndërsa neni 11 i kontratës e përcakton si detyrim të palës qiradhënëse. Nuk konfirmohet të jetë lidhur kontratë tjetër pas kësaj dhe pagesa nga sektori i financës ka vazhduar deri në vitin 2021. (sipas tabelës anekse nr.37).

5. Janë paguar shpenzime udhëtimi në shumën **137,800 lekë** si pasojë e mënyrës së llogaritjes gabim dhe mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (pa aktkontroll/procesverbal konstatimi), në kundërshtim me Nenin 4, pika 26 e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, (sipas tabelës anekse nr.39). (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.88-89 të Raportit të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të arkëtojë detyrimet për z. M.H. në vlerën 16,398 lekë; z. P. T. në vlerën 215,766 lekë; z. D.V. në shumën 69,766 lekë dhe vlerën prej 137,800 lekë (19 persona sipas tabelës anekse) të cilat në total arrijnë në vlerën prej **439,730 lekë**.

*Menjëherë*

### **Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Përsa i përket pjesës së masave për shpërblim dëmi theksojmë si më poshtë vijon:

Me datën 04.09.2024 ka dalë Urdhri i Drejtorit të Institucionit me Nr. Protokolli 2273, datë 04.09.2024, “Për ngritjen e komisionit të verifikimeve të zbatimeve të rekomandimeve të KLSH-

së”, i përbërë nga dy juristë dhe një financier. Mbas këtij komisioni, titullari i Institucionit, ka nxjerrë shkresën me nr. protokollit 3619, datë 23.12.2024 mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Më tej, është vazhduar me Urdhrin Nr.34, datë 26.12.2024, mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së. Në datën 20.02.2025 me numër protokollit 489, Drejtori i Institucionit ka nxjerrë Urdhër për bashkërendimin e punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Sipas këtij urdhri, Sektori i Financës ka bërë në datën 21.02.2025 dhe me Nr. Protokollit: 502 deri 517, lajmërimin shkresërisht të punonjësve dhe pastaj “Marrëveshjet mbi rikthimin e shumave të identifikuara nga KLSH”, për 19 specialistët, sipas listës emërore të raportit të KLSH-së, për vlerën 137.800 lekë.

Theksojmë se, në marrëveshjet për rikthimin e shumave, personat e poshtëshënuar: D. V., P. T., A. Gj., B. D. dhe M. H., kanë kundërshtuar për vlerat si më poshtë:

- D. V. kundërshton vlerën prej 210.031 lekë,
- P. T. kundërshton vlerën prej 355.990 lekë.
- A. G. kundërshton vlerën prej 13480 leke.
- B. D. kundërshton vlerën prej 140265 lekë dhe
- M. H. vlerën prej 16398 lekë.

#### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion si dhe shpjegimeve të dhëna nga ana e Institucionit, rezulton se ka patur **qëndrime dhe veprime kontradiktore** për sa i takon zbatimit të rekomandimit. *Më hollësisht,*

Nga verifikimet e kryera dhe referuar shkresës së ARM Fier, Vlorë e Gjirokastër me **nr.1458 prot, datë 19.05.2024**, (drejtuar KLSH dhe AKM Tiranë), rezulton se, nga ana e Nëpunësit Zbatues janë hartuar Akt Marrëveshjet sipas listës emërore të punonjësve që shoqëron Raportin Përfundimtar të Auditimit për masat e shpërblimit të dëmit në shumën totale prej 860,524 lekë. Në shkresë përcaktohet se **“në rakordim dhe me AKM dhe duke u mbështetur edhe në Akt Marrëveshjet me çdo specialist kemi rënë dakord që të gjitha vlerat të ndalohen nga paga për çdo muaj”**.

Lidhur me këtë procedurë kemi edhe Akt-Marrëveshje ku specialistët nuk janë dakord me vlerat e dhëna për shpërblim dëmi nga ana e KLSH. Kjo është e qartë nga ana juaj edhe nga Observacionet e dërguara në KLSH. **vlera që kundërshtohet është:**

1.për specialistin **M. H.**, për vlerën 16,398 lekë pasi kjo është për vjetërsi;  
2.pagesa nga specialisti e financës **P. T.** për gjoba nga tatimet në shumën e 80,000 lekë, kundërshtohet se duke ndërprerë kontratën e qirasë nuk e dija që duhet tatimi në burim zero.

3.specialisti i financës **P. T.** kundërshton vlerën prej 139,532 lekë që është vlera e kamatëvonesave të OSHEE pasi VKM nr 54, datë 25.02.2020 u bashkuan tre ish DRM Fier, Vlorë dhe Gjirokastër me tre ish-inspektoriatet Fier, Vlorë dhe Gjirokastër, në një NIPT të vetëm. Si rrjedhim, kjo vlerë e OSHEE nuk u pagua e gjitha brenda vitit 2021duke u paguar më 5 Janar 2022. *Duke iu referuar dhe urdhrave të prokurimit shohim se titullari i institucionit riparoi makinën e vetme të institucionit dhe për 6 mujorin e dytë 2021 zëri 602 rezultoi zero.*

4. Po kështu, specialisti i financës **P. T.** kundërshton edhe sipas observacionit dërguar KLSH-së, vlerën prej 66,000 lekë për qiranë e zyrave në Gjirokastër, pasi përveçse ekziston kontrata e lidhur midis AKM, pronarit dhe drejtorit J. V., por unë dhe qiramarrësi kemi një kontratë noteriale me datë 31.05.2024 tek Noteri në Gjirokastër, në të cilën, qiramarrësi S. Rr. deklaroi se nëpërmjet bankës ka marrë këtë vlerë.

Pavarësisht kundërshtimeve të dërguara në rrugë shkresore nga ana e zyrtarëve të ARM-së, nga auditimi i dokumentacionit dhe shqyrtimi i të dhënave të partitarit të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, del se, **në fakt janë kryer kontabilizimet e detyrimeve për 21 persona**, për shumën totale të kësaj llogarie prej 932,704 lekë me datë 31.12.2024, shumë kjo në ngarkim të 21 personave, dhe u referohet rezultateve të dy Raporteve Përfundimtare të Auditimit, të dërguara në ARM, (përkatesisht në vitin 2018 dhe 2024), përkatesisht:

- I. Vlera sipas rekomandimit të auditimit të mëparshëm të KLSH-së, prej 83,180 lekë, (lënë nga Raporti i Auditimit të KLSH-së viti 2018), u përket 2 ish-punonjësve (2x41,590 lekë), të cilët rezultojnë të larguar para periudhës 2018 dhe konfirmohet se janë detyrime të pa likuiduara edhe gjatë periudhës së auditimit. Konstatohet se detyrimi është kontabilizuar për z.A. V. dhe z.E. L., (2 persona x 36,090= 72,180 lekë).
- II. Vlera sipas rekomandimeve të Raportit të Auditimit të KLSH-së të vitit 2024, prej 860,524 lekë, (e cila u përket 19 punonjësve, sipas kësaj ndarjeje: 19 persona për dieta 137,800 lekë; 56,100 për detyrime /qira; 9,900 lekë për tatim në burim; 80,000 lekë për gjoba në sistemin e Tatim-Taksave për vitet 2021,2022,2023 (referuar anakesit të RPA 2024).

Lidhur me detyrimet financiare të identifikuar nga raporti i KLSH-së dhe mënyrën e kthimit të shumave, nga ana e Sektorit të Financës të ARM-së janë hartuar njoftimet për secilin nga punonjësit e përmendur në Raportin e Auditimit, (shkresat me nr. 507, 518, 508, 505, 512, 510, 509, 502, 503, 514, 516, 513, 517, 519, 511, etj., datë 21.02.2025, nënshkruar nga ish-Drejtori z.D. V.).

Në listë-pagesën e muajit Qershor 2025, të kaluar në Degën e Thesarit Fier, ka filluar kryerja e ndalesave sipas detyrimeve që burojnë nga konkluzionet e auditimit të KLSH-së. Më hollësisht, Nëpunësi Zbatues z.P. T., nga kolona “Ndalesa page për zhdëmtim ndaj institucionit sipas legjislacionit në fuqi”, ka kryer ndalesa për 13 persona në shumën 14,000 lekë, rekomandim i filluar të zbatohet gjatë periudhës së auditimit të zbatimit të rekomandimeve.

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet pavarësisht qëndrimeve të subjektit, është kontabilizuar dhe ka filluar procedura administrative dhe vijon në proces zbatimi.

**Statusi: i pranuar, në proces zbatimi.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për furnizimin me karburant në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë për periudhat 2021-2022 rezultuan parregullsi si më poshtë:

-Mungesë e dokumentacionit të plotë vërtetues dhe të rregullt (fletëhyrje dhe fletëdalje) si dhe të pashoqëruara me dokumente justifikuese, në kundërshtim me kërkesat ligjore në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësite sektorit Publik”, i ndryshuar, pikat 37,38.

-Për vitin 2022, sasia 1,772 litra karburant (naftë), në vlerë 420,794 lekë, është e pajustificuar me dokumentacion vërtetues, fletë udhëtim, veprime në kundërshtim me pikën 36 të UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke shkaktuar dëm financiar dhe duhet kthyer në buxhetin e shtetit.(sipas tabelës Anekse nr. 43), (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.89-92 të Raportit të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të arkëtojë shumën në total **420,794 lekë** për përdorim të karburantit (naftë), e pajustificuar me dokumentacion vërtetues,

fletudhëtim, nga z. D. V. në cilësinë NA, z. P. T. në cilësinë NZ dhe z. B. D. me detyrë shofer në strukturën organizative.

*Menjëherë*

**Përgjigje e Agjencisë Rajonale të Mjedisit:**

Përsa i përket pagesës së naftës me vlerë 420,794 lekë sipas dhe observacioneve që ju kemi nisur më parë ju theksojmë se kjo sasi është e dokumentuar dhe e përdorur për gjithë vitin 2022.

**Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) si dhe nga verifikimet e kryera dhe referuar shkresës së ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë me nr.1458 prot, datë 19.05.2025, (drejtuar KLSH dhe AKM Tiranë), del se, nga ana e nëpunësit zbatues janë hartuar Akt Marrëveshjet sipas listës emërore të punonjësve që shoqëron Raportin Përfundimtar të Auditimit për masat e shpërblimit të dëmit në shumën totale prej 860,524 lekë. Në shkresë përcaktohet se *“në rakordim dhe me AKM dhe duke u mbështetur edhe në Akt Marrëveshjet me çdo specialist kemi rënë dakord që të gjitha vlerat të ndalohen nga paga për çdo muaj”*.

Lidhur me këtë procedurë janë vendosur në dispozicion të audituesve Akt-Marrëveshjet e nënshkruara. Sipas observacioneve të dërguara në KLSH vlera që kundërshtohet është për furnizimi me karburant nga z. D.V., B.D. dhe P.T., të cilët kundërshtojnë pagesën e vlerës prej 420,794 lekë pasi *“sasia e naftës prej 772 litra që është harxhuar nga 5 maj 2022 deri më 31 dhjetor 2022 , figuron e bërë hyrje në magazinë, po ashtu edhe e bërë dalje dhe e shoqëruar me Fletët e Udhëtimit”*.

Lidhur me detyrimet financiare të identifikuar nga raporti i KLSH-së dhe mënyrën e kthimit të shumave, nga ana e Sektorit të Financës të ARM-së janë hartuar njoftimet për secilin nga punonjësit e përmendur në Raportin e Auditimit, (shkresat me nr. 507 e në vijim, datë 21.02.2025, nënshkruar nga ish-Drejtori z.D. V.).

Në kontabilitet, në llogarinë e debitorëve të ndryshëm, është përfshirë vlera e naftës së lënë për zhdëmtim, në shumën prej **420,795 lekë**, e cila u është ngarkuar:

- z. P. L., në shumën 140,265 lekë;
- z. B. D., në shumën 140,265 lekë dhe
- z. D. V., në shumën 140,265 lekë.

Statusi: **i pranuar, në proces zbatimi.**

**Observacione mbi Akt Verifikimin nr 1, datë 16.07.2025:**

Në lidhje me Akt Verifikimin e dorëzuar në ARM, janë dërguar kundërshtime ndaj aktit të konstatimit nr. 1, nga z.D. V., Inspektor i Mjedisit, (ish-Drejtor i komanduar i ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë), objeksione të dërguara grupit të auditimit nëpërmjet e-mailit zyrtar, me datë 25.7.2025, ora 11:39 AM, me këtë përmbajtje:

### *I. Historiku i informimit të trupës audituese*

*Gjatë të gjithë procesit të auditimit, në çdo observacion të paraqitur, kam vënë në dijeni trupën audituese.*

*Sqarimet janë bërë në mënyrë të vazhdueshme, të qartë dhe të mbështetura në:*

- Ligjin nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar*
- Ligjin nr. 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar*
- Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”*
- VKM-të, udhëzimet dhe urdhrat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*
- Rregulloren e Brendshme të AKM-së.*

### *II. Kundërshtim i pozicionit të individualizuar në aktin e konstatimit*

*Në mënyrë të veçantë, kundërshtoj qartësisht çdo konstatim apo propozim të bërë në emrin tim personal, që lidhet me*

- 1. Detyrimet financiare për energjinë elektrike – janë detyrime të trashëguara, jo të krijuara gjatë periudhës sime si*
- 2. Menaxhimi i karburantit – ka ndjekur të gjitha rregulloret përkatëse; është mbajtur dokumentacioni i kërkuar.*
- 3. Procesi i inspektimeve – është ndjekur sipas planeve të miratuara nga AKM.*
- 4. Administrimi financiar – është kryer nga sektori i financës sipas urdhërave dhe legjislacionit dhe drejtuesi nuk ka ushtruar detyra teknike.*
- 5. Zbatimi i detyrave funksionale si drejtues – është bërë në përputhje me rregulloren, me urdhra zyrtarë.*

### *III. Kërkesë për rishikim*

*Duke u bazuar në provat dhe argumentet e dorëzuara në proces, kërkoj që Akti i Konstatimit të rishikohet në mënyrë objektive.*

*Vlerësoj se çdo pretendim i adresuar individualisht ndaj meje është i pabazuar në fakt dhe në ligj.*

### *IV. Kundërshtim ligjor i masës disiplinore (“mbambajtje paga deri në 1/3”)*

#### *1. Lejet mjedisore dhe VNM*

*- Drejtori nuk shqyrton teknikisht dokumentacionin, por vetëm përcjell dokumentacionin e përgatitur nga sektori përkatës.*

*- Referenca ligjore: VKM nr. 419/2014, VKM nr. 686/2015, Rregullorja e AKM nr. 120/2021.*

#### *2. Inspektimet e perealizuara*

*- Janë detyrë e sektorëve përkatës dhe planifikohen nga AKM.*

*- Neni 7 dhe 16 i Ligjit nr. 10433/2011 dhe Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm.*

#### *3. Karburanti*

*- Drejtori nuk shpërndan manualisht karburant; çdo veprim dokumentohet nga magazinieri dhe shoferi.*

*- Referenca: Libri i karburantit, urdhra zyrtarë dhe procesverbale.*

#### *4. Pagesat e energjisë elektrike me kamatëvonesa*

*- Detyrime të trashëguara; paguar për të shmangur ndërprerjen e shërbimit po nga ish drejtuesi.*

*- Ligji nr. 9936/2008, neni 40/2: institucionet paguajnë detyrimet e trashëguara.*

#### *5. Dosjet e personelit dhe raportimet*

*- Dosjet administrohen nga HRMIS dhe specialisti i burimeve njerëzore.*

*- Drejtori ka nxjerrë urdhra për përmirësim sipas rekomandimeve të KLSH-së.*

#### V. Referenca ligjore mbështetëse

- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” – neni 58
- Ligji nr. 8485/1999 “Kodi i Procedurave Administrative” – nenet 100–103
- Rregullorja e AKM nr. 120/2021
- Ligji nr. 10433/2011 “Për inspektimin”
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”

#### VI. Përfundim

- Nuk ekziston përgjegjësi individuale për veprimet e pretenduara.
- Funksioni i drejtuesit nuk përfshin kompetenca teknike financiare, por vetëm ndjekje institucionale.
- Detyrat janë realizuar në përputhje të plotë me ligjin, rregulloren dhe urdhrat zyrtarë.
- Për periudhën e drejtimit tim (04.05.2022 – 22.05.2025), institucionit nuk i është adresuar asnjë masë ndëshkimore. Masat e propozuara nga KLSH nuk qëndrojnë dhe nuk përputhen me faktet apo përgjegjësitë ligjore.

#### Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Nga shqyrtimi i observacionit, audituesit e KLSH-së vërejnë se nga ana e ish-Drejtorit të ARM ngrihen pretendime mbi sistemin e dokumentacionit të mbajtur në procesin e auditimit të mëparshëm, procesi i cili është finalizuar sipas Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH-së. Konkluzionet e dërguara për auditimin e mëparshëm janë përfundimtare. Ky fakt i është bërë me dije disa herë z.D.V.. në takimet e zhvilluara me kërkesën e grupit të auditimit. Ky angazhim i auditimit ka për objekt verifikimin e zbatimit të rekomandimeve që lidhen me Raportin Përfundimtar të Auditimit, të dërguar zyrtarisht në institucionin e ARM-së.

Lidhur me sa pretendohet që “Akti i Konstatimit të rishikohet në mënyrë objektive”, bëjmë më dije se, çdo e dhënë dhe informacion i pasqyruar në Aktin e Verifikimit i referohet me korrektesë dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e zyrtarëve të atij institucioni, ndaj pretendimet janë të pa bazuara dhe nuk merren në konsideratë nga ana e grupit të auditimit të KLSH-së.

#### C. MASA DISIPLINORE

Referuar dokumentacionit të administruar nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit dhe ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, për zbatimin e rekomandimeve disiplinore (*dokumentet, shkresat apo çdo veprim tjetër zyrtar i ndërmarrë nga institucioni për të zbatuar rekomandimet e lëna*), është audituar ecuria e zbatimit të çdo rekomandimi / mase disiplinore.

Në zbatim të kompetencave të parashikuara në ligjin organik të KLSH-së si dhe përcaktimeve të pikës “D” të shkresës së KLSH-së me Nr.108/9 Prot., datë 26.06.2024, (*dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit Tiranë dhe protokolluar në këtë institucion me nr.7032 prot., datë 27.06.2024*), është kërkuar fillimi i procedurave për dhënien e këtyre **20 masave disiplinore** që janë sipas kësaj strukture:

- **12 masa disiplinore “vërejtje”** neni 58, pika a, e Ligjit nr. 153/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”,
- **4 (katër) masa disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”**, neni 58, pika b, e Ligjit nr. 153/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”,

- **4 (katër) masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, neni 58, pika ç, e Ligjit nr. 153/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”.**

*Më hollësisht,*

### **C. I. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE**

Mbështetur në nenin 58, të Ligjit nr. 153/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

#### **"Vërejtje", neni 58, pika a.**

Për mos zbatim të Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 7 dhe neni 16, në kundërshtim me Vendimin nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, pika 4/b. të Rregullores së brendshme së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, nr.120 prot; datë 12.01.2021 “Kreu II.V, pika 1 dhe 3 dhe Rregullores nr.01, datë 03.03.2017 "Për zbatimin e procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" lidhur me mangësitë në dokumentacionin në lejet mjedisore Tipi A dhe B, si më poshtë:

1. Për **z. J. V.**, me detyrë specialist i Sektorit të përpunimit të dhënave, i deleguar pranë Sektorit të lejeve mjedisore, për periudhën objekt auditimi.
2. -Për **zj.K. R.**, me detyrë specialiste e Sektorit të përpunimit të dhënave, e deleguar pranë Sektorit të lejeve mjedisore, për periudhën objekt auditimi.
3. -Për **z. G. Zh.**, me detyrë specialist i Sektorit të përpunimit të dhënave, i deleguar pranë Sektorit të lejeve mjedisore, për periudhën objekt auditimi.
4. -Për **z. A. G.**, me detyrë specialist i Sektorit të përpunimit të dhënave, i deleguar pranë Sektorit të lejeve mjedisore, për periudhën objekt auditimi.
5. -Për **z. A. H.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mjedisit.
6. -Për **z. E. Sh.**, me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.
7. -Për **z. A. C.**, me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.
8. -Për **Z. E. Z.**, me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.
9. -Për **z. L. I.**, me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.
10. -Për **z. E. B.**, me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.
11. -Për **z. I. M.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Natyrore Ujëra.
12. -Për **z. A. Xh.**, me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.

*(Trajtuara më gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pika 3 faqet 38-52 dhe pika 4 nga faqet 60-68 )*

#### **“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj", neni 58 , pika b.**

1. -Për **z. D. V.** me detyrë inspektor i Sektorit të Mjedisit, i komanduar si drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, për periudhën nga data 04.05.2022 e në vazhdim. Për problematikat e konstatuara në lidhje me dhënie mendimi për lejet mjedisore për mos zbatimin e kërkesave të VKM-së nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B” si dhe të VKM-së nr.686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të

ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”; të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Rregullores nr. 01, datë 03.03.2017 "Për zbatimin e procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" si dhe për mangësitë e konstatuara në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e sistemit financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

**2. -Për z. T. Z.,** me detyrë specialist për lejet mjedisore dhe VNM, lidhur me mangësitë e konstatuara lidhur me dokumentacionin për lejet mjedisore Tipi A dhe B, në moszbatim të Rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nr.120 prot., datë 12.01.2021, Kreu II.V, pika 1 dhe 3;

**3. -Për znj. F. Z.,** me detyrë specialiste për lejet mjedisore dhe VNM, lidhur me mangësitë në dokumentacionin për lejet mjedisore Tipi A dhe B, në kundërshtim me Rregulloren së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me Nr.120 prot. datë 12.01.2021 Kreu II.V, pika 1 dhe 3;

**4. -Për znj. P. V.,** me detyrë specialiste Burimeve Njerëzore/ protokoll- arkiv-magazinë, për mos ushtrim të detyrës sipas përcaktimit në "Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit" nr.120 prot., datë 12.01.2021, si dhe në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit" Kreu II.

(Trajtuar më gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pika 2,3 dhe pika 4 nga faqe 38-52)

#### **"Largim nga shërbimi civil" neni 58, pika ç.**

**1. -Për z. M. H.,** me detyrë inspektor i Sektorit Burimeve Natyrore Ujëra, për shkeljet e konstatuara në lidhje me inspektimin e subjekteve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", me nenin 19 të Ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; neni 24, pika 2 të Ligjit nr. 9115 "datë 24/07/2003" Për trajtimin mjedisor të Ujërave të ndotur" neni 23 pika ç, me nenin 48 të Ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 41, Neni 73 Shkarkimet në ujë, tokë nëntokë dhe neni 97.

**2. -Për z. B. F.,** me detyrë specialist i Sektorit të lejeve mjedisore VNM, i komanduar, në vitin 2023 inspektor pranë Sektorit të Burimeve Natyrore Ujërave, lidhur me shkeljet e konstatuara për dhënie mendime për VNM për lejet mjedisore Tipi A dhe B, në kundërshtim me "Rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" nr.120 prot., datë 12.01.2021 Kreu II.V, pika 1 dhe 3 e saj. Gjithashtu për shkeljet e konstatuara në lidhje me inspektimet e ushtruara në Sektorin e Burimeve Natyrore Ujëra, në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit", me nenin 19 të Ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; neni 24, pika 2 të Ligjit nr. 9115 " datë 24/07/2003" Për trajtimin mjedisor të Ujërave të ndotur" neni 23 pika ç, i ndryshuar me nenin 48 të Ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 41, Neni 73 Shkarkimet në ujë, tokë nëntokë dhe neni 97, Rregullores nr.01, datë 03.03.2017 "Për zbatimin e procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore".

**3. -Për z. P. T.,** me detyrë përgjegjës i Sektorit të Shërbimit dhe Financës, për problematikat e konstatuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e sistemit

financiar dhe kontrollin”i ndryshuar; me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**4. -Për z. A. Q.**, më detyrë inspektor pranë Sektorit të Burimeve Natyrore Ujëra për veprime të kryera në kundërshtim me Ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 të Ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”; nenit 24, pika 2 të Ligjit nr. 9115 “ datë 24/07/2003”Për trajtimin mjedisor të Ujërave të ndotur” neni 23 pika ç; me nenin 48 të Ligjit nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”; neni 41, Neni 73 Shkarkimet në ujë, tokë nëntokë dhe neni 97, si dhe të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” *Urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm nr.28, datë 17.04.2014* “Për miratimin e kodit të etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, pika 6.3-6.5-6.8-6.9; Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me nenin 46, pika 1-Rregullores së Brendshme nr.120, datë 12.01.2021, Neni 29 pika f). (Trajtuar më gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pika 2.3 dhe pika 2.4 nga faqet 67-74 ).

## **C.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi **5 (pesë)** personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “vërejtje” përkatësisht:

- Për **znj. F. B.**, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit të lejeve të Mjedisit.
- Për **znj.P. A.**, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit të lejeve të Mjedisit.
- Për **znj. E. B.**, me detyrë ish/përgjegjëse e Sektorit të lejeve të Mjedisit dhe VNM.
- Për **z. N. S.**, me detyrë ish/inspektor i Sektorit të lejeve të Mjedisit dhe VNM.
- Për **znj. A. N.**, me detyrë ish/inspektore e Sektorit të Mjedisit.

## **D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

### **Komenti i grupit të auditimit.**

Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion nga ana e AKM dhe ARM, si dhe shpjegimeve të dhëna nga ana e Institucionit (personat përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve), rezulton se janë ndërmarrë me vonesë veprimet e nevojshme dhe fillimi i procedurave për zbatimin e rekomandimeve në lidhje me masat disiplinore të rekomanduara nga KLSH. Më hollësisht, në

lidhje me rekomandimet për masat disiplinore të kërkuara për zbatim nga ana e KLSH-së sipas shkresës me Nr.108/9 Prot., datë 26.06.2024 (protokolluar në AKM Tiranë me nr. 7032 datë 27.06.2024), rezulton se nga ana e AKM ka patur vonesa të pajustificuara për trajtimin në afat të rekomandimeve dhe janë kryer këto procedura, të referuara në vijim:

- Sipas **memo-s me nr. prot. 7106, datë 02.07.2025**, hartuar nga ana e znj. B. B.- me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe znj. A. Z.- me detyrë përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Çështjeve Gjyqësore, konfirmuar nga Drejtori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse znj.E. O., dhe të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj.A. D. është dhënë një informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të ushtruar nga ana e KLSH-së në ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë. Në përfundim të kësaj memo-je është theksuar se ARM ka kompetencat për ngritjen e Komisionit Disiplinor dhe se ligji nuk përcakton detyrimin e organit epror për ngritjen e këtij Komisioni. Për këtë arsye, si dhe duke qenë se ARM nuk kishte dijeni që pjesa e masave disiplinore në Raportin Përfundimtar i është dërguar AKM-së, është propozuar ngritja e Komisionit Disiplinor nga ana e ARM-së, për të cilën dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së është shprehur dakord.
- Bazuar në sa më sipër, sipas **shkresës me nr 7106/1. prot., datë 02.07.2025**, me lëndë “*Delegim për kompetencë*”, përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, është përcjellë ARM-së Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH-së i kryer në vitin 2024 së bashku me masat e kërkuara për zbatim, me qëllim ngritjen e Komisionit Disiplinor për punonjësit, sipas kërkesave të KLSH-së.
- Me **shkresën me nr. prot. 7232, datë 07.07.2025**, me lëndë “*Kërkesë për interpretim*”, hartuar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, AKM Tiranë i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike një mendim nëse është kompetencë e ARM-së ngritja e Komisionit Disiplinor për marrjen e masave disiplinore sipas rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së. Në këtë kërkesë AKM ka nënvizuar faktin që “ARM-ja i ka të gjitha kompetencat që përcakton ligji për nëpunësin civil”; se “në ligj nuk përcaktohet detyrimi i organit epror për ngritjen e Komisioneve Disiplinore”; dhe se “eprori direkt i ARM-së duhet të vlerësojë rast pas rasti rëndësinë ose masën e shkeljeve të pretenduara ndaj nëpunëse dhe të kërkojë ngritjen e Komisionit Disiplinor”.
- Departamenti i Administratës Publike ka kthyer përgjigje me **shkresën me nr. 3670/1 prot., datë 10.07.2025**, (administruar në AKM Tiranë me nr. 7232/1, datë 11.07.2025), me lëndën “*Mbi kërkesën për interpretim*”. Departamenti i Administratës Publike në interpretimin e bërë ka shpjeguar se sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetues (vendimi nr. 11/2009), është përcaktuar se interpretimi i ligjit bëhet nga gjykata dhe jo nga institucionet publike. *Pavarësisht kësaj*, DAP ka bërë një vlerësim të parashtrimeve të dërguara nga AKM dhe në referim të nenit 59 (3), të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” me ndryshimet, “...në çdo institucion krijohet një komision i përhershëm disiplinor që përfshin të paktën një përfaqësues të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dhe një përfaqësues të DAP për institucionet e administratës shtetërore”.

VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, (ndryshuar me VKM nr. 437, datë 18.7.2018), në pikën nr.2 të tij përcakton, se:

“Komisioni disiplinor, për institucionet e administratës shtetërore, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka këtë përbërje: a) nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin; b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore; c) drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë

*nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore*; ç) një përfaqësues të DAP-it; d) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore”.

***Nga ana e KLSH-së evidentohet se, në kushtet që nga konkluzionet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit, është kërkuar dhënia e masës disiplinore edhe për Drejtorin e ARM-së si dhe Specialistin e Burimeve Njerëzore, formimi i Komisionit Disiplinor nga ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë bëhej i pamundur.***

Në arsyetimin e DAP , (shkresa nr. 3670/1 prot., datë 10.07.2025), thuhet se, “në rast se për shkak të organikës së institucionit si dhe pozicionit të punë së punonjësi për të cilin kërkohet procedimi nuk mundësohet ndërtimi i komisionit disiplinor me përbërje të plotë, i kërkohet institucionit epror caktimi i një përfaqësuesi në cilësinë e anëtarit të KD-së sipas pozicionit përkatës (*shiko pika nr. 22 e udhëzimit nr. 1/2025*) me qëllim plotësimin e përbërjes së saktë të komisionit”.

Më tej Departamenti i Administratës Publike ka vlerësuar se, “duke mbajtur parasysh faktin se institucioni juaj ka zhvilluar dhe më parë procedime disiplinore dhe është i njohur me aplikimin e institutit të disiplinës në shërbimin civil, vlerësojmë se, referuar rregullimeve të mësipërme, si dhe në kuadër të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, është i nevojshëm bashkërendimi midis degës territoriale (ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë) dhe organit publik qendror (AKM Tiranë) në drejtimin e marrjes së masave të nevojshme, për të vijuar me zhvillimin e ecurive disiplinore”

Në një situatë të tillë, Komisioni Disiplinor duhet të ishte ngritur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ose me një komision që mban në themel ***kombinimin midis degës territoriale dhe organit publik qendror***<sup>15</sup>. Grupi i auditimit të KLSH-së sjell në vëmendje se, në këtë mënyrë është vepruar për një rast tjetër nga ana e AKM Tiranë, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 141 datë 24.009.2021, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtim të një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë”, ku drejtimi i komisionit i është caktuar Drejtorit të Drejtorisë së Inspektim - Kontrollit në AKM Tiranë dhe pjesa tjetër e komisionit ka në përbërje zyrtarë të ARM-së).<sup>16</sup>

Në vijimësi, pas administrimit të përgjigjes së dhënë nga DAP, nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë zbatuar këto procedura për ngritjen e **Komisionit Disiplinor** për shqyrtimin e një ecurie disiplinore për **3 (tre) punonjësit**:

- Sipas shkresës nr. 7451 , datë 14.07.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.136, datë 14.07.2025), me objekt “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë”, është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit ***zj.P. V.***, me këtë përbërje: E.O., M.D., A.T., A.H. dhe një përfaqësues i DAP.
- Sipas shkresës nr. 7452 , datë 14.07.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.137, datë 14.07.2025), me objekt “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë”, është ngritur Komisioni

<sup>15</sup> - Referuar sipas interpretimit që DAP ka bërë me shkresën nr.3670, datë 10.07.2025, dërguar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit Tiranë.

<sup>16</sup> - Në këtë mënyrë është vepruar për një rast tjetër nga ana e AKM Tiranë, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 141 datë 24.009.2021, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtim të një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë”, ku drejtimi i komisionit i është caktuar Drejtorit të Drejtorisë së Inspektim - Kontrollit në AKM Tiranë dhe pjesa tjetër e komisionit ka në përbërje zyrtarë të ARM-së.

Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit **z.D. V.** me këtë përbërje: D.S., E.O., A.D., A.H. dhe një përfaqësues i DAP.

- Sipas shkresës nr. 7453 , datë 14.07.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.138, datë 14.07.2025), me objekt “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë”, është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit **z.P. T.** me këtë përbërje: E.O., M.D., A.T., A.H. dhe një përfaqësues i DAP.

Drejtori i ARM-së Fier, Vlorë e Gjirokastrë, z.A. T. i është drejtuar AKM-së me shkresën Nr. 1950 Prot. 15.07.2025, me lëndë: *“Kërkesë për ngritjen e Komisionit Disiplinor në AKM dhe shqyrtimin e masave disiplinore sipas rekomandimeve të KLSH-së, me nr.108/9 prot., datë 26.06.2024”*. Ndër të tjera në shkresë është nënvizuar se *“ARM nuk ka organikë të mjaftueshme për fillimin e ecurisë disiplinore, por edhe sikur organika të mjaftonte, shfaqja e konfliktit të interesave mes pozicionit të punës së punonjësve për të cilat kërkohet procedim dhe pjesëmarrja e tyre në KD pamundëson ndërtimin e Komisionit Disiplinor me përbërjen e tij të plotë.”* Për sa më sipër, ARM i ka kërkuar AKM-së në cilësinë e institucionit epror ngritjen e KD-së me qëllim plotësimin e përbërjes së saktë të Komisionit dhe ndjekjen e procedurave përkatëse brenda afateve ligjore”.

Në vijim të emailit të dërguar nga z. A. T., me detyrë Drejtor në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë në të cilën është kërkuar asistencë e AKM-së për ngritjen e komisioneve disiplinore AKM ka bërë më dije se ka vijuar me ngritjen e **Komisioneve Disiplinore** edhe për **4 (katër) punonjësit** e mëposhtëm:

- Sipas shkresës nr. 7533 , datë 16.07.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.148, datë 16.07.2025), me objekt “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë”, është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit **z. M. H.** me këtë përbërje: D.S., E.O., A.T., A. H. dhe një përfaqësues i DAP.
- Sipas shkresës nr. 7528 , datë 16.07.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.145, datë 16.07.2025), me objekt “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë”, është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit **z. T. Z.** me këtë përbërje: M.P., E.O., A.T., A.H. dhe një përfaqësues i DAP.
- Sipas shkresës nr. 7532, datë 16.07.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.147, datë 16.07.2025), me objekt “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë”, është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit **z. B. F.** me këtë përbërje: M.P., E.O., A.T., A.H. dhe një përfaqësues i DAP.
- Sipas shkresës nr. 7529, datë 16.07.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.146, datë 16.07.2025), me objekt “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e një ecurie disiplinore në ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë”, është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit **zj. F. Z.** me këtë përbërje: M.P., E.O., A.T., A.H. dhe një përfaqësues i DAP.
- Për punonjësin **z. A. Q.** AKM ka informuar se ka dalë në pension dhe masa konsiderohet e ezauruar. Konkretisht, sipas shkresës nr. 6716, datë 20.06.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.117, datë 20.06.2025), me objekt “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil”, rezulton se z.Q. është liruar nga detyra e Inspektorit në Sektorin e Burimeve Natyrore (Ujëra) për shkak të plotësimit të moshës së daljes në

pensionin e plotë të pleqërisë. Në funksion të kësaj praktike shkresore janë dhe Akti i Konstatimit për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të nëpunësit A.Q., që është mbajtur për këtë qëllim nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe shkresa e AKM me nr.6716/3, datë 20.06.2025 dërguar DAP dhe KMSHC për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil.

Referuar e-mailit të dërguar nga ana e Drejtorit të ARM-së Fier, Vlorë e Gjirokastrë z. A. T., (datë 26.7.2025, ora 11:12), konstatohet se janë njoftuar **11 (njëmbëdhjetë) punonjës** për fillimin e ecuresë disiplinore për masën “Vërejtje”, si vijon:

<i>Nr.</i>	<i>Masa disiplinore "Vërejtje", referuar nenit 58, pika a e ligjit "Për nëpunësin civil"</i>	<i>Njoftimi zyrtar i Drejtorit të ARM-së për fillimin e ecuresë disiplinore, dhe për ijëni Drejtori i Përgjithshëm i AKM Tiranë</i>
1.	Për <b>z. J. V.</b> , me detyrë specialist i Sektorit të përpunimit të dhënave, i deleguar pranë Sektorit të lejeve mjedisore, për periudhën objekt auditimi.	Njoftimi sipas shkresës me nr.1998, datë 23.07.2025
2.	Për <b>zj.K. Xh.</b> me detyrë specialiste e Sektorit të përpunimit të dhënave, e deleguar pranë Sektorit të lejeve mjedisore, për periudhën objekt auditimi	Njoftimi sipas shkresës me nr.2002, datë 23.07.2025
3.	-Për <b>z. G. Zh.</b> , me detyrë specialist i Sektorit të përpunimit të dhënave, i deleguar pranë Sektorit të lejeve mjedisore, për periudhën objekt auditimi	Njoftimi sipas shkresës me nr.1999, datë 23.07.2025
4.	Për <b>z. A. G.</b> , me detyrë specialist i Sektorit të përpunimit të dhënave, i deleguar pranë Sektorit të lejeve mjedisore, për periudhën objekt auditimi.	Njoftimi sipas shkresës me nr.2000, datë 23.07.2025
5.	Për <b>z. A. H.</b> me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mjedisit.	Njoftimi sipas shkresës me nr.2007, datë 23.07.2025
6.	Për <b>z. E. Sh.</b> , me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.	Njoftimi sipas shkresës me nr.2005, datë 23.07.2025
7.	Për <b>z. A. C.</b> , me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.	Njoftimi sipas shkresës me nr.2006, datë 23.07.2025
8.	-Për <b>Z. E. Z.</b> , me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit	Njoftimi sipas shkresës me nr.2004, datë 23.07.2025
9.	Për <b>z. L. I.</b> me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.	Njoftimi sipas shkresës me nr.2008 , datë 23.07.2025

10.	Për <b>z. E. B.</b> , me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.	<i>Liruar nga detyra sipas urdhrorit nr.6, date 14.01.2022, ezauroar masa disiplinore</i>
11.	-Për <b>z. I. M.</b> me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Natyrore Ujëra	Njoftimi sipas shkresës me nr.2003 , datë 23.07.2025
12.	-Për <b>z. A. Xh.</b> , me detyrë Inspektor i Sektorit të Mjedisit.	Njoftimi sipas shkresës me nr.2001, datë 23.07.2025

### **Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:<sup>17</sup>**

**Statusi: i pranuar, në proces zbatimi.**

### **VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:**

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresat me shkresat Nr.108/8 Prot., Nr.108/9 Prot. datë 26.06.2024 konstatohet se një pjesë e madhe e tyre paraqitet e zbatuar pjesërisht ose në proces zbatimi. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Sektori i Mjedisit, në 6 raste ndaj subjekteve me veprimtari të ndryshme ka dhënë masa administrative me dënim kryesor *Paralajmërim*, për mosparaqitje dhe zbatim të kushtit 3.29. Monitorimi, për Vlerësim me Ndikim në Mjedis VNM pranë AKM-së, (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr.61 të Raportit të mëparshëm të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Mjedisit të planifikojë inspektime për zbatimin e detyrave të lëna për plotësimin e kushteve të lejes mjedisore, për subjektet: “Hotel S.”, Nipt K.....O; “I.”, Nipt J.....D; “L.”, Nipt K.....K; “M&K”, Nipt L.....E; “Bashkia Lushnje”, Nipt K.....L; “A. M.”, Nipt K.....U.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, nuk ka bazë të dhënash të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit bazuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut, në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2, nenet 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”. Po ashtu, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut dhe frekuencën

<sup>17</sup> - Masa disiplinore për dy punonjës të larguar është konsideruar e ezauroar/ realizuar. Konkretisht, Referuar shkresës së AKM me nr. 6716, datë 20.06.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.117, datë 20.06.2025), me objekt “Për përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil”, 1 masë konsiderohet e ezauroar, meqenëse nëpunësi **A.Q.** ka ndërprerë marrëdhëniet e punës (mbushja e moshës së pensionit të plotë të pleqërisë). Referuar shkresës së ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë, me nr. 6716, datë 20.06.2025, (urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKM nr.6, datë 14.01.2022), me objekt “Për lirim punonjësi”, 1 masë konsiderohet e ezauroar, meqenëse nëpunësi **E.B.** ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare.

e inspektimit gjatë një viti të subjekteve që do të inspektohen. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2.faqe nr. 63-66 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim me sektorin e Mjedisit dhe të sektorit të Burimeve Natyrore (Ujëra), të marrë masa për krijimin e regjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt në sistemin E-Inspektim.

**Menjëherë**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga sektorit i Burimeve Natyrore (Ujëra) rezultoi se, në sistemin *on-line* E-inspektim mungon dokumentacioni i duhur ligjor për 33 subjekte të konstatuara me shkelje, në kundërshtim me Ligjin nr.9115 “Për trajtimin mjedisor të Ujërave të ndotura”, datë 07.04.2003, Ligjin Nr.111/2012 “Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, neni 30 “Shkarkimet industriale dhe trajtimi i tyre”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqe nr.67-70 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

**3. Rekomandimi:** Drejtori i Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Natyrore (Ujëra) për 33 subjektet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të mëparshëm, të cilat nuk kanë dokumentacionin e plotë ligjor në sistemin E-inspektimit të marrë këto masa:

**3.1.** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të përcjellë listën e këtyre subjekteve pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizime, për të kryer inspektimet përkatëse për monitorimin dhe inspektimin e zbatueshmërisë së standardeve mjedisore të ujërave, krahas monitorimeve sipas Aktit Normativ nr. 8, datë 28.12.2023, “Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”.

**3.2.** Strukturat e ARM-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, të marrin masat që të koordinohen veprimet me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe *Task Forcë-n* e ngritur, referuar edhe shkresës së Inspektoratit Qendror me nr. 374/1, datë 30.08.2023, “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushë veprimtarinë inspektuese të mjedisit, për Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.

**Menjëherë**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 43 praktikave për leje mjedisi Tipi A/B, janë dhënë mendime pozitive nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të përcjella Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe pse nga auditimi i tyre rezultojnë me mangësi në dokumentacion.

-Gjithashtu për 17 aplikime është tejkualuar afati 10 ditor për dhënien e mendimit, veprime në kundërshtim me VKM nr.419, datë 25.06.2014 si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”, Kreu III, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.38-52 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Sektori i Lejeve pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të rishqyrtojë dokumentacionin për dhënie mendimi Leje Mjedisore të Tipit A/B, për 43 rastet e trajtuara në Raportin e Auditimit, në respektim të kriterëve dhe afateve të legjislacionit në fuqi dhe në përfundim të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e bërë për saktësinë e paraqitjes së llogarisë 31 “Materiale” rezultoi se në mbyllje të vitit 2022 paraqitet e pandryshuar në vlerën 61,469 lekë, krahasuar me periudhën e mëparshme.

-Nga verifikimi dhe kontrolli i dokumentacionit vërtetues (fletëhyrje dhe fletëdalje) rezultoi se, në mbyllje të vitit 2022 gjendja kontabël e llogarisë 31 “Materiale” paraqitet në vlerën 560,187 lekë, vlerë e cila rakordoi me gjendjen fizike të materialeve gjendje në magazinë, bazuar në kontrollin e ushtruar në magazinën e institucionit, dhe se kjo vlerë nuk rezulton e pasqyruar në bilanc.

-Nuk ka akt rakordim në fund të çdo muaji/viti të mbajtur midis magazinierit dhe përgjegjësit të financës për gjendjen për çdo zë të këtyre aktiveve, duke ndikuar kështu në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar të klasës 3, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 pika 52, 53.

-Nga verifikimi i shënimeve shpjeguese në lidhje me këto zëra, nuk ka të dhëna në lidhje me politikat që përdoren nga ana e subjekteve për vlerësimin e tyre, ashtu siç përcaktohet në SKK 4 “Inventarët”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 18-19 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

### **5.1.Rekomandimi:**

Të merren masat nga ana e Sektorit të Financës që të sigurohet mbajtja e rakordimeve periodike mujore dhe vjetore për të gjitha zërat e aktiveve materiale ndërmjet magazinierit dhe sektorit të financës, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël dhe për të evidentuar gjendjen reale në kontabilitet të llogarisë 31 “Materiale” dhe llogarisë 32 “Inventari i imët”.

Sa më sipër, Librat e magazinës dhe kartelat përkatëse të kundërfirmosen nga personat përgjegjës për kontrollin material dhe financiar, në mënyrë që të garantohet integriteti dhe transparenca e të dhënave kontabël.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga analizimi i vlerës së llogarisë 218 “Inventar ekonomik” rezulton të jetë paraqitur me vlerë më pak për 110,304 lekë.

- Pakësimet në vlerën 241,920 lekë të cilat janë ç’regjistruar nga kontabiliteti, më parë se nga data e bërjes dalje të këtij aktivi, në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” pika 32; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, pika 39.

-Nga llogaria 218 “Inventar ekonomik” janë transferuar (pa pagesë) aktive në shumën 769,424 lekë tek Administrata e Zonave të Mbrojtura Divjakë, të cilat sipas listës rezultojnë në kontabilitetin e njësisë, nuk janë bërë dalje, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, në kundërshtim me pikat 34, 39,43,55.

-Një pjesë të aktiveve të regjistruar në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” janë pajisje kompjuterike në vlerën 1,399,746 lekë të cilat janë përlllogaritur drejt me 25%, por jo në llogarinë 218 “inventar ekonomik”. Gjithashtu në këtë zë të aktivitetit rezultojnë pajisje kompjuterike në vlerën prej 3,328,098 lekë, për të cilat nuk është zbatuar norma e amortizimit 25%, por janë llogaritur në grup me 20%, në mosrespektim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,2. faqet 25-27 të Raportit të mëparshëm të Auditimit)

**6.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masa për ri paraqitjen e saktë të llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” si dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme për pasqyrimin e saktë të amortizimit të përlllogaritur për zërat e aktiveve të institucionit.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastrë, në 5 raste u konstatuan parregullsi në dokumentacionin bashkëlidhur, në sistemin E-inspektim, konkretisht:

- për 2 subjekte mungon plani i rehabilitimit;
- për 1 rast raportet e vet monitorimit/monitorimit vjetor;
- për 2 raste dokumentacioni bashkëlidhur është pa nr. protokollin të AKM-së, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “*Për Mbrojtjen e Mjedisit*” Seksioni 2, Neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit” si dhe me Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2. faqet 57-58- të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

#### **7.Rekomandimi:**

**7.1.ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë** të njoftojë zyrtarisht Agjencinë Kombëtare të Mjedisit / Inspektoratin Qendror për përfshirjen në programet e tyre, inspektimi i zbatimit të kushteve të lejes mjedisore, për subjektet që nuk mund të inspektohen nga ana e ARM-së për shkak të konfliktit të interesit, në mënyrë që kryerja e procedurave të delegohet menjëherë te një strukturë e paanshme. Në këtë kuadër, të kërkohet kryerja e inspektimit për zbatimin e kushteve të lejes mjedisore për subjektin "C." shpk.

**7.2.**Të përmirësohet mekanizmi i sistemit të kontrollit të brendshëm për menaxhimin e rasteve me konflikt interesi, për të garantuar që asnjë subjekt të mos mbetet jashtë mbikëqyrjes ligjore në fushën e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

**7.3.**Të dokumentohen të gjitha komunikimet dhe veprimet e ndërmarra nga ana e institucioneve shtetërore (si pjesë e gjurmës së auditimit për këtë çështje), në përputhje me kërkesat e kuadrit të transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në Sektorin e Mjedisit u konstatua se në 6 subjekte, (nga të cilat 4 subjekte për nxjerrjen e mineraleve, rërë-argjilës nga karrierat në qiell të hapur dhe nga guroret si dhe 2 subjekte me veprimtari të ndryshme), inspektorët në procesverbal kanë cituar se: “*subjekti u gjend i mbyllur*”, ose nuk kryen aktivitetet. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit.

-Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKB-së;

-Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe me institucione të tjera, veprime jo në përmbushje të Nenit 36- *Detyrimet e subjektit të inspektimit*, pika “d”; me Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “*Për Mbrojtjen e Mjedisit*” Seksioni 2, neni 62-66 “*Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit*” si dhe me Ligjin Nr.10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, Nenin 45-48; Nenin 11 “*Parimi i përgjegjësive së ndërsjellë dhe bashkëpunimi*” të Ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011“*Për Mbrojtjen e Mjedisit*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4.2, faqe nr.60-62, të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB me qëllim që të hartojnë dhe nxjerrjen e autorizimeve për kryerjen e inspektimeve ndaj subjekteve, nëse janë aktiv si subjekte ose në të kundërt të merren masa administrative (gjobë) sipas legjislacionit në fuqi.

**Menjëherë**

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga Sektorit i Burimeve Natyrore (Ujërave) rezultoi se, për 3 subjekte nuk janë hartuar vendimet përfundimtare sipas procesverbaleve të shkeljeve të konstatuar, në kundërshtim me Ligjit Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, i ndryshuar, si dhe Nenin 23 të Ligjit nr. 9115/2003 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të ndotur”, Neni 42-46. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.66-67 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

**9.1.Rekomandimi:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të kryejë inspektimin në subjektin “K.” sipas autorizimit të lëshuar pas auditimit të ushtruar nga ana e KLSH-së dhe të realizojë inspektimin brenda një afati të përcaktuar kohor. Për më tej, për të shmangur vonesa të ngjashme në të ardhmen, rekomandohet që Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërat), të hartojë një plan të balancuar pune që të marrë në konsideratë burimet në dispozicion, ngarkesën aktuale, si dhe rastet e pazbatuara nga planet e mëparshme, duke përfshirë kritere risku për përzgjedhjen e subjekteve.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se përgjegjësi i Sektorit të Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore (Ujërave) nuk ka hartuar dhe paraqitur periodikisht pranë Titullarit një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, për verifikimin e detyrave të lëna. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,4, faqe 62-64 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të marrë masa që në fund të çdo muaji, në bashkëpunim me Sektorin e Mjedisit dhe të Burimeve Natyrore (Ujërave), të hartojnë dhe të paraqesin pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një raport mbi situatën dhe nivelin e realizimit të kushteve të lejeve të paplotësuara nga subjektet, me qëllim miratimin e planeve mujore për verifikimin e detyrave të lëna.

**Në vijimësi**

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inspektimeve të kryera nga sektori i Burimeve Natyrore (Ujëra) u konstatua se:

-Në 5 subjekte nuk janë kryer inspektimet për arsye pengimi nga subjekti i inspektuar.

-Në 3 subjekte nuk është finalizuar me marrjen e masës për mbyllje të aktiviteti, në kundërshtim me Ligjin nr.9115 “Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të ndotura”, Neni 23, ç; Ligji nr.111/2012, datë 11/15/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, Neni 97, pika 1 “Shkarkimi në mjedis i ujërave të përdorura”. (Më hollësisht trajtuar në pikën,4.2. faqe nr.67-67 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

Nr.	Emri i subjektit	Aktiviteti	Vlera e gjobës 000/në lekë	Nr.Seri sipas Proc.Verb. të dënimit me gjobë	Data e Vendimit të dënimit me gjobë
1.	D.....F.....	Prodhim dhe tregim të materialeve inerte	10,000	AKM-FR-2021-000057	30/06/2021
2.	T... A...	Mbarështimi i kafshëve në fermat	100,000	AKM-FR-2021-000045	09/06/2021
3.	E.....	Ndërtim dhe rikonstruksion	10,000	AKM-FR-2021-000061	21/06/2021
4.	K....K.....	Akuakulturë	100,000	AKM-FR-2021-000146-	18.10.2021
5.	M.....E.....	Hec	100,000	AKM-FR-2021-000146-	13.08.2021

**11.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të kryejë inspektimin e subjektit “K. K.”, programuar sipas autorizimit nr.2072, datë 04.08.2025 (pas kryerjes së auditimit nga ana e KLSH-së), si dhe të realizojë inspektimin brenda një afati të përcaktuar kohor. Për të shmangur vonesa të ngjashme në të ardhmen, rekomandohet që Sektori i Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërat), të hartojë një plan të balancuar pune që të marrë në konsideratë burimet në dispozicion, ngarkesën aktuale, si dhe rastet e pazbatuara nga planet e mëparshme, duke përfshirë kriteret e rrishtit për përzgjedhjen e subjekteve.

**Menjëherë**

**12 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i inventarizimit të pronës shtetërore u konstatua se, për asnjë vit të periudhës audituese nuk është kryer inventarizimi i aktiveve dhe pronës publike për Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastrë, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr.32-39 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

### **12.1.Rekomandimi:**

Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me përgjegjësin e Sektorit të Shërbimit dhe Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrin masat për kryerjen në kohë të procesit të inventarizimit të plotë të pronës shtetërore dhe të vlerësimit të aktiveve që disponon institucioni, si dhe paraqitjen e saktë të rezultateve të inventarizimit në pasqyrat financiare të njësive. Nëpunësi zbatues të marrë masa të menjëhershme për krijimin e regjistrimit të aktiveve të institucionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në Agjencinë Rajonale Fier, Vlorë, Gjirokastrë, mbi pasqyrat financiare rezultoi si më poshtë:

1.Pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar në Drejtorinë e Tatimeve Fier nëpërmjet sistemit C@ts, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, pika 3.12. “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit” në lidhje me depozitimin on-line të pasqyrave financiare brenda afateve ligjore deri me 31 mars të çdo viti pasardhës.

2.Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin, në mosrespektim të kërkesave të Nenit 3, pika 1 të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Kreu

II, Dispozita të Përgjithshme mbi Dokumentet Kontabël dhe Pasqyrat Financiare Neni 6, Mbjajta e kontabilitetit, Neni 7 Dokumenti kontabël; Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II, 2.1 “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 2.2; Kreu III Paragrafi 43.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike në *exel* me vlera, por nuk janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës, etj, në të cilat regjistrohen të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike të marra nga dokumentet bazë të bankës, magazinës; nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë.

-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël, të cilat shërbejnë si bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike, të marra nga dokumentet vërtetuese.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 17 të Raportit të Auditimit)*

**13.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të sigurojë plotësimin e librave sintetikë të llogarisë që janë baza për hartimin e bilancit vërtetues (verifikues), përpara plotësimit të Pasqyrave Financiare të Llogaridhënies Vjetore të ARM-së. Kjo kërkon veprime të strukturave menaxheriale me qëllim shmangien e vonesave për plotësimin në afat të librave bazë sintetikë të llogarive (mastro ose centralizator) dhe siguruar kronologjinë dhe gjurmët e veprimeve ekonomike në informacionin financiar të raportuar.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” del se, në mbyllje të vitit 2021 dhe vitit 2022 është 0 lekë. Nga verifikimi i bërë dhe nga analizimi e kësaj llogarie rezulton se në mbyllje të bilancit vjetor 2020 është 83,180 lekë dhe paraqet detyrimin e dëmit ekonomik lënë nga Raporti i Auditimit të KLSH-së viti 2018 dhe i përket 2 ish punonjësve (2x 41,590 lekë), të cilët rezultojnë të larguar para vitit 2018 dhe konfirmohet se janë detyrime të pa likuiduara edhe gjatë periudhës së auditimit. Si rrjedhim, vlera e detyrimit nga të tretët rezulton e hequr padrejtësisht nga kontabiliteti i njësisë dhe duhet pasqyruar në periudhën në vijim. Veprimi në kundërshtim me UMFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III 3.1 Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme pika 32. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqet 19-20 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).*

**14.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës të ri paraqesë në llog.468 “Debitorë të ndryshëm” vlerën 83,180 lekë, pasi është kontabilizuar shuma prej 72,180 lekë dhe jo vlera e plotë e detyrimit sipas rekomandimit të KLSH-së si dhe evidentimin e këtij detyrimi në Pasqyrat Financiare të Llogaridhënies Vjetore të vitit 2024, krahas marrjes së masave të duhura ligjore për arkëtimin e vlerës.

**Menjëherë**

**15.Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione” rezultoi se, përbëhet nga vlera e 5 godinave në kosto historike në total për 9,512,610 lekë marrë nga ISHMPUT Fier nga procesi i ristrukturimit sipas Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrisë të MTM-së “Kalim në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve dhe inventarit ekonomik të ISHMPUT Qendër

dhe degëve rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM” dhe se nuk është pasqyruar realisht vlera e aktiveve në pronësi të subjektit pasi:

a) Në gjendjen e llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione” përfshihen tre godina në kosto historike vlerë 5,652,686 lekë, të cilat duhet t’i kishin kaluar IKMT-së, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të MTM-së. Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë janë bërë kërkesa për kalimin e 3 godinave, referuar Urdhrit të Ministrit të MTM-së, por nuk është sqaruar përfundimisht.

Nga ana e Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë nuk është insistuar më për sqarimin me ministrinë përgjegjëse nga ajo varet, me MTM, në lidhje me zbatimin e Urdhrit të Ministrit të MTM-së Nr.54 datë 24.02.2020, në mosrespektimin me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, *Kreu (II), pika (16): Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik pika 16.*

b) Nga verifikimi i titujve të pronësisë të këtyre aktiveve, rezultoi se nuk ka certifikata për vërtetimin pronësie e për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur dhe nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2. faqe 21-22 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).*

**15.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të saktësojë dhe kalojë në pronësi të Inspektoratit Kombëtar të Mbrotjtjes së Territorit, tre godina me kosto historike në vlerën 5,652,686 lekë, në zbatim të Urdhrit Nr.54, datë 24.02.2020 të Ministrit të Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, duke bërë dhe sistemimin kontabël të kësaj vlere në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”.

**Menjëherë**

**15.2.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të ngrejë grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të aseteve në pronësi e në përdorim dhe të përshpejtojë veprimet për realizimin pa vonesa të regjistrimit të pronave në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

**Menjëherë**

**16.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi për dhënien e mendimit të VNM-ve paraprahe/të thelluar u konstatua se mendimi dërgohet elektronikisht nga specialisti në adresën e drejtuesit të institucionit për t’u nënshkruar elektronikisht dhe për t’u ngarkuar më tej në sistemin E-Leje. Si pasojë e sulmit kibernetik të ndodhur në Shqipëri në muajin korrik 2022, çdo korrespondencë në formë elektronike (specialistë-titullar institucioni) para kësaj periudhe është fshirë (konfirmuar me e-mail nga 20 shkurt 2024), veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, Neni 17/b. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr.36-38 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).*

**16.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të marrë masa që specialistët e lejeve mjedisore të aplikojnë në *sistemin e-albania*, për tu pajisur me nënshkrim elektronik të gjithë Specialistëve të sektorit të lejeve mjedisore dhe VNM-ve që ende nuk janë pajisur me këtë nënshkrim, me qëllim plotësimin e strukturës së dokumentit elektronik.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**17.Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i të dhënave, në lidhje me strukturën e miratuar sipas Urdhrit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, Rregullores nr.120 prot, datë 12.01.2021, rezulton se: Në fund të vitit 2021, struktura paraqitet me realizim në masën 87,5% dhe numri i vendeve të lira 6; në fund të vitit 2022, struktura paraqitet me realizim në masën 75% dhe numri i vendeve të lira 12; në fund të vitit 2023 struktura paraqitet me realizim në masën 69% dhe numri i vendeve të lira 15, pra kjo drejtori ka vepruar vetëm me rreth 77% të kapacitetit të saj, duke sjell ulje të efektivitetit dhe efikasitetit në punë për njësinë.

b) Në lidhje me auditimin e ushtruar për plotësimin e dosjeve të personelit, u përzgjedhën 15 dosje ku rezultoi se dosjet e personelit nuk kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, në kundërshtim me VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrimit Qendror të Personelit” II. Dosja e personelit.- Nuk kanë rregullshmëri në pasqyrimin dhe renditjen sipas inventarit si edhe mënyrës së mbajtjes pranë zyrës së Burimeve Njerëzore.

-Për punonjësit e larguar mungonte akti i dorëzimit të dokumentacionit dhe punës përpara largimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.85-89 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

**17.1.Rekomandimi:** Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrin masa për plotësimin e vendeve të lira të punës pasi janë 3 (tre) vende vakante si dhe specialisti i burimeve njerëzore, të plotësojë mangësitë e dosjeve të personelit.

**Në vijimësi**

**18.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 14 procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në 13 prej tyre, të realizuara në rrugë shkresore kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion:

-në 6 raste mungojnë procesverbalet e marrjes në dorëzim, ndërsa në 7 raste të tjera procesverbalet përkatëse nuk janë të nënshkruara, nga të gjithë anëtarët e komisionit të marrjes në dorëzim, kjo në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 43,47,54.

Në 1 procedurë të prokurimit publik, të realizuar në sistemin elektronik rezultoi se kriteret e përgjithshme dhe specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe të VKM-së nr.285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.85-89 të Raportit të mëparshëm të Auditimit).

**18.1.Rekomandimi:** Titullari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë, të vlerësojë përfundimet e grupit të punës të ngritur sipas urdhrit nr.21, datë 17.07.2025 të Drejtorit për analizimin e 14 rasteve në shkelje të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, dhe të propozoj masa konkrete për anëtarët e komisionit të prokurimit, bazuar në Raportin me nr. 1974/1 datë 21.07.2025 “Raport përfundimtar i grupit të punës për analizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në zbatim të urdhrit të brendshëm nr.21, datë 17.07.2025”, të hartuar për këtë qëllim.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**18.2.Rekomandimi:** Titullari i Institucionit të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve që zhvillon ASPA, me qëllim përmirësimin e punës së Njesisë së Prokurimit për hartimin e dokumentacionit dhe zbatimin e procedurave konform rregullave të prokurimit publik. Referuar kërkesave të shkresës së APP me nr. 6067 prot, datë

03.09.2024 dërguar Autoriteteve/Enteve Kontraktore, personat e ngarkuar me realizimin e procedurave të prokurimit publik në ARM Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë të marrin masat për ndjekjen në vijimësi të trajnimeve me qëllim përmirësimin e punës së Njësisë së Prokurimit për hartimin e dokumentacionit dhe zbatimin e procedurave dhe të rregullave të prokurimit publik.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## **B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nga Titullari i Institucionit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, sipas rasteve. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të bëjë sistemimet e veprimeve ekonomike për detyrimet e dëmit në vlerën **860,524 lekë**, e cila vjen nga:

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve me bankë kanë rezultuar shkelje dhe parregullsi të kuadrit ligjor përkatësisht, si më poshtë:

**1.** Në shumën e përlogaritjeve për pagën e z. M. H., rezulton se është paguar **16,398 lekë** më shumë se sa duhet. Kjo diferencë duhet të rikthehet në llogarinë e institucionit, në mosrespektim me Udhëzimin Nr. 1, datë 21.05.2021 “Për formën, elementët dhe plotësimin e liste pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 13.

**2.** Në periudhën 2021-2023, janë likuiduar gjoba në shumën e 80,000 lekë (16x5,000 lekë) për deklaram të vonuar të tatimit të mbajtur në burim dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të gjeneruara automatikisht nga sistemi elektronik i tatimeve. Shuma prej **80,000 lekë** ka rënduar padrejtësisht buxhetin e institucionit, pasi vjen si rezultat i neglizhencës së NZ dhe duhet të kthehet në llogarinë e institucionit, veprim ky në kundërshtim me Nenin 35 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. (sipas tabelës anekse nr.36).

**3.** Janë likuiduar detyrime të prapambetura për energji elektrike për periudhën 2020-2023 në shumën 614,107 lekë, nga e cila shuma prej 139,532 lekë rezulton kamatë vonesë. Likuidimi i tyre është rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve ligjore për pagesën e detyrimeve për energji elektrike, siç parashikohet në pikën 151 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, dhe në Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, pika 3, Shuma e kamatës **139,532 lekë**, konsiderohet dëm dhe duhet kthyer në llogarinë e institucionit, përgjegjësi e së cilës janë drejtori aktual, z. D. V. dhe përgjegjësi e financës, z. P. T.

**4.** Janë likuiduar detyrime për marrje ambienti me qira në shumën **66,000 lekë** (56,600 lekë detyrim+9,900 lekë Tatim i mbajtur në burim) sipas Kontratës së qirasë nr.1036 prot., datë 28.07.2020 për një ambient, mjedis pune në Gjirokastrë, e cila nuk përmbush elementët ligjorë të një kontrate të vlefshme, pasi nuk është nënshkruar nga pala qiradhënëse, në kushte të mosrespektimit të nenit 801 të Kodit Civil. Gjithashtu likuiduar edhe tatimi i mbajtur në burim, ndërsa neni 11 i kontratës e përcakton si detyrim të palës qiradhënëse. Nuk konfirmohet të jetë lidhur kontratë tjetër pas kësaj dhe pagesa nga sektori i financës ka vazhduar deri në vitin 2021. (sipas tabelës anekse nr.37).

**5.**Janë paguar shpenzime udhëtimi në shumën **137,800 lekë** si pasojë e mënyrës së llogaritjes gabim dhe mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (pa aktkontroll/procesverbal konstatimi), në kundërshtim me Nenin 4, pika 26 e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar

dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, (sipas tabelës anekse nr.39). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.88-89 të Raportit të Auditimit).*

### **1.1.Rekomandimi:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të arkëtojë detyrimet për z. M. H. në vlerën 16,398 lekë; z. P. T. në vlerën 215,766 lekë; z. D. V. në shumën 69,766 lekë dhe vlerën prej 137,800 lekë (19 persona sipas tabelës anekse) të cilat në total arrijnë në vlerën prej **439,730 lekë.**

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për furnizimin me karburant në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë për periudhat 2021-2022 rezultuan parregullsi si më poshtë:

-Mungesë e dokumentacionit të plotë vërtetues dhe të rregullt (fletëhyrje dhe fletëdalje) si dhe të pashoqëruara me dokumente justifikuese, në kundërshtim me kërkesat ligjore në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë sektorit Publik”, i ndryshuar, pikat 37,38.

-Për vitin 2022, sasia 1,772 litra karburant (naftë), në vlerë 420,794 lekë, është e pajustificuar me dokumentacion vërtetues, fletë udhëtim, veprime në kundërshtim me pikën 36 të UMFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, duke shkaktuar dëm financiar dhe duhet kthyer në buxhetin e shtetit.(sipas tabelës Anekse nr. 43). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe nr.89-92 të Raportit të Auditimit).*

### **2.1.Rekomandimi:**

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë të arkëtojë shumën në total **420,794 lekë** për përdorim të karburantit (naftë), e pajustificuar me dokumentacion vërtetues, fletudhëtim, nga z. D. V. në cilësinë NA, z. P. T. në cilësinë NZ dhe z. B. D. me detyrë shofer në strukturën organizative.

**Menjëherë**

## **C. MASA DISIPLINORE**

### **1.1.Rekomandimi:**

Për 18 masat disiplinore të rekomanduara të cilat rezultojnë të pazbatuara, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit të merren masat për kryerjen e procedurave të plota të hetimit administrativ dhe të ecurisë nga Komisionet Disiplinore të ngritura për këtë qëllim nga ky institucion i administratës shtetërore duke vlerësuar elementet kryesore proceduriale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore, në zbatim të plotë të kuadrit ligjor në fuqi për vendimmarrjen në një procedure disiplinore dhe rregullave të përcaktuara në Udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike nr. 1, datë 21.01.2025.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

### **2.1. Rekomandimi:**

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë të njoftojë zyrtarisht Agjencinë Kombëtare të Mjedisit mbi rezultatet e përfundimit të ecurisë disiplinore, të iniciuar sipas shkresave të njoftimit për fillimin e ecurisë disiplinore të Drejtorit të ARM Fier, Vlorë e Gjirokastrë, me nr.1998 deri nr.2008, datë 23.07.2025. Njësia e Burimeve Njerëzore të pasqyrojë masat disiplinore në dosjet personale të nëpunësit dhe të vijojë me hedhjen në Regjistrin Qendror të Personelit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e tyre.

**D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit që do të jepen masa disiplinore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Për sa më sipër u mbajt ky Raport Auditimi.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

#### 4. ANEKSE

#### Përmbledhëse e masave sipas llojit për 4-auditimet e kryera.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuara											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar <sup>18</sup>		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ																				
2	Masa organizative	60		60				100%		14		21		15							
3	Masa shpërblim dëmi	2		2	860			100%						2		14	846	23			
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
5	Për eliminimin e efekteve ....																				
6	Masa disiplinore	53		53				100 %		22				18							
7	Masa Administrative																				
<b>TOTALI</b>		115	-	115	860			100 %		36		21		35		14	846	23			

<sup>18</sup> Përfshirë dhe dy masat disiplinore të ezauruara, nga dalja në pension dhe lirimi nga detyra e një punonjësi

## Aneksi nr. 1

### PËR AUDITIMIN ME TEMË “BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE, PËRMES PËRFSHIRJES NË TREGUN E PUNËS”

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuara												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislacioni																					
2	Masa organizative	11		11				100%		1		6						4				
3	Masa shpërblim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve ....																					
6	Masa disiplinore																					
7	Masa Administrative																					
<b>TOTALI</b>		<b>11</b>		<b>11</b>				<b>100 %</b>		<b>1</b>		<b>6</b>						<b>4</b>				

## Aneksi nr. 2

### PËR AUDITIMIN ME TEMË “MBËSHËTETJA FINANCIARE E STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE NËPUNËSVE CIVILË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE” (FONDI I EKSELENCËS), NË MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT.

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuara												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ																					
2	Masa organizative	7		7				100 %		1		2		4								
3	Masa shpërblim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve																					
6	Masa disiplinore	28		28				100 %		15									13			
7	Masa Administrative																					
<b>TOTALI</b>		<b>35</b>	<b>-</b>	<b>35</b>	<b>-</b>		<b>-</b>	<b>100 %</b>		<b>16</b>		<b>2</b>		<b>4</b>					<b>13</b>			

### Aneksi nr. 3

**PËR AUDITIMIN ME TEMË “RESPEKTIMI I STANDARDEVE NË MENAXHIMIN E MBETJEVE URBANE, SFIDË E QËNDRUESHME NË ZVOGËLIMIN E NDOTJES SË MJEDISIT DHE MBROJTJEN E SHËNETIT TË POPULLSISË”, NË BASHKITË SHKODËR, DURRËS, VLORE E KORÇË.**

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi I rekomandimeve te pranuara												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne gjyq proces		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ																					
2	Masa organizative	10		10				100 %				5		3					2			
3	Masa shpërblim dëmi																					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve																					
6	Masa disiplinore																					
7	Masa Administrative																					
<b>TOTALI</b>		<b>10</b>		<b>10</b>				<b>100 %</b>				<b>5</b>		<b>3</b>					<b>2</b>			

## Aneksi nr. 4

### PËR AUDITIMIN PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË NË AGJENCITË RAJONALE TË MJEDISIT FIER, VLORË DHE GJIROKASTËR.

Përmbledhëse e masave sipas llojit.

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomanduar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranuar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuara												
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Zbatuar <sup>19</sup>		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq		
										Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtuar	Mbetja	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislatoni																					
2	Masa organizative	32		32				100%		12		8		8				4				
3	Masa shpërblim dëmi	2		2				100%						2		14	846					
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																					
5	Për eliminimin e efekteve ....																					
6	Masa disiplinore	25		25				100%		7				18								
7	Masa Administrative																					
<b>TOTALI</b>		<b>59</b>		<b>59</b>				<b>100 %</b>		<b>19</b>		<b>8</b>		<b>28</b>				<b>4</b>				

<sup>19</sup> -Përfshirë dhe dy masat disiplinore të ezazuara, nga dalja në pension dhe lirimi nga detyra e një punonjësi

